RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

AGJENCINË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE (AMVV).

Tiranë, 08 Maj 2020

	PËRMBAJTJA E LËNDËS	**Faqe**
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3 - 7**
II.	**HYRJA (Të dhënat mbi raportin e auditimit)**	**7 - 11**
	a. Objektivat dhe qëllimi.	
	b. Identifikimi i çështjes.	
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	d. Përgjegjësitë e audituesve	
	e. Kriteret e vlerësimit	
	f. Standardet e auditimit.	
	g. Metodat e auditimit	
	i. Dokumentimi i rezultateve të auditimit.	
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**11-12**
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**12-124**
	1. "*Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të AMVV -së, bazuar në ligjet vjetore të buxhetit të vitit 2015 – 2019, si dhe në udhëzimet e përgjithshme dhe vjetore për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit*".	12-39
	2. "*Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, bazuar në aktet ligjore në fuqi për periudhën 2015-2019*"	39-67
	3. "*Mbi përputhshmërinë e veprimeve në lidhje me marrëdhëniet e punës, bazuar në aktet ligjore në fuqi për periudhën 2015 – 2019*"	67-75
	4. "*Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2016 "Për prokurimin publik", me ndryshimet dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për periudhën 2015–2019*"	75-103
	5. "*Aspekti organizativ i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore*"	103-110
	6. "*Mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, bazuar në VKM nr. 910, datë 21.12.2016 çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjes Vendore*"	110-121
	7. "*Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm*"	121-122
	8. "*Mbi fondet e përfituara nga grantet apo projektet të financuara nga donatorë të ndryshëm*"	122-123
	9. "*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*"	123-124
V.	**KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**	**124-135**
VI.	**DOKUMENTACIONI SHOQËRUES**	**136-148**
	Shtojcat nr. 1: "*Të dhëna për strukturën, shkolla/arsimi bazë që ka kryer, datat e emërimit etj, për 14 punonjësit e Agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore"*	136-138
	Shtojca nr. 2: *"Realizimi i procedurave të prokurimit për vitet 2015–2019*"	138-140
	Shtojca nr. 3: "*Listat e prokurimeve publike sipas viteve operatorët pjesëmarrës dhe fitues":.*	140-143
	Shtojca nr. 4: *"Transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhat e fundit të vitit ushtrimor"*	144-145
	Shtojca nr. 5: "*Qasja dhe metodologjia e auditimit*"	146-146
	Shtojca nr. 6: "*Lista e akt konstatimeve*"	147-147
	Shtojca nr. 7: "*Lista e shkurtimeve të përdorura në material*"	148-148

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim të Projektit dhe të riauditimit nr. 924/5, dt. 24.01.2020 në plotësim të programit të auditimit nr. 924/1, datë 18.11.2019 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 18.11.2019 deri në 31.12.2019 dhe nga data 27.01.2020 deri në 24.02.2019, ushtroi auditim *"Mbi përputhshmërisë",* në subjektin Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), për periudhën nga 01.01.2015 – 30.12.2019, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në prokurimin e fondeve publike dhe administrimin e aktiveve.
Nga auditimi u konstatuan si më poshtë:
- Nga auditimi mbi planifikimin, detajimin, rishpërndarjen dhe realizimin e fondeve buxhetore nëse janë në përputhje me kriteret e paracaktuara, kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi rezultoi se, kërkesat për rishpërndarje fondesh, jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, në përputhje me kriteret e paracaktuara në udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 me ndryshime;
- Janë kryer rishpërndarje fondesh gjatë vitit ushtrimor, transferimet e fondeve për investime, ku u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve. Kjo tregon gjithashtu, për një performancë jo të mirë të planifikimit të buxhetit, referuar kritereve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012.
-Nga auditimi është evidentuar fenomeni i përqendrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor, gjë e cila shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të arkës, që është një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.
- Nga auditimi u konstatua se në pasqyrat e performancës financiare për vitet 2018 dhe 2017 janë njohur gabimisht si të ardhura detyrimi i tatimit mbi të ardhurat personale në vlerën 1,064,246 lekë dhe detyrimi nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 3,908,619 lekë.
- Nga të dhënat e dokumentacionit të transferimit pa pagesë të aktiveve të AMVV-së pranë 61 Njësive Vendore të cilat janë pajisje kompjuterike rezulton se për 41 bashki, praktika për marrjen në dorëzim të mallit/paisjeve elektronike (*kompiutera, printera, switch, kabllo dhe UPS*) *nuk kishte të bashkangjitur fletëhyrjen e bërë nga bashkitë* pavarësisht se, marrja në dorëzim e tyre është konfirmuar në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Përdorimit.
- Në disa raste për periudhën e vitit 2017 dhe 2018 *pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik*, janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje*" në vlerën **3,338,070** lekë, ku në urdhrin janë përcaktuar vetëm numri i personelit të AMVV *pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë*, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja"* të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.06.1999. Vlera e mësipërme do të konsiderohet përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në.

I.b. Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	REFERENCA ME RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi mbi planifikimin, detajimin, rishpërndarjen dhe realizimin e fondeve buxhetore nëse është në përputhje me	Faqja 14 – 26 e Raportit përfundimtar.	I mesëm	- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

	kriteret e paracaktuara, kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi rezultoi se: - Gjatë viteve buxhetore kërkesat për rishpërndarje fondesh nga AMVV, jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, në përputhje me kriteret e paracaktuara në udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 me ndryshime; - Janë kryer rishpërndarje fondesh gjatë vitit ushtrimor, transferimet e fondeve për investime (*fondet për investime shtuar në vitin 2016 në vlerën 78,454,150 lekë*), ku u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve. Kjo tregon gjithashtu, për një performancë jo të mirë të planifikimit të buxhetit, referuar kritereve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012. -Nga auditimi rezulton se janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhat e fundit të vitit ushtrimor, gjë e cila shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të arkës, që është një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.			të marrë masa planifikimin, detajimin, rishpërndarjen dhe realizimin e fondeve buxhetore duke i shoqëruar me analiza, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
4	Nga auditimi u konstatua se në pasqyrat e performancës financiare për vitet 2017 dhe 2018 janë njohur gabimisht si të ardhura detyrimi i tatimit mbi të ardhurat personale në vlerën 1,064,246 lekë dhe detyrimi nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 3,908,619 lekë..	Faqja 39 – 66 e Raportit përfundimtar.	I ultë	- Nga ana AMVV, Sektori i Financës të merren masa për të sistemuar në pasqyrat financierë të vitit 2019 vlerën e paraqitur gabimisht si të ardhura në pasqyrën e performancës financiare, tatimin mbi të ardhurat personale në vlerën 1,064,246 lekë dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 3,908,619 lekë.
15	Nga të dhënat e dokumentacionit të transferimit pa pagesë të aktiveve të AMVV-së pranë 61 Njësive Vendore të cilat janë pajisje kompjuterike rezulton se për 41 bashki, praktika për marrjen në	Faqja 39 – 66 dhe faqe 80 – 84 e Raportit përfundimtar	I mesëm	- Nga AMVV, Sektori i Financës të merren masat për plotësimin e procedurës së kalimit të pajisje kompjuterike me dokumentacionin

	dorëzim të mallit/paisjeve elektronike (*kompiutera, printera, switch, kabllo dhe UPS*) <u>*nuk kishte të bashkangjitur fletëhyrjen e bërë nga bashkitë*</u> pavarësisht se, marrja në dorëzim e tyre është konfirmuar në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Përdorimit nga Kryetari i Bashkisë si dhe konfirmimin për marrjen në dorëzim të mallit pa pagesë, kjo sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik*" Kap III, pika 56 ku citohet "*Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe Nëpunësi Autorizues*". Nga verifikimi në disa Bashki rezultoi se: a. Bashkia Kurbin me Fletë hyrjen nr. 70, dt. 06.12.2018 ka bërë hyrje pajisjet elektronike sipas Fletë Daljes së AMVV nr. 187, dt. 6.12.2018. Gjithashtu rezultoi se materialet e mësipërme janë bërë hyrje nga Bashkinë Kurbin me FH nr. 89, dt. 31.12.2016 dhe nr. 90, dt. 31.12.2016 të cilat edhe janë kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2016. Por vlerat e tyre nuk përputhen me vlerat e FH nr. 70, dt. 06.12.2018. b. Bashkia Skrapar me Fletë hyrjen nr. 42, dt. 12.11.2018 ka bërë hyrje pajisjet elektronike sipas Fletë Daljes së AMVV nr. 217, dt. 19.12.2018. Gjithashtu rezultoi se materialet e mësipërme janë bërë hyrje nga Bashkinë Kurbin me FH nr. 54, dt. 02.11.2016 dhe nr. 53, dt. 02.11.2016. Gjithashtu nga Bashkia Skrapar është mbajtur procesverbali i datës 19.12.2018 ku saktësohet se çmimet do të			përkatës te fletëhyrjeve nga njësitë vendore sipas fletë daljeve të AMVV. Me plotësimin e praktikave dokumentare në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" dokumentacioni i plotë konfirmuar kjo nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues i Njësisë ti vihet në dispozicion Kontrollit të Lartë të Shtetit.

	jenë sipas faturave të vitit 2018 pasi çmimet nuk përputhen.			
B/1	Komisioni i prokurimit me vlera të vogla dhe titullari AK, kanë s'kualifikuar ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedurë për vitet 2018 dhe 2019 me argumentin se, "*Ofertat janë anomalisht të ulëta*" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "*çmimi më i ulët*" dhe kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE me oferta ekonomike më të larta se ato të s'kualifikuara, për rrjedhoje midis ofertave të shpallura fituese dhe ofertave të s'kualifikuara rezulton një diference në total për shumën 800,710 lekë pa tvsh, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", Udhëzimin e APP nr.3, datë 08.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla të zhvilluar me mjete elektronike* " pika 10, i ndryshuar:	Faqja 90 – 95 dhe 99 - 100 e Raportit përfundimtar	I mesëm	Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, sektori i financës të merren masat të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit: Për arkëtimin e vlerës prej **800,710** lekë
C/1	Nga auditimi i veprimeve nëpërmjet Bankës (Urdhër shpenzimeve) u konstatua se: a. Në 5 raste për periudhën e vitit 2017 <u>pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik</u>, janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje" në vlerën 2,282,570 lekë, ku në urdhrin janë përcaktuar vetëm numri i personelit të AMVV <u>pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë</u>, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" të ndryshuar me VKM nr. 258,	Faqja 89 – 100 e Raportit përfundimtar	I mesëm	Titullari i Autoritetit Kontraktor, të analizojë dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e shkeljeve të cilësuara më lart, me pasojë efekte financiare negative, në buxhetin e AMVV-në, i cili në rastin konkret rezulton në vlerën **3,338,070** lekë.

	datë 3.06.1999. Vlera e mësipërme do të konsiderohet përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në. b. Në 4 raste për periudhën e vitit 2018 pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik, janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje" në vlerën 1,055,500 lekë, ku në urdhrin janë përcaktuar vetëm numri i personelit të AMVV pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.06.1999. Vlera e mësipërme do të konsiderohet përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në.			

II. Hyrja.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim të Projektit dhe të riauditimit nr. 924/5, dt. 24.01.2020 në plotësim të programit të auditimit nr. 924/1, datë 18.11.2019 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 18.11.2019 deri në 31.12.2019 dhe data 27.01.2020 deri në 24.02.2019, u krye auditimi *"Mbi përputhshmërisë",* në subjektin Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), për periudhën nga 01.01.2015 – 30.12.2019, nga grupi i auditimit me përbërje:

1-Z. B.Z. (*përgjegjës grupi*),
2-Z. N.N., anëtar,
3-Znj. M.H., anëtar,
4-Z. A.H., anëtar,
5- Z. D.K., anëtar
6- Z. D.Z., anëtar.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi veprimtarinë e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në prokurimin e fondeve publike dhe administrimin e aktiveve.
Auditimi u krye me zgjedhje për periudhën 01.07.2015, deri 31.12.2019.

Bazuar të dhënave të marra në subjekt, fondet e trajtuar, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, u identifikuan fushat e auditimit të cilat janë;

a. hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare (viti 2015-2018) përkatëse në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si; Udhëzimi i MF nr. 26,datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, date 28.12.2006".* UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*". Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit;

b. planifikim dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime;

c. Mbi fondet e përfituara nga grantet apo projektet të financuara nga donatorë të ndryshëm.

a) <u>Titulli</u>:

Raporti i Auditimit të përputhshmërisë në Agjencinë Mbështetëse të Vetëqeverisjes Vendore**.**

b) <u>Marrësi</u>:

Ky Raport i adresohet Agjencisë Mbështetëse të Vetëqeverisjes Vendore.

c) <u>Objektivat dhe qëllimi i auditimit</u>:

Ky auditim ka për <u>qëllim</u> kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim vlerësimin e përgjithshëm të përputhshmërisë së aktivitetet të parashikuara në programin e auditimit me kaudrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit dhe procedurave të kontrollit të lidhura me transaksione individuale.

Menaxhimi është përgjegjës për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm që siguron përputhshmërinë me ligjet dhe rregullat.

Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me auditimin e llogarive vjetore për institucionin (të mbyllura deri vitin 2018).

Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, *<u>ka për qëllim</u>* të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar si edhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

<u>Objektivat e këtij auditimi konsistojnë në:</u>

- Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.
- Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e shpenzimeve dhe të ardhurave janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

d) <u>Identifikimi i çështjes:</u> Agjencia Mbështetëse e Vetëqeverisjes Vendore është institucion publik, person juridik, me seli në Tiranë, në varësi të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore që ka për mision dhënien e ndihmës për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo–territoriale. Agjencia ka si qëllim mundësimin e zbatimit të reformës administrativo-territoriale, nëpërmjet bashkërendimit të të gjitha masave, proceseve dhe mbështetjes administrative deri në arritjen e funksionalitetit të plotë të 61 bashkive të reja.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e riauditimit nr. 924/5, dt. 24.01.2020 në plotësim të programit të auditimit nr. 924/1, datë 18.11.2019 "*Mbi auditimin e Përputhshmërisë*" në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për periudhën 01.01.2015 – 30.12.2019,

e) <u>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:</u>

Drejtimi i (**AMVV)** është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

f) <u>Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:</u>

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të AMVV, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

g) <u>Kriteret e vlerësimit:</u>

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", Ligjin nr. 139/15 dt. 17.12.15 "*Për vetëqeverisjen vendore".*

Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si; Udhëzimi i MF nr. 26,datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006".*

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*".

VKM nr. 83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin dhe funksionimin e agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore"* i ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.1.2018.

h) <u>Standardet e Auditimit:</u>

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit Përputhshmërisë, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:
- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
-ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë)* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";*
-ISSAI 1000-2999 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
-ISSAI 1300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
-INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"*; INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";

i) <u>Metodat e auditimit:</u>

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2018 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej **2%,** vlerën ***484,566*** lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. *(Shtojca nr. 5)*

<u>Puna e auditit të brendshëm u bë pjesë efektive e mjedisit të kontrollit, duke dhënë ndihmesë në drejtim të risqeve të punës në mënyrë të strukturuar dhe dha siguri për operacionet dhe procedurat e kontrollit duke u referuar edhe gjetjeve të tyre</u>[1].

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

j) <u>Dokumentimi i rezultateve të auditimit</u>:

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Manualit të Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "*Dokumentimi i Auditimit*".

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

[1] Mbështetur në **ISSAI 1610** "*Përdorimi i punës së Audituesve të Brendshëm"*.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Transaksionet e AMVV.

Nisur nga fakti se janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhat e fundit të vitit ushtrimor, bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur u filtruan të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor dhjetor për vitet 2015, 2016, 2017, 2018, 2019 në vlerat si më poshtë:

- Urdhër Shpenzimet (13) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2015 në vlerën totale 4,655,856 lekë.
- Urdhër Shpenzimet (10) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2016 në vlerën totale 77,786,967 lekë.
- Urdhër Shpenzimet (11) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2018 në vlerën totale 3,078,422 lekë.
- Urdhër Shpenzimet (16) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2019 në vlerën totale 1,814,108 lekë.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik"* për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj*.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi. (shtojca nr. 4)*

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Raporti i Auditimit pa opinion me rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

III. PËSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Agjencia Mbështetëse e Vetëqeverisjes Vendore krijuar me VKM nr.83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për zbatimin e reformës territoriale*" i ndryshuar ka selinë në Tiranë dhe është në varësi të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore.

Struktura Organizative e Agjencisë përbëhet nga:

- Drejtori i Përgjithshëm;
- Sektori i Koordinimit me Qeverisjen Vendore i përberë nga Përgjegjësi i Sektorit dhe 8 Inspektorë;
- Sektori i Analizës dhe Mbështetjes Institucionale i përberë nga Përgjegjësi i Sektorit (Ekonomiste), Specialisti i IT, Specialisti i Shërbimeve dhe Specialist Protokolli.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta në dhënien e ndihmës për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo–territoriale duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim dhënien e ndihmës për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor).*

Objektivat burojnë nga VKM "*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore*".

Agjencia ka si qëllim: Mundësimin e zbatimit të reformës administrativo-territoriale, nëpërmjet bashkërendimit të të gjitha masave, proceseve dhe mbështetjes administrative deri në arritjen e funksionalitetit të plotë të 61 bashkive të reja.

Agjencia ka këto detyra dhe përgjegjësi:

Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore në koordinimin e punës për zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore. Monitoron zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020, si dhe planit të veprimit përkatës. Informon periodikisht institucionet publike, grupet e interesit dhe qytetarët mbi çështjet që lidhen me qeverisjen vendore. Bashkëpunon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020. Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore. Siguron informacione lidhur me çështjet e vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike qendrore e vendore dhe harton raporte, analiza periodike mbi këto çështje. Ofron këshillim ligjor dhe teknik për njësitë e vetëqeverisjes vendore në procesin e ushtrimit të funksioneve të tyre. Shërben si qendër e evidentimit dhe e promovimit të praktikave më të mira dhe/ose modeleve rekomanduese për çështjet e vetëqeverisjes vendore. Bashkërendon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare. Mbështet ministrinë përgjegjëse për çështjet vendore (në rolin e një sekretariati teknik) në koordinimin e punës me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë që mbështesin zhvillimin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Raporton periodikisht pranë ministrit përgjegjës për çështjet vendore mbi veprimtarinë e saj dhe për realizimin e detyrave e të përgjegjësive.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të AMVV -së, bazuar në ligjet vjetore të buxhetit të vitit 2015 – 2019, si dhe në udhëzimet e përgjithshme dhe vjetore për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Sipas Programit të Auditimit ,është audituar planifikimi dhe zbatimi i buxhetit të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019. Për auditimin e kësaj pike grupi i auditimit është mbështetur në:
Ligjet vjetore të "Zbatimit të buxhetit të Shtetit";
Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit";
Ligji nr.9936, datë 26.06.2018 "Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
Ligji nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019";
Ligji nr.147/2015, datë 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016";
Udhëzimin nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", udhëzimet plotësuese vjetore, si dhe çdo akt nënligjor i nxjerrë në zbatim të tij;
Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "Mbi procedurat e zbatimit të buxhetit" me ndryshime, udhëzimet plotësuese vjetore, si dhe çdo akt nënligjor i nxjerrë në zbatim të tij;
Ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Manualin mbi MFK-në, etj.

1/a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit.
Pesha specifike e zërave të shpenzimeve ndaj planit total.

Zërat	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore				
	Në % ndaj totalit				
	2015	2016	2017	2018	2019
600	24.10	5.27	46.58	43.01	20.28
601	3.85	0.85	6.60	6.85	3.15
602	52.36	5.97	41.45	39.41	17.43

602/5					
604					
605					
606				0.18	
231	19.68	87.91	5.38	10.54	59.13
Total	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme **për vitin 2015**, zëri i shpenzimeve operative (602) ka peshën specifike më të lartë kundrejt shpenzimeve të planifikuara me rreth 52.36% në nivel grupi, zëri i pagave (600) me rreth 24.10 %, investimet (231) me 19.68 % ndaj totalit.
Për vitin 2016 vihet re nga të dhënat e mësipërme, se zëri i investimeve (231) ka peshën më të lartë specifike kundrejt shpenzimeve të planifikuara me rreth 87.91 % në nivel grupi, zëri i pagave (600) me 5.27 %, dhe shpenzimet operative (602) me 5.97 % ndaj totalit.
Për vitin 2017 siç shihet nga të dhënat e mësipërme, zëri i pagave (600) ka peshën më të lartë specifike kundrejt shpenzimeve të planifikuara me rreth 46.58 % në nivel grupi, investimet (231) me 5.38 % dhe shpenzimet operative (602) me 41.45 % ndaj totalit.
Për vitin 2018 siç shihet nga të dhënat e mësipërme, zëri i pagave (600) ka peshën më të lartë specifike kundrejt shpenzimeve të planifikuara me rreth 43.01 % në nivel grupi, investimet (231) me 10.54 % dhe shpenzimet operative (602) me 39.41 % ndaj totalit.
Për vitin 2019 siç shihet nga të dhënat e mësipërme, zëri i investimeve (231) ka peshën më të lartë specifike kundrejt shpenzimeve të planifikuara me rreth 59.13 % në nivel grupi, zëri i pagave (600) me 20.28 % dhe shpenzimet operative (602) me 17.43 % ndaj totalit.

3.1/b. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, transferimi i fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor konform dispozitave ligjore.

Buxheti i vitit 2015:
Për vitin 2015, plani i buxhetit të Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (sot AMVV) dhe detajimi i tij është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 8197/1, datë 09.06.2015 "*Dërgim i detajimit të buxhetit dhe numrit të punonjësve të vitit 2015*", për shpenzimet korente.
Buxheti i vitit 2016:
Për vitin 2016, plani i buxhetit të Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (sot AMVV) dhe detajimi i tij është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17761/232, datë 18.01.2016 "*Detajimi i buxhetit të vitit 2016*", për shpenzimet korente.
Titullari i Institucionit gjatë vitit 2016 i ka bërë kërkesë MF për shtesë buxheti për vitin 2016 për shpenzimet korrente në vlerën prej 5,000,000 lekë. Nga ana e Ministrisë së Financave është kthyer përgjigje me shkresë nr.6885 datë 20.05.2016 ku AZRT-së i është çelur shtesë fondi në vlerën prej 3,000,000 lekë.
Ministria e Financave me shkresën nr.8173 datë 15.06.2016 specifikon projektet për financim për programin Shqipëria Dixhitale të cilat kanë rezultuar të papërdorura në fund të vitit 2015 dhe miratohet kalimi i këtyre fondeve në planin e vitit 2016.
Buxheti i vitit 2017:
Për vitin 2017, plani i buxhetit të Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (sot AMVV) dhe detajimi i tij është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17911/142, datë 18.01.2017 "*Dërgim i detajimit të buxhetit të vitit 2017*", për shpenzimet korente.
Ministria e Brendshme me shkresën nr.8414 datë 30.11.2017 për njësitë e saj shpenzuese përfshirë këtu edhe Agjencinë për Zbatimin e Reformës Territorial i ka njoftuar për rishpërndarje fondi sipas projekteve ku për projektin Star 2 është akorduar fondi prej 70,357,000 lekë dhe për projektin DLDP fondi prej 200,000,000 lekë.
Buxheti i vitit 2018:

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka bërë detajimin e shpenzimeve korente, dërguar në Ministrisë Për Çështjet Vendore me shkresën nr. 9/1, datës 20.01.2018.
Për vitin 2018, plani i buxhetit të Agjencisë dhe detajimi i tij është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 13203/1, datë 20.07.2018 "*Për rishpërndarje fondesh të infrastrukturës vendore rajonale".*

Buxheti i vitit 2019:

Me shkresën nr. 22760/65, datë 14.01.2019 Ministria e Financave ka dërguar buxhetin e miratuar për vitin 2019 Ministrisë së Brendshme. Ministria e Brendshme me shkresën nr.301/4 datë 23.01.2019 i ka dërguar Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore detajimin e buxhetit të vitit 2019.
Për vitin 2019, plani i buxhetit të Ministrisë së Brendshme dhe Institucioneve në vartësi dhe detajimi i tij është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 22760/65, datë 14.01.2019 "*Dërgim i detajimit të buxhetit të vitit 2019*" sipas strukturës buxhetore dhe të detajuar në periudha mujore për shpenzimet korrente.

Plani me ndryshime AMVV për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

Emërtimi i shpenz.	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
	Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P
(600)	9,500,000	-2,000,000	7,500,000	11,500,000	445,000	11,945,210	12,000,000	3,399,453	15,399,453
(601)	1,400,000		1,400,000	1,800,000	128,000	1,928,100	1,600,000	581,700	2,181,700
(602)	11,100,000	2,000,000	13,100,000	11,100,000	2,426,690	13,526,690	13,000,000	703,300	13,703,300
(604)									
(605)									
(606)									
T/Korente	**22,000,000**	**0**	**22,000,000**	**24,400,000**	**3,000,000**	**27,400,000**	**26,600,000**	**4,684,153**	**31,284,453**
T/Investime	**94,680,000**	**0**	**94,680,000**	**125,680,000**	**78,454,150**	**176,634,150**	**275,186,800**	**0**	**275,186,800**
Total	**116,680,000**	**0**	**116,680,000**	**153,580,000**	**81,454,150**	**233,034,150**	**301,786,800**	**4,684,153**	**306,471,253**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

Plan me ndryshime AMVV për vitet 2018 dhe 2019

Emërtimi i shpenz.	Viti 2018			Viti 2019		
	Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P
600	13,900,000	302,541	14,202,541	13,000,000	820,680	13,880,000
601	2,256,726	0	2,256,726	2,300,000		2,300,000
602	13,010,000	0	13,010,000	12,898,000		12,898,000
604						
605						
606	60,000	0	60,000			
T/Korente	**29,532,541**	**302,541**	**319,993**	**28,198,000**	**820,680**	**29,018,680**
T/Investime	**3,479,800**	**0**	**3,479,800**	**40,556,000**		**40,556,000**
Total	**33,012,341**	**302,541**	**462,350**	**68,754,000**	**820,680**	**69,574,680**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

Mbi rishpërndarjen e fondeve buxhetore.

1. Nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, nuk janë hartuar, dhe nuk janë dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe nuk janë publikuar në faqen zyrtare të AMVV, informacionet e detajuara mbi performancës buxhetore si dhe Raportet e monitorimit vjetore, të cilët janë të konfirmuar Nëpunësi Autorizues (NA), Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit, sipas kërkesave të pikës 256 dhe 257 të udhëzimit ku cilësohet:

NA e njësive të qeverisjes qendrore duhet të paraqesin te NPA brenda datës 28 të çdo muaji pasardhës të tremujorit informacion të detajuar mbi performancën e produkteve të buxhetit vjetor. Raporti i monitorimit duhet të paraqitet brenda datës 30 Janar.

2. Gjithashtu, rishpërndarjet e fondeve buxhetore për projektet e investimeve janë miratuara nga Ministri i Financave, sipas përcaktimit të bërë në pikën 76.b ku cilësohet:

b) Rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore miratohen nga Ministri i Financave pa cenuar burimet e financimit (buxheti, financimi i huaj, të ardhurat dytësore)

- Gjatë viteve buxhetore *Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nuk ka dorëzuar raportet e monitorimit të shpenzimeve dhe informacionet e performancës në MF.*
- Gjatë viteve buxhetore **kërkesat për rishpërndarje fondesh jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë** ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat;
- **Janë kryer rishpërndarje fondesh gjatë vitit ushtrimor**, që prekin të gjithë zërat e buxhetit transferimet e fondeve për investime, ku u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve.

1/b. Zbatimi i limiteve të fondeve buxhetore të miratuara, realizimi sipas klasifikimit ekonomik si dhe kompetenca e përdorimit të tyre.

Realizimi i planit të buxhetit, në nivel Grupi/AMVV (2015, 2016 dhe 2017)

Emërtimi i shpenz.	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
	Pl/P	Fakt	R/%	Pl/P	Fakt	R/%	Pl/P	Fakt	R/%
(600)	7,500,000	5,488,406	73	11,945,210	11,945,210	100	15,399,453	15,399,371	100
(601)	1,400,000	879,229	63	1,928,100	1,928,100	100	2,181,700	2,181,700	100
(602)	13,100,000	11,928,100	91	13,526,690	13,526,671	99.9	13,703,300	13,703,216	100
(604)									
(605)									
(606)									
T/Korente	22,000,000	18,295,735	83	27,400,000	27,399,981	100	31,284,453	31,284,287	100
T/Investime	94,680,000	4,483,542	5	205,634,150	199,260,376	96.9	275,186,800	1,778,730	0.65
Total njësie	**116,680,000**	**22,779,277**	**20**	**233,034,150**	**226,660,357**	**97**	**306,471,253**	**33,063,017**	**11**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

Realizimi i planit të buxhetit, në nivel Grupi/AMVV (2018 dhe 2019)

Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2018			Viti 2019		
	Pl/P	Fakt	F/P në %	Pl/P	Fakt	F/P në %
(600)	14,202,541	14,161,869	99.71	13,920,672	13,870,273	99.64
(601)	2,260,000	2,256,726	99.86	2,200,000	2,153,727	97.90
(602)	13,010,000	12,977,456	99.75	12,848,008	11,919,068	92.77
(604)						
(605)						
(606)	60,000	60,000	100	50,000		0
T/Korente	**29,532,541**	**29,456,051**	**99.74**	**29,018,680**	**27,943,068**	**96.29**
T/Investime	**3,479,800**	**3,470,242**	**99.73**	**40,556,000**	**40,434,305**	**99.70**
Total Aparati	**33,012,341**	**32,926,293**	**99.74**	**69,574,680**	**68,377,373**	**98.28**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

Midis Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Degës së Thesarit Tiranë është mbajtur Aktrakordimi mujor/progresiv për realizimin e shpenzime, si dhe Aktrakordimi vjetor për periudhën Maj-Dhjetor 2015, Janar-Dhjetor 2016, Janar-Dhjetor 2017, Janar-Dhjetor 2018 dhe Janar-Dhjetor 2019. Aktrakordimet për vitet 2015, 2016 dhe 2017 janë firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.S., në cilësinë e NA, Drejtori i Financës në cilësinë e NZ si dhe përfaqësuesi i Degës së Thesarit Tiranë, Specialisti i thesarit, kurse për vitet 2018 dhe 2019 aktrakordimet janë firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm z. B.M. në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe nga Përgjegjësi i Financës znj. F.M. në cilësinë e nëpunësit zbatues si dhe nga specialisti i Degës së Thesarit Tiranë, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 2 datë 06. 02. 2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", "*Rakordimi mujor i shpenzimeve*" pika 172 ku cilësohet:

"Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme".

Nga auditimi me zgjedhje, për 5 vitet objekt auditimi, nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, janë zbatuar kërkesat për zbatimin e buxhetit të shtetit edhe në aspektin e zbatimit të ligjit për "*Menaxhimin Financiar dhe kontrollin*", përsa i përket kompetencës së përdorimit të tyre.

Për vitin 2015, rezulton se realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 20 %. Në këtë mosrealizim, ndikim ka patur realizimi i investimeve me 5 % dhe i shpenzimeve operative në masën 83 %.

Për vitin 2016, rezulton se realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 97 %, por edhe sipas zërave të shpenzimeve është realizuar në nivele optimale, ku shpenzimet për investime janë realizuar në masën 96% dhe i shpenzimeve operative në masën 100%.
Për vitin 2017, plani i buxhetit është realizuar në masën 11%. Në këtë mosrealizim, ndikim ka patur realizimi i investimeve me 0.65 % ndërsa realizimi i shpenzimeve operative është 100 %.
Për vitin 2018, rezulton se realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 99 %, por edhe sipas zërave të shpenzimeve është realizuar në nivele optimale, ku shpenzimet për investime janë realizuar në masën 99.73% dhe i shpenzimeve operative në masën 99.74%.
Për vitin 2019, rezulton se realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 98.28 %, por edhe sipas zërave të shpenzimeve është realizuar në nivele optimale, ku shpenzimet për investime janë realizuar në masën 99.70% dhe i shpenzimeve operative në masën 96.29%.

Sa konstatuar më lart Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, ka vepruar në përputhje me kriteret e paracaktuara, në lidhje me zbatimin e buxhetit për vitet 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019, me përjashtim ***përgendrimin e likuidimit të shpenzimeve në fund të periudhës buxhetore, shoqëruar kjo me ndryshim të planit mujor të arkës gjatë gjithë vitit.***

1/c Zbatimi i buxhetit me destinacion shpenzimet operative.
Zbatimi i shpenzimeve operative në vitin 2015, ka rezultuar në masën 91%, ku janë planifikuar shpenzime për materiale dhe shërbime të përgjithshme në vlerën prej 1,810,000 lekë dhe janë realizuar në masën 98%. Janë planifikuar shërbime nga të tretët në vlerën prej 450,000 dhe janë realizuar në masën 86%. Shpenzimet e transportit janë planifikuar në vlerën prej 1,470,000 lekë dhe janë realizuar në masën 96%. Shpenzimet e udhëtimit janë planifikuar në vlerën prej 3,950,000 dhe janë realizuar në masën prej 87%
Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative, në lekë.

Nr	Emërtimi	P/Vjetor	Fakti	Diferenca	R/ %
602	**Mallra dhe shërbime të tjera**				
6020	**Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme**	**1,810,000**	**1,786,788**	**23,212**	**98**
6020100	Kancelari	700,000	696,194	3,806	99
6020200	Materiale për pastrim, ngrohje	350,000	345,960	4,040	98
6020300	Materiale për funks e paisjeve të zyrës Tonera	320,000	305,034	14,966	95
6020400	Materiale për funksionimin e paisjeve speciale				
6020500	Blerje dokumentacioni	120,000	119,760	240	99
6022010	Shpenzime të printimit dhe publikimit	120,000	119,040	960	99
6020900	Furnizime dhe materialet të tjera zyre	100,000	100,800	(800)	100
6021	Shpenzime për softe informatike	100,000	100,000	0	100
6022	**Shërbime nga të tretët**	**450,000**	**386,943**	**63,057**	**86**
6022001	Elektricitet				
6022002	Ujë				
6022003	Telefon dhe faks	120,000	118,610	1,390	98
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	200,000	150,437	49,563	75
6022005	Shërbim ngrohjeje				
6022009	Shërbime të gjelbërimit				
6022099	Shërbime të tjera (Interneti)	130,000	117,896	12,104	90
6023	**Shpenzime transporti**	**1,470,000**	**1,410,182**	**59,818**	**96**
6023100	Karburant	950,000	937,173	12,827	98
6023100	Vaj				
6023200	Goma	120,000	119,800	200	99
6023200	Bateri				
6023300	Shpenzime siguracioni	100,000	94,415	5,585	94
6023200	Pjesë këmbimi				
6023200	Filtra për automjetet				
6023900	Të tjera	300,000	258,794	41,206	86
6024	**Shpenzime udhëtimi**	**3,950,000**	**3,423,067**	**526,933**	**87**
6024000	Udhëtim i brendshëm	3,800,000	3,275,750	524,250	86
6024000	Udhëtim i jashtëm	150,000	147,317	2,683	98
6025	**Shpenzime mirëmbajtje**	**1,920,000**	**3,442,931**	**(1,522,931)**	**179**
6025200	Shpenzime për mirmb e objekteve ndërtimore		842,104	(842,104)	50
6025300	Shpenzime për mirmb e rrjeteve hidraulike		706,800	(706,800)	
6025300	Shpenzime për mirmb e rrjetit elektrike	450,000	431,326	18,674	96

6025300	Shpenzime për mimb e ashensorit		66,000	(66,000)	
6022009	Shpenzime për mirmb e pastrim gjelbërimit	900,000	846,000	54,000	94
6025400	Shpenzime për mirmb e mjeteve të tranpsortit	120,000	111,981	8,019	93
6025800	Shpenzime për mirmb e paisjeve të zyrave	450,000	438,720	11,280	97
6029	**Shpenzime të tjera operative**	**1,500,000**	**1,478,189**	**21,811**	**98**
6029007	Shpenz për pjesmarrje në konferenca dhe seminare	1,350,000	1,311,140	38,860	97
6029008	Shpenz për tatime dhe taksa të papaguara		8,763	(8,763)	
6029002	Shpenz për aktivitete sociale				
6029099	Shpenz të tjera materiale dhe shërbime operative	150,000	158,286	(8,286)	105
	Total	**11,100,000**	**11,928,100**	**(828,100)**	**107**
	Rialokim Fondi	*2,000,000*			
	Totali me rialokimet	*13,100,000*	**11,928,100**	**1,171,900**	**91**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

<u>Në analizë:</u>

1. Urdhër Shpenzimi nr. 59, dt. 25.11.2015 për 515,023 lekë likuiduar në favor të përfituesit "*A&T sh.p.k.*" shpk sipas faturës tatimore nr. 79, dt. 19.11.2015 për vlerën 515,023 lekë në vazhdimësi të kontratës nr. 61/4, dt. 28.08.2015 më vlerë totale 781,000 lekë pa tvsh me objekt "*Shitje karburanti (benzinë pa plumb 10ppm) me 140.72 lekë litri në tollona sasia 5550 litra*". Me urdhrin e titullarit nr. 61/4, dt. 27.08.2015 është dhënë autorizimi nga titullari i Institucionit për punonjësen znj. F.M. për tërheqjen karburanti dhe për zbatimin e kontratës dhe marrjen në dorëzim. Me fletë-hyrjen nr.11 datë 19.11.2015 është bërë hyrje e karburantit nga znj. Fatima Miça për sasinë 3050 litra me vlerën 515,023 lekë.

Procedura e prokurimit me vlerë të vogël për objektin "*Blerje Karburanti*" me fond limit 798,000 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.61 datë 25.08.2015 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 798,000 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në ofertën më të ulët lekë/litër dhe është prokuruar me vlerën 798,000 lekë, ku cili operator ekonomik ofron më shumë litra ai është fitues i kësaj procedure prokurimi. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.61/1, datë 25.08.2015. Me datën 26.08.2015, është hapur procedura e prokurimit, ku morën pjesë 4 OE, oferta ekonomike më e vogël është 781,000 lekë nga OE A...

Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OE të renditur të katërtin A... shpk me ofertë ekonomike 781,000 lekë me proces verbal shpallje fituesi 61/2, datë 27.08.2015 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me 61/3, datë 27.08.2015

2. Urdhër Shpenzimi nr. 67, dt. 10.12.2015 për 1,244,280 lekë me tvsh likuiduar në favor të përfituesit "*B...*" shpk sipas faturës tatimore nr. 840, dt. 07.12.2015 për vlerën 1,244,280 lekë sipas kontratës nr. 441/1, dt. 10.11.2015 më vlerë totale 1,244,280 lekë me tvsh me objekt "*Blerje kompjuter, desktop, workstation, laptop*".Me shkresë nr.44/1 datë 28.07.2015 është miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, urdhri i prokurimit për procedurën e prokurimit të përqendruar me objekt *"Blerje paisje elektronike dhe telekomunikacioni për DAP-in dhe AZRT-në"*. Është ngritur komisioni për zbatimin e kontratës dhe marrjen në dorëzim me personat z. M.U., z. G.C. dhe z. E.H. Nga ky komision është mbajtur proces verbali nr.441/1, dt. 07.12.2015 ku përcaktohet se dokumentacioni bashkëlidhur këtij procesverbali është; fatura tatimore, akt dorëzimi nga operatori ekonomik. Janë dorëzuar kompjutera sipas specifikimeve teknike Fujitsu Esprimo P520 10 copë, Kompjuter Workstation Fujitsu W530 1 copë, Monitor Fujitsu E22T 11 copë, Laptop Celsius H730 1 copë dhe Laptop E554 HM 1 copë. Janë bërë hyrje me fletë-hyrjen nr.13 datë 07.12.2015 nga znj. F.M.

3. Urdhër Shpenzimi nr. 78, dt. 22.12.2015 për vlerën 479,640 lekë likuiduar në favor të përfituesit "*N...*" sipas faturës tatimore nr. 122, dt. 21.12.2015 për vlerën 479,640 lekë sipas preventivit të punimeve, dt. 15.12.2015 më vlerë totale 479,640 lekë me tvsh me objekt "*Mirëmbajtje riparim të tendës së tarracës dhe riparim të derës dhe të vetratave të magazinës*". Me shkresë nr.126/1 datë 09.12.2015 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 504,200 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në preventivin e punimeve. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.126/2, datë

09.12.2015. Me proces-verbalin nr.126/3 datë 15.12.2015 është shpallur fitues personi fizik N.H. i renditur i dyti. Operatori i renditur i pari A... nuk është paraqitur në kohën e caktuar në ftesën për ofertë.
Njësia e prokurimit ka shpallur fitues personin fizik N.H. me ofertën në vlerën 399,700 lekë pa tvsh. Me shkresën nr.126/4 datë 15.12.2015 është bërë dhe njoftimi i fituesit nga titullari i AK. Me shkresën nr.126/5, dt. 15.12.2015 është dhënë autorizimi nga titullari i Institucionit për punonjësin e AZRT-së me profesion Arkitekt z. P.Z. për ndjekje të zbatimit të punimeve. Me shkresën nr.126/6 datë 21.12.2015 është mbajtur proces-verbali nga z. P.Z. si personi i autorizuar nga titullari i AK ku vërteton se janë realizuar shërbimet sipas ftesës për ofertë, si dhe është lëshuar fatura tatimore nr.122 datë 21.12.2015.
4. Urdhër Shpenzimi nr. 84, dt. 30.12.2015 për vlerën 416,400 lekë likuiduar në favor të përfituesit "*R...*" sipas faturës tatimore nr.677, dt. 15.12.2015 për vlerën 416,400 lekë. Me shkresën nr.114/1 datë 15.11.2015 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 511,000 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në preventivin e përllogaritur me çmimet e tregut nga komisioni i prokurimit për blerje të vogël. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.114/2, datë 15.11.2015. Me proces-verbalin nr.114/3 datë 19.11.2015 është shpallur fitues OE R... i renditur i treti. Operatori i renditur i pari A.. nuk është paraqitur në kohën e caktuar në ftesën për ofertë. Operatori i renditur i dyti O.. nuk u paraqit pas ftesës për ofertë të dërguar nëpërmjet APP. Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OE R... me ofertën në vlerën 347,000 lekë pa tvsh. Me shkresën nr.114/4 datë 19.11.2015 është bërë dhe njoftimi i fituesit nga titullari i AK. Me shkresën nr.114/5, dt.19.11.2015 është dhënë urdhër i brendshëm nga titullari i Institucionit për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të pajisjeve të zyrës (mobileri) nga OE R... Me shkresën nr.114/6 datë 25.12.2015 është mbajtur proces-verbali nga komisioni i autorizuar nga titullari i AK me personat z. G.C., z. A.J. dhe z. X.C. ku pasi kanë bërë verifikimet e duhura në sasi dhe cilësi këto materiali kanë qenë sipas porosisë, si dhe është lëshuar fatura tatimore nr.677 datë 15.12.2015 në vlerën prej 416,400 lekë. Këto materiale janë bërë hyrje me fletë-hyrjen nr.19 datë 15.12.2015
5. Urdhër Shpenzimi nr. 92, dt. 30.12.2015 për vlerën 305,034 lekë likuiduar në favor të përfituesit "*I...*" sipas faturës tatimore nr.199838700, dt. 30.12.2015 për vlerën 305,034 lekë. Me shkresën nr.141/1 datë 23.12.2015 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 380,000 lekë pa tvsh. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.141/2, datë 23.12.2015. Me proces-verbalin nr.143/3 datë 28.12.2015 është shpallur fitues OE "I..." shpk. Me shkresën nr.141/4 datë 28.12.2015 është bërë dhe njoftimi i fituesit nga titullari i AK. Me shkresën nr.141/5, dt.28.12.2015 është dhënë urdhër i brendshëm nga titullari i Institucionit për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të pajisjeve. Me shkresën nr.141/6 datë 30.12.2015 është mbajtur proces-verbali nga komisioni i autorizuar nga titullari i AK me personat z. G.C., z. A.J. dhe z. X.C. ku kanë bërë verifikimet e duhura në sasi dhe cilësi këto materiali kanë qenë sipas porosisë, është lëshuar fatura tatimore nr.11983870 datë 30.12.2015 në vlerën prej 305,034 lekë.
Këto materiale janë bërë hyrje me fletë-hyrjen nr.25 datë 30.12.2015 por vihet re se shuma te fletë hyrja prej 116,500 lekë nuk është e njëjtë me shumën te fatura tatimore prej 305,034 lekë. (Në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik".

Komente dhe shpjegime:
Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:
Përsa i përket urdhër shpenzimit nr.92 ,datë 30.12.2015 është e vërtetë që shuma e fletë hyrjes është 116,500 lekë jo 305,034 lekë që është fatura, por kjo është një gabim mbledhje e faturës, se zërat e fletë hyrjes përbëjnë shumën 305,034 lekë dhe jo 116,500 lekë, në kontabilitet dhe magazinën e hyrjeve regjistrimi është bërë sipas artikujve dhe shuma është 305,035 lekë.

Përfundimisht është një mbledhje e gabuar e fletë hyrjes,(bashkëlidhur kopie e fletë hyrjes nr.25 datë 30.12.2015).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i merr në konsideratë komentet dhe shpjegimet e dhëna.

Zbatimi i shpenzimeve operative në vitin 2016, ka rezultuar me tejkalim limiti në masën 121%, por dhe ka patur shtesë fondi në muajin gusht 2016 në vlerën 3,000,000 lekë. Janë planifikuar shpenzime për materiale dhe shërbime të përgjithshme në vlerën prej 1,300,000 lekë dhe është tejkaluar limit në masën 144%. Janë planifikuar shërbime nga të tretët në vlerën prej 440,000 dhe janë realizuar në masën 95%. Shpenzimet e transportit janë planifikuar në vlerën prej 1,210,000 lekë dhe është tejkaluar planifikimi në masën 131%. Shpenzimet e udhëtimit janë planifikuar në vlerën prej 5,500,000 dhe është tejkaluar limiti në masën prej 116%

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative, në lekë.

Nr.	Emërtimi	P/Vjetor	Fakti	Diferenca	R/ %
602	**Mallra dhe shërbime të tjera**				
6020	**Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme**	**1,300,000**	**1,871,167**	**(571,167)**	**144**
6020100	Kancelari	800,000	862,140	(62,140)	108
6020200	Materiale për pastrim, ngrohje	200,000	188,400	11,600	94
6020300	Materiale për funks e paisjeve të zyrës Tonera				
6020400	Materiale për funksionimin e paisjeve speciale				
6020500	Blerje dokumentacioni		178,800	(178,800)	
6022010	Shpenzime të printimit dhe publikimit		345,600	(345,600)	
6020900	Furnizime dhe materialet të tjera zyre	300,000	296,227	3,773	103
6021	Shpenzime për softe informatike				
6022	**Shërbime nga të tretët**	**440,000**	**417,416**	**22,584**	**95**
6022001	Elektricitet	120,000	124,418	(4,418)	104
6022002	Ujë				
6022003	Telefon dhe faks	130,000	133,377	(3,377)	103
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	190,000	172,888	17,112	91
6022005	Shërbim ngrohjeje				
6022009	Shërbime të gjelbërimit				
6022099	Shërbime të tjera (Interneti)	120,000	111,151	8,849	93
6023	**Shpenzime transporti**	**1,210,000**	**1,580,520**	**(370,520)**	**131**
6023100	Karburant	960,000	960,000	0	100
6023100	Vaj	400,000	377,647	22,353	94
6023200	Goma	120,000	119,760	240	100
6023200	Bateri				
6023300	Shpenzime siguracioni	130,000	123,113	6,887	95
6023200	Pjesë këmbimi				
6023200	Filtra për automjetet				
6023900	Të tjera				
6024	**Shpenzime udhëtimi**	**5,500,000**	**6,395,866**	**(895,866)**	**116**
6024000	Udhëtim i brendshëm	5,500,000	6,395,866	(895,866)	116
6024000	Udhëtim i jashtëm				
6025	**Shpenzime mirëmbajtje**	**500,000**	**649,505**	**(149,505)**	**130**
6025200	Shpenzime për mirmb e objekteve ndërtimore	400,000	405,700	(5,700)	101
6025300	Shpenzime për mirmb e rrjeteve hidraulike				
6025300	Shpenzime për mirmb e rrjetit elektrike		82,205	(82,205)	
6025300	Shpenzime për mimb e ashensorit		86,000	(86,000)	
6022009	Shpenzime për mirmb e pastrim gjelbërimit				
6025400	Shpenzime për mirmb e mjeteve të tranpsortit				
6025800	Shpenzime për mirmb e paisjeve të zyrave	100,000	75,600	24,400	76
6029	**Shpenzime të tjera operative**	**2,150,000**	**2,612,197**	**(462,197)**	**121**
6029007	Shpenz për pjesmarrje në konferenca dhe seminare	2,000,000	2,466,613	(466,613)	123
6029008	Shpenz për tatime dhe taksa të papaguara				
6029002	Shpenz për aktivitete sociale				
6029099	Shpenz të tjera materiale dhe shërbime operative	150,000	145,584	4,416	97
	Total	**11,100,000**	**13,526,671**	**(2,426,671)**	**122**
	Shtesë Fondi	*3,000,000*			
	Rialokim Fondi	*(573,310)*			

	Totali	*13,526,690*	**13,526,671**	**19**	**100**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

Zbatimi i shpenzimeve operative në vitin 2017, ka rezultuar në masën 100%, ku janë planifikuar shpenzime për materiale dhe shërbime të përgjithshme në vlerën prej 1,170,000 lekë dhe janë realizuar në masën 98%. Janë planifikuar shërbime nga të tretët në vlerën prej 640,000 dhe janë realizuar në masën 100%. Shpenzimet e transportit janë planifikuar në vlerën prej 1,110,000 lekë dhe janë realizuar në masën 100%. Shpenzimet e udhëtimit janë planifikuar në vlerën prej 7,000,000 dhe janë realizuar në masën prej 100%

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative, në lekë.

Nr.	Emërtimi	P/Vjetor	Fakti	Diferenca	R/ %
602	**Mallra dhe shërbime të tjera**				
6020	**Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme**	**1,170,000**	**1,142,186**	**27,814**	**98**
6020100	Kancelari	650,000	645,600	4,400	99
6020200	Materiale për pastrim, ngrohje	250,000	248,400	1,600	99
6020300	Materiale për funks e paisjeve të zyrës Tonera	150,000	131,186	18,814	87
6020400	Materiale për funksionimin e paisjeve speciale				
6020500	Blerje dokumentacioni				
6022010	Shpenzime të printimit dhe publikimit				
6020900	Furnizime dhe materialet të tjera zyre	120,000	117,000	3,000	98
6021	Shpenzime për softe informatike				
6022	**Shërbime nga të tretët**	**640,000**	**638,821**	**1,179**	**100**
6022001	Elektricitet	150,000	156,720	-6,720	104
6022002	Ujë	50,000	47,278	2,722	95
6022003	Telefon dhe faks	120,000	125,955	-5,955	105
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	100,000	90,710	9,290	91
6022005	Shërbime printimi për këshillin konsultativ	120,000	116,372	3,628	97
6022009	Shërbime të gjelbërimit				
6022099	Shërbime të tjera (Interneti)	100,000	101,786	-1,786	102
6023	**Shpenzime transporti**	**1,110,000**	**1,108,364**	**1,636**	**100**
6023100	Karburant	960,000	959,420	580	100
6023100	Vaj				
6023200	Goma				
6023200	Bateri				
6023300	Shpenzime siguracioni	150,000	148,944	1,056	99
6023200	Pjesë këmbimi				
6023200	Filtra për automjetet				
6023900	Të tjera				
6024	**Shpenzime udhëtimi**	**7,000,000**	**7,012,147**	**-12,147**	**100**
6024000	Udhëtim i brendshëm	6,500,000	6,413,347	86,653	99
6024000	Udhëtim i jashtëm	500,000	598,800	-98,800	120
6025	**Shpenzime mirëmbajtje**	**1,765,000**	**1,743,576**	**21,424**	**99**
6025200	Shpenzime për mirmb e objekteve ndërtimore	530,000	522,000	8,000	98
6025300	Shpenzime për mirmb e rrjeteve hidraulike	100,000	93,240	6,760	93
6025300	Shpenzime për mirmb e rrjetit elektrike	85,000	80,080	4,920	94
6025300	Shpenzime për mimb e ashensorit				
6022009	Shpenzime për mirmb e pastrim gjelbërimit	550,000	543,596	6,404	99
6025400	Shpenzime për mirmb e mjeteve të tranpsortit	500,000	504,660	-4,660	101
6025800	Shpenzime për mirmb e paisjeve të zyrave				
6029	**Shpenzime të tjera operative**	**2,018,300**	**2,058,122**	**-39,822**	**102**
6029007	Shpenz për pjesmarrje në konferenca dhe seminare	2,000,000	2,041,322	-41,322	102
6029008	Shpenz për tatime dhe taksa të papaguara	15,000	15,000	0	100
6029002	Shpenz për aktivitete sociale				
6029099	Shpenz të tjera materiale dhe shërbime operative	3,300	1,800	1,500	55
	Total	**13,703,300**	**13,703,216**	**84**	**100**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

Zbatimi i shpenzimeve operative në vitin 2018, ka rezultuar në masën 100%, ku janë planifikuar shpenzime për materiale dhe shërbime të përgjithshme në vlerën prej 1,850,000 lekë dhe janë realizuar në masën 91%. Janë planifikuar shërbime nga të tretët në vlerën prej 830,000 dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet e transportit janë planifikuar në vlerën prej 1,100,000 lekë dhe janë realizuar në masën 99%. Shpenzimet e udhëtimit janë planifikuar në vlerën prej 6,600,000 dhe janë realizuar në masën prej 99%

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative, në lekë.

Nr.	Emërtimi	P/Vjetor	Fakti	Diferenca	R/ %
602	**Mallra dhe shërbime të tjera**				
6020	**Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme**	**1,850,000**	**1,675,644**	**174,356**	**91**
6020100	Kancelari	600,000	538,840	61,160	90
6020200	Materiale për pastrim, ngrohje	150,000	121,164	28,836	81
6020300	Materiale për funks e pajisjeve të zyrës Tonera	500,000	449,640	50,360	90
6020400	Materiale për funksionimin e paisjeve speciale				
6020500	Blerje dokumentacioni				
6022010	Shpenzime të printimit dhe publikimit				
6020900	Furnizime dhe materialet të tjera zyre	600,000	566,000	34,000	94
6021	Shpenzime për softe informatike				
6022	**Shërbime nga të tretët**	**830,000**	**812,672**	**17,328**	**98**
6022001	Elektricitet	200,000	206,707	-6,707	103
6022002	Ujë	160,000	152,026	7,974	95
6022003	Telefon dhe faks	80,000	77,444	2,556	97
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	220,000	211,295	8,705	96
6022005	Shërbime printimi për këshillin konsultativ	120,000	117,600	2,400	98
6022009	Shërbime të gjelbërimit				
6022099	Shërbime të tjera (Interneti)	50,000	47,600	2,400	95
6023	**Shpenzime transporti**	**1,100,000**	**1,094,319**	**5,681**	**99**
6023100	Karburant	960,000	960,000	0	100
6023100	Vaj				
6023200	Goma				
6023200	Bateri				
6023300	Shpenzime siguracioni	140,000	134,319	5,681	96
6023200	Pjesë këmbimi				
6023200	Filtra për automjetet				
6023900	Të tjera				
6024	**Shpenzime udhëtimi**	**6,600,000**	**6,512,677**	**87,323**	**99**
6024000	Udhëtim i brendshëm	6,600,000	6,512,677	87,323	99
6024000	Udhëtim i jashtëm				
6025	**Shpenzime mirëmbajtje**	**1,660,000**	**1,545,896**	**114,104**	**93**
6025200	Shpenzime për mirmb e objekteve ndërtimore	500,000	477,276	22,724	95
6025300	Shpenzime për mirmb e rrjeteve hidraulike	160,000	152,160	7,840	95
6025300	Shpenzime për mirmb e rrjetit elektrike				
6025400	Shpenzime për larje automjetesh	50,000	40,800	9,200	82
6022009	Shpenzime për mirmb e pastrim gjelbërimit				
6025400	Shpenzime për mirmb e mjeteve të tranpsortit	400,000	367,060	32,940	92
6025800	Shpenzime për mirmb e paisjeve të zyrave	550,000	508,600	41,400	92
6029	**Shpenzime të tjera operative**	**1,550,000**	**1,336,248**	**213,752**	**86**
6029007	Shpenz për pjesmarrje në konferenca dhe seminare	1,500,000	1,296,248	203,752	86
6029008	Shpenz për tatime dhe taksa të papaguara				
6029002	Shpenz për aktivitete sociale				
6029099	Shpenz të tjera materiale dhe shërbime operative	50,000	40,000	10,000	80
	Total	**13,590,000**	**12,977,456**	**612,544**	**95**
	Rialokim Fondi nga 602 te 600	*(573,310)*			
	Totali	*13,010,000*	**12,977,456**	**32,544**	**100**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

Zbatimi i shpenzimeve operative në vitin 2019, ka rezultuar në masën 92%, ku janë planifikuar shpenzime për materiale dhe shërbime të përgjithshme në vlerën prej 1,750,000 lekë dhe janë realizuar në masën 94%. Janë planifikuar shërbime nga të tretët në vlerën prej 991,000 dhe janë realizuar në masën 74%. Shpenzimet e transportit janë planifikuar në vlerën prej 1,400,000 lekë dhe janë realizuar në masën 97%. Shpenzimet e udhëtimit janë planifikuar në vlerën prej 6,552,000 ku përbëhet vetëm udhëtim i brendshëm me të njëjtën vlerë dhe paraqitet niveli i realizimit në masën prej 99.9%

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative, në lekë.

Nr.	Emërtimi	P/Vjetor	Fakti	Diferenca	R/ %
602	**Mallra dhe shërbime të tjera**				
6020	**Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme**	**1,750,000**	**1,643,624**	**106,376**	**94**
6020100	Kancelari	400,000	365,888	34,112	91
6020200	Materiale për pastrim, ngrohje	300,000	253,152	46,848	84
6020300	Materiale për funks e paisjeve të zyrës Tonera	250,000	246,000	4,000	98

6020400	Materiale për funksionimin e paisjeve speciale	100,000	96,000	4,000	96
6020500	Blerje dokumentacioni	250,000	238,584	11,416	95
6020900	Furnizime dhe materialet të tjera zyre	450,000	444,000	6,000	98
6022	**Shërbime nga të tretët**	**991,000**	**733,159**	**257,841**	**74**
6022001	Elektricitet	200,000	172,709	27,291	86
6022002	Ujë	200,000	149,329	50,671	75
6022003	Telefon dhe faks	120,000	103,607	16,393	86
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	200,000	137,550	62,450	69
6022005	Shërbim ashensori	23,000	22,140	860	96
6022009	Shërbime të gjelbërimit	150,000	116,464	33,536	78
6022099	Shërbime të tjera (Interneti)	98,000	31,360	66,640	32
6023	**Shpenzime transporti**	**1,400,000**	**1,358,707**	**41,293**	**97**
6023100	Karburant	1,100,000	1,079,300	20,700	98
6023100	Vaj				
6023200	Goma	150,000	120,000	30,000	80
6023200	Bateri				
6023300	Shpenzime siguracioni	150,000	159,407	(9,407)	106
6023200	Pjesë këmbimi				
6023200	Filtra për automjetet				
6023900	Të tjera				
6024	**Shpenzime udhëtimi**	**6,552,000**	**6,544,420**	**7,580**	**99.9**
6024000	Udhëtim i brendshëm	6,552,000	6,544,420	7,580	99.9
6024000	Udhëtim i jashtëm				
6025	**Shpenzime mirëmbajtje**	**1,561,000**	**1,113,315**	**447,685**	
6025200	Shpenzime për mirmb e objekteve ndërtimore	720,000	356,364	363,636	50
6025300	Shpenzime për mirmb e paisjeve të zyrave	250,000	236,600	13,400	95
6025400	Shpenzime për larje automjetesh	91,000	78,951	12,049	87
6025600	Shpenzime për mirmb e mjeteve të transportit	500,000	441,400	58,600	88
6029	**Shpenzime të tjera operative**	**817,000**	**525,843**	**291,157**	
6029007	Shpenz për pjesmarrje në konferenca dhe seminare	800,000	504,650	295,350	63
6029008	Shpenz për tatime dhe taksa të papaguara	17,000	15,069	1,931	89
6029002	Shpenz për aktivitete sociale				
6029099	Shpenz të tjera materiale dhe shërbime operative		6,124	(6,124)	
	Total	**12,898,000**	**11,919,068**	**978,932**	**92**

Burimi i informacionit: AMVV, Punoi: KLSH

3.1/d Zbatimi i buxhetit me destinacion fondet e investimeve.

Zbatimi i planit të investimeve në vitin 2015, ka rezultuar në masën 5 %, ku janë planifikuar shpenzime për investime në vlerën prej 94,680,000 lekë dhe janë realizuar vetëm shpenzimet për investimet e ambienteve të zyrave në godinë në vlerën prej 4,483,542 lekë. Diferenca që nuk është shpenzuar është prej 90,180,000 lekë e cila përbën vlerën e fondit për programin "*Shqipëria Dixhitale si pjesë e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve*" ku me vendim të këshillit të ministrave nr.40, datë 16.10.2015, Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (sot AMVV) për vitin 2015 i është akorduar vlera e projektit për 90,180,000 lekë.

Në nivelin e mosrealizimeve pra ka ndikuar projekti "*Shqipëria Dixhitale*" fondi i alokuar gjatë vitit buxhetor dhe që është realizuar në masën 0 %.

Zbatimi i planit të investimeve në vitin 2016, ka rezultuar në masën 97 %. Gjatë këtij viti niveli i realizimit të investimeve ka rezultuar në nivele optimale. Me nivel të lartë realizimi paraqitet projekti "*Shqipëria Dixhitale*", ku me shkresën nr.8173 datë 15.06.2016 të Ministrisë së Financave ku specifikohet për projektet për financim për programin Shqipëria Dixhitale të cilat kanë rezultuar të papërdorura në fund të vitit 2015, miratohet kalimi i këtyre fondeve në planin e vitit 2016, dhe realizimi i këtij projekti rezulton në masën 97 %.

Zbatimi i planit të investimeve në vitin 2017, ka rezultuar në masën 11% ku janë planifikuar shpenzime për investime në vlerën prej 275,186,800 lekë dhe janë realizuar vetëm shpenzimet për investimet e ambienteve të zyrave në godinë në vlerën prej 1,778,730 lekë. Diferenca që nuk është shpenzuar është prej 273,236,800 lekë e cila përbën vlerën e fondit për projektin "Star 2" ku Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (sot AMVV) për vitin 2017 i është akorduar vlera e projektit për 70,357,000 lekë me nivel realizimi 0%. Mosrealizimi ka ardhur si shkak i mosparaqitjes së situacioneve të shpenzimit në lidhje më projektin Star 2. Ndërsa vlera tjetër prej 200,000,000 lekë i është akorduar Agjencisë për Zbatimin e Reformës

Territoriale (sot AMVV) nga Marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane mbi Programin për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal (dldp), ku sipas marrëveshjes deri më 31 Dhjetor 2017 Qeveria e Konfederatës Zvicerane synon të parashikojë fonde në formë të një granti të parimbursueshëm në vlerën maksimale prej CHF 7,280,000 (franga zvicerane). Niveli i realizimit ka qenë 0% ,ka ardhur si shkak i mosparaqitjes së situacioneve përkatëse në Agjencinë për Zbatimin e Reformës Territoriale (sot AMVV). Sipas AMVV-së rezulton se në 01.11.2017 ka kaluar me buxhet në vartësi të Ministrisë së Brendshme dhe bashkë me kalimin e fondeve nga Kryeministria te Ministria e Brendshme kanë kaluar në llogarit të AZRT-së (Agjencisë për zbatimin e reformës territoriale). Këto shuma nuk u përdorën nga AZRT dhe ju rikthyen Ministrisë së Financave në fund të vitit 2017 për ti kaluar destinacioneve të caktuara për këtë qëllim.
Zbatimi i planit të investimeve në vitin 2018, ka rezultuar në masën 99 %. Gjatë këtij viti niveli i realizimit të investimeve ka rezultuar në nivele optimale.
Zbatimi i planit të investimeve në vitin 2019, ka rezultuar në masën 98 %. Gjatë këtij viti niveli i realizimit të investimeve ka rezultuar në nivele optimale

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin që: *Mosrealizimi i shpenzimeve për investime në nivel projekti gjatë vitit 2015, 2016 dhe 2017, ka patur si shkak kryesor fillimin e projekteve të investimeve gjatë vitit buxhetor, gjë e cila shkakton mos realizimin e tyre në kohën e duhur, si për shkak të procedurave të prokurimit, po ashtu edhe për shkak se realizimi i tyre kërkon kohën e duhur, si dhe për shkak se nuk janë paraqitur situacionet e shpenzimeve përkatëse.*

Për sa më sipër bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "P*ër menaxhimin financiar dhe kontrollin*" me ndryshime, neni 9 dhe neni 12, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të buxhetit"* Kapitulli II.2 "*Buxheti i shtetit*", Rishpërndarja e fondeve buxhetore, pika 75.

Titulli i Gjetjes:	Mbi planifikimin dhe detajimin e rishpërndarjen e fondeve, në përputhje me kriteret e paracaktuara, kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.
Situata 1:	Nga auditimi mbi planifikimin, detajimin, rishpërndarjen dhe realizimin e fondeve buxhetore nëse është në përputhje me kriteret e paracaktuara, kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi rezultoi se: - Gjatë viteve buxhetore kërkesat për rishpërndarje fondesh nga AMVV, jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, në përputhje me kriteret e paracaktuara në udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 me ndryshime; - Janë kryer rishpërndarje fondesh gjatë vitit ushtrimor, transferimet e fondeve për investime (*fondet për investime shtuar në vitin 2016 në vlerën 78,454,150 lekë*), ku u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve. Kjo tregon gjithashtu, për një performancë jo të mirë të planifikimit të buxhetit, referuar kritereve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012. -Nga auditimi rezulton se janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhat e fundit të vitit ushtrimor, gjë e cila shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të arkës, që është një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit. - Urdhër Shpenzimet (13) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2015 në vlerën totale 4,655,856 lekë.

	- Urdhër Shpenzimet (10) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2016 në vlerën totale 77,786,967 lekë. - Urdhër Shpenzimet (11) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2018 në vlerën totale 3,078,422 lekë. - Urdhër Shpenzimet (16) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2015 në vlerën totale 1,814,108 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "P*ër menaxhimin financiar dhe kontrollin*" me ndryshime, neni 9 dhe neni 12, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të buxhetit"* Kapitulli II.2 "*Buxheti i shtetit*", Rishpërndarja e fondeve buxhetore, pika 75.
Ndikimi/Efekti	Përqendrimi i likuidimit të shpenzimeve në periudha të caktuara të vitit buxhetor, sidomos në muajin dhjetor, shkakton vështirësi në nivelin e likuiditetit të buxhetit të shtetit. Zvarritje e procedurave të prokurimit, të realizimit të investimeve publike në kohë, likuidimi i tyre brenda vitit ushtrimor për shkak të mos transferimit të tyre në vitin buxhetor pasardhës.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të marrë masa planifikimin, detajimin, rishpërndarjen dhe realizimin e fondeve buxhetore duke i shoqëruar me analiza, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Në vijimësi*

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:

AZRT (sot Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore) është krijuar në vitin 2015 dhe është viti i parë i aplikimit të Reformës Administrative Territoriale në vendin tonë, si i tillë planifikimi dhe detajimi i fondeve për llogarinë 602 ishte me rezervë. Teprica e fondeve në fund të vitit 2015 në llogarinë 600 dhe 601 është si rezultat e mos plotësimit të stafit të AZRT nga 12 punonjës në 8 punonjës. Për vitet 2016, 2017 ,2018 dhe 2019, planifikimi dhe detajimi është bërë duke marrë parasysh vijimësinë e vitit të mëparshëm. Fondet për investime institucioni ynë i ka në vlera të vogla ndërsa fondet për likuidim TVSH , janë çelur me akte normative. Për vitin aktual nuk kemi fonde për investime, pasi nuk janë më të nevojshme me aq punonjës sa jemi.

Përsa i përket fondeve të projekteve ato kanë ardhur në nëntor të vitit 2017 kur u bë kalimi nga Kryeministria në Ministrinë e Brendshme dhe ishin fonde në kapitullin 02 pa asnjë dokumentacion shpjegues, në këtë mënyrë nuk kishim si ti përdornim dhe ju kthyen buxhetit të shtetit në fund të vitit ushtrimor. Fonde të tjera të programeve kur na janë vënë në dispozicion nga ana e AMVV nuk ka patur asnjë herë neglizhencë për likuidim, por vonesa apo mos likuidimi i tyre është bërë për arsye për mos dorëzim i dokumentacionit shoqërues nga ana e projekteve.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është institucion vartësie dhe nuk ka të drejtë të dërgojë pranë MF raportet e monitorimit të shpenzimeve dhe informacionet e performancës , por AMVV ja ka dërguar Ministrisë së Brendshme dhe kjo e fundit ja dërgon Ministrisë së Financave, ashtu sikur plani i buxhetit na vjen nga MB jo nga MF.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:
...Në lidhje me shpjegimet e paraqitura, referuar kapitullit nr.2 të Udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pikave nr.54 ku përcaktohet se *"Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore mbështetur në informacionin e marrë nga Nëpunësi i Parë Autorizues, krahasojnë buxhetin e planifikuar me buxhetin e miratuar për njësinë që mbulojnë, dhe organizojnë procesin e detajimit të fondeve për organin qendror dhe për njësitë e vartësisë"*, pika nr.55 ku përcaktohet *se "Nëpunësit autorizues të nivelit të dytë, për njësitë e vartësisë direkt nga Titullari: e. krahasojnë buxhetin e miratuar, të dërguar nga nëpunësi autorizues me buxhetin e planifikuar dhe bëjnë rregullimet përkatëse në rastet kur ka ndryshime; f. bëjnë detajimin e buxhetit vjetor si edhe të tavaneve për dy vitet e tjera buxhetore të miratuara në ligjin e buxhetor vjetor, për të gjitha nivelet e njësisë shpenzuese që drejtojnë (nëse ka nivele të tjera vartësie), sipas klasifikimit buxhetor deri në nivel artikulli dhe e dërgojnë zyrtarisht dhe në formë elektronike tek nëpunësi autorizues"* dhe pika nr.56 ku përcaktohet se *"Nëpunësi autorizues, mbështetur nga nëpunësi zbatues dhe drejtuesit e programeve, kryen të njëjtat kontrolle si më lart dhe miraton dokumentin e detajimit të buxhetit për njësinë e qeverisjes qendrore"* shpjegojnë qartë mos analizimin e duhur nga ana juaj përsa i përket rishpërndarjes së fondeve prandaj komentet e paraqitura prej jush nuk merren në konsideratë.
Në lidhje me shpjegimet e paraqitura për raportin e monitorimit të shpenzimeve dhe informacionet e performancës merren pjesërisht në konsideratë si njësi në vartësi të Ministrisë së Brendshme duke e dërguar te kjo e fundit, por vihet re mos publikimi i raportit të monitorimit të shpenzimeve në faqen web të AMVV-së.

2/A. Në zbatim të pikës "B" mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, ligjshmërinë dhe rregullaritetin e shpenzimeve të programit të auditimit nr.924/1, datë 18.11.2019, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Për vitin 2017

Nga auditimi me të zgjedhur i veprimeve nëpërmjet Bankës (Urdhër shpenzimeve).

a. Për 9 raste për periudhën e vitit 2017dhe një rast për periudhën e vitit 2018 urdhrat për kryerjen e shpenzime për pjesëmarrje në seminare ***në vlerën 2,282,570 lekë****, janë nënshkruar nga* ***z. A.S.****, ish drejtor i përgjithshëm i Agjencisë të Reformës Territoriale në cilësinë e Nëpunësi autorizues dhe* ***z. S.P.****, ish Përgjegjësit i Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale, në cilësinë e Nëpunësit zbatues.*

Në formë tabelore kryerja e shpenzimeve për pjesëmarrje në seminare për vitin 2017 paraqitet:

Nr	Urdhri i brendshëm i Drejtorit Përgjit		Urdhër shpenzimi			Fatura tatimore		Subjekti	Adresa	Tematike e takimeve
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Në lekë	Nr.	datë			
1	220	4.11.17	142	05.12.17	178,360	6235	01.11.17	G...	Tiranë	Takim kombëtar i këshillit konsultativ
2	16	16.01.18	4	16.01.18	241,248	256	16.01.18	M...	Pogradec	Takim pune 2 ditor për analizën e punës së AZRT-së
3	52	16.03.17	31	17.03.17	279,936	42	05.03.17	M...	Pogradec	Takim rajonal informues financimi i projekteve për zhvillimin e bujqësisë
4	23	10.02.17	13	10.02.17	51,000	16	30.01.17	Ç...shpk	Gjirokastër	Takimi 2 ditor mbi planin e punës për vitin 2017
5	232	06.12.17	145	11.12.17	470,448	17	07.12.17	Hotel M...	Tiranë	Takim ditor informues dhe trajnues në lidhje me funksionin e menaxhimit të ujitjes dhe kullimit

6	*232*	*06.12.17*	*144*	*07.12.17*	*470,448*	*99*	*01.12.17*	*Hotel M...*	*Tiranë*	*Takim 1 ditor me përfaqësues të 61 Bashkive mbi menaxhimin e pyjeve dhe kullotave*
7					*419,630*	*Thesar*	*30.05.17*			*Kosto Trajnimi*
8					*34,500*		*22.07.17*	*I.K.*		*Kosto Trajnimi*
9					*35,000*		*28.02.17*	*The P..*	*Tiranë*	*Kosto Trajnimi*
10					*54,000*		*10.02.17*	*H.K.*		*Kosto Trajnimi*
					48,000		*10.02.17*	*E.T.*		*Kosto Trajnimi*
Totali i Urdhër shpenzimeve					***2,282,570***					

Shpenzime për Seminare. Institucioni gjatë vitit 2017 ka shpenzuar në total **vlerën 2,282,570** lekë, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare*". Likuidimi i kësaj vlerë është kryer gjatë vitit në 10 raste dhe **konkretisht**:

1-U/Shpenzimi nr.142, datë 05.12.2017 në shumën **178,360 lekë**, likuiduar subjekti privat "G..." Tiranë, për "*Takim kombëtar i këshillit konsultativ".*

2-U/Shpenzimi nr.31, datë 17.03.17 në shumën **279,936 lekë**, likuiduar subjekti privat "M... shpk" Pogradec, për "*takim rajonal informues financimi I projekteve për zhvillimin e bujqësisë".*

3-U/Shpenzimi nr.13, datë 10.02.17 në shumën **51,000 lekë**, likuiduar subjekti "Ç... Hotel Turizmi shpk" Gjirokastër, "*takimi 2 ditor mbi planin e punës për vitin 2017".*

4-U/Shpenzimi nr.145, datë 11.12.17 në **shumën 470,448 lekë**, likuiduar subjekti "Hotel M... shpk" Tiranë, me temë "*Takim 1 ditor informues dhe trajnues në lidhje me funksionin e menaxhimit të ujitjes dhe kullimit"*

5-U/Shpenzimi nr.144, datë 07.12.17 në shumën **470,448 lekë**, likuiduar subjekti "Hotel M... shpk" Tiranë, me temë "*Takim 1 ditor me përfaqësues të 61 Bashkive mbi menaxhimin e pyjeve dhe kullotave".*

6-U/Shpenzimi nr.63 datë 30.05.2017 në shumën **419,630 lekë**, likuiduar subjekti "Hotel M... shpk" Tiranë, me temë "*Takim 1 ditor me drejtues të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së rrugëve rurale".*

7-Veprimi kaluar në Thesar më dt.22.07.2017 në shumën **34,500 lekë**, likuiduar subjekti "I. K."

8-Veprimi kaluar në Thesar më dt.28.02.2017 në shumën **35,000 lekë**, likuiduar subjekti "Th P...", Tiranë.

9-Veprimi kaluar në Thesar më dt.10.02.2017 në shumën **54,000 lekë**, likuiduar subjekti "H.K."

10-Veprimi kaluar në Thesar më dt.10.02.2017 në shumën **48,000 lekë**, likuiduar subjekti "Ë.T>".

Për vlerat e mësipërme të likuiduara sa i përket dokumentimit të procedurës, konstatojmë se,

1- Me urdhër shpenzimin nr.142, **datë 05.12.2017, është shpenzuar vlera 178,360 lekë**, likuiduar subjektit privat "*G...*" Pogradec, sipas faturës tatimore nr. 6235, datë 01.11.2017, për Takimin 1 ditor të Këshillit Konsultativ.

Bazuar në dokumentacionin e procedurës evidentojmë se, likuidimi i vlerës së mësipërme është kryer sipas urdhrit të brendshëm të ish Titullarit të AMVV (A. Shkëmbi) nr.220, datë 04.11.2017 në të cilin është urdhëruar që, "*Të bëhet pagesa për qiranë e sallës, mikrofonat, projektorin dhe koktejin për zhvillimin e mbledhjes të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore në ambientet e "G..." shpk në datën 1 nëntor 2017sipas faturës tatimore të subjektit"*. Në këtë shpenzim janë përfshirë, qira salle 47,600 lekë, mikrofona sistem konferencë 11,200 lekë, koktej 60 persona 109,200 lekë, projektor 7,000 lekë.

Nisur nga dokumentacioni që shoqëron urdhër shpenzimin (përshkruar më sipër) rezulton se, shpenzimi nuk është i shoqëruar me dokumentacionin që justifikon kryerjen në fakt të shpenzimit e konkretisht,

- likuidimi është kryer nga fondet e akorduara në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare*", ndërkohë që objekti i shpenzuar është për analizë pune dhe nuk përfshihet në objektin e artikullit 602/9009.
- Vlera e shpenzuar nuk është përfshirë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve. Pra institucioni nuk ka kryer ndonjë procedurë prokurimi me blerje me vlera të vogla në mënyrë që të përzgjidhej OE ku do të realizohej ky shpenzim dhe nuk ka ndonjë kontratë apo marrëveshje të nënshkruar më parë për kryerjen e shërbimit në subjektin privat, por është likuiduar me urdhër të brendshëm nr.220, datë 04.11.2017 të ish Drejtorit të AZRT-së, pa u hartuar dhe miratuar më parë preventivi i shpenzimeve dhe analiza e çmimeve të tregut mbi të cilën të përllogaritej fondi për tu shpenzuar.
- **Nuk është përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë.**
-likuidimi është kryer sipas faturës tatimore nr.6235, datë 01.11.2017 të subjektit privat e cila nuk shoqërohet me listën e personelit pjesëmarrës të nënshkruar.

2-Me urdhër shpenzimin nr.31, **datë 17.03.2017, është shpenzuar vlera 279,936 lekë**, likuiduar subjektit privat "*M... shpk*" Pogradec, sipas faturës tatimore nr.42, datë 05.03.2017, për pajisjen e fermerëve me tituj pronësi për tokat bujqësore.

Bazuar në dokumentacionin e procedurës evidentojmë se, likuidimi i vlerës së mësipërme është kryer sipas urdhrit të brendshëm të ish Titullarit të AMVV (A. S.) nr.52, datë 16.03.2017 në të cilin është urdhëruar që, "*Të bëhet pagesa për takimin 1 ditor në Pogradec, me administratorët e Njësive Administrative, kryepleq, përfaqësues të shoqatave dhe fermerë, në lidhje me regjistrimin e tokave bujqësore në zbatim të ligjit nr.7501,sipas faturës tatimore të subjektit për fjetje 1 natë për punonjësit e AZRT-së, një darkë për 16 persona dhe drekën për pjesëmarrësit"*. Në këtë shpenzim janë përfshirë, qira salle 12,000 lekë, fjetje në hotel 40,000 lekë për 16 persona dhe 176,320 lekë shpenzime ushqimi dreka, darka, kafe e uji për 87 persona.

Nisur nga dokumentacioni që shoqëron urdhër shpenzimin (përshkruar më sipër) rezulton se, shpenzimi nuk është i shoqëruar me dokumentacionin që justifikon kryerjen në fakt të shpenzimit e konkretisht.

-likuidimi është kryer nga fondet e akorduara në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare*", ndërkohë që objekti i shpenzuar është për analizë pune dhe nuk përfshihet në objektin e artikullit 602/9009.
-Vlera e shpenzuar nuk është përfshirë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2017, pra institucioni nuk ka kryer ndonjë procedurë prokurimi me blerje me vlera të vogla në mënyrë që të përzgjidhej OE ku do të realizohej ky shpenzim dhe nuk ka ndonjë kontratë apo marrëveshje të nënshkruar më parë për kryerjen e shërbimit në subjektin privat Pogradec, por është likuiduar me urdhër të brendshëm nr.52, datë 16.03.2017 të ish Drejtorit të AZRT-së, pa u hartuar dhe miratuar më parë preventivi i shpenzimeve dhe analiza e çmimeve të tregut mbi të cilën të përllogaritej fondi për tu shpenzuar.
-**Nuk është përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë, por është përcaktuar në urdhër vetëm numri 12 i personelit të AMVV.**
-likuidimi është kryer sipas faturës tatimore nr.42, datë 05.03.2017 të subjektit privat e cila jo vetëm që nuk është e nënshkruar nga personeli përgjegjës i AMVV-së por nuk shoqërohet me listën e personelit pjesëmarrës të nënshkruar.
-Sa i përket përllogaritjes në faturë të zërit "*Shpenzimeve ushqimi drekë e darkë*" në shumën 169,360 lekë, rezulton se kjo vlerë është llogaritur për 87 persona me çmimin 1,680 lekë/person, pa analizuar dhe justifikuar këtë shpenzim për menynë e përdorur si dhe personelin pjesëmarrës.

3 -Me urdhër shpenzimin nr.13, **datë 10.02.2017 është shpenzuar vlera 51,000 lekë**, likuiduar subjektit privat "*Ç... Hotel Turizmi shpk*" Gjirokastër, sipas faturës tatimore nr.16, datë 30.01.2017, për takimin mbi planin e punës në luftën kundër korrupsionit 2017.
Bazuar në dokumentacionin e procedurës evidentojmë se, likuidimi i vlerës së mësipërme është kryer sipas urdhrit të brendshëm të ish Titullarit të AMVV (A. S.) nr.23, datë 10.02.2017 në të cilin është urdhëruar që, "*Të bëhet pagesa për shpenzimet e takimit 2 ditor në Gjirokastër nga data 27-29 janar 2017, për akomodimin në hotel K... & Hotel K... & Hotel G..., si dhe darka datës 27.01.2017 dhe dreka e datës 28.01.2017 tek restorant Çajupi, dhe darka tek Taverna Kuka, sipas faturave përkatëse të lëshuara nga subjektet e sipërpërmendura.* Në këtë shpenzim janë përfshirë, darkë e dt.27.01.17 për 17 persona 25,500 lekë, dreka e dt.28.01.17 për 17 persona 25,500 lekë.
Nisur nga dokumentacioni që shoqëron urdhër shpenzimin (përshkruar më sipër) rezulton se, shpenzimi nuk është i shoqëruar me dokumentacionin që justifikon kryerjen në fakt të shpenzimit e konkretisht,
-likuidimi është kryer nga fondet e akorduara në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare*", ndërkohë që objekti i shpenzuar është për analizë pune dhe nuk përfshihet në objektin e artikullit 602/9009.
-Vlera e shpenzuar nuk është përfshirë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve. Pra institucioni nuk ka kryer ndonjë procedurë prokurimi me blerje me vlera të vogla në mënyrë që të përzgjidhej OE ku do të realizohej ky shpenzim dhe nuk ka ndonjë kontratë apo marrëveshje të nënshkruar më parë për kryerjen e shërbimit në subjektin privat Gjirokastër, por është likuiduar me urdhër të brendshëm nr.23, datë 10.02.2017 të ish Drejtorit të AZRT-së, pa u hartuar dhe miratuar më parë preventivi i shpenzimeve dhe analiza e çmimeve të tregut mbi të cilën të përllogaritej fondi për tu shpenzuar.
-**Nuk është përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë, por është përcaktuar në urdhër vetëm numri 17 i personelit të AMVV**.
-likuidimi është kryer sipas faturës tatimore nr.16, datë 30.01.2017 të subjektit privat e cila jo vetëm që nuk është e nënshkruar nga personeli përgjegjës i AMVV-së por nuk shoqërohet me listën e personelit pjesëmarrës të nënshkruar.
4-Me urdhër shpenzimin nr.145, **datë 11.12.2017 është shpenzuar vlera 470,448 lekë**, likuiduar subjektit privat "*Hotel M... shpk*" Tiranë, sipas faturës tatimore nr.17, datë 07.12.2017, për Takimin 1 ditor me përfaqësues të 61 Bashkive mbi informimin dhe trajnimin në lidhje me funksionimin e menaxhimit të ujit dhe kullimit.
Bazuar në dokumentacionin e procedurës evidentojmë se, likuidimi i vlerës së mësipërme është kryer sipas urdhrit të brendshëm të ish Titullarit të AMVV (A. S.) nr.232, datë 06.12.2017 në të cilin është urdhëruar që, "*Të bëhet pagesa për qiranë e sallës, mikrofonat, projektorin pushim kafeje dhe drekën për zhvillimin e takimit informues dhe trajnues në lidhje me funksionimin e menaxhimit të ujit dhe kullimit në M... shpk sipas faturës tatimore të subjektit nr.17 datë 07.12.2017"*. Në këtë shpenzim janë përfshirë, qira salle 474euro, mikrofona sistem konferencë 100euro, drekë150 persona 1,950euro, projektor 50euro.
Nisur nga dokumentacioni që shoqëron urdhër shpenzimin (përshkruar më sipër) rezulton se, shpenzimi nuk është i shoqëruar me dokumentacionin që justifikon kryerjen në fakt të shpenzimit e konkretisht,
-likuidimi është kryer nga fondet e akorduara në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare*", ndërkohë që objekti i shpenzuar është për analizë pune dhe nuk përfshihet në objektin e artikullit 602/9009.
-Vlera e shpenzuar nuk është përfshirë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve. Pra institucioni nuk ka kryer ndonjë procedurë prokurimi me blerje me vlera të vogla në mënyrë që të përzgjidhej OE ku do të realizohej ky shpenzim dhe nuk ka ndonjë kontratë apo marrëveshje të nënshkruar më parë për kryerjen e shërbimit në subjektin privat, por është likuiduar me urdhër të brendshëm nr.232, datë 06.12.2017 të ish Drejtorit të AZRT-së, pa u

hartuar dhe miratuar më parë preventivi i shpenzimeve dhe analiza e çmimeve të tregut mbi të cilën të përllogaritej fondi për tu shpenzuar.
-Nuk është përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë.
-likuidimi është kryer sipas faturës tatimore nr.16, datë 07.12.2017 të subjektit privat e cila nuk shoqërohet me listën e personelit pjesëmarrës të nënshkruar.
5-Me urdhër shpenzimin nr.144, **datë 07.12.2017, është shpenzuar vlera 470,448 lekë**, likuiduar subjektit privat "*Hotel M... shpk*" Tiranë, sipas faturës tatimore nr.99, datë 01.12.2017, për Takimin 1 ditor me përfaqësues të 61 Bashkive mbi informimin dhe trajnimin në lidhje me funksionimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave.
Bazuar në dokumentacionin e procedurës evidentojmë se, likuidimi i vlerës së mësipërme është kryer sipas urdhrit të brendshëm të ish Titullarit të AMVV (A. S.) nr.232, datë 06.12.2017 në të cilin është urdhëruar që, "*Të bëhet pagesa për qiranë e sallës, mikrofonat, projektorin pushim kafeje dhe drekën për zhvillimin e takimit informues dhe trajnues në lidhje me funksionimin e menaxhimit të ujit dhe kullimit në Mondial shpk sipas faturës tatimore të subjektit nr.99 datë 01.12.2017"*. Në këtë shpenzim janë përfshirë, qira salle 474euro, mikrofona sistem konferencë 100euro, drekë150 persona 1,950euro, projektor 50euro.
Nisur nga dokumentacioni që shoqëron urdhër shpenzimin (përshkruar më sipër) rezulton se, shpenzimi nuk është i shoqëruar me dokumentacionin që justifikon kryerjen në fakt të shpenzimit e konkretisht,
-likuidimi është kryer nga fondet e akorduara në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare*", ndërkohë që objekti i shpenzuar është për analizë pune dhe nuk përfshihet në objektin e artikullit 602/9009.
-Vlera e shpenzuar nuk është përfshirë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve. Pra institucioni nuk ka kryer ndonjë procedurë prokurimi me blerje me vlera të vogla në mënyrë që të përzgjidhej OE ku do të realizohej ky shpenzim dhe nuk ka ndonjë kontratë apo marrëveshje të nënshkruar më parë për kryerjen e shërbimit në subjektin privat, por është likuiduara me urdhër të brendshëm nr.232, datë 06.12.2017 të ish Drejtorit të AZRT-së, pa u hartuar dhe miratuar më parë preventivi i shpenzimeve dhe analiza e çmimeve të tregut mbi të cilën të përllogaritej fondi për tu shpenzuar.
-Nuk është përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë.
-likuidimi është kryer sipas faturës tatimore nr.99, datë 01.12.2017 të subjektit privat e cila nuk shoqërohet me listën e personelit pjesëmarrës të nënshkruar.
6**. Me urdhër shpenzimin nr.4, datë 16.01.2018 është shpenzuar vlera 241,248 lekë**, likuiduara subjektit privat "*M... shpk*" Pogradec, sipas faturës tatimore nr.255, datë 08.01.2018, për analizë pune të AMVV për vitin 2017.
Bazuar në dokumentacionin e procedurës evidentojmë se, likuidimi i vlerës së mësipërme është kryer sipas urdhrit të brendshëm të ish Titullarit të AMVV (A. S.) nr.16, datë 16.01.2018 në të cilin është urdhëruar që, "*Të kryhet pagesa për qiranë e sallës, kafe, fjetje 1 natë për 12 persona, 1 drekë e 1 darkë për 87 persona, sipas faturës tatimore të subjektit si dhe një dokumenti (axhenda e veprimtarisë) e pa miratuar*". Në këtë shpenzim janë përfshirë, qira salle 12,000 lekë, fjetje në hotel 36,000 lekë për 12 persona dhe 193,140 lekë shpenzime ushqimi dreka, darka, kafe e uji për 87 persona.
Nisur nga dokumentacioni që shoqëron urdhër shpenzimin (përshkruar më sipër) rezulton se, shpenzimi nuk është i shoqëruar me dokumentacionin që justifikon kryerjen në fakt të shpenzimit e konkretisht,
-likuidimi është kryer nga fondet e akorduara në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare*", ndërkohë që objekti i shpenzuar është për analizë pune dhe nuk përfshihet në objektin e artikullit 602/9009.
-Vlera e shpenzuar nuk është përfshirë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve. Pra institucioni nuk ka kryer ndonjë procedurë prokurimi me blerje me vlera të vogla në mënyrë që të përzgjidhej OE ku do të realizohej ky shpenzim dhe nuk ka ndonjë kontratë apo marrëveshje të nënshkruar më parë për kryerjen e shërbimit në subjektin privat Pogradec, por

është likuiduar me urdhër të brendshëm nr.16, datë 16.01.2018 të ish Drejtorit të AZRT-së, pa u hartuar dhe miratuar më parë preventivi i shpenzimeve dhe analiza e çmimeve të tregut mbi të cilën të përllogaritej fondi për tu shpenzuar.
-Nuk është përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë, por është përcaktuar në urdhër vetëm numri 12 i personelit të AMVV.
-likuidimi është kryer sipas faturës tatimore nr.255, datë 08.01.2018 të subjektit privat e cila jo vetëm që nuk është e nënshkruar nga personeli përgjegjës i AMVV-së por nuk shoqërohet me listën e personelit pjesëmarrës të nënshkruar.
- -Sa i përket përllogaritjes në faturë të zërit "*Shpenzimeve ushqimi drekë e darkë*" në shumën 174,348 lekë, rezulton se kjo vlerë është llogaritur për 87 persona me çmimin 2,004 lekë/person, pa analizuar dhe justifikuar këtë shpenzim për menynë e përdorur si dhe personelin pjesëmarrës.

Titulli i Gjetjes:	*Janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje" në vlerën* ***2,282,570*** *lekë, pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik, dhe pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë.*
Situata 1:	Në 5 raste për periudhën e vitit 2017 *pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik*, janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje*" në vlerën **2,282,570** lekë, ku në urdhrin janë përcaktuar vetëm numri i personelit të AMVV *pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë*, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja"* të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.06.1999. Vlera e mësipërme do të konsiderohet përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në.
Kriteri:	Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, Neni 1-Objekti dhe qëllimi, Pika 1, paragrafi i II-të, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*". Pika *4*,VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" Neni 4 Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja*" të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 (Pasi ky vendim lejon pagesa për pritje përcjellje nga buxheti i shtetit, vetëm në pritjen e delegacioneve të huaj)
Ndikimi/Efekti	Janë përdorur fondet buxhetore në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Mos zbatimi i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik",* i ndryshuar, Neni 1-Objekti dhe qëllimi, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*". Pika *4,* mos njohje e VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja*" të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 (Pasi ky vendim lejon pagesa për pritje përcjellje nga buxheti i shtetit, vetëm në pritjen e delegacioneve të huaj. Vlera prej 2,282,570 lekë ka sjellë përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në
Rëndësia	I mesëm

Rekomandimi	Titullari i Autoritetit Kontraktor, të analizojë dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e shkeljeve të cilësuara më lart, me pasojë efekte financiare negative, në buxhetin e AMVV-në, i cili në rastin konkret rezulton në vlerën **2,282,570** lekë.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Menjëherë*

B. Për vitin 2018

Për 4 raste për periudhën e vitit 2018, urdhrat për kryerjen e shpenzimeve për pjesëmarrje në seminare në vlerën **1,055,500** lekë, janë nënshkruar nga z. B.M. drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore në cilësinë e Nëpunësi autorizues dhe z. nj. F.M. Përgjegjëse e Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale, në cilësinë e Nëpunësit zbatues.

Në formë tabelore kryerja e shpenzimeve për pjesëmarrje në seminare për vitin 2018 paraqitet:

Nr	*Urdhri i brendshëm i Drejtorit të Përgjithshëm*		*Urdhër shpenzimi*			*Fatura tatimore*		*Subjekti*	*Adresa*	*Tematike e takimeve*
	Nr	*Datë*	*Nr*	*Datë*	*Në lekë*	*Nr*	*datë*			
1	*843*	*18.12.18*	*167*	*20.12.18*	*344,400*	*1083*	*17.12.18*	*G... Shpk*	*Tiranë*	*Takim 1 ditor për analizën e praktikave më të mira të bashkive*
2	*845*	*21.12.18*	*171*	*21.12.18*	*287,000*	*19*	*20.12.18*	*L. H.*	*Fier*	*Takim 1 ditor për analizën e praktikave më të mira të bashkive*
3	*856*	*26.12.18*	*175*	*26.12.18*	*283,200*	*483*	*20.12.18*	*G. T.*	*Elbasan*	*Takim 1 ditor për analizën e praktikave më të mira të bashkive*
4	*730*	*19.11.18*	*146*	*20.11.18*	*140,400*	*9790*	*16.11.18*	*G... shpk*	*Tiranë*	*Takim mbivlerësimin afat mesëm të strategjisë ndërsektoriale*
		SHUMA			***1,055,000***					

<u>Shpenzime për Seminare.</u> Institucioni gjatë vitit 2018 ka shpenzuar në total vlerën **1,055,000** lekë, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009"*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare*". likuidimi i kësaj vlerë është kryer gjatë vitit me 5 urdhër shpenzime e konkretisht,

-U/Shpenzimi nr. 167, datë 20.12.18 në shumën **344,400 lekë** për seminar në Tiranë me temë "*Analiza e konkursit të praktikave më të mira*". (*Listat me 90 persona u paraqitën më datën 18.01.2010)*

-U/Shpenzimi nr.171, datë 21.12.18 në shumën **287,000 lekë** për seminar në Fier me temë "*Analiza e konkursit të praktikave më të mira*"

-U/Shpenzimi nr.175, datë 26.12.18 në shumën **283,200 lekë** për seminar në Elbasan me temë "*Analiza e konkursit të praktikave më të mira*".

-U/Shpenzimi nr.146, datë 20.11.18 në shumën **140,400 lekë**, për seminar në Tiranë me temë "*Vlerësimi afatmesëm të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore*".

Për vlerat e mësipërme të likuiduara sa i përket dokumentimit të procedurës, përdorimit me ekonomi dhe efektivitet evidentojmë se,

Si përfundim:

I. Pagesat për pjesëmarrje në seminare, në 9 raste për vitin 2017 dhe 1 rast për vitin 2018 për **shumën 2,282,570 lekë,** janë me efekt efekte financiare negative **për buxhetin e shtetit** për të cilën mbajnë përgjegjësi ***z. A.S.*** *ish drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në cilësinë e Nëpunësi autorizues dhe* ***z. S.P.*** *ish Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale, në cilësinë e Nëpunësit zbatues,*

Dhe,

II. Pagesat për pjesëmarrje në seminare, në 4 raste për vitin 2018 për shumën **1.055,500** lekë, *janë me efekt efekte financiare negative për buxhetin e shtetit, për të cilën mbajnë përgjegjësi z. B.M. drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në cilësinë e Nëpunësi autorizues dhe znj. F.M. Përgjegjëse e Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale, në cilësinë e Nëpunësit zbatues.*

Pasi këto shpenzime janë kryer në kundërshtim me:

1. VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja*" të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999;

2. Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar,

A . Neni 1 Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.

2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

B-neni 4-fusha e zbatimit, ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij.

3.Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar pikën 3, neni 11 ku përcaktohet se, "*Menaxherët e njësisë publike janë përgjegjës për garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiare të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë,…*";

4. Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar,* me pikën 35 shkronja(b e,)

5.Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*". Pika *4. Ku parashikohet se:* Autoriteti kontraktor planifikon që në fillim të vitit kalendarik natyrën, sasitë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë dhe i përfshin ato në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik Urdhri i Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013, i ndryshuar me urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014 "*Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe ta lartë";*

6. Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.9, datë 20.03.2018 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018*", * *për urdhrat e shpenzimeve të cilat janë kryer për vitin 2018,* pikën 165 ku përcaktohet se, "*Për të gjitha shpenzimet e kryera, nëpunësi zbatues kryen kontrollet para pagesës,…, kontrollon dokumentet origjinale të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit dhe kontrollet e tjera të nevojshme dokumentare*".

Titulli i Gjetjes:	*Janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për*

	pritje përcjellje" në vlerën ***1,055,500*** *lekë, pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik, dhe pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë.*
Situata 1:	Në 4 raste për periudhën e vitit 2018 *pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik*, janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje*" në vlerën **1,055,500** lekë, ku në urdhrin janë përcaktuar vetëm numri i personelit të AMVV *pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë*, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja"* të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.06.1999. Vlera e mësipërme do të konsiderohet përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në.
Kriteri:	Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, Neni 1-Objekti dhe qëllimi, Pika 1, paragrafi i II-të, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*". Pika *4*,VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" Neni 4 Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik'' VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja*" të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 (Pasi ky vendim lejon pagesa për pritje përcjellje nga buxheti i shtetit, vetëm në pritjen e delegacioneve të huaj)
Ndikimi/Efekti	Janë përdorur fondet buxhetore në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Mos zbatimi i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 1-Objekti dhe qëllimi, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*". Pika *4,* mos njohje e VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja"* të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 (Pasi ky vendim lejon pagesa për pritje përcjellje nga buxheti i shtetit, vetëm në pritjen e delegacioneve të huaj. Vlera prej 2,282,570 lekë ka sjellë përdorim të fondeve pa efektivitet për AMVV-në.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Titullari i Autoritetit Kontraktor, të analizojë dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e shkeljeve të cilësuara më lart, me pasojë efekte financiare negative, në buxhetin e AMVV-në, i cili në rastin konkret rezulton në vlerën **1,055,500** lekë.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Menjëherë*

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:

Për sa i përket shpenzimeve për pjesëmarrje në seminare për vitin 2018, të cilat janë parashikuar në buxhetin e vitit 2018 në zërin kosto e trajnimit dhe seminareve llogarinë 6022011 dhe është bërë përshkrimi në urdhër shpenzimin, bashkëlidhur është programi i seminarit, marrëveshja me DLDP e cila do të zhvillonte trajnime për konkursin e praktikave më të mira si dhe raportin përfundimtar të seminarit, në dy raste janë lista me pjesëmarrjen dhe dy të tjera nuk na është kthyer nga DLDP e cila

e mori për ti pajisur pjesëmarrësit me "Certifikatë Pjesëmarrje për trajnim të projekteve". rezultat i seminareve janë dhe fitues të praktikave me të mira , nga ku kemi 6 fitues tre me çmime të para dhe 3 me çmime të dyta, çmimi parë më 10 mijë euro dhe çmimi dytë 5 mijë euro. Çmimet e fituesve janë derdhur në llogarinë e Njësive Vendore të shpallura fituesve të praktikave më të mira nga ana e DLDP. Për vitin 2019, aktivitetet janë zhvilluar me procedurë prokurimi, me përcaktim numrit të pjesëmarrësve sipas ligjeve në fuqi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:
Pavarësisht se fondet kanë qenë të parashikuara në buxhet, por për përdorimin e këtyre fondeve buxhetore duhet të zbatohen procedurat e prokurimit të përcaktuara në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006" Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1-Objekti dhe qëllimi, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 03.6.1999, duhet të depozitoheshin listat e pjesëmarrësve (Pasi ky vendim lejon pagesa për pritje përcjellje nga buxheti i shtetit, vetëm në pritjen e delegacioneve të huaj), prandaj observacionet (komentet dhe sqarimet) nuk merren ne konsideratë, dhe për të ardhmen, të mos organizohen shpenzime për pjesëmarrje në seminare pa u zhvilluar procedura prokurimi.

II. Mbi disa mangësi që u konstatuan në lidhje me pagesat e shpenzimeve për udhëtim dhe dieta dhe harxhimit të karburantit për 3 mjetet që ka në funksionim AMVQV.
Nga ana e auditit të Ministrisë në mënyrë të përmbledhur është konstatuar se gjatë vitit 2018, për shërbime udhëtim e dieta brenda vendit janë shpenzuar në total 6,391,290 lekë. Për këto shërbime për udhëtim e dieta janë pajisur për secilin rast me autorizimin përkatës, të Drejtorit të Përgjithshëm, por nuk ishin të shoqëruara me programe pune dhe nuk është hartuar një relacioni apo raportimi të shoqëruar edhe me dokumentacionin e mbajtur në njësitë vendore sipas objektit të shërbimit. ***Qëllimi i shërbimit****: Për vlerësim dëmesh në bashkitë e përmbytura, vlerësim urash, takime pune për ecurinë e funksioneve të transferuara, verifikim pajisjeve kompjuterike pronë e AMVV, monitorim dhe kontrolli i ecurisë së grupeve të punës për sigurinë e plazheve sipas VKM nr. 315, datë 29.05.2018.Asistenca për buxhetin e vitit 2019.* Sa sipër duke qenë se auditimi i shpenzimeve për udhëtim e dieta për vitin 2018 ishin audituar nga Auditi i Ministrisë Brendshme, nuk u audituan nga grupi i auditimit të KLSH.

Këto mangësi në lidhje me pagesën për udhëtim e dietave u konstatuan edhe gjatë vitit 2017.
Grupi i auditimit të KLSH ***për udhëtim e dieta*** *auditoi me* ***zgjedhje për tremujorin e fundit vitin 2019, ku u konstatua se:***
Duke qene se Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore zbaton urdhrat e ndryshme të Kryeministrit, Ministrisë Brendshme, për mbështetjen që u jep Bashkive në fusha të ndryshme, si dixhitalizimi i arkivave të Bashkive, verifikimin e funksionimin e veprave kulluese, verifikimin e pasojave të tërmetit, etj. 14 punonjësit e Agjencisë dhe pjesën më të madhe të vitit janë në teren.
Për 11-mujorin të vitit 2019 janë shpenzuar për udhëtim dhe dieta në vlerën 5,552,839 lekë, nga auditimi rezulton se për vitin 2019 për secilin shërbim është pajisur me autorizimin me shkrim nga drejtori përgjithshëm sipas kërkesës së VKM nr. 997,datë 10.12.2010 "*Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës se punës brenda vendit"*. Kapitull V- ku përcaktohet se: Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga:
a-Titullari i njësisë shpenzuese. *Në disa raste faturat e fjetjes në hotel nuk janë nënshkruar nga personi i cili ka qenë me shërbim. Në mjaft raste dërgimi i personave me shërbim është bërë pa patur parasysh fushën që mbulon. Theksojmë se për periudhën e 11-mujorit të vitit 2019, janë korrigjuar konstatimet e Auditit të Brendshëm të Ministrisë Brendshme dhe në përfundim të secilin shërbim, përveç autorizimit është hartuar një raport i hollësishëm për qëllimin e shërbimit (bashkëlidhur fotokopje të një praktike të dërguar me shërbime cila*

përmban gjithë dokumentacionin argumentues). Megjithatë nga auditimi i disa urdhër shpenzimeve u konstatua se:

1. Me Urdhër shpenzimin nr. 15, datë 28.01.2019, udhëtim e dieta muaji janar 2019, nëpunës autorizues drejtori i përgjithshëm i AMVQV z. B.M., nëpunës zbatues znj. F.M., autorizimi nr. 105, datë 28.01.2019 për shërbim në qarkun e Fierit nga data 28.01.2019 deri 30.01.2019, **takim me kryetarët e bashkive për paketën fiskale të qarkut Fier**, nënshkruar nga z. B.M., Drejtor i Përgjithshëm i AMMV-së, punonjësi udhëtues z. **N.D.**, specialit pranë AMVV-së, edhe pse disponohet kuponi tatimor 01.02.2019, nuk ka nënshkruar faturën tatimore lëshuar nga hoteli "D..." me Nuis K....V, nr. 06 me serial nr. 70252107 datë 31.01.2019 për fjetje 2 net x 3000lekë/nata **= 6,000 lekë.**

Po kështu edhe **z. B.M.**, me detyrë drejtor i përgjithshëm i AMVV-së, edhe pse disponohet kuponi tatimor 01.02.2019, nuk ka nënshkruar faturën tatimore lëshuar nga hoteli "D..." me Nuis K...Vnr. 07 me serial nr. 70252108 datë 31.01.2019 për fjetje 2 net x 3000lekë/nata **= 6,000 lekë**.

2.Me **Urdhër shpenzimin nr. 15, datë 28.01.2019,** udhëtim e dieta muaji janar 2019, nëpunës autorizues drejtori i përgjithshëm i AMVQV z. B.M., nëpunës zbatues znj. F.M., autorizimi nr. 51/2, datë 16.01.2019 për shërbim në qarkun e Fierit nga data 16.01.2019 deri 18.01.2019,në zbatim të urdhrit brendshëm nr. 04, datë 29.12.2018 **"** Për monitorimin dhe zbatimin nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore mbi organizimin e zgjedhjeve vendore për vitin 2019, nënshkruar nga z. B.M., Drejtor i Përgjithshëm i AMMV-së, punonjësja udhëtuese znj. S.P. me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit të Qeverisjes Qendrore dhe Vendore pranë AMVV-së, edhe pse disponohet kuponi tatimor 01.02.2019, nuk ka nënshkruar faturën tatimore të hotelit "D..." me Nuis K...V, nr. 06 me serial nr. 70252107 datë 31.01.2019 për fjetje 2 net x 3000lekë/nata = 6,000 lekë. Po kështu edhe **z. B.M.**, me detyrë drejtor i përgjithshëm i AMVV-së, edhe pse disponohet kuponi tatimor 01.02.2019, nuk ka nënshkruar faturën tatimore të hotelit "D..." me Nuis K...Vnr. 07 me serial nr. 70252108 datë 31.01.2019 për fjetje 2 net x 3000lekë/nata = 6,000 lekë.

Gjatë auditimit të dokumentacionit të bankës rezulton se *në mjaft raste punonjësi nuk ka marrë fjetjen por është paguar vetëm për trajtimin me ushqim.*

Pagesat e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 997,datë 10.12.2010 "*Për trajtimin financiar te punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës se punës brenda vendit"*. Kapitull III. Trajtimi financiar i punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit, bëhet i diferencuar, sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës, si më poshtë vijon:

b) Shpenzimet e fjetjes kundrejt dokumentit tatimor përkatës të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3,000 (tre mijë) lekë, për çdo natë.

Titulli i Gjetjes:	*Në disa raste shpenzimet e likuiduara për shërbime udhëtim e dieta rezulton se faturat e fjetjes në hotel nuk janë nënshkruar nga personi i cili ka qenë me shërbim.*
Situata 1:	Nga auditimi i shpenzimeve operative, shërbime udhëtimi e dieta për vitin 2017 në vlerën 6,413,347 lekë, vitin 2018 në vlerën 6,391,290 lekë dhe vitin 2019 në vlerën 5,552,839 lekë rezultoi se urdhër shpenzimet janë shoqëruar me autorizimin me shkrim nga drejtori përgjithshëm por në disa raste rezulton se: nuk ishin të shoqëruara me programe pune, relacion apo raportime shoqëruar edhe me dokumentacionin e mbajtur në njësitë vendore sipas objektit të shërbimit, faturat e fjetjes në hotel nuk janë nënshkruar nga personi i cili ka qenë me shërbim dhe dërgimi i personave me shërbim është bërë pa patur parasysh fushën që mbulon, kërkesa sipas VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës se punës brenda vendit".

Kriteri:	VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "*Për trajtimin financiar te punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës se punës brenda vendit*". Kapitull III/b) "*Shpenzimet e fjetjes kundrejt dokumentit tatimor përkatës të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë, për çdo natë*"
Ndikimi/Efekti	përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në
Rëndësia	I ultë
Rekomandimi	Nga ana AMVV, Sektori i Financës, të merren masat që urdhër shpenzimet për likuidimin e shërbimeve për udhëtim e dieta të shoqërohen me faturat tatimore të nënshkruara nga nëpunësi udhëtues dhe një raport i hollësishëm për objektin dhe qëllimin e shërbimit.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Menjëherë*

*III.2.***Mbi dokumentimin e harxhimit të karburantit**
Agjencia ka në funksion 3 mjete dhe për vitin 2018,
Për periudhën objekt auditimi Agjencia për mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, për transportin e punonjësve ka në funksion 3 mjete të vogla, por nuk ka në strukturë drejtues mjeti (shofer) dhe mjetet drejtoheshin nga punonjësit e Agjencisë duke harxhuar edhe karburantin (por pa u nënshkruara prej secilit) **dhe konkretisht;**

-Mjeti tip Hyndai me targë AA401 MF.
-Mjeti tip FORD, me targë AA694 AG.
-Mjeti tip TOJOTA, me targë AA781 PM .

Për këto 3 mjete janë harxhuar mesatarisht 611 litra në muaj, por nuk është e mundur të evidentohen harxhimet për secilin mjet, pasi janë përdorur nga punonjës të ndryshëm. Për më hollësisht dalja e karburanti për periudhën 01.01.2017 deri 30.09.2019 paraqitet si më poshtë:

Nr.	Viti	Nr. mjet	Dalje Gjithsej sipas viteve			Harxhuar Mesatarisht Litra/muaj
			Litra	Çmimi mesat	Lekë	
1	2017	2	8099	154	1,247,169	674
2	2018	2	6289	158	992,879	524
3	2019	2.5	5801	144,75	839,694	644
	Gjithsej		20,189	152	3,079,742	611

Nga auditimi rezultoi se për vitet 2017-2018 Fletë daljet e karburantit priteshin jo në fund të muajit dhe nuk bëhej rakordimi ndërmjet km të përshkruara, shënimit të matësit dhe sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina dhe harxhimin nga secili mjet. Në disa raste Fletë daljet e magazinës karburantit, nuk nënshkruhen nga personi i cili ka tërhequr karburantin, por procedohet në bazë të një përmbledhëse, dhe ne disa raste në fletë daljet e karburantit padrejtësisht i kishte nënshkruar znj. F.M., Përgjegjëse e Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale e cila kryen edhe funksionin e nëpunësit zbatues (Financës). Për normativat e harxhimi të karburantit ishin kryer testime për secilin mjet, ndërkohë për administrimin e gomave nuk disponohen normativa të miratuara për kilometrat e përshkuara.

-Urdhër shpenzimi nr. 13, datë 28.01.2019 blerje karburant për vitin 2019, nëpunës autorizues drejtori i përgjithshëm i AMVQV z. B.M., nëpunës zbatues znj. F.M., urdhër prokurimi nr.1, datë 08.01.2019,proces verbali nr. 8/3, prot, datë 10.01.2019 mbi vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të Procedurës së prokurimit me vlera të vogla ref nr. 01, datë 08.01.2019 me fond limit 800,000 lekë, kontrata nr. 8/5, datë 11.01.2019 subjekti "G..." me

Nuis K...T, Faturë nr. 34 me serial nr. 70642647 datë 11.01.2019, për sasinë benzine litra 2000 x 120.65 lekë/litër pa tvsh= 241,250 lekë. Fletë Hyrja nr. 01, datë 11.01.2109 nënshkruar nga magazinieri O.R. duhet 2000 litra x144,75 lekë/litri= 289,500 lekë litra dhe jo 2000 litra x 120.65 pa tvsh= 241,250 lekë dhe jo 289.500 lekë ose më pak 48,250lekë, pra në fletë dalje është shënuar çmimi pa tvsh prej 120,65 lekë/litri dhe jo çmim prej 144,75 lekë/litri.

Në disa raste Fletë daljet e karburantit, nuk nënshkruhen nga personi i cili ka tërhequr karburantin, por procedohet në bazë të një përmbledhëse, dhe ne disa raste në fletë daljet e karburantit padrejtësisht i kishte nënshkruar znj. F.M., Përgjegjëse e Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale, në cilësinë e Nëpunësit zbatues.

Kështu me fletë daljen e magazinës nr. 165, datë 28.12.2018 magazinieri O.R., është bërë dalje sasi e karburantit (nga kartat elektronike) sasia 6,076 litra x 158 lekë/litri = 960,000 lekë dalje sipas tabelave bashkëlidhur mujore, pa u nënshkruar nga personi i cili ka ekzekutuar tërhequr karburantin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar*, pika 36, ku përcaktohet se: 36. *Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative12. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishte si dhe atë të mashtrimeve.*

Për dokumentimin e harxhimit të karburantit mbaheshin fletë udhëtimet për secilin mjet por nuk rakordoheshin km e përshkruara me shënimin e aparatit matës të kilometrazhit, me qëllim justifikimin e km të përshkruara.

Për normativat e harxhimi të karburantit ishin kryer testime për secilin mjet, ndërkohë për administrimin e gomave nuk disponohen normativa të miratuara për kilometrat e përshkuara. Bazuar në kërkesën e grupit të auditimit të KLSH, për të fiksuar sasinë e km të përshkruara nga secili mjet, sipas të dhënave të mara nëpërmjet pamjeve fotografike me celular të paraqitura nga Agjencia dhe konkretisht nga z*nj. F.M., Përgjegjëse e Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale, në cilësinë e Nëpunësit zbatues, më datën 27.12.2019 ditën e Premte në orën 10.51 minuta paradite, gjendja e numrit të kilometrave është* ***fiksuar si më poshtë:***

-Mjeti tip Hyndai me targë AA401 MF më datën 27.12.2019 ora 10.51 paraqet me 167,540 km.

-Mjeti tip FORD, me targë AA694 AG më datën 27.12.2019 paraqet me 150,182 km.

-Mjeti tip TOJOTA, me targë AA781 PM më datën 27.12.2019 paraqet me 78,029 km.

Titulli i Gjetjes:	*Për transportin e punonjësve ka në funksion 3 automjete autovetura, por në strukturën e saj nuk ka drejtues mjeti (shofer) dhe automjetet drejtohen nga punonjësit e Agjencisë pa nënshkruar secili për sasinë e karburantit të harxhuar.*
Situata 1:	AMVV për periudhën objekt auditimi, për transportin e punonjësve ka në funksion 3 automjete autovetura, por në strukturën e saj nuk ka drejtues mjeti (shofer) dhe automjetet drejtohen nga punonjësit e Agjencisë pa nënshkruar secili për sasinë e karburantit të harxhuar konkretisht: -Mjeti tip Hyndai me targë AA401 MF më datën 27.12.2019, paraqet 167,540 km. -Mjeti tip FORD, me targë AA694 AG më datën 27.12.2019 paraqet 150,182 km. -Mjeti tip TOJOTA, me targë AA781 PM më datën 27.12.2019 paraqet 78,029 km. Për këto 3 mjete janë harxhuar mesatarisht 611 litra në muaj në vlerën **3,079,742** lekë, por nuk mund të evidentohen harxhimet për secilin mjet, pasi janë përdorur nga punonjës të ndryshëm.

	Gjithashtu nga auditimi rezultoi se për vitet 2017-2018 Fletë Daljet e karburantit priteshin jo në fund të muajit dhe nuk bëhej rakordimi ndërmjet km të përshkruara, shënimit të matësit dhe sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina dhe harxhimin nga secili mjet. Në disa raste Fletë daljet e magazinës karburantit, nuk nënshkruhen nga personi i cili ka tërhequr karburantin, por procedohet në bazë të një përmbledhëse, dhe në disa raste në fletë daljet e karburantit ishin nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale e cila kryen edhe funksionin e nëpunësit zbatues (Financës). Ndërkohë për administrimin e gomave nuk disponohen normativa të miratuara për kilometrat e përshkuara.
Kriteri:	Udhëzimi i MF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, përgjegjësi e komisionit të inventarizimit dhe menaxhimit të institucionit*" në mospërputhje me pikat 36, 37, 38 ,39 ,40 dhe 82/a,b,c.
Ndikimi/Efekti	Fletëdalja e karburantit si dokument kontabël vërtetues duke mos u nënshkruar nga personi i cili ka ekzekutuar veprimin, tërheqjen dhe harxhimin e karburantit, por fletëdalja është bazuar në një përmbledhëse të hartuar nga punonjësja e financës, për këtë arsye fletëdalja e karburantit, si dokument kontabël vërtetues nuk ka forcën e një prove ligjore ose administrative.
Rëndësia	I ultë
Rekomandimi	Nga AMVV, Sektori i Analizës dhe Mbështetjes Institucionale të merren masat që Fletë Daljet e harxhimit të karburantit të priten veçmas për secilin automjet në fund të çdo muaji duke u nënshkruhen nga personat udhëtues të cilët kanë përdorur kartën e tërheqjes së karburantit duke i bashkëlidhur kuponët e nxjerrë nga kasa fiskale. Për secilin mjet në fund të muajit të plotësohen fletët e udhëtimit të bëhet rakordimi me km e përshkruara, normativat e miratuara duke shënuar edhe numrin e matësit. Gjithashtu të merren masat për miratimin e normativave të harxhimit të gomave sipas Tipeve/Markave dhe km/përshkruara, etj.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Menjëherë*

Sa trajtuar më hollësisht në Akt Konstatimin nr. 09, dt.27.12.2019. "Mbi zbatimin e buxhetit dhe kryerjen e disa pagesave të kundërligjshme"

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:

Për vitin 2015, 2016 dhe 2017 flete daljet e karburantit janë të mbajtura mujore , dhe të kontabilizuara mujore, vetëm për vitin 2018 u përdor për herë të parë financa 5 dhe kontabilizimi i daljeve të karburantit u bë me një përmbledhëse me një dalje të vetme vjetore , pasi magazine e karburantit është mbajtur si magazine e ndare nga ajo e kancelarive dhe detergjenteve. Fletë dalja është përmbledhëse e fletudhëtimeve të cilat janë të firmosura nga personat udhëtues për çdo shërbim dhe në fletëdalja përgjegjësja e sektorit e cila bën dhe punën e ekonomistes pasi ka verifikuar fletudhëtimet të krahasuara me fletëdaljen ka firmosur duke bërë shënimin u pa, pasi janë shumë drejtues dhe duhej të pritej për çdo fletë udhëtimi një dalje. (bashkëlidhur fletë dalja e karburanteve nr. 1 datë 31.01.2018, nr 2 datë 01.03.2018, nr.3 datë 1.04.2018, nr. 4 datë 2.05.2018, nr.5 datë 1.06.2018, nr.6 datë 01.07.2018, nr.7 datë 01.08.2018, nr. 8 datë 31.08.2018, nr.9 datë 01.10.2018, nr.10 datë 1.11.2018, nr.11 datë

01.12.2018 dhe nr.12 datë 01.12.2018). ***Për periudhën në vazhdim do të pritet fletë dalja për çdo fletë udhëtimi të firmosen nga personat udhëtues dhe të rakordouara me km e përshkruara***.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:
Nga AMVV, Sektori i Analizës dhe Mbështetjes Institucionale të merren masat që Fletë Daljet e harxhimit të karburantit të priten veçmas për secilin automjet në fund të çdo muaji duke u nënshkruhen nga personat udhëtues të cilët kanë përdorur kartën e tërheqjes së karburantit duke i bashkëlidhur kuponët e nxjerrë nga kasa fiskale.

2. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, bazuar në aktet ligjore në fuqi për periudhën 2015-2019.

Në zbatim të pikës mbi auditimin dhe organizimin në mbajtjen e kontabilitetit, hartimin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare të programit të auditimit nr.924/1, datë 18.11.2019, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1.1.Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2018

Në fund të periudhës ushtrimore, janë plotësuar 8 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*
Format nr. 1 –Pasqyra e Pozicionit Financiar.
Format nr. 2 –Pasqyra e Performancës Financiare.
Format nr. 3– Pasqyra e Flukseve Monetare (Cash Flow).
Format nr. 4– Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto/ Fondet Neto.
Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.
Format nr. 7/a – Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Kosto Historike).
Format nr. 7/b – Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto).
Format nr. 8 – Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave.

1.2.Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2017

Në fund të periudhës ushtrimore, janë plotësuar 11 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj"* i ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007.
Format nr. 1 – Aktivi i Bilancit.
Format nr. 2 – Pasivi i Bilancit.
Format nr. 3/1 –Shpenzime të ushtrimit.
Format nr. 3/2 –Të ardhura të ushtrimit.
Format nr. 4 – Burimet dhe Shpenzimet të lidhura me investimet.
Format nr. 5 – Pasqyra e Lëvizjes në "Cash".
Format nr. 6 – Gjendja dhe ndryshimi i Aktiveve të Qëndrueshme.
Format nr. 7 – Pasqyra e Amortizimit të Aktiveve të Qëndrueshme.
Format nr. 8 – Pasqyra e Lëvizjes së Fondeve.
Format nr. 9- Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave.
Formati nr.10 – Pasqyra e konsoliduar e gjendjes financiare 2017.
Formati nr.11 – Pasqyre e Konsoliduar e Të Ardhurave e Shpenzimeve të Funksionimit.

2. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe i pasqyrave financiare (bashkë me formatet përkatëse) rezulton se:

Bilanci i vitit 2017 është hartuar dhe depozituar me nr.2212 prot., në datën 28.02.2018 miratuar nga Dega e Thesarit Tiranë, brenda afatit ligjor, gjithashtu edhe Bilanci i vitit 2018 është hartuar dhe depozituar me nr.2242 në datën 27.03.2019 miratuar nga Dega e Thesarit Tiranë brenda afatit ligjor. Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, centralizator dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.
Partitarët analitikë të të gjitha llogarive janë mbajtur dhe azhornuar si dhe i llogarive inventariale të magazinës për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2018 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej **2%,** vlerën ***484,566*** lekë për tu konsideruar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.
Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:
- Kontrolli i brendshëm:
Kontrolli i brendshëm në Agjencinë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike nuk mund ta dijë ku mundet të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.
- Kontabiliteti:
Në nenin 10 të Ligjit nr. 9228, dt. 29.04.2004 *"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" përcaktohen parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. (SKK 1) i përmirësuar.*
Mos aplikimi i rregullave kontabël mbi bazën e parimit të kontabilitetit pra mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe regjistrohen në kontabilitet dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t'u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.

Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. *Kontrolli aritmetik.*
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në

llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët,

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakorduar)* me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE.

2/1. Auditimi i pasqyrave financiare viti 2018.

1. Nga verifikimi formal i pasqyrave financiare për vitin 2018 rezultoi se janë:

- *pasqyra e pozicionit financiar*, - *pasqyra e performancës financiare*, - *pasqyra e flukseve monetare*, - *pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto*, – *investimet dhe burimet e financimit*, – *gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata*, - *numri i punonjësve dhe fondi i pagave*.

Hartimi i pasqyrave financiare bazohet në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 "*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*"), të përcaktuara në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*".

Në mbështetje të nenit 3 dhe 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për "*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 për "*Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, nenit 10 dhe 11 të Ligjit nr.9228 datëc29.04.2004 "*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*".

Nuk ka patur komunikim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.

Udhëzimi nr.14 datë 28.12.2006 "*Për Institucionet Qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë në varësi"*.

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.26 datë 27.12.2007 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14 datë 28.12.2006.

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2019 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme*".

a. Pasqyrat Financiare (Bilanci kontabël):

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore në fund të periudhës kontabël dt. 31.12.2018.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë:

- *Aktivet, Detyrimet, Kapitali.*

Klasifikimi i elementeve të mësipërme në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare. Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse .

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënnzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Pasqyrat e pozicionit financiar të Agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore në 31.12.2018 janë si më poshtë:

Pasqyra e aktiveve, detyrimeve dhe kapitali:

lekë

	Përshkrimi i elementeve	31.12.2017	Shtesa (+)	Pakësime (-)	31.12.2018
A	**AKTIVET**				
I	**Aktive afatshkurtra**				
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre	**0**			**0**
520	Disponibilitete në thesar	-			-
532	Vlera të tjera	-			-
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**458,985**			**1,064,312**
31	Materiale	357,016	611,241.00		968,257
32	Inventar i imët	101,969		(5,914.00)	96,055
	3.Llogari të arkëtueshme	**1,446,721**			**1,550,320**
423	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	947,231		947,231	-
431	Tatim e taksa	95,724		95,724	-
435	Sigurime shoqërore	323,332		323,332	-
436	Sigurime shëndetsore	41,118		41,118	-
468	Debitorë të ndryshëm	39,316		39,316	-
4342	Operacione me shtetin(Të drejta)	-	1,550,320		1,550,320
	4.Të tjera aktive afatshkurtra	**-**			**-**
	Totali i aktiveve afatshkurtra	*1,905,706*			*2,614,632*
II	**Aktivet afatgjata**				
	1.Aktive afatgjata jo materiale	**-**			**-**
202	Studime dhe kërkime	-			-
	2.Aktive afatgjata materiale	**111,420,947**			**12,571,780**
210	Toka, Troje, Terrene	-			-
212	Ndërtesa dhe Konstruksione	1,538,591	1,749,549		3,288,140
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	-			-
214	Instalime teknike, makineri, dhe paisje	1,819,521		(1,819,521)	-
215	Mjete Transporti	4,979,172		(687,126)	4,292,046
218	Inventar ekonomik	103,083,663		(98,092,069)	4,991,594
	3.Aktive afatgjata financiare	**-**			**-**
25	Huadhënie dhe Nënhuadhënie	-			-
26	Pjesmarrje në kaptialin e vet	-			-
	4.Investime	**-**			**-**
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	-			-
231	Për Aktive Afatgjata materiale	-			-
	Totali i aktiveve afatgjata	*111,420,947*			*12,571,780*
	Totali i aktiveve (I+II)	**113,326,653**			**15,186,412**
B	**DETYRIMET**				
I	**Detyrime afatshkurtra**				
	1.Llogari të Pagueshme	**1,446,721**			**1,550,320**
401,8	Furnitorë dhe llogari të lidhura me to	-			-
42	Detyrime ndaj personelit	947,231	9,255		956,486
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	95,724	83,309		179,033
435	Sigurime shoqërore	323,332	19,075		342,407
436	Sigurime shëndetësore	41,118		(1,115)	40,003
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	-			-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-			-
467	Kreditorë të ndryshëm	39,316		(6,925)	32,391
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	-			-
	2.Të tjera pasive afatshkurtra	**-**			**-**

	Totali i detyrimeve afatshkurtra	*1,446,721*			*1,550,320*
II	**Detyrime afatgjata**	**-**			**-**
	Totali i detyrimeve (I+II)	**1,446,721**			**1,550,320**
III	**Kapitali**				
101	Fondi i akumuluar	111,420,947		(98,849,167)	12,571,780
12	Rezultatet e mbartura	637,184		(178,199)	458,985
85	Rezultat i Veprimtarisë Ushtrimore	-178,199	783,526		605,327
105	Teprica e Granteve kapitale të brendshme	-			-
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	-			-
	Totali i kapitalit	*111,879,932*			*13,636,092*
	Totali i kapitalit dhe detyrimeve (I+II+III)	**113,326,653**			**15,186,412**

A. AKTIVET

I. Aktivet afatshkurtra.

1. Mjete monetare.

Në këtë zë përfshihen kryesisht aktivet monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide. Gjithashtu mund të përfshihen edhe llogaritë hua dhe letra me vlerë, zhvlerësimi i aktiveve financiare nëse plotësojnë kushtin e përkufizimit si ekuivalente të mjeteve monetare.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre paraqiten në vlerën 0 lekë për vitet 2017 dhe 2018.

2. Inventari.

Në këtë zë të bilancit jepen informacionet për inventarin gjendje në datën e ndërtimit të bilancit. Paraqitja e gjendjes së këtyre inventarëve bëhet në Bilanc me vlerën neto. Në vartësi të llojit të inventarit ky zë mund të paraqitet i ndarë në disa nënzëra ku paraqiten tepricat e llogarive si: *lëndët e para dhe materialet e konsumueshme si dhe llogaritë e zhvlerësimit të tyre, prodhime në proces dhe gjysëmprodukte, produkte të gatshme, mallra për rishitje, parapagesa për inventar (llog. 371- 376)...*

Në përputhje me SKK nr. 4 e përmirësuar në informacionet plotësuese të pasqyrave financiare në lidhje me inventarët duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm:

(a) politikat kontabël të përdorura si dhe formulat e përdorura për llogaritjen e kostos;

(b) vlerën kontabël të të gjithë inventarëve si dhe vlerën kontabël të tyre sipas klasifikimit të bërë nga njësia ekonomike;

(c) vlerën e inventarëve të njohur si shpenzim gjatë periudhës kontabël;

(d) shumën e ndonjë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme;

(e) vlerën kontabël të inventarit të dhënë si garanci;

(f) vlerën kontabël të inventarëve që janë në ruajtje të palëve të tjera;

(g) informacion mbi inventarin , shumat dhe nëse është e mundur përllogaritjen e vlerës, që nuk janë të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike por që janë në ruajtje të saj.

Inventari është detajuar si më poshtë:

	31/12/2018	31/12/2017
Gjendje Inventari	**1,064,312**	**458,985**
Mallra	*0*	*0*
Materiale	*968,257*	*357,016*
Inventar i imët	*96,055*	*101,969*

Nga analiza e kryer për llogarinë 32 "*Inventar i imët*", Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore vihet re se gjatë vitit 2018 kemi shtesa prej 611,241 lekë.

Inventari i imët në fund të vitit ushtrimor 31.12.2018 paraqitet në shumën prej 96,055 lekë.

Nga rakordimi me urdhrin e ngritjes së komisionit për inventarizimin e aktiveve me nr.848 datë 21.12.2018 me kontabilitetin dhe Pasqyrën e Gjendjes dhe Ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme nuk rezultuan diferenca përsa i përket llogarisë 32 "*Inventar i imët*" dhe llogarisë 31 "*Materiale*".

Nga auditimi evidentohet se: Llogaritë inventariale për aktivet e Institucionit janë të rakorduara me fletë inventarë kontabël si dhe me inventarët e fund vitit ushtrimor 2018.

3. Llogari të arkëtueshme tregtare.

Në këtë nënzë përfshihen të gjitha të drejtat ndaj klientëve për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm. Konkretisht, nëse do t'i referohemi listës së llogarive të publikuar nga KKK, në këtë zë do të përfshihen tepricat debitore të llogarive të më poshtme:

411. Klientë për mallra, produkte e shërbime
423. Personeli, Paradhënie, Deficite, Gjoba
468. Debitorë të ndryshëm
4342. Operacione me shtetin (Të drejta)

Llogaritë e arkëtueshme tregtare paraqiten si më poshtë:

	31/12/2018	31/12/2017
-Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	0	947,231
-Tatim e Taksa	0	95,724
-Personeli, Paradhënie	0	0
-Debitorë të ndryshëm	0	39,316
-Sigurime Shoqërore	0	323,332
-Sigurime Shëndetësore	0	41,118
-Operacione me shtetin (Të drejta)	1,550,320	0
	1,550,320	**1,446,721**

➢ **Llog.4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)",***

Është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara. Raste të tilla mund të jenë këto (*por jo vetëm këto*) si; *pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi te ardhurat*, që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Në fund të vitit ushtrimor *2018 llogaria.4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"* paraqitet në vlerën prej **1,550,320** lekë rezulton se kjo shumë është e rakorduar me llogaritë koresponduese të pasqyruara në pasiv të bilancit dhe konkretisht përbëhet nga shuma e llogarive 42 "*Detyrime ndaj personelit*" në vlerën 956,486 lekë e cila përfaqëson pagat e punonjësve të muajit Dhjetor 2018 e përputhur me listë pagesën mujore, llog.431 "*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa*" në vlerën 179,033 lekë e cila përfaqëson tatimin e llogaritur e të ndalur në pagat e punonjësve të muajit Dhjetor 2018 e përputhur me liste pagesën mujore, llog.435 "*Sigurime shoqërore*" në vlerën 342,407 lekë e cila përfaqëson sigurimet shoqërore të llogaritura në pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2018 e përputhur me liste pagesën mujore, llog.436 "*Sigurime shëndetësore*" në vlerën 40,003 lekë dhe llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*" në vlerën 32,391 lekë e cila përfaqëson detyrimin e institucionit për dy subjekte privatë të cilat kanë kryer shërbime të mirëmbajtjes së ashensorit.

II. Aktivet afatgjata.

I. Aktive afatgjata jo materiale.

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas udhëzimit nr.8 përfshin primet të emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme.

Aktivet afatgjata jo materiale (AAJM) janë aktive jo materiale që:

(a) është e mundur që nga përdorimi i aktivit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike

(b) kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri.

(c) aktivi nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda njësisë ekonomike për një zë jo material

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar.
Për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018 vlera në bilanc paraqitet në vlerën 0 lekë.

1I. Aktive afatgjata materiale.

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5 i përmirësuar.
Aktivet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që:

(*a) përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për tua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe*
(b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar.
Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:
- Toka, paraqiten Toka, troje terrene.
Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:
210. Toka,
211. Pyje, Plantacione,
- Ndërtesa, përfshihen Ndërtesa, struktura, rrugë dhe investime në objekte me qira.
Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:
212. Ndërtesa,
213. Rrugë, rrjete, vepra ujore,
- Makineri dhe pajisje, përfshihen Pajisje prodhimi, Mjete transporti dhe Makineri e Pajisje të tjera.
Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:
214. Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune,
215. Mjete transporti,
- Aktive të tjera afatgjata materiale.
Në këtë zë paraqiten zakonisht Mobiljet dhe Pajisjet e zyrave si dhe aktive të tjera afatgjata materiale që nuk përfshihen në grupet e tjera. Sipas përmbajtjes së tij në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:
Aktivet afatgjata materiale (neto) janë detajuar si më poshtë:

	31/12/2018	31/12/2017
-Toka, Troje, Terrene (210)	0	0
-Pyje, Plantacione (211)	0	0
-Ndërtesa dhe Konstruksione (212)	3,288,140	1,538,591
-Rrugë, rrjete, vepra ujore (213)	0	0
-Instalime teknike, makineri, dhe paisje (214)	0	1,819,521
-Mjete Transporti (215)	4,292,046	4,979,172
-Inventar ekonomik (218)	4,991,594	103,083,663
-Aktive afatgjata te demtuara(24)	0	0
-Caktime te Aktiveve Afatgjata(28)	0	0
	12,571,780	**111,420,947**

-*Për llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene"* paraqitet në vlerën 0 lekë gjatë vitit 2018 dhe vitit 2017.
-*Për llogarinë 211 "Pyje, Plantacione"* në bilanc paraqitet në vlerën 0 lekë.
-*Për llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione"* në fund të vitit ushtrimor për vitin 2017 paraqitet në vlerën neto 1,538,591 lekë dhe amortizim të akumuluar prej 35,209 lekë.
Gjatë bilancit ushtrimor të vitit 2018 "*llog. 212"* paraqitet në vlerën prej 3,288,140 lekë e cila përfaqëson shpenzimet e kryera nga Institucioni për rikonstruksionin e godinës të bëra në vitet 2015-2017. Evidentohet se, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.473, datë 03.06.2015 pika 2.1 thuhet që *"Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore t'i jepet në përdorim të*

përkohshëm kati i shtatë i godinës, sipas planimetrive dhe plan vendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT)". Institucioni nuk ka në inventar objekte ndërtimore pasi objekti në të cilën ushtron veprimtarinë është pronë e Ministrisë së Mbrojtjes.

-Për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri dhe pajisje" paraqitet në vlerën 0 lekë. Në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 në këtë llogari ishin të kontabilizuar shpenzimet për instalime elektrike dhe hidraulike të cilat për shumën 1,764,935 të mbartura nga viti 2017 janë kontabilizuar në llogarinë 212.

Nga analiza e kryer për llogaritë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" dhe 214 "Instalime teknike, makineri dhe pajisje" (në vlerën totale prej 3,288,140 lekë) janë bërë këto veprime:

- Në datën 25.06.2015 është kryer ristrukturimi godinës më vlerën 706,800 lekë.
- Në datën 21.07.2015 është kryer ristrukturimi i godinës me dyer, dritare etj, me vlerën 496,800 lekë.
- Në datën 21.12.2016 është kryer ristrukturimi i godinës për instalime elektrike me vlerën 255,600 lekë.
- Në datën 15.12.2016 është kryer ristrukturimi i godinës për sistemin biometrik të derës së jashtme me vlerën 99,684 lekë.
- Në datën 14.12.2016 është kryer ristrukturimin i godinës (rikonstruksione të pjesshme) me vlerën 780,000 leke.
- Në datën 22.12.2016 janë kryer instalime interneti me vlerën 118,000 lekë.
- Në datën 29.12.2016 janë kryer instalime hidraulike me vlerën 46,000 lekë.
- Në datën 19.12.2017 është kryer ristrukturimi i godinës për vendosje dyer, dritare dhe fasada e godinës me vlerën 766,200 lekë.

Nga verifikimi rezulton se për llogaritë si më poshtë:

-Llog.218 "Inventar ekonomik"

Në fund të vitit ushtrimor 2018 llog.218 "*Inventar ekonomik"* paraqitet në vlerën 4,991,594 lekë e cila përbëhet nga mallra dhe materiale gjendje në institucion të cilat janë në përdorim nga personeli. Kjo vlerë është e inventarizuar sipas zyrave dhe fletë inventari të nënshkruar nga personeli që i ka në përdorim.

Nga auditimi u konstatua se:

Krahasuar me gjendjen në çelje të vitit ushtrimor (103,083,663 lekë), evidentohet një zbritje prej 98,092,069 lekë. Kjo ka ardhur si rezultat i transferimit pa pagesë të aktiveve pranë 61 Njësive Vendore të cilat janë pajisje kompjuterike ku Institucioni Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (ish-AZRT) i ka blerë me procedurë prokurimi në vitin 2016 dhe me faturë tatimore shitje nr.558 datë 06.07.2016 të lëshuar nga subjekti privat "B..." me NIPT "J....1" për dixhitalizimin e arkivave të Njësive Vendore.

Nga ana e Agjencisë bëhet e ditur se bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.40 datë 16.10.2015 "*Për shpërndarjen e fondit për programin Shqipëria Dixhitale pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve"* është çelur fondi përkatës për blerjen e pajisjeve kompjuterike.

Vlera e pajisjeve është likuiduar me urdhër shpenzimi nr. 68, Dt. 08.07.2016 për vlerën 90,180,000 lekë Shoqëruar me faturën tatimore nr. 558, dt. 06.07.2016 me vlerën 149,634,150 lekë dhe Fletë hyrjen e magazinës nr. 8, Dt. 06.07.2016 për vlerën 149,634,150 lekë. Gjithashtu diferenca është likuiduar me urdhër Shpenzimin nr. 136, dt. 19.12.2016 për 44,890,245 lekë dhe Urdhër Shpenzimin nr. 85, dt. 08.08.2016 për 14,563,905 lekë

Këto aktive janë transferuar gjatë muajve shtator-dhjetor 2018 pa pagesë në 61 njësitë vendore me vlerë totale prej 149,366,310 (*sipas kostos historike*), e cila përbëhet nga vlera kontabël neto e këtyre aktiveve për 98,275,241 lekë dhe vlerën e amortizimit të akumuluar për 2 vjet prej 51,091,069 lekë.

Procesi i transferimit të këtyre aktiveve është i shoqëruar me urdhrat e përbashkët ndërmjet Institucionit të AMVV-së dhe Kryetarëve të Bashkive, me kontratat e përdorimit si dhe janë

dokumentuar me fletë daljet përkatëse për çdo njësi vendore dhe hyrjet përkatëse të firmosur nga të dy palët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të transferimit referuar një procedure (Bashkia Mat) u evidentua se kjo procedurë shoqërohet:

1. Me kontratën e përdorimit nr.721, datë 20.10.2016 të lidhur ndërmjet Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (AZRT) përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.S. dhe Bashkisë Mat përfaqësuar nga Kryetari z. N.R., në prani edhe të përfaqësuesit të kompanisë "B...", ku qëllimi i kontratës së lidhur ndërmjet palëve të sipër përmendura është dhënia në përdorim të Bashkisë Mat të pajisjeve kompjuterike me qëllim dixhitalizimin e arkivave të Bashkisë dhe Njësive Administrative në përbërje të saj, në kuadër të zbatimit të projektit "*Shqipëria Dixhitale*", financuar nga FZHR, më kohëzgjatje të kontratës 18 muaj nga dita e dorëzimit. Kontrata është e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm të AZRT z. A.S. dhe Kryetarit të Bashkisë Mat z. N.R.
2. Nëpërmjet Urdhrit të Përbashkët me nr. prot.692, datë 09.11.2018 të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe me nr.prot.2873 datë 12.11.2018 të Bashkisë Mat, në zbatim të kontratës nr.721 është vendosur për kalim kapitali pa pagesë të pajisjeve kompjuterike (përkatësisht 16 kompjutera Dell Optilex 3020 MT, 10 fotokopje Kyocera Fs-6525 MFP, 6 fotokopje Kyocera TASK alfa 2200, 16 pajisje UPS SPS PLI650I, 8 copë switch dhe 24 copë kabëll FTP CAT5).
3. Nga ana e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është bërë dalje me fletë daljen nr.159 datë 12.11.2018 me vlerën 3,030,720 lekë të firmosur nga personi përgjegjës për magazinën zj. O.R.
4. Nga ana e Bashkisë Mat është bërë hyrje me fletë hyrjen nr.42 datë 12.11.2018 të pajisjeve kompjuterike firmosur nga personi përgjegjës i magazinës për Bashkinë Mat.

Nga verifikimi në disa Bashki rezultoi se:

a. Bashkia Kurbin nga verifikimi rezultoi se me fletë daljen nr. 187, dt. 6.12.2018 janë bërë dalje pajisjet të cilat me Fletë hyrjen nr. 70, dt. 06.12.2018 janë bërë hyrje në Bashkinë Kurbin. Gjithashtu nga verifikimi në Bashkinë Kurbin rezultoi se materialet e mësipërme janë bërë hyrje me FH nr. 89, dt. 31.12.2016 dhe nr. 90, dt. 31.12.2016 të cilat edhe janë kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2016. Por vlerat e tyre nuk përputhen me FH nr. 70, dt. 06.12.2018.
b. Bashkia Skrapar nga verifikimi rezultoi se me fletë daljen nr. 217, dt. 19.12.2018 firmosur nga përfaqësues i Bashkisë Skrapar i janë bërë dalje pajisjet të cilat janë bërë hyrje në Bashkinë Skrapar me FH nr. 42, dt. 12.11.2018. Nga verifikimi në Bashkinë Skrapar rezultoi se materialet e mësipërme janë bërë hyrje me FH nr. 54, dt. 02.11.2016 dhe nr. 53, dt. 02.11.2016. Gjithashtu nga Bashkia Skrapar është mbajtur procesverbali i datës 19.12.2018 ku saktësohet se çmimet do të jenë sipas faturave të vitit 2018 pasi çmimet nuk përputhen.

Llog. 215 "Mjete transporti", për vitin 2018 ka vlerën 4,292,046 lekë. Në kartelën e inventarizimit kjo llogari është zbërthyer në mënyrë analitike dhe përbëhet nga 2 automjete.
Nuk ka patur shtesa gjatë vitit ushtrimor 2018dhe është e rakorduar me formatin nr. 6 të pasqyrave financiare "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*".
Për vitin 2018 llogaria 215 ka vlerën neto 4,292,046 lekë. Amortizimi i akumuluar i kësaj llogarie është në vlerën 2,969,247 lekë.
Gjatë vitit ushtrimor 2017 llog.215 "*Mjete Transporti"* paraqitet në vlerën 4,979,172 lekë ku evidentohet se ka patur shtesa pa pagesë (formati 7- pasqyra e amortizimeve) në vlerën prej 5,006,418 lekë. Amortizimi i akumuluar është paraqitur në vlerën 1,484,991 lekë.

➢ Inventarizimi i aktiveve

Për vitin 2018 inventarizimi i aktiveve paraqitet si më poshtë:

- llog.218 "*Inventar ekonomik*" në vlerën prej 4,991,594 lekë.
- llog.32 "*Inventar i imët*" në vlerën prej 1,064,312 lekë.

Në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është kryer duke u bazuar në urdhrin e titullarit nr. 848, datë 21.12.2018, për vitin 2018 sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", me ndryshimet.
Në këtë urdhër është përcaktuar ngritja dhe funksionimi i komisionit të inventarizimit i cili është i përbërë nga 3 persona (X.C., S.L. dhe N.N.) të cilët kanë kryer inventarizimin sipas këtij urdhri dhe kanë kryer vetëm përgatitjen si dhe nënshkrimin e fletë inventarëve përkatës. Fletë inventarët e materialeve në përdorim janë nënshkruar edhe nga personeli përgjegjës që i ka në ngarkim. Nga auditimi rezultoi se nuk kanë rezultuar diferenca nga inventari kontabël të paraqitur nga Sektori i Financës me inventarin fizik.

-Auditimi i inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme e aktiveve qarkulluese.

Angazhimi i auditimit në drejtim të kryerjes së inventarizimeve të aktiveve të qëndrueshme dhe aktiveve qarkulluese në Institucionin u krye hap pas hapi, për vitin 2017 dhe 2018.
Nga auditimi i kryer për inventarizimin fizik të aktiveve për AMVV rezultoi se, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore që normojnë këtë fushë, ka dalë Urdhri titullarit "*Për inventarizimin vjetor të aktiveve të AMVV-së*". Në këtë urdhër, është përcaktuar ngritja dhe funksionimi i komisionit të inventarizimit të aktiveve, i përbërë me tre persona.
Komisioni "*Për inventarizimin vjetor të aktiveve të AMVV-së*" ka kryer inventarizimin sipas objekteve të përcaktuara në urdhër duke u mjaftuar vetëm me përgatitjen dhe nënshkrimin e fletë inventarëve përkatës. Fletë inventarët e mallrave në përdorim nga personeli institucionit janë të nënshkruara edhe nga personeli përgjegjës. Sipas vlerës së pasqyruar në llogaritë inventariale në sektorin e financës dhe fizikut të aktiveve gjatë inventarizimit nuk kanë rezultuar diferenca.
Sa i përket procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit evidentojmë se, komisioni i inventarizimit të aktiveve , nuk ka kryer të rregullt procesin e inventarizimit kjo pasi komisioni nuk ka përpiluar proces verbalet përkatëse të verifikimit fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë, në mospërputhje me *pikën 82/a,b,c (Komisioni nuk duhet të jetë me më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi13. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi) të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, përgjegjësi e komisionit të inventarizimit dhe menaxhimit të institucionit.
Për vitin 2018 dalja e mallrave e materialeve është kryer nga magazina e institucionit bazuar në urdhër dorëzimin e mallit të miratuar nga shefi sektorit. Dalja e mallrave është nënshkruar nga magazinierja dhe punonjësi përkatës.
Për vitin 2017 ditari i hyrje daljeve është mbajtur në mënyrë kronologjike dhe me kartela të nënshkruara nga financieri dhe magazinieri. Për vitin 2018 dhe 2019 ditari i magazinës hyrje – dalje është mbajtur me financën 5. Mungojnë kartelat apo libri i magazinës, të cilat duhet ti ketë magazinieri dhe të rakordojë me ditarin e magazinës në mospërputhje me *pikat36, 37, 38,39 dhe 40 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". ku përcaktohet se (Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre.)*

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr.7/b) Viti 2018.

Në fillim të vitit 2018 rezulton se Amortizimi i Akumuluar në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për Aktivet Afatgjata Materiale paraqitet për vlerën 5,576,258 lekë në fund të vitit 2018.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivit. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Ligji nr. 8438, dt. 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", neni 22, i ndryshuar dhe UMF nr. 5, dt. 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" pika 3.7 "*Amortizimi*", i ndryshuar, si edhe udhëzimi nr.8, dt.09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",*

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2018 si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	*Vlera e mbetur*	*20%*
Ndërtesa	*Vlera e mbetur*	*5%*
Pajisje informatike	*Vlera e mbetur*	*25%*
Mobilje dhe orendi	*Vlera e mbetur*	*20%*
Pajisje zyre	*Vlera e mbetur*	*20%*
Mjete transporti	*Vlera e mbetur*	*20%*
Të tjera	*Vlera e mbetur*	*20%*

Aktivet në proces nuk amortizohen.

Testi substancial i amortizimit.

Qëllimi: Është kryer Riperformimi i amortizmimit duke u bazuar në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të riperformuar sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në regjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet.

Nr	Aktivi	Sasia	Cmimi	Vlera	Data e blerjes	Amortizimi I akumuluar	Amortizimi 2018	Vlera Neto 2018	Vlera Neto e rillogaritur nga audituesi
1	Proje TIP 1-A 123 PH	1	58,242	58,242	29.10.2015	26,846	7,849	23,547	23,547
2	Laptop E554 HM86	1	180,360	180,360	07.12.2015	78,908	25,363	76,089	76,089
3	Kompjuter Desktop	11	87,840	966,240	07.12.2015	422,730	135,878	407,632	407,363
4	Laptop Cells H730	1	97,680	97,680	07.12.2015	42,735	13,736	41,209	41,209
5	Kompj Fujitsu Celsisu M470	1	258,600	258,600	31.05.2016	92,935	41,416	124,249	124,249
6	Fotok Toshibaest 557	1	534,000	534,000	31.05.2016	191,906	85,523	256,571	256,570
7	Laptop	2	132,599	265,198	14.12.2017	-	15,381	249,817	249,817
8	Laptop	1	454,800	454,800	14.12.2017	-	26,378	428,422	428,422

Burimi: Të dhënat e AMVV nga librat kontabël të përpunuara nga Audituesi në tabelë.

Pas ri llogaritjes vihet re se janë zbatuar normat e amortizimit të parashikuara nga Udhëzimi nr.8 dhe nuk janë vënë re anomali të theksuara. Për amortizimin e aktiveve për shtesat që janë bërë gjatë vitit 2018 nga ana e Sektorit të Financës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është bëra rillogaritja mujore e normës së amortizimit duke patur parasysh muajin e blerjes së aktivit.

III. Aktivet Afatgjata Financiare.

Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2018 paraqiten në vlerën 0 lekë.

B. DETYRIMET DHE KAPITALI

I. DETYRIMET

Huatë dhe parapagimet.

Në këtë grup përfshihen kryesisht të gjitha llogaritë që paraqesin detyrimet tregtare të Agjencisë ndaj të tretëve për mallrat dhe shërbimet e blera e të papaguara, për paradhëniet e

marra, detyrimet ndaj punonjësve të vet, detyrimet ndaj shtetit për tatimet e taksat e ndryshme të papaguara, dhe hua të tjera.

1. Llogari të pagueshme tregtare.

Në këto llogari paraqiten të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme. Në të do të përmblidhen tepricat kreditore të llogarive vijuese si:

401. Furnitorë për mallra, produkte e shërbime;
403. Premtim pagesa të pagueshme;
404. Furnitorë për aktivet afatgjatë;

Llogaritë e pagueshme tregtare paraqiten në vlerën 0 lekë për vitet 2017 dhe 2018.

2. Detyrimet ndaj personelit dhe Detyrimet tatimore

Në këtë zë përfshihen të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të llogaritura e të papaguara ndaj shtetit si psh TVSH, Tatimi mbi fitimin, Akcizat, Tatimi mbi të Ardhurat Personale, Tatim në Burim, Tatimet e tjera, si dhe për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, kur ato parashikohen që të shlyhen brenda 12 muajve nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare. Në këtë nënzë do të përmblidhen tepricat kreditore të llogarive vijuese:

42. Detyrime ndaj personelit;
43. Detyrime për sigurimet shoqërore dhe llogari të lidhura me to;
435. Sigurime shoqërore
436. Sigurime shëndetësore
438. Detyrime të tjera
44. Shteti për tatime dhe taksa dhe llogari të lidhura me to;
441. Akciza,
442. Tatim mbi të ardhurat personale,
443. Tatime të tjera për punonjësit,
444. Tatim mbi fitimin,
445. TVSH,
4453. Shteti-TVSh për t'u paguar,
447. Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer (teprica kreditore),
448. Tatime të shtyra (teprica kreditore),
449. Tatimi në burim,

Detyrimet për vitin e mbyllur janë detajuar si më poshtë:

	31/12/2018	31/12/2017
42-Detyrime ndaj personelit	*956,486*	*947,231*
431-Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	*179,033*	*95,724*
435-Detyrime për sigurime shoqërore	*342,407*	*323,332*
436-Detyrime Shëndetësore	*40,003*	*41,118*
	1,517,929	**1,407,405**

-Llog.(42); "*Personeli e llogari të lidhura me to",* analizuar e kuadruar me gjendje kontabile vlera *956,486 lekë* përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit periudha (*dhjetor 2018*) dhe në fund të vitit 2017 për vlerën *947,231 lekë* me një rritje në vlerën *9,255 lekë*.

-Llog.(431);"*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*", analizuar e kuadruar me gjendje kontabile vlera *179,033 lekë* përfaqëson detyrimet për tatimi mbi pagat e personelit në periudhën (*dhjetor 2018*) vlerë e likuiduar me pagesat e kryera në muajin Janar 2019.

-Llog.(435); "*Sigurime shoqërore*" e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile vlera *342,407 lekë* përfaqëson detyrimet për kontribut në sigurimet shoqërore në periudhën (*dhjetor 2018*) vlerë e likuiduar me pagesat e kryera në muajin Janar 2019.

-Llog.(436); "*Sigurime shëndetësore*" e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile vlera *40,003 lekë* përfaqëson detyrimet për kontribut në sigurimet shëndetsore në periudhën (*dhjetor 2018*) vlerë e likuiduar me pagesat e kryera në muajin Janar 2019.

Në mbyllje të periudhës raportuese llogaritë kreditore (*42;431;435;436*) në vlerën totale *1,517,929 lekë*, përfaqëson detyrime të njësisë publike Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore, si dhe tatimi mbi pagë, të përllogaritura për pagesë në muajin (*dhjetor 2018*), ndërsa janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin Janar 2019.

3. Detyrime afatshkurtra të tjera;

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.

Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.

Në këtë zë të detyrimeve afatshkurtër mund të paraqiten tepricat kreditore të llogarive vijuese si:

	31/12/2018	31/12/2017
466.Kreditorë për mjete në ruajtje	*0*	*0*
467.Kreditorë të ndryshëm	*32,391*	*39,316*
4341.Operacione me shtetin (detyrime)	*0*	*0*
	32,391	**39,316**

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm" në fillim të vitit 2018 rezulton për vlerën 39,316 lekë dhe në fund të vitit 2018 për vlerën 32,391 lekë ose me zbritje në vlerën 6,925 lekë, e cila është e zbërthyer në mënyrë analitike.

DETYRIME AFATGJATA

1. Provizione afatgjata.

Në këtë zë të bilancit paraqiten të gjitha detyrimet e klasifikuara si provizione të cilat njësia ekonomike do t'i shlyejë pas më shumë se 12 muaj nga data e bilancit kontabël. Edhe për provizionet afatgjata vlen komenti i bërë për provizionet afatshkurtra. Llogaria provizione afatgjata paraqiten në bilanc për 2017 dhe 2018 në vlerën 0 lekë.

KAPITALI

Sipas përcaktimit të bërë në SKK kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4) njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.

	31/12/2018	31/12/2017
-(Llog. 101) Fondi i akumuluar	12,571,780	111,879,932
- (Llog. 12)Rezultatet e mbartura	458,985	637,184
- (Llog. 85)Humbja/fitimi i ushtrimit	605,327	-178,199

Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve përfaqëson tepricën e vitit e cila vjen si rezultat i ndryshimit të gjendjes së inventarit qarkullues (1,064,312 lekë – 458,985 lekë = 605,327 lekë)

Pasqyra e Performancës Financiare

	EMERTIMI I LLOGARIVE	Ushtrimi I Mbyllur 31.12.2018	Ushtrimi Paraardhës
A	**Te Ardhurat**	**29,926,378**	**37,818,918**
I	Të ardhurat nga taksat dhe tatimet	1,079,246	961,848
	Kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,908,619	4,125,896
	Të ardhurat jo tatimore	-	-
	Të ardhura financiare	-	-
	Grante korente	24,938,513	32,731,174
	Të ardhura të tjera	-	-
	Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve	-	-
	Totali i te ardhurave	**29,926,378**	**37,818,918**
B	**Shpenzimet**	**29,321,051**	**37,997,117**
I	**Pagat dhe përfitimet e punonjësve**		

	6001.Shpenzime të personelit	13,148,677	13,767,918
	6002.Paga personel i përkohshëm	616,323	0
	6003.Shpenzime të tjera për personelin	261,869	1,631,453
II	**Kontribute të sigurimeve**		
	6010.Kontribute të sigurimeve	1,672,775	1,951,447
	6011.Kontribute të sigurimeve shëndetësore	583,951	230,253
III	**Blerje mallra dhe shërbime**		
	602.Mallra dhe shërbime te tjera		
	6020.Materiale zyre e te përgjithshme	1,675,644	1,025,186
	6021.Materiale dhe shërbime speciale		
	6022.Sherbime nga te trete	2,149,720	3,906,419
	6023.Shpenzime transporti	1,461,379	1,613,024
	6024.Shpenzime udhëtimi	6,512,677	6,543,347
	6025.Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	1,138,036	615,240
	6026.Shpenzime të tjera operative	40,000	15,000
IV	**Subvencione**		
	6030.Subvencione për diferencë çmimi	-	-
V	**Transferime korente**		
	6040.Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë		6,519,631
	6061.Transferta paguara nga ISSH e ISKSH	60,000	
VII	**Kuota amortizimi dhe shuma te parashikuara**		
	681.Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit	-5,576,258	-55,502,959
	682.Vlera e mbetur e AAGJ, të nxjerra jashtë përdori dhe të shitura	18,148,038	166,923,906
VIII	**Ndryshimi i gjendjes së inventarit**	-605,327	178,199
IX	**Shpenzime të tjera**	-	-
	Teprica e ushtrimit	605,327	-178,199

Sipas SKK nr. 2, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.
Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:
(a) Efektet e korrigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (*SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*);
(b) Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;
(i) fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (*SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit*);
(ii) fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (*SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale);*
(iii) fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (*shih SKK 3 –Instrumentet Financiare);*
(iv) Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet
Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës.
Pasqyra e përformancës do të tregojë, si minimum, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen. Fitimi ose humbja do të jetë rreshti i fundit i kësaj pasqyre.

A. TË ARDHURAT

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet .

Të ardhurat nga taksat detajohen si më poshtë:

	31/12/2018	31/12/2017
7000.Tatim mbi të ardhurat personale	*1,064,246*	*946,848*
7002.Tatim mbi biznesin e vogël	*15,000*	*15,000*
750.Kontribute e sigurime shoqërore nga të punësuarit	*1,648,619*	*1,944,196*
751. Kontribute e sigurime shoqërore nga të punëdhënësi	*2,260,000*	
755.Kontribute nga buxheti për sigurime shoqërore		*1,951,447*
756.Kontribute nga buxheti për sigurime shëndetësore		*230,253*
	4,987,865	**5,087,744**

Nga auditimi u konstatua se tek pasqyra e performancës financiare për vitin 2018 dhe 2017 janë njohur gabimisht si të ardhura detyrimi i tatimit mbi të ardhurat personale në vlerën **1,064,246** lekë dhe detyrimi nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën **3,908,619** lekë. *(Në kundërshtim me pikën 4.2. të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e Përgatitjes dhe Raportimit Të Pasqyrave financiare vjetore'').*

Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit formati nr.2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2018 (*grant*) në shumën 23,085,652 lekë.
Vlera prej 23,085,652 lekë përfaqëson transferimet e granteve korente të përgjithshme për mbështetjen e veprimtarisë së funksionimit të institucionit, ku donatori në këtë rast është buxheti i shtetit.

-Grant korent i huaj:

Institucioni ka përfituar grant korent të huaj nga Organizata Ndërkombëtare (OSCE) gjatë vitit 2018 në vlerën prej 302,541 me aktrakordimin me thesarin dega Tiranë dhe në vitin 2017 në vlerën prej 1,631,453 lekë me aktrakordimin me thesarin dega Tiranë. Nga ana e Institucionit bëhet e ditur se ky grant i përfituar nga OSCE është përdorur në formë shpenzimi për pagesat e 4 punonjësve gjatë vitit 2017 në bazë të marrëveshjes midis Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe OSCE nr.471702, datë 17.05.2017 ku qëllimi i kësaj marrëveshje me titull "*Support Anti-Corruption Measures in Albania*" është fondi i akorduar nga OSCE për pagesën e 4 punonjësve ku janë paraqitur edhe kontratat repsektive të shërbimit midis titullarit të Institucionit (AMVV) dhe këtyre të fundit.
Më poshtë paraqitet edhe borderoja e pagave me pagesat dhe kohëzgjatjen e kontratave të shërbimit stopkorrupsionit.al midis Institucionit dhe punonjësve.

Emer, Mbiemer	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	paga	TAP	SHUMA TOTALE
E.M.	138,568	90,522	93,040	93,296	91,221	93,040	599,687	59,380	659,067
D.E.						66,473	66,473	63,781	130,254
I.B.	98,960	64,674	66,473	66,656	65,174	66,473	428,410	39,100	467,510
F.V.	98,960	64,674	66,473		65,174		295,281	38,800	334,081
TOTALI	336,488	219,870	225,986	159,952	221,569	225,986	1,389,851	201,061	1,590,912

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje ka qenë nga 17 Maj 2017 deri në 31 Dhjetor 2017.
U verifikuan edhe urdhër shpenzimet përkatëse me pagesat që ka bërë Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për pagat e 4 punonjësve si më sipër të paraqitur te tabela, përkatësisht urdhër shpenzimet nr.79, 80 dhe 81 datë 24.07.2017 me shpenzime për pagë muaji 17-31 maj 2017 dhe 1-30 qershor 2017, me urdhër shpenzimin nr.90 datë 16.08.2017 është paguar tatimi i mbajtur në burim në vlerën prej 59,380 lekë, urdhër shpenzimet nr.103, 104 dhe 105 datë 18.09.2017 për pagesat e punonjësve për periudhën 1-31 gusht 2017, urdhër shpenzimi nr.117 datë 17.10.2017 me pagesën për tatimin e mbajtur në burim shtator 2017 për punonjësit e OSCE në vlerën prej 39,100 lekë, urdhër shpenzimet nr.118, 119 dhe 120 datë 24.10.2017 me shpenzimet për pagat e punonjësve të OSCE për muajin shtator 2017, urdhër shpenzimet nr.134, 135 datë 22.11.2017 me shpenzimet për pagat e punonjësve të OSCE për muajin tetor 2017, urdhër shpenzimet nr.154, 155 dhe 156 datë

18.12.2017 me shpenzimet për pagat e punonjësve të OSCE për muajin nëntor 2017, urdhër shpenzimi nr.158 datë 20.12.2017 me pagesën për tatimin e mbajtur në burim nëntor 2017 për punonjësit e OSCE në vlerën prej 63,781 lekë.

B. SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat dhe përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore.

	31/12/2018	31/12/2017
6001.Paga personel i përhershëm	*13,148,677*	*13,767,918*
6002.Paga personel i përkohshëm	*616,323*	
6609.Shpenzime të tjera për personelin	*261,869*	*1,631,453*
6010.Kontributi i sigurimeve shoqërore	*1,672,775*	*1,951,447*
6011.Kontributi i sigurimeve shoqërore	*583,951*	*230,253*
	16,283,595	**17,581,071**

Gjatë vitit 2018 kemi një rënie të shpenzimeve për pagat dhe kontributet shoqërore prej 1,297,476 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë me po të njëjtën vlerë.

2. Blerje mallra dhe shërbime.

Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime gjatë vitit 2018 janë 12,977,456 lekë me një rënie prej 740,760 lekë krahasuar me vitin paraardhës. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë me po të njëjtën vlerë.

3.Subvencione.

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi.

4.Transferime korente.

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Janë transferta me lëvizje fondesh.

2/2. Auditimi i pasqyrave financiare viti 2017.

1. Nga verifikimi formal i pasqyrave financiare për vitin 2017 rezultoi se janë:

- *pasqyra e pozicionit financiar*, - *pasqyra e performancës financiare*, - *pasqyra e flukseve monetare*, - *pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto*, – *investimet dhe burimet e financimit*, – *gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata*, - *numri i punonjësve dhe fondi i pagave*.

Hartimi i pasqyrave financiare bazohet në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 "*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*"), të përcaktuara në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*".

Në mbështetje të nenit 3 dhe 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për "*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 për "*Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, nenit 10 dhe 11 të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*".

Nuk ka patur komunikim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.

Udhëzimi nr.14 datë 28.12.2006 "*Për Institucionet Qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë në varësi*". Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.26 datë 27.12.2007 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14 datë 28.12.2006.

b. Pasqyrat Financiare (Bilanci kontabël):

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore në fund të periudhës kontabël dt. 31.12.2017.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë:

- *Aktivet, Detyrimet, Kapitali.*

Klasifikimi i elementeve të mësipërme në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare. Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse .

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënnzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Pasqyrat e pozicionit financiar të Agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore në 31.12.2017 janë si më poshtë:

Pasqyra e aktiveve, detyrimeve dhe kapitali:

lekë

	Përshkrimi i elementeve	31.12.2016	Shtesa (+)	Pakësime (-)	31.12.2017
A	**AKTIVET**				
I	**Aktive afatshkurtra**				
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre	**0**			**0**
520	Disponibilitete në thesar	-			-
532	Vlera të tjera	-			-
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**637,184**			**458,985**
31	Materiale	528,937		-171,921	357,016
32	Inventar i imët	108,247		-6,278	101,969
	3.Llogari të arkëtueshme	**1,240,204**			**1,446,721**
423	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba				
431	Tatim e taksa				
435	Sigurime shoqërore				
436	Sigurime shëndetësore				
486	Debitorë të ndryshëm	-	39,316		39,316
4342	Operacione me shtetin(Të drejta)	1,240,204	167,201		1,407,405
	4.Të tjera aktive afatshkurtra				-
	Totali i aktiveve afatshkurtra				
II	**Aktivet afatgjata**	138,929,446			111,420,947
	1.Aktive afatgjata jo materiale	-			-
202	Studime dhe kërkime	-			-
	2.Aktive afatgjata materiale	**138,929,946**			**111,420,947**
210	Toka, Troje, Terrene	-			-
212	Ndërtesa dhe Konstruksione	1,573,800			1,573,800
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	-			-
214	Instalime teknike, makineri, dhe pajisje	1,115,768	766,200		1,881,968
215	Mjete Transporti	2,254,875	5,006,418		7,261,293
218	Inventar ekonomik	155,462,155	744,690		156,206,845
219	Amortizimi aktiv.Qendr.të trupëzuara	-21,476,652		-34,026,307	-55,502,959
	3.Aktive afatgjata financiare	-			-
25	Huadhënie dhe Nënhuadhënie	-			-
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	-			-
	4.Investime	-			-
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	-			-
231	Për Aktive Afatgjata materiale	-			-
	Totali i aktiveve afatgjata				
	Totali i aktiveve (I+II)	**140,807,334**		**27,480,681**	**113,326,653**
B	**DETYRIMET**				
I	**Detyrime afatshkurtra**				
	1.Llogari të Pagueshme	**1,240,204**			**1,446,721**
401,8	Furnitorë dhe llogari të lidhura me to	-			-
42	Detyrime ndaj personelit	831,296	115,935		947,231
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	82,518	13,206		95,724
435	Sigurime shoqërore	289,780	33,552		323,332
436	Sigurime shëndetësore	36,610	4,508		41,118
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	-			-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-			-
467	Kreditorë të ndryshëm	-	39,316		39,316
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	-			-
	2.Të tjera pasive afatshkurtra				-
	Totali i detyrimeve afatshkurtra	*1,240,204*			*1,446,721*
II	**Detyrime afatgjata**	-			-

	Totali i detyrimeve (I+II)	**1,240,204**			**1,446,721**
III	**Kapitali**				
101	Fondi i akumuluar	139,567,130		-27,687,198	111,879,932
12	Rezultatet e mbartura				
85	Rezultat i Veprimtarisë Ushtrimore				
105	Teprica e Granteve kapitale të brendshme				-
107	Vlera e mjeteve te caktuara në përdorim				-
	Totali i kapitalit	*139,567,130*			*111,879,932*
	Totali i kapitalit dhe detyrimeve (I+II+III)	**140,807,334**			**113,326,653**

A. AKTIVET

I. Aktivet afatshkurtra.

1. Mjete monetare.

Në këtë zë përfshihen kryesisht aktivet monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide. Gjithashtu mund të përfshihen edhe llogaritë hua dhe letra me vlerë, zhvlerësimi i aktiveve financiare nëse plotësojnë kushtin e përkufizimit si ekuivalente të mjeteve monetare.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre paraqiten në vlerën 0 lekë për vitet 2017 dhe 2018.

2. Inventari.

Në këtë zë të bilancit jepen informacionet për inventarin gjendje në datën e ndërtimit të bilancit. Paraqitja e gjendjes së këtyre inventarëve bëhet në Bilanc me vlerën neto. Në vartësi të llojit të inventarit ky zë mund të paraqitet i ndarë në disa nënzëra ku paraqiten tepricat e llogarive si: *lëndët e para dhe materialet e konsumueshme si dhe llogaritë e zhvlerësimit të tyre, prodhime në proces dhe gjysëmprodukte, produkte të gatshme, mallra për rishitje, parapagesa për inventar (llog. 371- 376).*

Në përputhje me SKK nr. 4 e përmirësuar në informacionet plotësuese të pasqyrave financiare në lidhje me inventarët duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm:

(a) politikat kontabël të përdorura si dhe formulat e përdorura për llogaritjen e kostos;

(b) vlerën kontabël të të gjithë inventarëve si dhe vlerën kontabël të tyre sipas klasifikimit të bërë nga njësia ekonomike;

(c) vlerën e inventarëve të njohur si shpenzim gjatë periudhës kontabël;

(d) shumën e ndonjë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme;

(e) vlerën kontabël të inventarit të dhënë si garanci;

(f) vlerën kontabël të inventarëve që janë në ruajtje të palëve të tjera;

(g) informacion mbi inventarin, shumat dhe nëse është e mundur përllogaritjen e vlerës, që nuk janë të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike por që janë në ruajtje të saj.

Inventari është detajuar si më poshtë:

	31/12/2017	31/12/2016
Gjendje Inventari	**458,985**	**637,184**
Mallra	*0*	*0*
Materiale	*357,016*	*528,937*
Inventar i imët	*101,969*	*108,247*

Nga analiza e kryer për llogarinë 32 "*Inventar i imët",* Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore gjatë vitit 2017 kemi pakësim prej 6,278 lekë.

Inventari i imët në fund të vitit ushtrimor 31.12.2017 paraqitet në shumën prej 101,969 lekë.

Nga rakordimi me urdhrin e ngritjes së komisionit për inventarizimin e aktiveve me nr.848 datë 21.12.2017 me kontabilitetin dhe Pasqyrën e Gjendjes dhe Ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme nuk rezultuan diferenca përsa i përket llogarisë 32 "*Inventar i imët*" dhe llogarisë 31 "*Materiale*".

Nga auditimi evidentohet se: Llogaritë inventariale për aktivet e Institucionit janë të rakorduara me fletë inventarë kontabël si dhe me inventarët e fundvitit ushtrimor 2017.

3. Llogari të arkëtueshme tregtare.

Në këtë nënzë përfshihen të gjitha të drejtat ndaj klientëve për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm. Konkretisht, nëse do t'i referohemi listës së llogarive të publikuar nga KKK, në këtë zë do të përfshihen tepricat debitore të llogarive të më poshtme:

411. Klientë për mallra, produkte e shërbime
423. Personeli, Paradhënie, Deficite, Gjoba
468. Debitorë të ndryshëm
4342. Operacione me shtetin (Të drejta)

Llogaritë e arkëtueshme tregtare paraqiten si më poshtë:

	31/12/2017	31/12/2016
-Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	0	
-Tatim e Taksa	0	
-Personeli, Paradhënie	0	
-Debitorë të ndryshëm	0	
-Sigurime Shoqërore	0	
-Sigurime Shëndetësore	0	
-Operacione me shtetin (Të drejta)	1,407,405	1,240,204
	1,407,405	**1,240,204**

➢ **Llog.4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)",***

Është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara. Raste të tilla mund të jenë këto (*por jo vetëm këto*) si; *pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi te ardhurat*, që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Në fund të vitit ushtrimor *2017 llogaria.4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"* paraqitet në vlerën prej **1,407,405** lekë e cila përbëhet nga shuma e llogarive 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" në vlerën 947,231 lekë, llog.431 "*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa*" në vlerën 95,724 lekë, llog.435 "*Sigurime shoqërore*" në vlerën 323,332 lekë, llog.436 "*Sigurime shëndetësore*" në vlerën 41,118 lekë dhe llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*" në vlerën 39,316 lekë.

II. Aktivet afatgjata.

I. Aktive afatgjata jomateriale.

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas udhëzimit nr.8 përfshin prime të emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme.

Aktivet afatgjata jomateriale (AAJM) janë aktive jomateriale që:

(a) është e mundur që nga përdorimi i aktivit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike

(b) kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri.

(c) aktivi nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda njësisë ekonomike për një zë jomaterial

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar.

Për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018 vlera në bilanc paraqitet në vlerën 0 lekë.

1I. Aktive afatgjata materiale.

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5 i përmirësuar.

Aktivet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që:

(*a) përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për tua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe (b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël.*

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

- Toka, paraqiten Toka, troje terrene.

Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

210. Toka,

211. Pyje, Plantacione,

- Ndërtesa, përfshihen Ndërtesa, struktura, rrugë dhe investime në objekte me qira.

Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

212. Ndërtesa,

213. Rrugë, rrjete, vepra ujore,

- Makineri dhe pajisje, përfshihen Pajisje prodhimi, Mjete transporti dhe Makineri e Pajisje të tjera.

Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

214. Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune,

215. Mjete transporti,

- Aktive të tjera afatgjata materiale.

Në këtë zë paraqiten zakonisht Mobiljet dhe Pajisjet e zyrave si dhe aktive të tjera afatgjata materiale që nuk përfshihen në grupet e tjera. Sipas përmbajtjes së tij në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

Aktivet afatgjata materiale (neto) janë detajuar si më poshtë:

	31/12/2017	31/12/2016
-Toka, Troje, Terrene (210)	0	
-Pyje, Plantacione (211)	0	
-Ndërtesa dhe Konstruksione (212)	1,573,800	1,573,800
-Rrugë, rrjete, vepra ujore (213)	0	
-Instalime teknike, makineri, dhe pajisje (214)	1,881,968	1,115,768
-Mjete Transporti (215)	7,261,293	2,254,875
-Inventar ekonomik (218)	156,206,845	155,462,155
-Aktive afatgjata të dëmtuara(24)	0	0
-Caktime te Aktiveve Afatgjata(28)	0	0
-Amortizimi aktiv. Qendr.te trupëzuara(-)	-55,502,959	-21,476,652
	111,420,947	**138,929,946**

-*Për llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene"* paraqitet në vlerën 0 lekë gjatë vitit 2017.

-*Për llogarinë 211 "Pyje, Plantacione"* në bilanc paraqitet në vlerën 0 lekë.

-*Për llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione"* në fund të vitit ushtrimor për vitin 2017 paraqitet në vlerën neto 1,573,800 lekë dhe amortizim të akumuluar prej 35,209 lekë.

Gjatë bilancit ushtrimor të vitit 2018 "*llog. 212"* paraqitet në vlerën prej 1,573,800 lekë e cila përfaqëson shpenzimet e kryera nga Institucioni për rikonstruksionin e godinës të bëra në vitet 2015-2017. Evidentohet se, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.473 datë 03.06.2015 pika 2.1 thuhet që *"Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore t'i jepet në përdorim të përkohshëm kati i shtatë i godinës, sipas planimetrive dhe plan vendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT)"*. Institucioni nuk ka në inventar objekte ndërtimore pasi objekti në të cilën ushtron veprimtarinë është pronë e Ministrisë së Mbrojtjes.

-*Për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri dhe pajisje"* paraqitet në vlerën 1,881,968 lekë. *Nga analiza e kryer për llogaritë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" dhe 214 "Instalime teknike, makineri dhe pajisje" (në vlerën totale prej 3,288,140 lekë) janë bërë këto veprime:*

- Në datën 25.06.2015 është kryer ristrukturimi godinës më vlerën 706,800 lekë.

- Në datën 21.07.2015 është kryer ristrukturimi i godinës me dyer, dritare etj, me vlerën 496,800 lekë.
- Në datën 21.12.2016 është kryer ristrukturimi i godinës për instalime elektrike me vlerën 255,600 lekë.
- Në datën 15.12.2016 është kryer ristrukturimi i godinës për sistemin biometrik të derës së jashtme me vlerën 99,684 lekë.
- Në datën 14.12.2016 është kryer ristrukturimin i godinës (rikonstruksione të pjesshme) me vlerën 780,000 leke.
- Në datën 22.12.2016 janë kryer instalime interneti me vlerën 118,000 lekë.
- Në datën 29.12.2016 janë kryer instalime hidraulike me vlerën 46,000 lekë.
- Në datën 19.12.2017 është kryer ristrukturimi i godinës për vendosje dyer, dritare dhe fasada e godinës me vlerën 766,200 lekë.

Nga verifikimi rezulton se për llogaritë si më poshtë:
-Llog.215 "Mjete transporti"
-Llog.218 "Inventar ekonomik"
Në fund të vitit ushtrimor 2017 llog.218 "*Inventar ekonomik"* paraqitet në vlerën 156,206,485 lekë. Kjo ka ardhur si rezultat i blerjes së pajisjeve kompjuterike ku Institucioni Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (ish-AZRT) i ka blerë me procedurë prokurimi në vitin 2016 dhe me faturë tatimore shitje nr.558 datë 06.07.2016 të lëshuar nga subjekti privat B.... me NIPT "J....1" për dixhitalizimin e arkivave të Njësive Vendore. Nga ana e Agjencisë bëhet e ditur se bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.40 datë 16.10.2015 "*Për shpërndarjen e fondit për programin Shqipëria Dixhitale pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve*" është çelur fondi përkatës për blerjen e pajisjeve kompjuterike. Kjo ka ardhur si rezultat i transferimit pa pagesë të aktiveve pranë 61 Njësive Vendore të cilat janë pajisje kompjuterike ku Institucioni Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (ish-AZRT) i ka blerë me procedurë prokurimi në vitin 2016 për dixhitalizimin e arkivave të Njësive Vendore.
Llog. 215 "Mjete transporti", për vitin 2017 ka vlerën 4,979,172 lekë. Në kartelën e inventarizimit kjo llogari është zbërthyer në mënyrë analitike dhe përbëhet nga 2 automjete.
Ka patur shtesa gjatë vitit ushtrimor 2017dhe është e rakorduar me formatin nr. 6 të pasqyrave financiare "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*".
Gjatë vitit ushtrimor 2017 llog.215 "*Mjete Transporti"* paraqitet në vlerën 4,979,172 lekë ku evidentohet se ka patur shtesa pa pagesë (formati 7- pasqyra e amortizimeve) në vlerën prej 5,006,418 lekë. Amortizimi i akumuluar është paraqitur në vlerën 1,484,991 lekë.

➢ Inventarizimi i aktiveve
Për vitin 2017 inventarizimi i aktiveve paraqitet si më poshtë:
- llog.218 "*Inventar ekonomik*" në vlerën prej 99,863,366 lekë.
- llog.32 "*Inventar i imët*" në vlerën prej 485,985 lekë.

Në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është kryer duke u bazuar në urdhrin e titullarit nr. 261, datë 27.12.2017, për vitin 2017 sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", me ndryshimet.
Në këtë urdhër është përcaktuar ngritja dhe funksionimi i komisionit të inventarizimit i cili është i përbërë nga 3 persona (X.C., G.C. dhe E.H.) të cilët kanë kryer inventarizimin sipas këtij urdhri dhe kanë kryer vetëm përgatitjen si dhe nënshkrimin e fletë inventarëve përkatës. Fletë inventarët e materialeve në përdorim janë nënshkruar edhe nga personeli përgjegjës që i ka në ngarkim. Nga auditimi rezultoi se nuk kanë rezultuar diferenca nga inventari kontabël të paraqitur nga Sektori i Financës me inventarin fizik.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr.7/b) Viti 2017.

Në fillim të vitit 2017 rezulton se Amortizimi në çelje në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për Aktivet Afatgjata Materiale paraqitet për vlerën 33,335,421 lekë. Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivit. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.
Ligji nr. 8438, dt. 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", neni 22, i ndryshuar dhe UMF nr. 5, dt. 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" pika 3.7 "*Amortizimi*", i ndryshuar, si edhe udhëzimi nr.14, dt.28.12.2006 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",*
Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2017 si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	*Vlera e mbetur*	*5,8%*
Ndërtesa	*Vlera e mbetur*	*1%*
Pajisje informatike	*Vlera e mbetur*	*25%*
Mobilje dhe orendi	*Vlera e mbetur*	*3%*
Pajisje zyre	*Vlera e mbetur*	*3%*
Mjete transporti	*Vlera e mbetur*	*13,8%*
Të tjera	*Vlera e mbetur*	*3%*

Aktivet në proces nuk amortizohen.

Testi substancial i amortizimit

Qëllimi: Është kryer Riperformimi i amortizimit duke u bazuar në udhëzimin nr.14, dt.28.12.2006 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të riperformuar sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në regjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet.

Nr	Aktivi	Sasia	Cmimi	Vlera	Data e blerjes	Amortizimi I akumuluar	Amortizimi 2017	Vlera Neto 2017	Vlera Neto e rillogaritur nga audituesi
1	Projektor TIP 1-A 123 PH	1	58,242	58,242	29.10.2015	16,381	10,465	31,396	31,396
2	Laptop E554 HM86	1	180,360	180,360	07.12.2015	45,090	33,818	101,452	101,452
3	Kompjuter Desktop	11	87,840	966,240	07.12.2015	241,560	181,170	543,510	543,510
4	Laptop Cells H730	1	97,680	97,680	07.12.2015	24,420	18,315	54,945	54,945
5	Kompjuter Fujitsu Celsisu M470	1	258,600	258,600	31.05.2016	37,713	55,222	165,665	165,665
6	Fotokopi Toshibaest 557	1	534,000	534,000	31.05.2016	77,875	114,031	342,094	342,094

Burimi: Të dhënat e AMVV nga librat kontabël të përpunuara nga Audituesi në tabelë.

Pas ri llogaritjes vihet re se janë zbatuar normat e amortizimit të parashikuara nga Udhëzimi nr.14, dt.28.12.2006 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* dhe nuk janë vënë re anomali të theksuara. Për amortizimin e aktiveve për shtesat që janë bërë gjatë vitit 2017 nga ana e Sektorit të Financës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është bëra rillogaritja mujore e normës së amortizimit duke patur parasysh muajin e blerjes së aktivit.

III. Aktivet Afatgjata Financiare.

Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2017 paraqiten në vlerën 0 lekë.

B. DETYRIMET DHE KAPITALI

I. DETYRIMET

Huatë dhe paraparagimet.

Në këtë grup përfshihen kryesisht të gjitha llogaritë që paraqesin detyrimet tregtare të Agjencisë ndaj të tretëve për mallrat dhe shërbimet e blera e të papaguara, për paradhëniet e marra, detyrimet ndaj punonjësve të vet, detyrimet ndaj shtetit për tatimet e taksat e ndryshme të papaguara, dhe hua të tjera.

1. Llogari të pagueshme tregtare.

Në këto llogari paraqiten të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme. Në të do të përmblidhen tepricat kreditore të llogarive vijuese si:

401. Furnitorë për mallra, produkte e shërbime;
403. Premtim pagesa të pagueshme;
404. Furnitorë për aktivet afatgjatë;

Llogaritë e pagueshme tregtare paraqiten në vlerën 0 lekë për vitin 2017.

2. Detyrimet ndaj personelit dhe Detyrimet tatimore

Në këtë zë përfshihen të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të llogaritura e të papaguara ndaj shtetit si psh TVSH, Tatimi mbi fitimin, Akcizat, Tatimi mbi të Ardhurat Personale, Tatim në Burim, Tatimet e tjera, si dhe për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, kur ato parashikohen që të shlyhen brenda 12 muajve nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare. Në këtë nënzë do të përmblidhen tepricat kreditore të llogarive vijuese:

42. Detyrime ndaj personelit;
43. Detyrime për sigurimet shoqërore dhe llogari të lidhura me to;
435. Sigurime shoqërore
436. Sigurime shëndetësore
438. Detyrime të tjera
44. Shteti për tatime dhe taksa dhe llogari të lidhura me to;
441. Akciza,
442. Tatim mbi të ardhurat personale,
443. Tatime të tjera për punonjësit,
444. Tatim mbi fitimin,
445. TVSH,
4453. Shteti-TVSh për t'u paguar,
447. Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer (teprica kreditore),
448. Tatime të shtyra (teprica kreditore),
449. Tatimi në burim,

Detyrimet për vitin e mbyllur janë detajuar si më poshtë:

	31/12/2017	31/12/2016
42-Detyrime ndaj personelit	*947,231*	*831,296*
431-Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	*95,724*	*82,518*
435-Detyrime për sigurime shoqërore	*323,332*	*289,780*
436-Detyrime Shëndetësore	*41,118*	*36,610*
	1,407,405	**1,240,204**

-Llog.(42); "*Personeli e llogari të lidhura me to",* analizuar e kuadruar me gjendje kontabile vlera *947,231 lekë* përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit periudha (*dhjetor 2017*) dhe në fund të vitit 2016 për vlerën *831,296 lekë* me një rritje në vlerën *115,935 lekë*.

-Llog.(431);"*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*", analizuar e kuadruar me gjendje kontabile vlera *95,724 lekë* përfaqëson detyrimet për tatimi mbi pagat e personelit në periudhën (*dhjetor 2017*) vlerë e likuiduar me pagesat e kryera në muajin Janar 2018.

-Llog.(435); "*Sigurime shoqërore*" e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile vlera *323,332 lekë* përfaqëson detyrimet për kontribut në sigurimet shoqërore në periudhën (*dhjetor 2017*) vlerë e likuiduar me pagesat e kryera në muajin Janar 2018.

-Llog.(436); "*Sigurime shëndetësore*" e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile vlera *41,118 lekë* përfaqëson detyrimet për kontribut në sigurimet shëndetësore në periudhën (*dhjetor 2017*) vlerë e likuiduar me pagesat e kryera në muajin Janar 2018.
Në mbyllje të periudhës raportuese llogaritë kreditore (*42;431;435;436*) në vlerën totale *1,407,405 lekë,* përfaqëson detyrime të njësisë publike Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore, si dhe tatimi mbi pagë, të përllogaritura për pagesë në muajin (*dhjetor 2017*), ndërsa janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin Janar 2018.

3. Detyrime afatshkurtra të tjera;

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.
Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.
Në këtë zë të detyrimeve afatshkurtër mund të paraqiten tepricat kreditore të llogarive vijuese si:

	31/12/2017	31/12/2016
466.Kreditorë për mjete në ruajtje	*0*	*0*
467.Kreditorë të ndryshëm	*39,316*	*0*
4341.Operacione me shtetin (detyrime)	*0*	*0*
	39,316	**0**

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm" në fillim të vitit 2017 rezulton për vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2017 për vlerën 39,316 lekë ose me rritje në vlerën 39,316 lekë, e cila është e zbërthyer në mënyrë analitike.

DETYRIME AFATGJATA

1. Provizione afatgjata.

Në këtë zë të bilancit paraqiten të gjitha detyrimet e klasifikuara si provizione të cilat njësia ekonomike do t'i shlyejë pas më shumë se 12 muaj nga data e bilancit kontabël. Edhe për provizionet afatgjata vlen komenti i bërë për provizionet afatshkurtra. Llogaria provizione afatgjata paraqitet në bilanc për 2017 në vlerën 0 lekë.

KAPITALI

Sipas përcaktimit të bërë në SKK kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4) njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.

	31/12/2017	31/12/2016
-(Llog. 101) Fondi i akumuluar	111,879,932	139,567,130

Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Pasqyra e Performancës Financiare

	EMERTIMI I LLOGARIVE	Ushtrimi I Mbyllur 31.12.2017	Ushtrimi Paraardhës
A	**Te Ardhurat**	**313,005,718**	**49,863,909**
I	Të ardhurat nga taksat dhe tatimet	961,848	993,174
	Kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,125,896	3,789,439
	Të ardhurat jo tatimore	-	-
	Të ardhura financiare	-	-
	Grante korente	32,731,174	27,325,547
	Të ardhura të tjera	-	-
	Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve	-	-
	Punime për investime e rimarrje	275,186,800	6,379,800
B	**Shpenzimet**		
I	**Pagat dhe përfitimet e punonjësve**		
	6001.Shpenzime të personelit	13,767,918	12,655,244

	6002.Paga personel i përkohshëm	0	0
	6003.Shpenzime të tjera për personelin	0	0
II	**Kontribute të sigurimeve**		
	6010.Kontribute të sigurimeve	1,951,447	1,791,658
	6011.Kontribute të sigurimeve shëndetësore	230,253	211,335
III	**Blerje mallra dhe shërbime**		
	602.Mallra dhe shërbime te tjera	13,718,216	11,375,929
	6020.Materiale zyre e te përgjithshme	1,025,186	636,386
	6021.Materiale dhe shërbime speciale	0	0
	6022.Sherbime nga te trete	3,906,419	2,288,170
	6023.Shpenzime transporti	1,613,024	1,501,026
	6024.Shpenzime udhëtimi	6,543,347	6,413,347
	6025.Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	615,240	522,000
	6026.Shpenzime të tjera operative	15,000	15,000
IV	**Subvencione**		
	6030.Subvencione për diferencë çmimi	-	-
	Shpenzime Financiare	1,631,453	1,301,145
	Ndryshimi i gjendjes së inventarit		
IX	**Shpenzime të tjera**		
	Teprica e ushtrimit		

Sipas SKK nr. 2, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.
Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:
(a) Efektet e korrigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (*SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*);
(b) Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;
(i) fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (*SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit*);
(ii) fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (*SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale);*
(iii) fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (*shih SKK 3 –Instrumentet Financiare);*
(iv) Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet;
Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës.
Pasqyra e përformancës do të tregojë, si minimum, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen. Fitimi ose humbja do të jetë rreshti i fundit i kësaj pasqyre.

A. TË ARDHURAT

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet.

Të ardhurat nga taksat detajohen si më poshtë:

	31/12/2017	31/12/2016
7000.Tatim mbi të ardhurat personale	*946,848*	*978,174*
7002.Tatim mbi biznesin e vogël	*15,000*	*15,000*
750.Kontribute nga të punësuarit	*1,944,196*	*1,787,466*
755.Kontr.buxhetit për sigurimet shoqërore	*1,951,447*	*1,790,658*

756.Kontr.buxhetit për sigurimet shëndetësore	*230,253*	*211,335*

Nga ana e Institucionit bëhet e ditur që nuk paraqesin dhe realizojnë të ardhura.
Nga auditimi u konstatua se tek pasqyra e performancës financiare për vitin 2017 janë njohur gabimisht si të ardhura detyrimi i tatimit mbi të ardhurat personale në vlerën **946,848** lekë dhe detyrimi nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën **4,125,896** lekë.
(Në kundërshtim me pikën 3.4. të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e Përgatitjes dhe Raportimit Të Pasqyrave financiare vjetore'').

Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit formati nr.2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2017 (*grant*) në shumën 32,731,174 lekë.

B. SHPENZIMET
1. Shpenzimet për pagat dhe përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore.

	31/12/2017	31/12/2016
6001.Paga personel i përhershëm	*13,767,918*	*12,655,244*
6002.Paga personel i përkohshëm		
6009.Shpenzime të tjera për personelin		
6010.Kontributi i sigurimeve shoqërore	*1,951,447*	*1,791,658*
6011.Kontributi i sigurimeve shoqërore	*230,253*	*211,335*
	15,949,618	**14,658,237**

Gjatë vitit 2017 kemi një rritje të shpenzimeve për pagat dhe kontributet shoqërore prej 1,291,381 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë me po të njëjtën vlerë.
2. Blerje mallra dhe shërbime.
Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.
Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime gjatë vitit 2017 janë 15,949,618 lekë me një rritje prej 1,291,381 lekë krahasuar me vitin paraardhës. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë me po të njëjtën vlerë.
3.Subvencione
Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi.
4.Transferime korente
Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Janë transferta me lëvizje fondesh.

Sa më sipër për Pasqyrat Financiare 2018 dhe 2017 arrihet në konkluzionin që:

1)-Sa i përket procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit evidentojmë se, komisioni i inventarizimit të aktiveve, nuk ka kryer të rregullt procesin e inventarizimit kjo pasi komisioni nuk ka përpiluar proces verbalet përkatëse të verifikimit fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë, në mospërputhje me *pikën 82/a,b,c (Komisioni nuk duhet të jetë me më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi13. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi) të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, përgjegjësi e komisionit të inventarizimit dhe menaxhimit të institucionit.
Për vitin 2017dalja e mallrave e materialeve është kryer nga magazina e institucionit bazuar në urdhër dorëzimin e mallit të miratuar nga shefi sektorit. Dalja e mallrave është nënshkruar nga magazinierja dhe punonjësi përkatës .

Për vitin 2017 ditari i hyrje daljeve është mbajtur në mënyrë kronologjike dhe me kartela të nënshkruara nga financieri dhe magazinieri. Për vitin 2018 dhe 2019 ditari i magazinës hyrje – dalje është mbajtur me financën 5. Mungojnë kartelat apo libri i magazinës, të cilat duhet ti ketë magazinieri dhe të rakordojë me ditarin e magazinës në mospërputhje me *pikat 36, 37, 38, 39 dhe 40 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ku përcaktohet se (Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre).*

2)-Gjatë procesit të inventarizimit të aktiveve komisioni i inventarizimit duke u bazuar në urdhrin e titullarit nr. 848, datë 21.12.2018, për vitin 2018 sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve të aktiveve nuk i është përmbajtur si duhet ***pikave 30, 74, 76 dhe 82 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",*** *ku përcaktohet se (Inventarizimi bëhet, sipas rastit, me numërim, matje/peshim, verifikim etiketash/matjesh teknike etj. të të gjitha objekteve që inventarizohen. Komisioni nuk duhet të jetë me më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin.*

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 " *Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pikat**40***(Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre)*,**74 n** (*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës)*,**76** (*Inventarizimi bëhet, sipas rastit, me numërim, matje/peshim, verifikim etiketash/matjesh teknike, etj të të gjitha objekteve që inventarizohen. Si përjashtim, me autorizim të titullarit për aktivet e ambalazhuara standard dhe të vulosura nga prodhuesi, inventarizimi në magazinë mund të bëhet në bazë të të dhënave të etiketave, duke bërë kontrolle në jo më pak se 5 për qind të numrit të përgjithshëm të pakove dhe, kur dalin diferenca, shtrihet në të gjithë sasinë*), dhe pika 82 (*Komisioni nuk duhet të jetë me më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin.)*

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2019 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme*".

3) Nga auditimi u konstatua se tek pasqyra e performancës financiare për vitin 2018 dhe 2017 janë njohur gabimisht si të ardhura detyrimi i tatimit mbi të ardhurat personale në vlerën **1,064,246** lekë dhe detyrimi nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën **3,908,619** lekë.

Sa më lart është në kundërshtim me pikën 3.5 të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e Përgatitjes dhe Raportimit Të Pasqyrave financiare vjetore''.

Titulli i Gjetjes:	*Gjatë procesit të inventarizimit të aktiveve komisioni i inventarizimit të aktiveve nuk i është përmbajtur si duhet pikave 30, 74, 76,82dhe 85 të Udhëzimit nr.30 të datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*
Situata 1:	Nga auditimi u konstatua se Komisionet e Inventarizimit të Aktiveve për vitet 2017 dhe 2018, gjatë procesit të inventarizimit nuk kanë përpiluar proces verbalet përkatëse të verifikimit fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë. Gjithashtu në komisionin e inventarizimit ka marrë pjesë punonjësi që ka në

	ngarkim/përdorim aktivin në kundërshtim me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* pika 82, 83.
Situata 2:	Nga auditimi u kostatua se tek pasqyra e performancës financiare për vitin 2018 dhe 2017 janë njohur gabimisht si të ardhura detyrimi i tatimit mbi të ardhurat personale në vlerën 1,064,246 lekë dhe detyrimi nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 3,908,619.
Kriteri:	- Udhëzimi i MF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, përgjegjësi e komisionit të inventarizimit dhe menaxhimit të institucionit*" në mospërputhje me pikat 82, 83. - Mosnjohja dhe zbatimi jo i duhur i Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e Përgatitjes dhe Raportimit Të Pasqyrave financiare vjetore''*, në kundërshtim me pikën 3.5.
Ndikimi/Efekti	- Inventarizimi i aktiveve i gabuar në kontabilitet dhe deformim i informacionit mbi verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim. - Klasifikim i gabuar në kontabilitet dhe deformim i informacionit mbi detyrimet mbi tatimin e pagave dhe të kontributeve shoqërore.
Rëndësia	I ultë
Rekomandimi	- Nga Komisionet e Inventarizimit të Aktiveve të merren masat që gjatë procesit të inventarizimit të hartojnë proces verbalet përkatëse të verifikimit fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë. Gjithashtu Titullari i Agjencisë të merren masat që në komisionet e inventarizimit të mos marrin pjesë punonjësit që kanë në ngarkim/përdorim aktivin pas nuk duhet të ketë konflikt interesi, por ata duhet të jenë të i pranishëm kur bëhet inventarizimi i aktiveve. - Nga ana AMVV, Sektori i Financës të merren masa për të sistemuar në pasqyrat financierë të vitit 2019 vlerën e paraqitur gabimisht si të ardhura në pasqyrën e performancës financiare, tatimin mbi të ardhurat personale në vlerën 1,064,246 lekë dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 3,908,619 lekë.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Me mbylljen e Bilancit 2020*

Mbajtur Akt Konstatimi nr.6, dt. 26.12.2019 "Për mbajtjen e kontabilitetit hartimi i pasqyrave financiare për vitet 2017-2018 dhe inventarizimi i pasurisë publike dhe llogarive të AMVV".

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Garda e Republikës me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:

Udhëzimi i MF nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e Përgatitjes dhe Raportimit të Pasqyrave financiare vjetore, është pasi janë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2017 në 28 shkurt 2018. Për pasqyrat financiare të vitit 2018 tatimi mbi të ardhurat personale 1,064,246 lekë dhe detyrimi nga kontributet shoqërore dhe shëndetsore në vlerën 3,908,619 lekë, u sistemua në pasqyrat financiare te vitit 2019.(bashkëlidhur pasqyrat financiare 2019).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë*:*

...Në lidhje me shpjegimet e paraqitura dhe bilancit të 2019 të dërguar prej jush dhe të miratuar, sqarimi juaj merret në konsideratë për faktin që janë kryer sistemimet në pasqyrat financiare të vitit 2019.

Komente dhe shpjegime:
Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:
Përsa i përket procesit të inventarizimit, nga ana e komisionit të inventarizimit nuk është bërë vlerësimi i gjendjes fizike të aktiveve në ngarkim të gjithë secilit për vitin 2017 dhe 2018, po për vitin 2019 është mbajtur proces verbal për gjendjen fizike të aktiveve në ngarkim , ku kanë rezultuar në gjendje jo të mirë vetëm disa pajisje të dhëna falas nga kryeministria të viteve 1999, të gjitha aktivet e tjera janë në gjendje të mirë.
Përsa i përket marrjes pjesë të punonjësit që kanë në ngarkim mallin ka ndodhur vetëm në vitin 2017 kur është marrë një punonjëse e re në AZRT dhe i është caktuar detyra e magazinieres, dhe në fund të vitit është bërë dorëzimi dhe marrja në dorëzim e magazinës ku ishte i pranishëm komisioni i inventarizimit dhe punonjësja që do mbante magazinës.(bashkëlidhur urdhri i ngritjes së komisionit 2017,2018 dhe 2019 si dhe inventari 31 dhjetor 2017)
Në asnjë rast tjetër personi përgjegjës materialit nuk është në komision.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:
...Në lidhje me komentet e paraqitura nga ana juaj, përsa i përket viteve të auditimit 2017 dhe 2018 procesi i inventarizimit nga ana e komisionit nuk është kryer në përputhje me pikat 30, 74, 76, 82 dhe 85 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për inventarizimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ku përcaktohen qartë sesi duhet të kryhet procesi i inventarizimit dhe verifikimit të cilësisë dhe gjendjes së aktiveve prandaj dhe sqarimet tuaja nuk merren në konsideratë.

3. Mbi përputhshmërinë e veprimeve në lidhje me marrëdhëniet e punës, bazuar në aktet ligjore në fuqi për periudhën 2015 – 2019.

3/1. Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave (plan, fakt dhe në %).

C2.1-Llogaritja dhe pagesa e detyrimeve për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.
C2.2-Mbi pagesat jashtë kohës normale të punës, argumentimi dhe dokumentimi i tyre.
C2.3-Hapja dhe azhurnimi i regjistrit të punonjësve, pajisje e tyre me Libreza pune, evidentimi i vjetërsisë së përgjithshme në punë.
C3.4-Auditim mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimin nga puna, efektet financiare dhe nxjerrja e përgjegjësisë .
Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave (plan, fakt dhe në %).
Nga auditimi dhe të dhënat e paraqitura nga Agjencia për mbështetjen e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, rezulton se për secilin vit është zbatuar fondi i pagave në masën e parashikuar. Dhe nuk ka tejkalime. Respektivisht mesatarisht për 15 punonjësit shpenzohen për fondin e pagave dhe sigurimeve **15,950-16,157 mijë lekë/vit**. Në mënyrë të detajuar për secilin vit parashikimi dhe realizimi i fondit pagave dhe numrit të punonjësve për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2019, paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:
Për periudhën 2015-2016 *në 000/lekë*

Nr	Artik	Emërtimi	Viti 2015				Viti 2016			
			Plan vjetor	Reali	%	+ -	Plan	Reali	%	+ -
1	600	Paga	7,500	5,488	73.1		11,945	11,945	100	
2	601	Sigurime shoq +Shëndetësore	1,400	879	62.8		1,928	1,928	100	
3		Shuma	8,900	6,367	71.5		13,873	13,873	100	
A		Numri i Punonjësve	12	11	91.6		14	14	100	

B		Punonjës me kontrate provizore	0	0			0	0		
		Teknik i mesëm	0	0			0	0		
		Pastruese	0	0			0	0		

Për periudhën 2017-2019

Në 000/lekë

Nr	Artik	Emërtimi	Viti 2017				Viti 2018				Viti 2019			
			Plan vjetor	Reali	%	+ -	Plan	Reali	%	+ -	Plan vjetor	Reali	%	+ -
1	600	Paga	13,768	13,768	100		13,900	13,900	100		13,880	13,870	97	
2	601	Sigur shoq +Shëndetës	2,182	2,182	100		2,260	2,257	100		2,200	2,153	98	
3		Shuma	15,950	15950	100		16,160	16,157	100		16,080	16,024	98	
A		Numri i Punonjësve	14	14	100		14	14	100		14	14	100	
B		Punonjëse me kontratë	4	4			2				1	1		
		Teknik i mesëm	3	3			1							
5		Pastruese	1	1			1				1	1		

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore këtu e në vazhdim shkurtimisht (AMVV-së), është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, **në varësi të Ministrisë së Brendshme** dhe që financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Organigrama dhe struktura e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV-së) përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit nr.68, datë 05.05.2015, "*Për miratimin e strukturës së .Agjencisë së zbatimit të Reformës Territoriale*", ka qenë **me 12 punonjës**. Ndërsa me urdhrin e Kryeministrit nr. 82, datë 12.05.2016, janë shtuar edhe 2 punonjës, pra që nga muaji Maj 2016 e në vazhdim për vitet 217, 2018 dhe 2019, Struktura dhe organika e AMVV-së, aktualisht përbëhet mesatarisht në vit **nga 14 punonjës dhe 1 punonjës me kontratë provizore (1 sanitare me orar të reduktuar 6 orë), të inkuadruar në 2 sektorë:**

I**. Drejtor i Përgjithshëm Kategoria e Pagës II-a .....**1 Fakt 1

1.**Sektori i Analizës dhe i Mbështetjes Institucionale.....4 punonjës** fakt 4

Përgjegjës Sektori Kategoria e pagës III-a /1, me.....1 punonjës, Fakt 1
Specialist (Financë) Kategoria e pagës IV-a, me .....1 punonjës, Fakt 0
Specialist Kategoria e pagës IV-a, me.....1 punonjës, Fakt 1
Specialist IT, Kategoria e pagës IV-a, me..... 1 punonjës, Fakt 1

II**. Sektori i Koordinimit me Vetëqeverisjen Vendore....9 punonjës**.

Përgjegjës Sektori Kategoria e pagës III-a /1, me..... 1 punonjës, Fakt 1
Inspektor. Kategoria e pagës III-b, me ..... 7 punonjës, Fakt 7
Specialist Kategoria e pagës IV-a, me.....1 punonjës, Fakt 1
Gjithsej nga..... 14 punonjës me Kodin e Punës.

Agjencia për periudhën e auditimit ka një numër mesatar prej 14, punonjësish dhe 3 punonjës provizor 2 janë shtuar me VKM nr. 07, datë 11.01.2017 "*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme dhe 1 pastruese me sistem 6-orarsh shtuar me VKM nr. 169, datë 27.03.2019"*, Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 16, datë 16.01.2019, të KM "*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore*" të ndryshuar.

Nga verifikimi i listë pagesave më datën 31.12.2017 datën 31.12.2108 dhe datën 30.09.2019 rezulton se në total organika është zbatuar, por konstatohet se në Sektorin e Analizës dhe i Mbështetjes Institucionale nga 4 punonjës të parashikuar, në fakt në total janë 4 punonjës, por në 1 rast nuk është ruajtur struktura e parashikuar në urdhrin e kryeministrit, pasi specialisti i Financës është zëvendësuar me një specialist tjetër të profilit jo arsimim Financë, me znj. **F.H.,** Diplomë e nivelit të parë në Shkenca Politike, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale**,** emëruar me urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm **z. B..,** nr. 302, datë 13.05.2018, për

ndjekjen e detyrave sipas urdhrit kryeministrit nr.237, datë 13.12.2017, Sqarojmë se aktualisht specialistja **F.H.,** është me raport barë lindje deri në fillim të muajit janar 2020.
Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive. Por u konstatua si mangësi se në listë pagesat te kolona Emërtesa sipas strukturës së miratuar, nuk vendoseshin pozicionet zyrtare të secilit punonjës, (detyra funksionale) por vendosej vetëm shkurtimi i emrit Agjencisë (AMVV).
Nga auditimi rezulton se në fund të secilit muaj, nga 2 përgjegjësit e sektorit hartoheshin Listë prezenca e paraqitjes në punë të punonjësve për secilën datë, kjo listë prezencë nënshkruhej nga hartuesja në cilësinë e nëpunësit zbatues **znj. F.M.**, përgjegjëse e sektorit analizës dhe mbështetjes Institucionale dhe nëpunësi autorizues **z. B.M.**, drejtor i përgjithshëm, ndërkohë që listë pagesat nuk nënshkruheshin edhe nga punonjësi i ngarkuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrit Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" **i ndryshuar, pika 69, ku përcaktohet se:**
69. Listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listeprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen **dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dh**e nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.
C2.1-Llogaritja dhe pagesa e detyrimeve për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale..
Nga të dhënat e paraqitura rezulton se Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka llogaritur dhe kryer rregullisht pagesa e detyrimeve për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.
-Mbi zbatimin e procedurave të emërimit të punonjësve
Nga auditimi rezulton se për emërimin e 14 punonjësve gjithsej të Agjencisë, për 5 prej tyre emërimi në punë është bërë më urdhër të drejtorit të përgjithshëm, (pa përcaktuar asnjë kriter apo kërkesë, si konkurrim, shpallje të vendeve vakant etj) dhe **pa u marrë zyrtarisht (me shkrim) miratimin e ministrit për çështjet vendore**, **respektivisht**:
1.Për z. **G.S.**, në pozicionin pune (detyrën) Përgjegjës Sektori i koordinimit me qeverisjen vendore, emëruar në këtë detyrë nga drejtorit i Përgjithshëm z. Bekim Murati, me urdhrin nr. **238, datë 21.03.2019** për një periudhë 8 muaj dhe 10 ditë me pagë mesatare mujore neto prej 70,498 lekë, duke u paguar nga data 21.03.2019 deri më datën 30.11.2019 për shumën prej 585,133 lekë.
2.Për znj. **E.D.**, në pozicionin pune (detyrën) e Inspektorit në Sektorin e koordinimit me qeverisjen vendore, emëruar në këtë detyrë nga drejtorit i Përgjithshëm z. Bekim Murati, me urdhrin nr**. 97**, **datë 28.02.2018** për një periudhë 21 muaj me pagë mesatare mujore neto prej 60,962 lekë, duke u paguar nga data 01.03.2018 deri më datën 30.11.2019 për shumën prej 1,280,202 lekë.
3.Për znj**. I.R.**, në pozicionin pune (detyrën) e Inspektorit në Sektorin e koordinimit me qeverisjen vendore, emëruar në këtë detyrë nga drejtorit i Përgjithshëm z. Bekim Murati, me urdhrin **nr. 205, datë 26.03.2018** dhe 509/1, datë 11.09.2018, për një periudhë 29 muaj me pagë mesatare mujore neto prej 63,085 lekë, duke u paguar nga data 26.03.2018 deri më datën 30.11.2019 për shumën prej 1,848,390 lekë.
4.Për z. **N.N.**, në pozicionin pune (detyrën) e Specialistit në Sektorin e koordinimit me qeverisjen vendore, emëruar në këtë detyrë nga drejtorit i Përgjithshëm z. Bekim Murati, me urdhrin nr. **762, datë 23.11.2018**, për një periudhë 22 muaj dhe 10 ditë me pagë mesatare mujore neto prej 49,621 lekë, duke u paguar nga data 23.11.2018 deri më datën 30.11.2019 për shumën prej 600,414 lekë.
5.Për znj. **F.H.** në pozicionin pune (detyrën) e Specialistit në Sektorin e koordinimit me qeverisjen vendore, emëruar në këtë detyrë nga drejtorit i Përgjithshëm z. Bekim Murati, me

urdhrin **nr. 163/2, datë 26.03.2018** dhe 302 datë 07.05.2018 për një periudhë 11 muaj dhe 3 ditë me pagë mesatare mujore neto prej 50,459 lekë, duke u paguar nga data 26.03.2018 deri më datën 30.11.2019 për shumën prej 570,186 lekë, aktualisht është me raport bar lindje deri në fillim të muajit Janar 2020.
Sa sipër, emërimi në punë për 5 punonjësit është bërë më urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë, pa u marrë zyrtarisht (me shkrim) miratimi i ministrit për çështjet vendore, duke u paguar që nga periudha e emërimit deri më datën 30.11.2019, për shumën prej **4,819,325 lekë,** në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin dhe funksionimin e agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore*" botuar në Fletoren Zyrtare nr.14, 10 shkurt 2015, i ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.1.2018. botuar në Fletoren Zyrtare nr.03, 18 janar 2018, pika 8 ku përcaktohet se: 8. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Ata emërohen, lirohen ose shkarkohen nga drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore.

C2.2-**Mbi pagesat jashtë kohës normale të punës, argumentimi dhe dokumentimi i tyre**.
Nga të dhënat e paraqitura dhe verifikimi me të zgjedhur rezulton se Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, për periudhën objekt auditimi, respektivisht për vitet 2017, 2018 dhe ujorin 2019, nuk ka llogaritur apo kryer pagesa për kohën jashtë kohës normale të punës.
C2.3-Hapja dhe azhurnimi i regjistrit të punonjësve, pajisje e tyre me Libreza pune, evidentimi i vjetërsisë së përgjithshme në punë.
-Auditimi mbi organizimin e dosjes së regjistrit të personelit.
Nga të dhënat e paraqitura nga specialistja e ngarkuar më Personelin znj. Elisa Labi, rezulton se për 14 punonjësit u konstatua se janë hapur dosjet e personelit, përgjithësisht përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm, por nuk janë të sistemuara siç përcaktohet në kërkesat e VKM nr.117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes së personelit dhe Regjistrit Qendror të Personelit*" **dhe konkretisht**:
1)Dosjet e personelit janë të pajisura me fletë inventarin për çdo dosje, por nuk janë të nënshkruar nga punonjës dhe specialist i ngarkuar me administrimin e dosjes së personelit, në të cilin duhet te jetë pasqyruar i gjithë dokumentacioni që ndodhet në dosje dhe shtesat apo ndryshimet përkatëse, si vendosja e shkresave për marrjen e masave disiplinore, kualifikimet etj.
2)Mungon fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit me të mbi 21 të dhënat e saj
3)Mungon Certifikata e gjendjes familjare;
Vlen të theksohet se në zbatim të VKM nr.117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"* të dhënat e çdo punonjësi janë të hedhura në regjistrin qendror të personelit në formë elektronike, i cili përditësohet sa herë që struktura pëson ndryshime si emërime të reja në punë, lëvizje paralele apo ngritje në detyrë.
Disa fragmente të VKM nr.117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*"
Sipas kreut I- Dosja e personelit
1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuari në institucionin e tyre.
- Lidhja 1
Në dosjen teknike të nëpunësit duhet të përfshihen:
1. Fletë inventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje.
2. Fleta **prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit** (lidhja 2), formati i së cilës mund të jetë i ndryshueshëm.
3. Të dhënat që do të përmbajë dosja duhet të shoqërohen me dokumentin përkatës që vërteton pohimin e bërë:
a) **Certifikata e gjendjes familjare**;

4. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të **vërtetuara me noteri** dhe janë pjesë përbërëse e dosjes.
5. Të gjitha dokumentet në dosje shkruhen në inventarin e saj. Fletë inventari do të firmoset **nga nëpunësi dhe drejtori i personelit.**

Lidhja 2

TË DHËNAT QË DUHET TË PËRMBAJË FLETA PREZANTUESE E DOSJES TEKNIKE TË NËPUNËSIT

1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil;
2. Emri, atësia, mbiemri;
3. Numri kombëtar i identifikimit;
4. Shtetësia;
5. Gjinia;
6. Datëlindja;
7. Gjendja civile;
8. Përbërja familjare;
9. Adresa e vendbanimit të përhershëm;
10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm;
11. Arsimimi;
12. Diploma;
13. Kualifikimi (llojet);
14. Gradë shkencore (titulli);
15. Njohuri gjuhe të huaj;
16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;
17. Përshkrimi i karrierës;
18. Dënimet (masa disiplinore, gjyqësore);
19. Njësia e punës;
20. Pozicioni;
21. Paga bazë;
22. Shtesat mbi pagë;
23. Shpërblimi nga pjesëmarrja në borde drejtuese.

FLETË INVENTARI I DOSJES SË NËPUNËSIT

Nr. Përshkrimi i materialeve:
1.
2.

Nëpunësi Drejtori i Personelit
Z/Znj._____ Z/Znj._____

C3.4-Auditim mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimin nga puna, efektet financiare dhe nxjerrja e përgjegjësisë .

Nga të dhënat e paraqitura dhe verifikimi me të zgjedhur rezulton se Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për vitet 2017, 2018 dhe 2019, nuk ka vendime gjyqësore në proces apo të formës prerë në lidhje me largimet e padrejta nga puna.

Të dhëna për strukturën, shkolla/arsimi bazë që ka kryer, datat e emërimit etj, për 14 punonjësit e Agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore. (Shtojca nr. 1)

Titulli i Gjetjes:	*Në 1 rast nuk është ruajtur struktura e parashikuar në urdhrin e kryeministrit, pasi specialisti i Financës është zëvendësuar me një specialist tjetër jo të profilit Financë.*
Situata 1:	Nga auditimi i strukturës dhe organikës së AMVV–së e cila përcaktohet me Urdhër të Kryeministrit (përkatësisht nr. 68, datë 05.05.2015, "*Për miratimin e strukturës së Agjencisë së zbatimit të Reformës Territoriale*", ka qenë me 12 punonjës dhe nr. 82, datë 12.05.2016, janë shtuar edhe 2

	punonjës,) nga muaji Maj 2016 e në vazhdim për vitet 217, 2018 dhe 2019, Struktura dhe organika e AMVV-së, aktualisht përbëhet mesatarisht në vit nga 14 punonjës dhe 3 punonjës me kontratë provizore të inkuadruar në 2 sektorë. Nga verifikimi i listë pagesave më datën 31.12.2017 datën 31.12.2108 dhe datën 30.09.2019 rezulton se në total organika është zbatuar, por konstatohet se në Sektorin e Analizës & Mbështetjes Institucionale nga 4 punonjës të parashikuar, në fakt në total janë 4 punonjës, por në 1 rast nuk është ruajtur struktura e parashikuar në urdhrin e kryeministrit, pasi specialisti i Financës është zëvendësuar me një specialist tjetër jo të profilit Financë, në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 82, datë 12.05.2016.
Kriteri:	Urdhër të Kryeministrit nr. 68, datë 05.05.2015, "*Për miratimin e strukturës së Agjencisë së zbatimit të Reformës Territoriale*" dhe nr. 82, datë 12.05.2016 "*Për miratimin e strukturës së Agjencisë të mbështetjes të Vetëqeverisjes vendore*".
Ndikimi/Efekti	Në sektorin e financës janë emëruar punonjës jashtë profilit dhe për pasojë sektori i financës është me 1 punonjës duke mos përballuar volumin e punës në mbajtjen e kontabilitit dhe kryerjen e veprimeve të tjera financiare.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të merren masa që Sektori i Analizës & Mbështetjes Institucionale, (ku bën pjesë edhe zyra e financës), të plotësohet me 1 (një) punonjës specialist finance, kjo brenda numrit total të punonjësve të miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 82, datë 12.05.2016 "*Për miratimin e strukturës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore".*
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Brenda datës 30.06.2020*

Titulli i Gjetjes:	*Janë emëruar në punë 5 punonjës (pa përcaktuar asnjë kriter apo kërkesë, si konkurrim, shpallje të vendeve vakant etj) dhe pa u marrë zyrtarisht (me shkrim) miratimin e Ministrit për Çështjet Vendore.*
Situata 1:	Nga auditimi i strukturës dhe organikës së AMVV–së e cila përcaktohet me Urdhër të Kryeministrit rezulton se më urdhër të drejtorit të përgjithshëm, z. B.M. janë emëruar në punë 5 punonjës (*pa përcaktuar asnjë kriter apo kërkesë, si konkurrim, shpallje të vendeve vakant et*j) dhe pa u marrë zyrtarisht (*me shkrim*) miratimin e Ministrit për Çështjet Vendore, duke përfituar pagën nga periudha e emërimit deri më datën 30.11.2019, në shumën prej 4,819,325 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.01.2018, pika 8 ku përcaktohet se: *"Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Ata emërohen, lirohen ose shkarkohen nga drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore".*

Kriteri:	VKM nr. 83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin dhe funksionimin e agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.1.2018, **pika 8:** "*marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Ata emërohen, lirohen ose shkarkohen nga drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore".*
Ndikimi/Efekti	Emërimi në punë i punonjësve jo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të merren masat që për 5 punonjësit në Sektorin e Koordinimit me Qeverisjen Vendore, të cilët nuk janë miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet vendore, të merret miratimi zyrtar (me shkrim) nga Ministri i Brendshëm, siç përcaktohet në VKM nr. 83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore"* i ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.01.2018, pika 8, në të kundërtën të pezullohen pagesat deri në marrjen e miratimit.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Brenda datës 30.06.2020*

Titulli i Gjetjes:	*Dosjet e personelit për 14 punonjësit, nuk janë të sistemuara si përcaktohet në kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes së personelit dhe Regjistrit Qendror të Personelit".*
Situata 1:	Nga auditimi rezultoi se nga specialisti i ngarkuar më personelin, janë hapur dosjet e personelit për 14 punonjësit, të cilat përgjithësisht përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm, por nuk janë të sistemuara si përcaktohet në kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes së personelit dhe Regjistrit Qendror të Personelit"* konkretisht: *1) Dosjet e personelit janë të pajisura me fletë inventarin për çdo dosje, por nuk janë të nënshkruar nga punonjës dhe specialist i ngarkuar me administrimin e dosjes së personelit, në të cilin duhet të jetë pasqyruar i gjithë dokumentacioni që ndodhet në dosje dhe shtesat apo ndryshimet përkatëse, si vendosja e shkresave për marrjen e masave disiplinore, kualifikimet etj.* *2) Mungon fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit me mbi 21 kërkesat e tyre.* *3) Mungon Certifikata e gjendjes familjare.*
Kriteri:	VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes së personelit dhe Regjistrit Qendror të Personelit".*
Ndikimi/Efekti	Mos plotësimi i dosjeve të personelit me dokumentacionin e nevojshëm, sjell anomali dhe pasaktësi në prezantimin e të dhënave të punonjësve.
Rëndësia	I mesëm

Rekomandimi	Nga specialisti i ngarkuar me personelin të merren masat për plotësimin e 14 dosjeve të punonjësve me inventarët përkatës të nënshkruar nga secili duke u plotësuar me 21 kërkesat dhe dokumentacionin e përcaktuar në VKM nr.117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes së personelit dhe Regjistrit Qendror të Personelit*".
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Brenda datës 30.06.2020*

Titulli i Gjetjes:	Në listë-pagesat te kolona Emërtesa sipas strukturës së miratuar vendosej vetëm shkurtimi i emrit Agjencisë (AMVV), dhe jo pozicionet zyrtare të secilit punonjës (detyra funksionale). Gjithashtu dhe listë pagesat nuk nënshkruhen edhe nga punonjësi i ngarkuar me menaxhimin e burimeve njerëzore,
Situata 1:	Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se te kolona Emërtesa sipas strukturës së miratuar vendosej vetëm shkurtimi i emrit Agjencisë (AMVV), dhe jo pozicionet zyrtare të secilit punonjës (detyra funksionale). Nga përgjegjësit e sektorëve çdo muaj, hartohen Listë prezencat e paraqitjes në punë të punonjësve për secilën datë, të cilat nënshkruhen nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues, ndërkohë që listë pagesat nuk nënshkruhen edhe nga punonjësi i ngarkuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"* i ndryshuar, pika 69, *"Listë pagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij".*
Kriteri:	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"* i ndryshuar, pika 69, "*Listë pagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij".*
Ndikimi/Efekti	*Nuk administrohen dosjet e personeli sipas dispozitave ligjore/nënligjore në fuqi.*
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	-Nga AMVV, Sektorët përkatës dhe punonjësi i ngarkuar me menaxhimin e burimeve njerëzore të marrin masat për respektimin e kritereve ligjore në hartimin e Listë prezencave të paraqitjes në punë të punonjësve, listë pagesave me emërtesat sipas strukturës së miratuar, dhe pozicionet zyrtare të çdo punonjësi.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Në vijimësi*

Trajtuar me Aktin e Konstatimit nr. 2, dt. 26.12.2019 "Për auditimin e pagave".

Komente dhe shpjegime:
Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:
Nga ana e AMVV është marrë në konsideratë , rekomandimi i audituesve të KLSH dhe është shpallur vendi për financiar në sektorin e analizës dhe mbështetjes institucionale, por për efekt të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore është akoma në proces.
Për 5 punonjësit që janë marrë në punë me miratim verbal dhe jo me shkrim të ministrit do merret miratimi me shkrim nga ministri përgjegjës për çështjet vendore.
Dosjet e personelit janë plotësuar me inventarët përkatës të firmosur nga secili dhe duke plotësuar 21 kërkesat dhe dokumentacionin e përcaktuar në VKM nr. 117 , datë 05.03.2014.
Listë pagesat sipas rekomandimeve të audituesve të KLSH firmosen dhe nga specialistja e burimeve njerëzore dhe emërtesa është bërë sipas pozicionit dhe jo AMVV.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:
Të ndiqen dhe zbatohen rekomandimet në vijimësi deri në zbatimin e plotë të tyre.

4. Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2016 "*Për prokurimin publik*", me ndryshimet dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për periudhën 2015–2019.

Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017"; Blerjet në vlera të vogla, në bazë të Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 "*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël"*, Urdhri i Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013, i ndryshuar me urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014 "*Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*";
Për periudhën e audituar 01.06.2015 deri 31.12.2019, përmbledhësja e procedurave të prokurimeve paraqitet në pasqyrën më poshtë:

Nr	Periudha	Nr.	Vlera në Lekë				Të dhëna për numrin e pjesëmarrësve		Ecuria e Auditimit /lekë	
			Fondi limit pa tvsh	Fituesit pa tvsh	%	Diferenca nga fondi limit pa tvsh	Nr. pjesëmarrësve	Të s'kualifikuar	Audituar	Pa audituar
a	b	1	2	3		4	5	6	7	8
1	01.06.2015-31.12.2015	20	8,350,742	6,329,834	76	2,020,908				
2	01.01.2016-31.12.2016	17	152,710,702							
3	01.01.2017-31.12.2017	16	5,230,000	4,372.997	84	857,003	172	35	15	1
4	01.01.2018-31.12.2018	17	6,205,000	3,129,012	51	3,075,988	140	40	6	9
5	01.01.2019-31.12.2019	18	4,653,000	3,290,860	71	1,362,140	170	42	12	-
	Gjithsej	88	177,149,444							

Burim i të dhënave: Regjistrat e realizimit të paraqitura nga AMVV.

Auditimi prokurimeve publike për vitin 2015, 2016.
Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale (AZRT) sot Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), **për vitin 2015** me shkresën nr.45 prot, datë 19.01.2016 ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) regjistrin e realizimeve. Sipas regjistrit rezulton të jenë realizuar 20 procedura prokurimi "*blerje me vlerë të vogël*" me vlerë kontrate 7,595,801 lekë me TVSH dhe fond limit 8,350,852 lekë pa TVSH. Gjithashtu në vitin 2015 është akorduar fondi për zhvillimin e procedurës së prokurimit "*tenderi i hapur*" për "*Blerje pajisje Hardware, Software, instalim, mirëmbajtje, trajnim të përdoruesve për 1 vit*", me fond

limit 150,300,000 lekë pa TVSH i cili ka përfunduar në vitin 2016 dhe është raportuar në regjistrin e realizimit të prokurimit publik për vitin 2016.
Për **vitin 2016**, me shkresën nr.68 prot, datë 24.01.2017 dërguar në APP regjistri i realizimeve sipas të cilit rezulton të jenë kryer 16 procedura prokurimi "*blerje me vlerë të vogël*" dhe një procedurë "*Tender i hapur*" gjithsej me vlerë kontrate 183,074,043 lekë me TVSH dhe fond limit 152,710,702 lekë pa TVSH.

a. Nisur nga vlera e fondit limit (150,300,000 lekë) e cila është vlerë e konsiderueshme për risk u krye auditimi i kësaj procedure si më poshtë:
Me Vendimin të Këshillit të Ministrave nr.40, datë 16.10.2015 "*Për shpërndarjen e fondit për programin "Shqipëria Dixhitale" pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve*" për projektin "*Sistemi i menaxhimit të arkivës dhe protokollit në njësinë e qeverisjes vendore dhe infrastruktura për digjitalizimin e dokumenteve të këtyre njësive*" është bërë shpërndarja e fondit sipas tabelës 1 bashkëlidhur vendimit për programin e sipërm me autoritet kontraktues AZRT sot AMVV, si dhe është vendosur kryerja e procedurës së prokurimit nga ky autoritet kontraktues.
Me shkresën nr. 14881/3, datë 01.12.2015 të Ministrisë së Financave i është akorduar AZRT/AMVV, fondi prej 180,360,000 lekë (vlera e plotë e projektit) e ndarë kjo në vlerën 90,180,000 lekë për vitin 2015 dhe 90,180,000 lekë për vitin 2016 nga fondi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas VKM nr.40, datë 16.10.2015.
Me hyrjen në fuqi të VKM nr.40, datë 16.10.2015 AZRT/AMVV është ndodhur në kushtet e një "*organi qendror blerës (OQB*)" ku prokurohet për një kontratë komplekse (*blerje pajisje elektronike dhe shërbim mirëmbajtje, trajnim përdorimi dhe instalim aplikacioni*) në emër (për llogari) të 323 njësive administrative dhe 61 bashkive të cilat kanë nevojë të prokurojnë të njëjtin mall, punë apo shërbim.

Për të qartësuar pozicionin e saj si "*organi qendror blerës*" AZRT/AMVV i është drejtuar me shkresë:
I-Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) si "Organ Qendror Blerës(OQB)" ngarkuar prej legjislacionit të prokurimit publik (*shkresa nr.443, datë 11.11.2015 ku kërkon interpretimin… për zhvillimin e prokurimit të përqendruar pasi bazuar në pikën 3 të VKM nr.40* datë 16.10.2015, i është kërkuar AZRT/AMVV të kryej procedurën e prokurimit dhe lidhjen e kontratës…)
II-Agjencisë së Prokurimit Publik (*shkresën nr.445, datë 12.11.2015 ku kërkon mendim… nëse objekti i prokurimit mund të realizohet nga vetë autoriteti juaj kontraktor në kushtet kur Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e OQB nuk e ka marrë përsipër të zhvillojë këtë procedurë prokurimi).*
Në përgjigje:
I- MPB me shkresën nr.1409/1, datë 11.11.2015 sqaron se "*projekti duhet të prokurohet nga kjo Agjenci si Autoritet Kontraktor, pasi objekti i prokurimit nuk përfshihet në procedurat e prokurimit përcaktuar në pikën 1, germa g, të VKM nr.28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë për disa mallra e shërbime" që zhvillohen nga OQB*".

II- APP me shkresën nr.12264/1, datë 13.11.2015 sqaron se *"në kushtet kur OQB nuk ka pranuar ta zhvillojë procedurën e prokurimit për projektin e sipërpërmendur, mbetet përgjegjësi e AK si autoriteti përgjegjës së cilit i janë vënë në dispozicion këto fonde, të marrë masat për zhvillimin e procedurës së prokurimit"*. (neni 12, pika 1, ligji nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime ku citohet se "*Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij*").

Në vijim, ish titullari i AZRT/AMVV z. A.S. ka nxjerrë Urdhër Prokurimin nr. 530/1, datë 28.12.2015 për zhvillimin e procedurës së prokurimit "*Blerje pajisje Hardware, Software, instalim, mirëmbajtje, trajnim të përdoruesve për 1 vit*", me fond limit 150,300,000 lekë pa TVSH me procedurë prokurimi "*Tender i Hapur*" me të dhënat në tabelën më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blr. paisje Hardware, Software, zhvillim, instalim, testim, trajnim të përdoruesve dhe mirëmbajtje aplikacioni për 1 vit".		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 530/1, Datë 28.12.2015 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit T.Hapur**",	**3.Njësia e Prokurimit** S. P. - jurist M.B. –IT V.T.- ekonomiste	**4.Komisioni VO** F.M. -ekonomist G.Ç.- jurist M.U. -IT
5.Fondi Limit (pa tvsh) 150,300,000 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** BOE(B... &S..." 149,595,125 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 704,875 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 10.02.2016	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10.Operatore Ekonomike 6:**
11.Ankimime **AK**-ka;**KPP**-ka Infosoft shkresa nr.10, dt 12.01.2016 për DT dhe nr.49, dt 04.3.2016 për Skualifikimin BNT Electronics nr.216, datë 15.3.2016 dhe nr.264, dt 4.4.2016	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr.39 dt 14.01.2016 Shkresa nr.530/30 dt 18.3.2016	**13.Përgjigje** KPP Vendimi nr.298. datë 05.05.2016
b. Kontrata		
14.Lidhja e kontratës Nr.530/36, Datë 01.06.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 179,514,150 lekë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Përshkrim i shkurtër i procedurës bazuar në procesverbalin nr.523 prot, datë 25.02.2016 të mbajtur KVO.
Rezulton se kanë marrë pjesë në konkurrim 6 OE nga të cilët operatorët:
- "C...",
- "I....",
- "T...",

janë skualifikuar për mos përmbushje të asnjë kriteri të DT, pasi në SPE nuk kanë dhënë ofertë ekonomike si dhe dokumentacioni i ngarkuar për kriteret e përgjithshme dhe ato teknike mungon.

Për 2 operatorët e tjerë BOE "**B.... &S....**" (*pasi OE B... konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit se është bashkuar duke krijuar BOE me operatorin S...*) me ofertë 149,595,125 lekë pa TVSH dhe "**I...** me vlerë oferte 136,842,475 lekë pa TVSH, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, KVO ka njoftuar OE në rrugë elektronike në SPE mbi skualifikimin e tyre për mos plotësim të specifikimeve teknike kërkuar në shtojcën 10 të DT.

Nga auditimi i ushtruar nga audituesit e KLSH për këtë procedure prokurimi në SPE dhe dosjen fizike, konstatohet:
<u>Në faqen elektronike shfaqen në sistem 6 OE:</u>
1. I...;
2. B...;
3. I...;
4. T...;

5. C...;
6. S...;

Operatorët:
"I...",
"C..."
"T...",
nuk kanë dhënë ofertë ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor-teknik të kërkuar dhe për rrjedhojë skualifikohen automatikisht sikurse ka vepruar dhe KVO.
Pas këtij kualifikimi të gjeneruar nga SPE kanë mbetur për shqyrtim dhe vlerësim ofertat e operatorëve:
"I..."
"B..."
"S..."

Nga verifikimi i dokumentacionit të Operatorit "**S..."** ngarkuar në SPE, konstatohet se oferta e paraqitur përbëhet nga dokumentacioni si më poshtë:
- *bilanci 2012,*
- *vërtetim ekstrakti historik të regjistrit dhe ekstrakt regjistri tregtar,*
- *vërtetim nga OSHEE mbi detyrimet e energjisë nr.258, datë 13.01.2016*
- *katalog për pajisje "Dell 22 Monitor E 2216H"*
- *katalog për "Dell OptiPlex 3020",*
- *certifikatë regjistrimi në organin tatimor dhe licensë për ushtrim aktiviteti*
- *formular oferte (shtojca 1) i cili është plotësuar vetëm në rubrikën "përshkrimi i mallrave" dhe rubrikat e tjera janë bosh dhe për rrjedhojë oferta është pa vlerë ose vlerë 0.*

Nisur nga mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e kërkuar për tender, *ky operator duhej të ishte skualifikuar si operator që garon me një ofertë dhe jo me dy oferta ku bashkohet me ofertën e operatorit B... (shqyrtuar më poshtë) si një bashkim i përkohshëm operatorësh ekonomikë,* pasi bazuar në nenin 63, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", citohet "*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative*", pavarësisht faktit që në fund të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave si pjesëmarrës në BOE, KVO-ja ka vendosur skualifikimin e saj.
Po ky operator ka ngarkuar në sistem dokumentacion në cilësinë e një bashkimi të përkohshëm operatorësh me Operatorin "**B...**".

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e ngarkuar në SPE dhe dorëzuar pranë AK nga BOE "B... &S..." me vlerë oferte ekonomike **149,595,125** lekë pa TVSH (dokumentacioni për Operatorin **"B..."**):
-Në lidhje me Kriteret e përgjithshme (*kriteri 2/a mbi plotësimin e detyrimeve fiskale*) është paraqitur Vërtetimi nr.21632, datë 24.12.2015 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Vërtetimi është lëshuar si **dokument për tu paraqitur në Bankë** dhe nuk cilësohet për tender dhe as **nuk vendoset objekti** i tenderit.
- Shtojca 10 (Specifikimet teknike) për kriterin "*Kompjuter Desktop për protokollin dhe Arkivin*" është kërkuar si karakteristikë (specifikim) "Display Port" (1) VGA, (1) DVI, operatori ka ofertuar për (1) VGA, (1) DisplayPort dhe **jo për (1) DVI**.

- Shtojca 10, për pajisjen UPS 600 VA, operatori ka paraqitur modelin SPS PLI650I në ofertën teknike të paraqitur prej tij me logo të vetë operatorit nga ana e majtë dhe logo të prodhuesit nga ana e djathtë (Toshiba Fujitsu) ***pa e shoqëruar me katalogun*** përkatës të produktit sipas Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7 ku citohet se: "*operatori duhet të paraqesë katalogët me të dhënat teknike për artikujt e kuotuar…..Katalogu të përmbajë karakteristikat*

teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST …".

- Shtojca 10, për pajisjen "Switch plus Kabllo" është kërkuar si specifikë "*kabëll FTPcat.5, 5 metra për njësi,… etj*", operatori ka paraqitur modelin Netgear Prosafe FS 205-100PES për pajisjen por ***nuk ka shoqëruar me katalog*** ku të cilësohen specifikimet e kërkuara nga AK, sipas Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.

Meqenëse shqyrtimi i ofertës bëhet në tërësi si BOE ku secili operator në bazë të përqindjes në furnizim/shërbim, përmbush kriteret duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DT, referuar kontratës së bashkëpunimit nr.352 Rep. dhe nr.2771 Kol. datë 09.02.2016 konstatohet se:

-operatori "**B....**" merr përsipër të ofrojë "*furnizimin, mirëmbajtjen dhe çdo shërbim tjetër në lidhje me artikujt pajisje fotokopjimi si dhe implementimin e aplikacionit për sistemin e menaxhimit të protokollit dhe arkivit…..*"

-operatori "**S...**" merr përsipër "*furnizimin, mirëmbajtjen dhe çdo shërbim tjetër në lidhje me artikujt si Kompjuter, Switch, UPS si dhe aksesor ndihmës për lidhjen e pajisjeve….*".

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e BOE e ngarkuar në SPE dhe dorëzuar pranë AK nga BOE "B.... &S..." (dokumentacioni për Operatorin **S...**):

- Në kriteret e veçanta, pika 2.3.4 të DT është kërkuar "*certifikatë ISO 9001-2008, për sigurinë e informacionit ISO 27001-2013, për mbrojtjen e ambientit ISO 14001-2004, për sigurinë në punë BS OHSAS 1800*" për këtë operatori ka paraqitur certifikatë ISO 9001-2008, ISO 14001-2004, ***nuk ka paraqitur*** BS OHSAS 1800, pasi referuar kontratës së bashkëpunimit nr.352 Rep. dhe nr.2771 Kol. datë 09.02.2016 konstatohet se, operatori S... në bashkëpunim me operatorin "BNT Electronics" do të kryejë shërbimin e mirëmbajtës së aplikacionit për 1 vit.
- Shtojca 10 (Specifikimet teknike) për kriterin për pajisjen "*Switch plus Kabllo*" është kërkuar si specifikim "*kabëll FTPcat.5, 5 metra për njësi,… etj*", operatori ka paraqitur për këtë pajisje modelin Netgear Prosafe FS 205-100PES por ***nuk ka shoqëruar me katalog*** ku të cilësohen specifikimet e kërkuara nga AK, sipas Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7. (argumentimi si më sipër).
- Shtojca 10, për pajisjen UPS 600 VA, operatori ka paraqitur modelin SPS PLI650I në ofertën teknike të paraqitur nga "B..." me logo të tij nga ana e majtë dhe logo të prodhuesit nga ana e djathtë (Toshiba Fujitsu) ***pa e shoqëruar me katalogun*** përkatës të produktit ku të cilësohen specifikimet e kërkuara nga AK, sipas Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7. ndërkohë që referuar kontratës së bashkëpunimit nr.352 Rep. dhe nr.2771 Kol. datë 09.02.2016 operatori S... merr përsipër "*furnizimin, mirëmbajtjen dhe çdo shërbim tjetër në lidhje me artikujt si Kompjuter, Switch, UPS…".*

Për sa sipër, mos përmbushja e specifikimeve teknike (shtojca 10) nga BOE në tërësi dhe si operatorë në veçanti, në funksion të përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunim përbën kusht skualifikues për këtë bashkim operatorësh, i cili është skualifikuar dhe nga KVO.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e ngarkuar në SPE dhe dorëzuar pranë AK nga operatori **Infosoft** me vlerë oferte ekonomike **136,842,475** lekë pa TVSH:

Në "Shtojca 10" (specifikimet teknike) për pajisjen **UPS 600 VA** konstatohet se:

- ka paraqitur të dhëna për modelin Power Tree S650E. Për specifikimin "*rregullim automatik i tensionit AVR-Po*", operatori ***nuk ka këtë specifikim*** duke mos iu përgjigjur Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.
- për specifikimin "*prizë për komunikimin e të dhënave DATA*" është kërkuar *(1) DB9 Serial ose USB*) operatori **nuk ka dhënë specifikim** sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.

- për specifikimin "*Mbrojtja "Protection*" është kërkuar "*Overload, Discharge and Overcharge Protection*" operatori **nuk ka dhënë specifikim** sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.
- për specifikimin "Programi i fikjes/shutdoun Software-po" operatori **nuk ka dhënë specifikim** sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.
- për specifikimin "*tipi I baterive/Baterry Type"* është kërkuar "*12 DC 7Ah Lead-acid*" operatori **nuk ka dhënë specifikim** për 12 V 7Ah sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.
- për specifikimin "*kabëll për linjën kryesore/power cord*" është kërkuar *"(1)Europiean IEC-C13*" operatori **nuk ka dhënë specifikim** sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.
- për specifikimin *"kabëll për lidhjen e PC/PC power cord"* është kërkuar *"(2)IEC 320 C13-IEC 320 C14"* operatori **nuk ka dhënë specifikim** sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.
-për specifikimin "*periudha e mbulimit të garancisë/Warranty*" është kërkuar *"(2 vjet)* operatori **nuk ka dhënë specifikim** sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.
Në "Shtojca 10" (specifikimet teknike) për pajisjen **Fotokopje Multifunction B&W Copy Machine A3**" konstatohet se:
-ka paraqitur të dhëna për modelin Xerox WorkCentre 5022. Për specifikimin "*Kapaciteti në dalje/output capacity min standard*" është kërkuar "*250 fletë*", operatori **nuk ka dhënë specifikim** sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.
-për specifikimin "*SW i skanimit-po*" operatori **nuk ka dhënë specifikim** sipas kërkesave të Kritereve të veçanta të Kualifikimit pika 2.3.7.

Nisur nga mangësitë e mësipërme, mos përmbushja e kritereve të vendosura në shtojcën 10 "*Specifikimet teknike*" përbën kusht skualifikues për operatorin Infosoft i cili është skualifikuar dhe nga KVO.
Në lidhje me Vendimin e KVO, BOE "B... & S..." dhe "I..." kanë bërë ankim pranë Autoritetit Kontraktor i cili nuk ka marrë parasysh ankesat e tyre e ndodhur në këto kushte ato i janë drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).
KPP me vendimin nr.298/2016 datë 05.05.2016 ka vendosur:

- të mos pranojë ankesën e OE "I..."
-të pranojë ankesën e BOE "B... & S..."
-të anulojë vendimin e KVO mbi skualifikimin e BOE dhe të korrigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator ekonomik me vlerë ofertë 149,595,125 lekë pa TVSH.

Pas ekzekutimit të vendimit të KPP nr.298/2016 datë 05.05.2016, KVO ka kualifikuar BOE "**B... &S...**" me vlerë ofertë 149,595,125 lekë pa TVSH duke e njoftuar në SPE sipas formularit të njoftimit të fituesit nr. 530/34, datë 10.05.2016.

Lidhja dhe Zbatimi i kontratës.
Me fituesin është lidhur kontrata nr.530/36, datë 01.06.2016 në vlerën 179,514,150 lekë me TVSH me afat 6 muaj nga nënshkrimi i kontratës, si dhe është vendosur sigurim kontrate në kompaninë e sigurimit "E..." datë 26.5.2016 në vlerën 17,951,415 lekë deri në ekzekutimin përfundimtar të kontratës.
Me Urdhrin e titullarit të AK nr.530/39, datë 01.06.2016 është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të pajisjeve elektronike (*kompiutera, printera, switch, kabllo dhe UPS*) i përbërë nga 7 anëtarë të cilët ishin dhe personat e autorizuar për ndjekjen e kontratës sipas nenit 26, Kontrata nr.530/36, datë 01.06.2016. Gjithashtu është ngritur dhe Komisioni për marrjen në dorëzim të Sofware pajisje nr.530/41, datë 05.09.2016.

Me qëllim që furnizimi me pajisje elektronike për 61 Bashki të jetë sa më eficent dhe në funksion të objektit të kontratës nr.530/36, datë 01.06.2016/objekt tenderimi, janë lidhur me këto organe (61 bashki) Kontrata Përdorimi për pajisjet elektronike me të dhëna si në:

Tabela 1:

Kontratë Përdorimi

Nr.	Bashkia (Njësitë Administrative 327)	Nr.Prot Datë	31	Kukës (14)	Nr.685, Dt 05.10.2016
1	Fushë Arrëz (4)	Nr.712, Dt 17.10.2016	32	Tropojë (7)	Nr.687, Dt 05.10.2016
2	Kolonjë (8)	Nr.715, Dt 17.10.2016	33	Devoll (4)	Nr.713, Dt 17.10.2016
3	Elbasan (12)	Nr.508, Dt 29.6.2016	34	Maliq (6)	Nr.717, Dt 17.10.2016
4	Librazhd (6)	Nr.697, Dt 10.10.2016	35	Korçë (7)	Nr.5421,Dt 13.10.2016
5	Lezhë (9)	Nr.726, Dt 21.10.2016	36	Pogradec (7)	Nr.718, Dt 17.10.2016
6	Klos (3)	Nr.722 Dt 20.10.2016	37	Divjakë (4)	Nr.779, Dt 01.11.2016
7	Malësi e Madhe (5)	Nr.720, Dt 18.10.2016	38	Lushnje (10)	Nr.774, Dt 21.10.2016
8	Pukë (4)	Nr.711, Dt 17.10.2016	39	Fier (9)	Nr.775, Dt 31.10.2016
9	Shkodër (10)	Nr.719, Dt 18.10.2016	40	Patos (2)	Nr.776, Dt 31.10.2016
10	Vau-Dejës (5)	Nr.710, Dt 17.10.2016	41	Roskovec (3)	Nr.778, Dt 31.10.2016
11	Mirditë (6)	Nr.727, Dt 21.10.2016	42	Mallakastër (8)	Nr.777, Dt 31.10.2016
12	Kurbin (3)	Nr.729, Dt 21.10.2016	43	Gramsh (9)	Nr.714, Dt 17.10.2016
13	Durrës (5)	Nr.673, Dt 03.10.2016	44	Peqin (5)	Nr.688, Dt 07.10.2016
14	Shijak (3)	Nr.663, Dt 29.09.2016	45	Prrenjas (3)	Nr.696, Dt 10.10.2016
15	Krujë (5)	Nr.662, Dt 29.09.2016	46	Belsh (4)	Nr.687, Dt 07.10.2016
16	Pustec (0)	Nr.716, Dt 17.10.2016	47	Cërrik (4)	Nr.683, Dt 06.10.2016
17	Bulqizë (7)	Nr.723, Dt 20.10.2016	48	Rrogozhinë (4)	Nr.665, Dt 29.09.2016
18	Has (4)	Nr.686, Dt 05.10.2016	49	Vorë (2)	Nr.660, Dt 27.09.2016
19	Gjirokastër (6)	Nr.753 Dt 27.10.2016	50	Kuçovë (3)	Nr.791, Dt 02.11.2016
20	Libohovë (2)	Nr.757 Dt 27.10.2016	51	Ura Vajgurore (3)	Nr.794 Dt 02.11.2016
21	Dropull (3)	Nr.754 Dt 27.10.2016	52	Kavajë (4)	Nr.664 Dt 29.09.2016
22	Selenicë (5)	Nr.744 Dt 25.10.2016	53	Tiranë (24)	Nr.529 Dt 14.07.2016
23	Vlorë (4)	Nr.745 Dt 25.10.2016	54	Poliçan (2)	Nr.792 Dt 02.11.2016
24	Himarë (2)	Nr.246 Dt 25.10.2016	55	Memaliaj (5)	Nr.755 Dt 27.10.2016
25	Sarandë (1)	Nr.747 Dt 25.10.2016	56	Tepelenë (3)	Nr.752 Dt 27.10.2016
26	Konispol (2)	Nr.749 Dt 25.10.2016	57	Përmet (4)	Nr.758 Dt 27.10.2016
27	Finiq (4)	Nr.748 Dt 25.10.2016	58	Këlcyrë (3)	Nr.756 Dt 27.10.2016
28	Kamëz (1)	Nr.659 Dt 27.09.2016	59	Delvinë (1)	Nr.750 Dt 25.10.2016
29	Skrapar (8)	Nr.793 Dt 02.11.2016	60	Dibër (14)	Nr.724 Dt 20.10.2016
30	Berat (4)	Nr.790 Dt 02.11.2016	61	Mat (8)	Nr.721 Dt 20.10.2016

Kontrata e Përdorimit ka afat 18 muaj nga dita e dorëzimit të mallit/pajisjes nga AZRT/AMVV dhe në momentin e dorëzimit të mallit, bëhet nënshkrimi i kontratës nga Kryetari i Bashkisë nënshkrimi cili vlen njëkohësisht dhe si tregues për përmbushjen e detyrimit kontraktor nga "*shitësi*"/"*B... &S...*" brenda afatit 6 mujor nga nënshkrimi i kontratës nr.530/36, datë 01.06.2016.

Nga të dhënat e tabelës 1, konstatohet se shitësi/ "*B... &S...*" ka përmbushur brenda afatit ligjor detyrimet kontraktore për furnizimin e mallrave/pajisjeve elektronike (afati 01.06.2016-31.12.2016).

Pas përfundimit të afatit dhe respektimit rigoroz të përdorimit të pajisjeve në përputhje me qëllimin dhe funksionin e tyre, AZRT/AMVV në cilësinë e "*pronarit*" ka bërë kalimin e pronësisë së pajisjeve në favor të Bashkive në cilësinë e "*përdoruesit"* sipas detyrimeve kontraktore. Kontratës i bashkëlidhet fletëdalja për çdo pajisje të dhënë në përdorim.

Bashkitë dhe njësitë bashkiake pas marrjes së mallit në dorëzim sipas kritereve të përcaktuara në Kontratën e Përdorimit kanë bërë hyrje/dalje malli në magazinë bazuar në Urdhrin e Përbashkët "*Për kalim kapital*" mes AMVV dhe 61 Bashkive, si dhe detyrimeve kontratore të përcaktuar në Kontratën e Përdorimit duke shoqëruar me dokumentacionin përkatës, sipas të dhënave në tabelën 2:

Tabela 2

Nr.	Bashkia	Urdhri i Përbashkët AMVV/ Bashki Po/jo	Fletëdalje AMVV Po/jo	Fletëhyrje Bashkia Po/jo	Konfirmim nga Bashkia për marrje në dorëzim Po/jo
1	Libohovë	po	po	po	po
2	Lezhë	po	po	po	po

3	Klos	po	po	po	po
4	Mirditë	po	po	po	po
5	Roskovec	po	po	po	jo
6	Tropojë	po	po	po	jo
7	Gjirokastër	po	po	jo	jo
8	Divjakë	po	po	jo	jo
9	M.Madhe	po	po	jo	jo
10	F.Arrëz	po	po	jo	jo
11	Patos	po	po	jo	jo
12	Skrapar	po	po	jo	jo
13	Lushnje	po	po	po	jo
14	U.Vajgurore	po	po	jo	jo
15	Polican	po	po	jo	jo
16	Shijak	po	po	jo	jo
17	Durrës	po	po	jo	jo
18	Korçë	po	po	jo	jo
19	Pogradec	po	po	jo	jo
20	Maliq	po	po	po	po
21	Devoll	po	po	jo	jo
22	Pustec	po	po	jo	jo
23	Kolonjë	po	po	jo	jo
24	Gramsh	po	po	jo	jo
25	Prrenjas	po	po	jo	jo
26	Kamëz	po	po	jo	jo
27	Vorë	po	po	jo	jo
28	Krujë	po	po	jo	jo
29	Mat	po	po	po	jo
30	Kuçovë	po	po	jo	jo
31	Berat	po	po	jo	jo
32	Kurbin	po	po	po	jo
33	Fier	po	po	jo	jo
34	Mallakastër	po	po	jo	jo
35	Tiranë	po	po	po	jo
36	Librazhd	po	po	jo	jo
37	Cërrik	po	po	jo	jo
38	Peqin	po	po	po	jo
39	Belsh	po	po	jo	jo
40	Shkodër	po	po	jo	jo
41	Vau-Dejës	po	po	po	jo
42	Pukë	po	po	jo	jo
43	Finiq	po	po	po	jo
44	Konispol	po	po	jo	jo
45	Himarë	po	po	jo	jo
46	Delvinë	po	po	po	jo
47	Selenicë	po	po	jo	jo
48	Rrogozhinë	po	po	jo	jo
49	Sarandë	po	po	jo	jo
50	Tepelenë	po	po	jo	jo
51	Dibër	po	po	jo	jo
52	Bulqizë	po	po	jo	jo
53	Kukës	po	po	jo	jo
54	Has	po	po	jo	jo
55	Vlorë	po	po	po	jo
56	Përmet	po	po	po	po
57	Këlcyrë	po	po	jo	jo
58	Dropull	po	po	po	jo
59	Memaliaj	po	po	po	jo
60	Elbasan	po	po	po	jo
61	Kavajë	po	po	jo	jo

Në lidhje me marrjen në dorëzim të mallit nga grupi i auditimit u krye verifikimi fizik në Bashkinë Kurbin dhe Skrapar, rezultatet e të cilat janë trajtuar në auditimin e pasqyrave financiare, pika 2 "*Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit*" të Programit të riauditimit nr.924/5, datë 24.01.2020.

AMVV bazuar në respektimin e afatit për lëvrimin e mallit/pajisjeve dhe kohës në përdorim të pajisjeve, ka kryer likuidimin e faturave përkatëse si më poshtë:

-Me Urdhër Shpenzimin nr.68, datë 08.07.2016 është likuiduar përfituesi/ BOE "*B... &S....*" në vlerën 90,180,000 lekë për blerje pajisje elektronike sipas faturës tatimore të shitësit nr.558, datë 06.07.2016 si dhe bazuar në procesverbalin e Komisionit të marrjes në dorëzim nr.530/40, datë 06.07.2016 i cili konfirmon se "*Komisioni pasi bëri verifikimet e duhura në sasi dhe cilësi për pajisjet sipas tabelës.... vlerësohen se ato janë në përputhje me kontratën ..... dhe mund të bëhen hyrje në magazinë*".

-Me Urdhër Shpenzimin nr.85, datë 08.08.2016 është likuiduar përfituesi/ BOE "*B... &S...*" në vlerën 14,563,905 lekë si diferencë e USH nr. 68, datë 08.07.2016.
-Me Urdhër Shpenzimin nr.106, datë 25.10.2016 është likuiduar përfituesi/ BOE "*B... &S...*" në vlerën 15,120,000 lekë për Sotfware sipas faturës tatimore të shitësit nr.796, datë 11.10.2016 si dhe bazuar në procesverbalin e Komisionit të marrjes në dorëzim nr.530/43, datë 24.10.2016 i cili konfirmon se "*Komisioni pasi bëri verifikimet e duhura për software-in e arkivave, shprehet parimisht dakord që të merret në dorëzim..*".
- Urdhër Shpenzimin nr.119, datë 23.11.2016 është likuiduar përfituesi/BOE "*B... &S...*" në vlerën 2,400,000 lekë për trajnim të përdoruesve sipas faturës tatimore të shitësi nr.870, datë 09.11.2016 si dhe bazuar në procesverbalin e mbajtur nga specialist IT nr.530/46, datë 03.11.2016 caktuar me Urdhrin nr.530/45, datë 25.10.2016, i cili konfirmon se "*trajnimet u kryen Brenda një periudhe 5 ditore në datat 26,27,28 tetor dhe 1 dhe 2 Nëntor … .Në datën 2 Nëntor u realizua trajnimi për specialistët e IT të Njësive Administrative dhe Bashkive.. në fund të çdo seance pjesëmarrësve iu dha një certifikatë trajnimi*".
-Me Urdhër Shpenzimin nr.121, datë 24.11.2016 është likuiduar përfituesi/BOE "*B... &S...*" në vlerën 3,000,000 lekë për instalim dhe testim aplikacioni sipas faturës tatimore të shitësi nr.834, datë 25.10.2016 si dhe bazuar në procesverbalin e Komisionit të marrjes në dorëzim nr.530/44, datë 24.10.2016 i cili konfirmon se "*software është testuar nga operatori B... nga ana funksionale në prani të komisionit të marrjes në dorëzim, ..gjithashtu software është instaluar në njërin nga 2 kompjuterët e shpërndarë në çdo njësi.... sipas projektit dhe konform kërkesave…*".
-Urdhër Shpenzimin nr.136, datë 19.12.2016 është likuiduar përfituesi/BOE "*B... &S...*" në vlerën 51,370,245 lekë (30% për software dhe 30% shpenzim për blerje pajisje elektronike) sipas faturës tatimore të shitësi nr.558, datë 06.07.2016 dhe nr.796, datë 11.10.2016 dhe bazuar në procesverbalin e Komisionit të marrjes në dorëzim nr.530/48, datë 15.12.2016 i cili konfirmon se "*sistemimi i plotë i dixhitalizimit të arkivave.. i përbërë nga kompiutera, …. është përfunduar nga operatori…sipas kërkesave dhe specifikimeve të parashtruara në dokumentacionin e tenderit..*".
-Me Urdhër Shpenzimin nr.155, datë 03.12.2018 është likuiduar përfituesi/BOE "*B... &S...*" në vlerën 1,000,000 lekë për mirëmbajtje aplikacioni për 31 bashki.
-Me Urdhër Shpenzimin nr.100, datë 10.08.2018 është likuiduar përfituesi/BOE "*B... &S...*" në vlerën 500,000 lekë për mirëmbajtje aplikacioni.
-Me Urdhër Shpenzimin nr.126, datë 09.10.2018 është likuiduar përfituesi/BOE "*B... &S...*" në vlerën 500,000 lekë për mirëmbajtje aplikacioni.
-Me Urdhër Shpenzimin nr.162, datë 19.12.2018 është likuiduar përfituesi/BOE "*B... &S...*" në vlerën 879,800 lekë për mirëmbajtje aplikacioni.
Në total BOE "*B... &S...*" është likuiduar në vlerën 176,634,150 lekë me TVSH.

Titulli i Gjetjes:	Praktika për marrjen në dorëzim të mallit/paisjeve elektronike (*kompiutera, printera, switch, kabllo dhe UPS*) sipas Kontratës së Përdorimit.
Situata 1:	Nga të dhënat e dokumentacionit të transferimit pa pagesë të aktiveve të AMVV-së pranë 61 Njësive Vendore të cilat janë pajisje kompjuterike rezulton se për 41 bashki, praktika për marrjen në dorëzim të mallit/paisjeve elektronike (*kompiutera, printera, switch, kabllo dhe UPS*) *nuk kishte të bashkangjitur fletëhyrjen e bërë nga bashkitë* pavarësisht se, marrja në dorëzim e tyre është konfirmuar në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Përdorimit nga Kryetari i Bashkisë si dhe konfirmimin për marrjen në dorëzim të mallit pa pagesë, kjo sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik*" Kap III, pika 56 ku citohet "*Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si:*

	fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe Nëpunësi Autorizues". Procesi i transferimit të këtyre aktiveve është i shoqëruar me urdhrat e përbashkët ndërmjet Institucionit të AMVV-së dhe Kryetarëve të Bashkive, me kontratat e përdorimit si dhe janë dokumentuar me fletë daljet përkatëse për çdo njësi vendore dhe hyrjet përkatëse të firmosur nga të dy palët.
Situata 2:	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të transferimit referuar një procedure (Bashkia Mat) u evidentua se kjo procedurë shoqërohet: 1.Me kontratën e përdorimit nr.721, datë 20.10.2016 të lidhur ndërmjet Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (AZRT) përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.S.dhe Bashkisë Mat përfaqësuar nga Kryetari z. N.R., në prani edhe të përfaqësuesit të kompanisë "B....", ku qëllimi i kontratës së lidhur ndërmjet palëve të sipër përmendura është dhënia në përdorim të Bashkisë Mat të pajisjeve kompjuterike me qëllim dixhitalizimin e arkivave të Bashkisë dhe Njësive Administrative në përbërje të saj, në kuadër të zbatimit të projektit "Shqipëria Dixhitale", financuar nga FZHR, më kohëzgjatje të kontratës 18 muaj nga dita e dorëzimit. Kontrata është e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm të AZRT z. A.S. dhe Kryetarit të Bashkisë Mat z. N.R. 2.Nëpërmjet Urdhrit të Përbashkët me nr. prot.692, datë 09.11.2018 të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe me nr.prot.2873 datë 12.11.2018 të Bashkisë Mat, në zbatim të kontratës nr.721 është vendosur për kalim kapitali pa pagesë të pajisjeve kompjuterike (përkatësisht 16 kompjutera Dell Optilex 3020 MT, 10 fotokopje Kyocera Fs-6525 MFP, 6 fotokopje Kyocera TASK alfa 2200, 16 pajisje UPS SPS PLI650I, 8 copë switch dhe 24 copë kabëll FTP CAT5). 3.Nga ana e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është bërë dalje me fletë daljen nr.159 datë 12.11.2018 me vlerën 3,030,720 lekë të firmosur nga personi përgjegjës për magazinën zj. O.R. 4.Nga ana e Bashkisë Mat është bërë hyrje me fletë hyrjen nr.42 datë 12.11.2018 të pajisjeve kompjuterike firmosur nga personi përgjegjës i magazinës për Bashkinë Mat.
Situata 3:	Nga verifikimi në disa Bashki rezultoi se: **a.** Bashkia Kurbin me Fletë hyrjen nr. 70, dt. 06.12.2018 ka bërë hyrje pajisjet elektronike sipas Fletë Daljes së AMVV nr. 187, dt. 6.12.2018. Gjithashtu rezultoi se materialet e mësipërme janë bërë hyrje nga Bashkinë Kurbin me FH nr. 89, dt. 31.12.2016 dhe nr. 90, dt. 31.12.2016 të cilat edhe janë kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2016. Por vlerat e tyre nuk përputhen me vlerat e FH nr. 70, dt. 06.12.2018. **b.** Bashkia Skrapar me Fletë hyrjen nr. 42, dt. 12.11.2018 ka bërë hyrje pajisjet elektronike sipas Fletë Daljes së AMVV nr. 217, dt. 19.12.2018. Gjithashtu rezultoi se materialet e mësipërme janë bërë hyrje nga Bashkinë Kurbin me FH nr. 54, dt. 02.11.2016 dhe nr. 53, dt. 02.11.2016. Gjithashtu nga Bashkia Skrapar është mbajtur procesverbali i datës 19.12.2018 ku saktësohet se çmimet do të jenë sipas faturave të vitit 2018 pasi çmimet nuk përputhen.

Kriteri:	*Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm" neni 12, pika 3, germa dh, ë, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" Kap III, pika 52-60.*
Ndikimi/Efekti	Mos plotësimi me dokumentacion të praktikës së marrjes në dorëzim e aktiveve të furnizuara.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	-Nga AMVV, Sektori i Financës të merren masat për plotësimin e procedurës së kalimit të pajisje kompjuterike me dokumentacionin përkatës te fletëhyrjeve nga njësitë vendore sipas fletë daljeve të AMVV. Me plotësimin e praktikave dokumentare në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" dokumentacioni i plotë konfirmuar kjo nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues i Njësisë ti vihet në dispozicion Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	Në vijimësi

Komente dhe shpjegime:
Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:
Nga ana e AMVV menjëherë pas rekomandimeve të audituesve të KLSH, u morën masat për plotësimin e procedurës të kalimit me dokumentacion përkatës të fletë hyrjeve nga 41 Njësitë Vendore, filluam me qarkun i Korçës të cilët na vunë në dispozicion një kopje të fletë hyrjes të cilën e kishte prerë sipas fletëdaljes së AMVV(bashkëlidhur fletë hyrjet e disa njësive vendore të cilat mungonin në praktikat e AMVV, një pjesë e njësive vendore e ka bërë hyrje ne vitin 2016 , kur pajisjet elektronike ishin në përdorim të tyre më çmimin pa tvsh dhe një pjesë e na i kanë dërguar dhe nuk kanë mbërritur ne AMVV. Me të mbaruar gjendja e fatkeqësisë natyrore do ju vejmë në dispozicion të gjitha fletë hyrjes e munguar .(bashkëlidhur fletë hyrjet nga njësitë vendore Korçë, Kolonjë, Devoll, Pustec, Përrenjas, Durrës).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:
Nga AMVV, Sektori i Financës të merren masat për plotësimin me dokumentacion për mallrat që hyjnë pa pagesë dhe transferimin e tyre në 61 bashki për vitin 2018, konfirmuar kjo nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues i Njësisë Pritëse në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik".

b. Procedura e prokurimit "***Rikonstruksion godine***", me fond limit 796,750 lekë pa TVSH me procedurë prokurimi "*blerje me vlerë të vogël*" zhvilluar viti 2015 konstatohet se:
Me VKM nr.276, datë 01.04.2015 "*Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes ….Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT*)" të ndryshuar i është dhënë në përdorim holl në katin e shtatë të ish Shtëpisë së Ushtarakëve.
Me Urdhër Prokurimin nr.8, datë 22.05.2015 është vendosur kryerja e procedurë së prokurimit bazuar në projektin e hartuar nga operatori Elka fitues i tenderit me objekt "*Rikonstruksionin e zyrave*" me fond limit 796,750 lekë pa TVSH.
Bazuar në ligjin nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", neni 39, pika 1 citohet se "***Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo*** *ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji"* dhe nenit 41, pika 1 dhe 2 citohet se "*Rregullorja e zhvillimit përcakton listën e ndërtimeve, instalimeve dhe punimeve që, për shkak të ndërhyrjeve jothelbësore në objekt, natyrës së përkohshme së instalimeve ose rregullimit të*

kontrollit të zhvillimit nga një leje apo autorizim tjetër apo nga legjislacion i posaçëm sektorial, ***nuk kërkojnë pajisjen me një leje ndërtimi dhe janë objekt i një deklarate paraprake për kryerje punimesh****. 2. Në rastet e përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij neni, deklarata me shkrim e depozituar pranë autoritetit përgjegjës të kontrollit të zhvillimit, bashkërisht me projektin e punimeve, të hartuar dhe nënshkruar nën përgjegjësinë e profesionistëve të licencuar, është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për fillimin e punimeve të ndërtimit*".

Referuar detyrimeve të mësipërme ligjore, AZRT përfaqësuar nga ish titullari i AZRT z. A. S. për fillimin e punimeve të rikonstruksionit nuk ka marrë leje ndërtimi apo nuk ka depozituar deklaratë paraprake për kryerje punimesh në organin përkatës-bashki, në kundërshtim me nenin nenit 41, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Për llogaritjen e fondit limit Komisioni ka bërë testim tregu duke marrë oferta nga 3 operatorë ekonomikë dhe nxjerrë mesataren e tyre në vlerën 796,750 lekë pa TVSH.
Nga 28 Operatorët pjesëmarrës në tender, 4 prej tyre të kualifikuar në vend të parë deri në vend të katërt nga sistemi i APP, janë tërhequr konkretisht OE 2A... në vend të parë, tërhequr me kërkesë me shkrim, OE "A..." në vend të dytë, tërhequr me kërkesë në format elektronik (e-mail), OE "T..." në vend të tretë, nuk ka të dhënë në QKR, OE "U..." në vend të tretë, nuk ka të dhënë në QKR. OE "M.L." kualifikuar në vend të pestë është shpallur fitues me vlerën 589,000 lekë pa TVSH me të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr.78, datë 02.06.2015 në vlerën 706,800 lekë me TVSH.
Me Urdhër Shpenzimin nr.10, datë 16.07.2015 është likuiduar operatori në vlerën 706,800 lekë.

Mbajtur Akt – Konstatimi nr. 10, dt. 20.02.2020 "Auditimi i prokurimeve publike".

Për vitin 2017, institucioni i AZRT-së, fondet e akorduara në artikullin 602 "*Shpenzime operative*" i ka parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimit me procedurë "*Blerje me vlera të vogla*". Regjistri i parashikimit të prokurimeve dhe regjistrat e realizimeve janë hartuar në zbatim të kreut "T" Neni 4, të VKM nr.914, datë 29.12.2004 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*', i ndryshuar, sipas formatit "Tip" bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 "*Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik*" dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 "*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurës të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik*" Kreu U, pika3.

Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, me shkresën nr.68, datë 24.01.2017, për vitin 2017 janë zhvilluar 16 procedura prokurimi "*blerje me vlera të vogla*" me fond limit pa tvsh për vlerën prej 5,230,000 lekë, dhe vlerën e kontratës prej 4,372,997 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 857,003 lekë, sipas tabelës më poshtë:

Nr	Periudha	Nr.	Vlera në Lekë			Të dhëna për numrin e pjesëmarrësve		Ecuria e Auditimit /lekë	
			Fondi limit pa tvsh	Fituesit pa tvsh	Diferenca nga fondi limit pa tvsh	Nr. pjesëmarrësve	Të s'kualifikuar	Auditu ar	Pa auditua r
1	01.01.2017-31.12.2017	16	5,230,000	4,372.997	857,003	172	35	15	1

Realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2017**. (Shtojca nr. 2)**

A. Për vitin 2017, janë audituar këto procedura:
1. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje Kancelari*" me fond limit 335,000 lekë.
Me shkresë nr.123/2 datë 11.07.2017 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 335,000 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në çmimin e fletë hyrjeve së fundit të magazinës dokumentuar me proces verbal nr.123/1, datë 10.07.2017.

Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.123/3, datë 11.07.2017. Me datën 13 korrik 2017, është hapur procedura e prokurimit, ku morën pjesë 13 OE, oferta ekonomike më e vogël është 187,000 lekë nga "OE I...".
Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të dytin D.L. me ofertë ekomomike 236,000 lekë me proces verbal shpallje fituesi 123/4, datë 14.07.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr.123/5, datë 14.07.2017, pasi OE i renditur i pari është tërhequr nga procedura e prokurimit me njoftimin në SME e dokumentuar në dosjen e prokurimeve.
2. Procedura e prokurimit për objektin "*Shërbim automjeti Toyota prius* " me fondin limit 30,000 lekë.
Me shkresë nr.155/2, datë 23.09.2017 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 30,000 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në mesataren e tre ofertave të tregut dokumentuar me proces verbal nr.155/1, datë 22.09.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.155/3, datë 23.09.2017.
Me datën 25 shtator 2017 është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 6 OE, oferta ekonomike më e vogël është 24,000 lekë nga OE D.R.. Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të dytin S.K. me ofertë ekomomike 26,900 lekë me proces verbal shpallje fituesi nr.155/4, datë 26.09.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr.155/5, datë 26.09.2017, pasi OE i renditur i pari është tërhequr nga procedura e prokurimit me njoftimin në SME e dokumentuar në dosjen e prokurimeve.
3. Procedura e prokurimit për objektin "*Shërbim automjeti Hundai Santa Fe*" me fond limit 115,000 lekë.
Me shkresë nr.121/2, datë 06.07.2017 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 115,000 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në mesataren e tre ofertave të tregut dokumentuar me proces verbal nr.121/1, datë 05.07.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.121/3, datë 06.07.2017. Me datën 10 korrik 2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 10 OE, oferta ekonomike më e vogël është 220,000 lekë nga OE "H...". Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të dytin Kombinat – Servis me ofertë ekonomike 223,400 lekë me proces verbal shpallje fituesi nr.121/4, datë 12.07.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr.121/5, datë 12.07.2017, pasi OE i renditur i pari nuk është paraqitur pranë AK edhe me njoftim në APP.
4. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje materiale pastrimi & dezinfektimi*" me fond limit 175,900 lekë.
Me shkresë nr.130/2, datë 19.07.2017 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 175,900 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në mesataren e tre ofertave të tregut me proces verbal nr.130/1, datë 19.07.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.130/3, datë 19.07.2017. Me datën 21 korrik 2017 është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 16 OE, oferta ekonomike më e vogël është 125,000 lekë nga OE A.H. Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të katërtin Katerina Kapxhiu me ofertë ekonomike 139,000 lekë me proces verbal shpallje fituesi nr.130/4, datë 24.07.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr. 130/5, datë 24.07.2017, pasi OE i renditur i pari nuk është paraqitur sipas njoftimit në ftesën për ofertë, OE i renditur i dyti B.R. është tërhequr nga procedura e prokurimit. OE i renditur i treti nuk është paraqitur pas njoftimit me anë SME, të dokumentuar në dosjen e prokurimeve.
5. Procedura e prokurimit për objektin "*Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore*" me fond limit 689,000 lekë.
Me shkresë nr.132/2, datë 24.07.2017 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 689,900 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në mesataren e tre ofertave të tregut me proces verbal nr.132/1, datë 24.07.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.132/3, datë 24.07.2017. Me datën 26 korrik 2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 13 OE, oferta ekonomike më e vogël është 435,000 lekë nga OE B.L., i cili është shpallur nga njësia e prokurimit fitues i kësaj

procedure me proces verbal fituesi nr.132/4, datë 27.07.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK nr.132/5, datë 27.07.2017.

6. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje pajisje elektronike*" me fond limit 650,000 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.210/3, datë 14.11.2017 është miratuar nga titullari i AK urdhri i prokurimit me fond limit me vlerë 650,000 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar nga komisioni i ngritur me nr.210/1, datë 13.11.2017, i cili është referuar çmimeve të AKSHIT për vitin 2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.210/4, datë 14.11.2017. Me datë 22.11.2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 5 OE dhe oferta ekonomike më e vogël është 500,000 lekë nga OE R.T. Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OE të renditur të pestin me ofertën ekonomike 599,999 lekë me proces verbal shpallje fituesi nr.210/5, datë 05.12.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr.210/6, datë 05.12.2017 pasi OE i renditur i pari nuk është paraqitur sipas njoftimit të ftesës për ofertë, OE i renditur i dyti, i tretë dhe i katërt u tërhoqën pas njoftimit të bërë nëpërmjet APP, nëpërmjet SPE.

7. Procedura e prokurimit për objektin "*Zëvendësimi i derës kryesore*" me fond limit 649,400 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.255/2 datë 19.12.2017 është miratuar nga titullari i AK urdhri i prokurimit me fond limit me vlerë 649,400 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në mesataren ekonomike të tregut të tre ofertave te mbajtur ne proces verbalin nr.255/1, datë 19.12.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.255/3, datë 19/12/2017. Me datë 21 Dhjetor 2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 5 OE dhe oferta ekonomike më e vogël është 500,000 lekë nga OE "E...". Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të 4 me ofertën ekonomike 638,500 lekë me proces verbal shpallje fituesi nr.255/4, datë 26.12.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr.255/5, datë 26.12.2017, pasi OE i renditur i pari, i dyti dhe i treti nuk u paraqitën pranë zyrave te AZRT brenda afatit ligjor pas njoftimit të ftesës për ofertë, nëpërmjet SPE.

8. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje materiale pastrimi & dezinfektimi*" me fond limit 90,694 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.209/2, datë 12.12.2017, është miratuar nga titullari i AK urdhri i prokurimit me fond limit 90,694 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në fletë hyrjen e fundit të magazinës dokumentuar me nr.209/1, datë 12.12.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr. 209/7, datë 21.12.2017. Me datë 23 Dhjetor 2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 11 OE dhe oferta ekonomike me e vogël është 55,000 lekë nga OE Avni Hysa. Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të dytin me ofertën ekonomike 68,000 lekë me proces verbal shpallje fituesi nr.209/1, datë 12.12.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr.209/9, datë 26.12.2017, pasi OE i renditur i pari nuk është paraqitur pranë zyrave të AZRT.

9. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje tonera*" me fond limit 117,800 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.75/2, datë 19.04.2017 është miratuar nga titullari i AK urdhri i prokurimit me fond limit 117,800 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në fletë hyrjen e fundit të magazinës dokumentuar me proces verbalin me nr.75/1, datë 19.04.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.75/3, datë 19.04.2017.

Me datë 21 prill 2017 është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë15 OE dhe oferta ekonomike më e vogël është 87,000 nga OE Bledar Rusmaili i cili është shpallur fitues i kësaj procedure prokurimi me njoftim fituesi nr.75/5, datë 24.04.2019.

10. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje tonera*" me fond limit 44,950 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.10/2, datë 17.01.2017, është miratuar nga titullari i AK urdhri i prokurimit me fond limit 44,950 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në fletë hyrjen e fundit të magazinës dhe procedurës së prokurimit të zhvilluar së fundi me nr.10/1, datë 17.01.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.10/3, datë 17.01.2017. Me datë 19 janar 2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 18 OE dhe oferta ekonomike

më e vogël është 36,822 lekë nga OE "BT SOLUTIONS" i cili është shpallur fitues i kësaj procedure prokurimi me njoftim fituesi nr.10/5, datë 20.01.2019.

11. Procedura e prokurimit për objektin "*Kancelari*" me fond limit 49,070 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.62/2, datë 29.03.2017, është miratuar nga titullari i AK urdhri i prokurimit me fond limit 49,070 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në fletë hyrjet e fundit të magazinës dokumentuar me proces verbalin me nr.62/1, datë 29.03.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.62/3, datë 29.03.2017.

Me datë 31 mars 2017 është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 7 OE dhe oferta ekonomike me e vogël është 38,200 lekë nga M.B. i cili nuk është paraqitur pranë AK sipas ftesës për ofertë dhe me proces verbalin nr.62/4, datë 04.04.2017 të komisionit të njësisë së prokurimit është shpallur fitues i kësaj procedure prokurimi OE i renditur i dyti me ofertë ekonomike 46,000 lekë me njoftim fituesi nr.62/5 datë 04.04.2017.

12. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje Karburant*" me fond limit 800,000 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.1/2, datë 09.01.2017, është miratuar nga titullari i AK urdhri i prokurimit me fond limit 800,000 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në ofertën më të ulët lekë/litër dhe është prokura me vlerën 800,000 lekë, ku cili operator ekonomik afron më shumë litra ai është fitues i kësaj procedure prokurimi. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.1/3, datë 09.01.2017. Me datë 10 janar 2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 6 OE dhe oferta ekonomike më e vogël është 128,33 lekë/litër nga "S..." e cila është dhe fituese e kësaj procedure prokurimi me njoftim fituesi nr.1/4, datë 12.01.2017.

13. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje e kompjuterëve dhe printerave*" me fond limit 168,400 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.83/2, datë 03.05.2017, është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 168,400 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në çmimet e vendosur nga AKSHI për vitin 2017 me proces verbalin nr.83/1, datë 03.05.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.83/3, datë 03.05.2017. Me datën 5 Maj 2017 është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 13 OE, oferta ekonomike më e vogël është 139,995 lekë nga OE "J...". Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të tretin Mirjan Nico me ofertë ekonomike 144,110 lekë me proces verbal shpallje fituesi nr.83/4, datë 16.05.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr. 83/5, datë 17.05.2017 pasi OE i renditur i pari dhe i dyti nuk u paraqitën pranë zyrave të AZRT brenda afatit ligjor pas njoftimit të bërë nga ana AK.

14. Procedura e prokurimit për objektin "*Shërbimi i pastrimit dhe mirëmbajtjes*" me fond limit 731,670 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.8/2, datë 16.01.2017 është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 731,670 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në pagën minimale në shkallë vendi sipas proces verbalit nr.8/1, datë 16.1.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.8/3, datë 16.1.2017. Me datën 17 Janar 2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 18 OE, oferta ekonomike më e vogël është 589.000 lekë nga OE "B.L.". Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të parin B.L. me ofertë ekomomike 589.000 lekë me njoftim fituesi nga titullari i AK me nr. 8/4, datë 18.01.2017 .

15. Procedura e prokurimit për objektin "*Shërbim automjeti*" me fond limit 51,000 lekë pa tvsh.

Me shkresë nr.17/2 datë 24.01.2017, është miratuar nga titullari i AK, urdhri i prokurimit me fondin limit me vlerën 51,000 leke pa tvsh. Përllogaritja e fondit limit është bazuar në 3 ofertat e tregut dokumentuar me proces verbalin me nr.17/1, datë 24.01.2017. Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë nr.17/3, datë 24.1.2017. Me datën 25 Janar 2017, është hapur procedura e prokurimit ku morën pjesë 11 OE, oferta ekonomike më e vogël është 39,000 lekë nga OE "P...". Njësia e prokurimit ka shpallur fitues OK të renditur të pestin "K..." me ofertë ekonomike 47,750 lekë me proces verbal shpallje fituesi nr.17/4, datë 02.02.2017 dhe njoftim fituesi nga titullari i AK me nr.17/5, datë 02.02.2017 pasi OE i renditur i pari nuk u paraqit pranë zyrave të AZRT, brenda afatit ligjor pas njoftimit të bërë nga ana KBV, OE i

renditur i dyti, i treti dhe i katërti përkatësisht "R...", B.M. dhe "S..." janë tërhequr në mënyrë vullnetare duke dërguar njoftime shkresore elektronike.

B. Për vitin 2018, institucioni i AMVV-së, fondet e akorduara në artikullin 602 "*Shpenzime operative*" i ka parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimit me procedure "*Blerje me vlera të vogla*". Regjistri i parashikimit të prokurimeve dhe regjistrat e realizimeve janë hartuar në zbatim të kreut "T" Neni 4, të VKM nr.914, datë 29.12.2004 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*', i ndryshuar, sipas formatit "Tip" bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 "*Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publi*k" dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 "*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik*" Kreu U, pika3.

Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2018 janë zhvilluar 17 procedura prokurimi "*blerje me vlera të vogla*" me fond limit pa tvsh për vlerën prej 6,205,000 lekë dhe vlerën e kontratës prej 3,129,012 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 3,075,988 lekë, për vitin 2019, janë zhvilluar 18 procedura prokurimi "*blerje me vlera të vogla*" me fond limit pa tvsh për vlerën prej 4,653,000 lekë, dhe vlerën e kontratës prej 3,290,860 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 1,362,140 lekë, sipas tabelës më poshtë:

Nr	Periudha	Nr.	Vlera në Lekë			Të dhëna për numrin e pjesëmarrësve		Ecuria e Auditimit /lekë	
			Fondi limit pa tvsh	Fituesit pa tvsh	Diferenca nga fondi limit pa tvsh	Nr. pjesëmarrës ve	Të s'kualifikuar	Auditu ar	Pa auditua r
1	01.01.2018-31.12.2018	17	6,205,000	3,129,012	3,075,988	140	40	6	9
2	01.01.2019-31.12.2019	18	4,653,000	3,290,860	1,362,140	170	42	12	-

Realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2018**. (Shtojca nr. 2)**
Në auditimin e regjistrit të parashikimit dhe të realizimit të fondeve rezultoi se, në fillim të vitit 2018, janë parashikuar në regjistrin e parashikimit të fondeve për prokurim me procedurë "*Blerje me vlera të vogla*" në sistemin elektronik të APP-së, 15 objekte prokurimi. Në fund të vitit 2018 është hartuar regjistri realizimit, i cili sa i përket objekteve të parashikuara në fillim të vitit ka ndryshime të objekteve të parashikuara për prokurim, kjo si rezultat i akordimit të fondeve shtesë gjatë vitit 2018. Veç objekteve të mësipërme janë prokuruar edhe 2 objekte të tjera për, "*Blerje shtypshkrime*" në vlerën 700,000 lekë pa tvsh dhe "*Mirëmbajtje zyrash*" për vlerën 600,000 lekë pa tvsh. Gjatë vitit 2018 institucioni ka kryer edhe 2 procedura blerjesh me fond deri në 100,000 lekë për "*Shërbim larje automjetesh*" në vlerën 97,000 lekë dhe "*Mirëmbajtje ashensori*" për 98,000 lekë.
-Për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla është vepruar në zbatim të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 "*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*" në sistemin elektronik i ndryshuar. Komisioni bazuar në kërkesën e sektorit për prokurimin e mallit apo shërbimit ka miratuar te titullari për të gjitha objektet për llogaritjen e fondit limit, të cilën e ka bazuar në përvojën e procedurave të realizuara në vitin 2017. Titullari në çdo rast ka miratuar urdhrin e prokurimit sipas objekteve të parashikuara dhe fondeve të akorduara ku është përcaktuar sasia dhe natyra e blerjes.

Për vitin 2018, janë audituar këto procedura:
1. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje pjesë këmbimi dhe shërbim automjetesh*".
Me shkresën nr.310/1, datë 23.05.2018, është miratuar nga Titullari AK, fondi limit me vlerën 301,517 lekë pa tvsh. Përllogaritja e fondit është bazuar në çmimin mesatar të tre ofertave të tregut. Është miratuar urdhër prokurimi nr.310/2, datë 24.05.2018 me fond limit 301,517 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë nr.310/3, datë 24.05.2018. Në këtë procedurë në

datën 28.05.2018, të hapjes së 29 ofertave në sistemin elektronik, janë paraqitur oferta ekonomike nga 17 OE.

Nga këto oferta, rezulton se oferta më e ulët me vlerën 228,000 lekë pa tvsh është paraqitur nga OE "K...", të cilin komisioni i prokurimit e ka s'kualifikuar me argumentin se, "*Oferta është anomalish e ulët*" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE "B.M." me ofertën 258,900 lekë pa tvsh (*Diferenca midis ofertave është 258,900 – 228,000 =* ***30,900*** *lekë*). AK me OE "B.M." ka realizuar objektin e prokurimit "*Blerje pjesë këmbimi dhe shërbim automjetesh*", e dokumentuar kjo me procesverbalin nr.310/7, datë 01.06.2018.

Në këtë procedurë, komisioni i prokurimit të blerjes me vlera të vogla në proces verbalin nr.310/4, datë 28.05.2018 ka s'kualifikuar ofertën më të ulet të OE "K..." në shumën 228,000 lekë pa tvsh, me argumentin se, "Oferta është anomalisht e ulët" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE "B.M." të renditur në vend të dytë me vlerën 258,900 lekë pa tvsh. Për rrjedhojë nga krahasimi i ofertës së ulët të s'kualifikuar dhe ofertës së shpallur fituese e të likuiduar ka një diferencë në shumën ***30,900*** *lekë. Veprime në mospërputhje me nenin 40 pika 5 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP ", si dhe me piken 10 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 01.01.2018 "Për përdorimin e procedurës me vlerë të vogël".*

2. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje goma për 2 automjete*".

Komisioni në përllogaritjen e fondit limit ka vendosur çmimet e ofertave të tregut me përshkrimin (oferta 1,2,3), por nuk ka përcaktuar operatorët ekonomik të tregut në të cilët është marrë çmimi i artikullit "Goma". Pra nuk ka gjurmë të referencave të operatoreve të tregut. Është miratuar urdhri prokurimit nr.460/2, datë 14.08.2018 me fond limit 210,000 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë nr.460/3, datë 14.08.2018. Në datën 20.08.2018, komisioni me proces verbalin e vlerësimit të OE pjesëmarrës nr.460/4, datë 20.08.2018 ka vlerësuar dhe shpallur fitues OE "B.M." me vlerën 179,900 lekë pa tvsh, me të cilin është bërë edhe blerja dhe shërbimi i vendosjes së gomave në të 2 automjetet e institucionit, e dokumentuar kjo me proces verbalin nr.460/7, datë 20.08.2018. Në vlerësimin e procedurës për këtë objekt të prokuruar janë paraqitur ofertat ekonomike nga 13 OE. Komisioni ka skualifikuar me të drejtë 6 OE pasi në objektin tregtar të tyre nuk kanë të përfshirë objektin e prokurimit.

Ndërsa 3 OE (A... me ofertë 69,200 lekg pa tvsh, Paera me ofertë 128,000 lekë pa tvsh dhe B.A. me ofertë 138,000 lekë pa tvsh) komisioni i ka s'kualifikuar me argumentin se ofertat e tyre janë anomalisht të ulëta, pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim. Pas këtij vlerësimi komisioni ka klasifikuar 4 OE të mbetur nga të cilët ka vlerësuar e shpallur fitues OE "B.M." me vlerën 179,900 lekë pa tvsh, me të cilin është bërë edhe blerja dhe shërbimi i vendosjes së gomave në të 2 automjetet e institucionit (*Diferenca midis ofertave është 179,900 – 69,200 =* ***110,700*** *lekë*).

Në këtë procedurë, komisioni i prokurimit të blerjes me vlera të vogla, në proces verbalin nr.460/4, datë 20.08.2012 ka s'kualifikuar 3 oferta ekonomike ("A..." me ofertë 69,200 lekë pa tvsh, "P..." me ofertë 128,000 lekë pa tvsh dhe "B.A." me ofertë 138,000 lekë pa tvsh) me argumentin se, "Oferta është anomalisht e ulët" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE "B.M." të radhitur në vend të katërt me vlerën 179,900 lekë pa tvsh. Për rrjedhojë nga krahasimi i ofertës se shpallur fituese e të likuiduar me ofertën më të ulet 69,200 lekë pa tvsh të s'kualifikuar të OE "A..." rezulton një diferencë në shumën ***110,700*** *lekë. Veprimi është në mospërputhje me piken 5 të nenit 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP" dhe me piken 10 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 01.01.2018 "Për përdorimin e procedurës me vlere të vogël".*

3. Procedura e prokurimit me objekt "*Blerje shtypshkrime*".

Për objektin e prokurimit "Blerje shtypshkrime" me fondin limit në shumën 420,000 lekë pa tvsh, titullari AK ka miratuar urdhrin e prokurimit nr.581/2, datë 08.10.2018 si dhe ftesën për ofertë nr.581/3, datë 08.10.2018. Komisioni i blerjeve të vogla i krijuar me urdhrin nr.288, datë

25.04.2018, në datën 16.10.2018 ka vlerësuar 11 ofertat ekonomike, me proces verbalin e vlerësimit nr.581/4, datë 16.10.2018. Komisioni në proces verbalin e vlerësimit të ofertave datë 16.10.2018, ka s'kualifikuar 2 oferta ekonomike ("E.D." me ofertë **179,000** lekë pa tvsh i renditur i pari dhe ofertën e paraqitur nga OF "O..." me ofertë 194,100 lekë pa tvsh i radhitur i dyti) me argumentin se, "*Oferta është anomalisht e ulët*", pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët" (*Diferenca midis ofertave është 380,000 – 179,000 = **201,000** lekë*).. Nga OE të vlerësuar komisioni ka kualifikuar ofertën e OE "E..." në shumën **380,000** lekë pa tvsh pas njoftimit dhe mos paraqitjes se dy OE të renditur në OE e kualifikuar në vend të parë dhe të dytë (F... për 324,000 lekë dhe P.... për 377,000 lekë pa tvsh). Komisioni i prokurimit sa i përket procesit të dokumentimit me proces verbal të OE të njoftuar sipas klasifikimit dhe që nuk janë paraqitur brenda afateve, nuk ka bërë dokumentimin me proces verbal hap pas hapi të procedurës sipas datave 10, 11 dhe 12/10/2018 pas njoftimit e mos paraqitjes se dy OE "F..." dhe "P...", por këtë procedurë e ka dokumentuar vetëm në një proces verbal të mbajtur në datën 16.10.2018, në mospërputhje me pikën 17 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla të zhvilluar me mjete elektronike*", i ndryshuar. Komisioni i blerjeve, sa i përket dokumentacionit të kualifikimit të OE "E..." të shpallur fitues, nuk ka administruar deklaratën e operatorit për 4 kriteret e kërkuara në ftesën për ofertë si dhe nuk ka administruar nga OE një vërtetim të lëshuar nga OSHE për shlyerjen e detyrimeve. Likuidimi i OE "E..." në shumën 456,000 lekë me tvsh është kryer bazuar në procesverbalin e datës 18.10.2018 të mbajtur nga komisioni pritjes se mallit i krijuar me urdhër nr.581/6, datë 18.10.2018.

*Në këtë procedurë, komisioni i prokurimit të blerjes me vlera të vogla, në datën 16.10.2018, ka s'kualifikuar 2 oferta ekonomike ("E.D." me ofertë 179,000 lekë pa tvsh i renditur i pari dhe OE "O..." me ofertë 194,100 lekë pa tvsh i radhitur i dyti) me argumentin se, "Oferta është anomalisht e ulët" dhe ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "E..." me ofertën 380,000 lekë pa tvsh, pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët". Për rrjedhojë midis ofertës fituese 380,000 lekë pa tvsh të OE "E..." dhe ofertës 179,000 lekë pa tvsh të OE E.D." s'kualifikuar, rezulton një diferencë në shumën **201,000** lekë. Veprime të cilat janë në mospërputhje me piken 5 të Nenit 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP ", si dhe me pikat 10,14 dhe 17 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlera të vogël të zhvilluar me mjetë elektronike" i ndryshuar.*

4. Procedura për objektin "*Shërbim mirëmbajtje kondicionerësh*".

Me urdhrin e prokurimit nr.362/2, datë 02.07.2018 është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt "*Shërbim dhe mirëmbajtje kondicioneri*" me fondin limit 121,167 lekë pa tvsh. Është publikuar ftesa për ofertë nr.362/3, datë 02.07.2018 me datë zhvillimi 05.07.2018. Në datën 06.07.2018 komisioni i prokurimit ka mbajtur procesverbalin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave ekonomike me nr.362/4, datë 06.07.2018. Në ketë proces verbal komisioni nuk ka përshkruar (dokumentuar) të plotë të gjithë procedurën e kryer dhe sidomos përcaktimit në procesverbal të OE pjesëmarrës në sistem, 32 OE të s'kualifikuar si dhe arsyet e s'kualifikimit të ofertave, por ka përshkruar vetëm procedurën e ndjekur me dy OE nga të cilët ka kualifikuar **e shpallur fitues OE "C..." me ofertën 79,000 lekë pa tvsh**. **Janë** 18 operator ekonomik që kanë ofruar oferta ekonomike. Nga këta OE komisioni ka s'kualifikuar 2 OE "S..." me ofertën **49,500** lekë dhe "D.X." me ofertën 69,000 lekë me argumentin se, ofertat janë oferta anomalisht të ulta, *pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët". (Diferenca midis ofertave është 79,000 – 49,500 = **29,500** lekë).*

Sa i përket OE të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë vlerësojmë se komisioni i ka s'kualifikuar me të drejtë pasi këta OE nuk kanë në aktivitetet e përcaktuara në ekstraktin e QKB-së objektin e prokurimit.

Në këtë procedurë, komisioni i prokurimit të blerjes me vlera të vogla, ka s'kualifikuar 2 OE "S..." me ofertën 49,500 lekë dhe "D.X." me ofertën 69,000 lekë me argumentin se, ofertat janë oferta anomalisht të ulta dhe ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "C..." me ofertën 79,000 lekë pa tvsh, pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët". Për rrjedhoje midis ofertës fituese 79,000 lekë pa tvsh të OE "C..."' dhe ofertës 49,500 lekë pa tvsh të OE "S..." të s'kualifikuar, rezulton një diferencë në shumën ***29,500*** *lekë. Veprime të cilat janë në mospërputhje me piken 5 të Nenit 40 të VAM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", si dhe me pikat 10, 14 dhe 17 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlere të vogel të zhvilluar me mjete elektronike " i ndryshuar.*

5. Procedura e prokurimit për objektin "*Blerje kancelari*".

Për blerjen e kancelarive, komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla, i krijuar me urdhër të titullarit nr.288, datë 25.04.2018, kanë përllogaritur fondin limit për prokurim në shumën 427,155 lekë pa tvsh. Për prokurimin e fondit është miratuar urdhri prokurimit nr.379/2, datë 29.06.2018 si dhe ftesa për ofertë e publikuar me nr.379/3, datë 29.06.2018 (formulari 3). Në ftesën për ofertë komisioni ka miratuar kritere kualifikimi për OE të cilat kanë të bëjnë me "*Paraqitjen nga OE i klasifikuar i pari, të mostrave të mallit të kërkuar nga AK të shoqëruar me certifikatën e cilësisë së produkteve".* Komisioni në proces verbalin e vlerësimit të OE pjesëmarrës me nr. 379/4, datë 05.07.2018 ka klasifikuar në vend të parë duke e shpallur fitues OE "E...", me ofertën 240,000 lekë me tvsh.

Kriteret e kërkuara në ftesën për ofertë "*Paraqitja nga OE i mostrave të mallit*" edhe pse nuk duhet të kërkohen në ketë procedurë sipas pikës 8 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 01.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës me vlere të vogël"* i ndryshuar, komisioni nuk ka dokumentuar në proces verbal paraqitjen nga OE i shpallur fitues të mostrave të mallit dhe njëkohësisht komisioni nuk ka kërkuar dhe administruar paraqitjen nga subjekti fitues të "*Vërtetimit nga OSHE për pagesën e detyrimeve*" si dhe "Kontratave të ngjashme të realizuara me parë nga subjekti".

6. Procedura për objektin "*Mirëmbajtje ambientesh të jashtme*".

Titullari i AK me urdhrin e prokurimit nr.818/2, datë 14.12.2018 dhe me ftesën për ofertë nr.818/3, datë 14.12.2018, ka shpallur procedurën me objekt "*Mirëmbajtje ambientesh të jashtme"* me fondin limit 620,000 lekë pa tvsh. Komisioni i prokurimit të blerjes me vlera të vogla i krijuar me urdhrin nr.288, datë 25.04.2018, ka përllogaritur fondin limit, sipas ofertave të çmimeve të tregut dhe në datën 21.12.2018 ka vlerësuar ofertat për 11 OE pjesëmarrës e dokumentuar kjo me proces verbalin nr.818/4, datë 21.12.2018. Komisioni ka vlerësuar të rregullt procedurën dhe ka shpallur fitues ofertën e OE "A..." me vlerën 220,000 lekë pa tvsh i radhitur i dyti pas OE "D.L." i cili nuk është paraqitur pas njoftimit të fituesit. Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr.818/5, datë 24.12.2018, është paraqitur nga sektori shërbimeve kërkesa për anulim procedure me arsyen se, "*Koha e realizimit të shërbimit nuk është e mjaftueshme*". Me ketë kërkesë titullari AK ka miratuar formularin e njoftimit të anulimit të procedurës nr.818/6, datë 24.12.2018 bazuar në kërkesën e sektorit të shërbimeve pa bërë argumentimin ligjor të anulimit të procedurës ndërkohë që po nga ky sektor është kërkuar me kërkesën nr.818, datë 14.12.2018 të miratuar nga titullari AK, prokurimi i fondit për nevojën e kryerjes së këtij shërbimi.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla dhe titullari AK kanë s'kualifikuar ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedurë me argumentin se, "Ofertat janë anomalisht të ulëta" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët" dhe kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE me oferta ekonomike më të larta se ato të s'kualifikuara.(Në 4 raste të zhvillimit të procedurave të prokurimit "Blerje me vlera të vogla", për rrjedhoje midis ofertave të shpallura fituese dhe ofertave të s'kualifikuara rezulton një diference në total ***për shumën 372,100 lekë pa tvsh)****, veprime në mospërputhje me Nenin 40 pika 5 e VKM në të APP nr.3,*

datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlera të vogla të zhvilluar me mjete elektronike " i ndryshuar, ku ngarkon me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlera të vogla dhe ***Titullarin e AK, B.M.***, në cilësinë e titullarit të AK, ***S.P.***, me detyrë juriste në cilësinë e kryetares të komisionit blerjeve në vlera të vogla (larguar me Urdhrin nr.180, Prot. Datë 25.02.2019), ***E.D.***, me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***S.P.***, me detyrë jurist inspektor në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.

Shtojca nr. 3

Shënim: Sipas shkresës nr. 137/7, datë 24.09.2019, të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, nënshkruar nga z. B.M., Drejtor i Përgjithshëm i AMVV, na informojnë se është marrë masë disiplinore "vërejtje" për z. S.P. dhe znj. E.D. (bashkëlidhur shkresa e Agjencisë MVV nr.137/7, datë 24.09.2019).

Titulli i Gjetjes:	*Komisioni i prokurimit me vlera të vogla dhe titullari AK kanë s'kualifikuar ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit me vlera të vogla me argumentin se, "Ofertat janë anomalisht të ulëta".*
Situata 1:	Në procedurën e prokurimit "*Blerje pjesë këmbimi dhe shërbim automjetesh*" komisioni ka skualifikuar ofertën më të ulët me vlerën 228,000 lekë pa tvsh është paraqitur nga OE "K...", të cilin komisioni i prokurimit e ka s'kualifikuar me argumentin se, "*Oferta është anomalish e ulët*" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE "B.M." me ofertën 258,900 lekë pa tvsh (*Diferenca midis ofertave është 258,900 – 228,000 =* ***30,900*** *lekë*).
Situata 2:	Në procedurën e prokurimit "*Blerje goma për 2 automjete*" komisioni ka skualifikuar 3 OE (A... me ofertë 69,200 lekg pa tvsh, Paera me ofertë 128,000 lekë pa tvsh dhe B.A. me ofertë 138,000 lekë pa tvsh) me argumentin se ofertat e tyre janë anomalisht të ulëta, pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim. Pas këtij vlerësimi komisioni ka klasifikuar 4 OE të mbetur nga të cilët ka vlerësuar e shpallur fitues OE "B.M." me vlerën 179,900 lekë pa tvsh, me të cilin është bërë edhe blerja dhe shërbimi i vendosjes së gomave në të 2 automjetet e institucionit (*Diferenca midis ofertave është 179,900 – 69,200 =* ***110,700*** *lekë*).
Situata 3:	Në procedurën e prokurimit "*Blerje shtypshkrime*", Komisioni me proces verbalin e vlerësimit të ofertave datë 16.10.2018, ka s'kualifikuar 2 oferta ekonomike ("*E.D." me ofertë 179,000 lekë pa tvsh i renditur i pari dhe ofertën e paraqitur nga OF "O..." me ofertë 194,100 lekë pa tvsh i radhitur i dyti*) me argumentin se, "*Oferta është anomalisht e ulët*". Nga OE të vlerësuar komisioni ka kualifikuar ofertën e OE "E.R." në shumën 380,000 lekë pa tvsh pas njoftimit dhe mos paraqitjes se dy OE të renditur në OE e kualifikuar në vend të parë dhe të dytë (*F... për 324,000 lekë dhe P... për 377,000 lekë pa tvsh)*. (Diferenca midis ofertave është 380,000 – 179,000 = **201,000** lekë).
Situata 4:	Në procedurën për "*Shërbim mirëmbajtje kondicionerësh*", komisioni ka përshkruar vetëm procedurën e ndjekur me dy OE nga të cilët ka kualifikuar e shpallur fitues OE "C..." me ofertën 79,000 lekë pa tvsh. Gjithashtu komisioni nga 18 operatorë ekonomikë pjesëmarrës ka s'kualifikuar 2 OE "S..." me ofertën **49,500** lekë dhe "D.X." me ofertën 69,000 lekë me argumentin se, "*ofertat janë oferta anomalisht*

	të ulta". (*Diferenca midis ofertave është 79,000 – 49,500 =* ***29,500*** *lekë*).
Situata 5:	Në procedurën e prokurimit për "*Blerje kancelari*", komisioni në ftesën për ofertë komisioni ka miratuar kritere kualifikimi për OE të cilat kanë të bëjnë me "*Paraqitjen nga OE i klasifikuar i pari, të mostrave të mallit të kërkuar nga AK të shoqëruar me certifikatën e cilësisë së produkteve*". Kriteret e kërkuara në ftesën për ofertë "*Paraqitja nga OE i mostrave të mallit*" edhe pse nuk duhet të kërkohen në ketë procedurë sipas pikës 8 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 01.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës me vlere të vogël"* i ndryshuar, komisioni nuk ka dokumentuar në proces verbal paraqitjen nga OE i shpallur fitues të mostrave të mallit dhe njëkohësisht komisioni nuk ka kërkuar dhe administruar paraqitjen nga subjekti fitues të "*Vërtetimit nga OSHE për pagesën e detyrimeve*" si dhe "*Kontratave të ngjashme të realizuara me parë nga subjekti".*
Situata 6:	Procedura për "*Mirëmbajtje ambientesh të jashtme*", pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr.818/5, datë 24.12.2018, është paraqitur nga sektori shërbimeve kërkesa për anulim procedure me arsyen se, "*Koha e realizimit të shërbimit nuk është e mjaftueshme*". Me ketë kërkesë titullari AK ka miratuar formularin e njoftimit të anulimit të procedurës nr.818/6, datë 24.12.2018 bazuar në kërkesën e sektorit të shërbimeve pa bërë argumentimin ligjor të anulimit të procedurës ndërkohë që po nga ky sektor është kërkuar me kërkesën nr.818, datë 14.12.2018 të miratuar nga titullari AK, prokurimi i fondit për nevojën e kryerjes së këtij shërbimi.
Kriteri:	*Veprime të cilat janë në mospërputhje me piken 5 të Nenit 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", neni 40 si dhe me pikat 10, 14 dhe 17 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluar me mjete elektronike" i ndryshuar.*
Ndikimi/Efekti	Janë skualifikuar padrejtësisht operatorë me oferta më të ulta duke sjellë një efekt ekonomik më vlerën ***372,100*** *lekë pa tvsh.*
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	- Nga AMVV, sektori i financës të merren masat të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 372,100 lekë nga K*omisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla* ***S.P.***, me detyrë juriste në cilësinë e kryetares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***E.D.***, me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***S.P.***, me detyrë jurist inspektor në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla, për skualifikimin e operatoreve ekonomikë me argumentin e paraqitjes së, "*Ofertave anomalisht të ulët*" në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr.3, datë 08.01.2018 *"Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluar me mjete elektronike*" i ndryshuar, pikat 10, 14 dhe 17. - Nga AMVV sipas shkresës nr.137/7, datë 24.09.2019, nënshkruar nga z. B.M., Drejtor i Përgjithshëm i AMVV, janë marrë masë disiplinore "*vërejtje"* për z. S.P. dhe znj. E.D.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	Menjëherë

Komente dhe shpjegime:
Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:
Observacionet janë pasqyruar dhe në shkresën dërguar APP dhe në shkresën dërguar Drejtorisë së Auditimit të Ministrisë së Brendshme , ku sipas rekomandimit të APP ju është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me shkrim".

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:
KVO i ka s'kualifikuar OE me argumentin se, është "oferta anomalisht të ulta", pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët". Këto veprime janë në mospërputhje me piken 5 të Nenit 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", neni 40 si dhe me pikat 10, 14 dhe 17 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluar me mjete elektronike" i ndryshuar.
Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, sektori i financës të merren masat të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës së dëmit ekonomik të shkaktuar nga anëtarët e Komisionit të Blerjeve në Vlera të Vogla.

C. Për vitin 2019, institucioni i AMVV-se, fondet e akorduara në artikullin 602 "*Shpenzime operative*" i ka parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimit me procedurë "*Blerje me vlera të vogla*". Drejtori i Përgjithshëm të AMVQ z. B.M. ka caktuar si anëtarë të komisionit të blerjeve në vlera të vogla (AKBVV), me urdhrin Nr.1, datë 07.01.2019 dhe me urdhrin Nr.7, datë 06.05.2019 të, personat si më poshtë:
1.z. N.N., me detyrë jurist në cilësinë e kryetarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.
2.znj. E.D., me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla.
3.z. S.L., me detyrë jurist inspektor në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.
4.znj.G.X., me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla (larguar me Urdhrin nr.12, Prot. Datë 04.09.2019).

Realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2019

Objekti i prokurimit	Fondi limit (Pa TVSH)	Vlera e Kontratës (Pa TVSH)	Procedura	Koha e zhvillimit të procedurës 2018
Blerje kancelari	**700,000**	125,000	Blerje e vogël	Dhjetor
		256,000	Blerje e vogël	Maj
Blerje karburant	**800,000**	800,000	Blerje e vogël	Janar
Blerje pajisje elektronike	**600,000**	85,000	Blerje e vogël	Dhjetor
		500,000	Blerje e vogël	Mars
Blerje pajisje zyre	**230,000**	50,000	Blerje e vogël	Dhjetor
		170,000	Blerje e vogël	Maj
Blerje shtypshkrime	**500,000**	48,900	Blerje e vogël	Tetor
		370,000	Blerje e vogël	Korrik
		80,000	Blerje e vogël	Mars
Karburant diezel	**125,000**	125,000	Blerje e vogël	Korrik
Materiale pastrimi dizifektimi	**300,000**	99,900	Blerje e vogël	Dhjetor
		77,500	Blerje e vogël	Maj
		33,560	Blerje e vogël	Janar
Seminare	**798,000**	190,000	Blerje e vogël	Maj
Shërbime për mjetet e transportit	**600,000**	130,000	Blerje e vogël	Tetor
		12,000	Blerje e vogël	Gusht
		138,000	Blerje e vogël	Korrik
TOTALI	**4,653,000**	**3,290,860**		

Për vitin 2019, janë audituar këto procedura:

1.Procedura për objektin "*Blerje detergjente*".

Në bazë të urdhrit nr.7 Prot, datë 06.05.2019 të titullarit kontraktor është ngritur komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga N.N., E.D., G.X. Komisioni për përllogaritjen e vlerës së fondit limit dhe kërkesës për nevojat e institucionit është bazuar në vlerat e ministrisë së brendshme si organ qendror blerës dhe çmimet e magazinës për vitin 2019. Me shkresën nr.339/1, datë 28.05.2019, është miratuar nga titullari kontraktor fondi limit prej 106,840 lekë pa tvsh. Në këtë procedurë me datë 31.05.2019 të hapjes së 27 ofertave është shpallur e vlefshme nga komisioni i vlerësimit të ofertave O/E "H..." shpk, i renditur i pari në klasifikimin elektronik dhe komisioni e ka shpallur ofertën e parë të renditur të vlefshme pa kaluar te operatoret e tjerë, me ofertën prej 77,500 lekë pa tvsh e dokumentuar me procesverbalin nr.339/4, datë 31.05.2019. AK me operatorin ekonomik H... ka realizuar objektin e prokurimit të shërbimit "*Blerje detergjente*", e dokumentuar me procesverbalin nr.339/6, datë 03.06.2019, të komisionit të pritjes së mallit i ngritur me urdhër nr.339/7, datë 03.06.2019.

2. Procedura për objektin "*Blerje benzinë pa plumb 10 ppm*".

Sipas nevojave të institucionit është miratuar fondi limit prej 800,000 lekë pa tvsh, me urdhër nr.8/1 Prot, datë 08.01.2019 i shoqëruar me ftesën për ofertë nr.8/2 Prot, datë 08.01.2019. Në këtë procedurë datë 09.01.2019 të hapjes së 3 ofertave, operatori i renditur i pari "O..." shpk në klasifikim u s'kualifikua nga komisioni i vlerësimit të ofertave për arsye të mospasjes në ekstraktin e tij objektin e prokurimit. I renditur i dyti në klasifikimin elektronik "G..." shpk u shpall fitues nga komisioni i vlerësimit të ofertave për ofertën më të vlefshme prej 5,600 litra në vlerën 800,000 lekë pa tvsh me marzh fitimi 14 lekë për litër e dokumentuar me procesverbalin nr. 8/3 prot, datë 10.01.2019. O/E ka realizuar objektin e prokurimit me kontratën nr.8/5 Prot, datë 11.01.2019.

3. Procedura për objektin "*Blerje karburant Diezel 10 ppm*".

Në bazë të kërkesës nr.379, datë 15.07.2019 nga specialistët e shërbimeve dhe me urdhër të brendshëm nr.379/1 Prot, datë 16.07.2019 është miratuar fondi limit prej 124,167 lekë pa tvsh e shoqëruar me ftesën për ofertë nr.379/2 Prot, datë 16.07.2019. Me ftesën nr.379/6 Prot, datë 31.07.2019, procedura është dokumentuar me procesverbalin nr.379/7, datë 31.07.2019 të hapjes së tre ofertave. Komisioni i vlerësimit të ofertave pasi verifikoi pjesëmarrësit vendosi të shpallë fitues ofertën më të vlefshme O/E "A..." sha, me çmim 139 lekë/litër pa tvsh i renditur i pari në klasifikimin elektronik për fondin limit prej 125,000 lekë pa tvsh në sasinë 922 litra me çmim 135 lekë për litër e dokumentuar me kontratën nr.379/9 Prot, datë 05.08.2019.

4. Procedura për objektin "*Blerje kancelari*".

Me shkresën nr.309/2 Prot, datë 07.05.2019, është miratuar fondi limit prej 305,391 lekë pa tvsh i shoqëruar me ftesën për ofertë nr.309/3 Prot, datë 07.05.2019. Në këtë procedurë të hapjes së ofertave morën pjesë 12 O/E ndër të cilët 3 O/E "O.D." i renditur i pari nuk u paraqit për arsye të angazhimit në një procedurë tjetër prokurimi. Po ashtu dhe i dyti "R.B." nuk u paraqit për arsye të angazhimit në një procedurë tjetër tenderimi. Po njësoj dhe për O/E "L..." shpk i cili nuk u paraqit për arsye të angazhimit në një procedurë tjetër prokurimi. Komisioni i vlerësimit vendosi të shpalli fitues "I..." shpk i renditur i katërti me ofertë më të vlefshme prej 305,390 lekë pa tvsh. O/E "I..." shpk, realizoi objektin e prokurimit e pasqyruar me procesverbalin nr. 309/7 Prot, datë 27.05.2019.

5. Procedura për objektin "*Blerje kompjutera*".

Komisioni ka përllogaritur fondin limit 561,314 leke pa tvsh me specifikime të marra nga "AKSHI" e dokumentuar me urdhër nr.233/1 Prot, datë 19.03.2019 dhe i shoqëruar me ftesën për ofertë me nr.233/2 Prot, 19.03.2019, ku morën pjesë 21 O/E, ndër të cilët 4 operatorë ekonomikë të renditur të parët në klasifikim: 1) "J..." shpk, me ofertën 350,000 lekë pa TVSH, 2) "D.B." me ofertën 299,000 lekë pa TVSH, 3) "F.L." me ofertën 368,200 lekë me TVSH, 4) "P..." shpk, me ofertën 392,500 lekë pa TVSH u s'kualifikuan për ofertë anomalish të ulët ekonomike, *pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe*

njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët", ndërsa operatori ekonomik "S..." i renditur i pesti u s'kualifikua për mospasje në ekstrakt objektin e prokurimit. Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla mbështetur në kriteret e kualifikimit kërkuar sipas ftesës për ofertë vendosi ta konsiderojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik "E...", me vlerë 500,000 lekë, si ofertë e vlefshme e dokumentuar me procesverbalin nr.233/3 prot, datë 25.03.2019, e cila është në përputhje me kriteret e kualifikimit të kërkuara nga AK në ftesën për ofertë. O/E ka realizuar objektin e prokurimit me AK, e dokumentuar kjo me procesverbalin nr.233/8 Prot, datë 29.03.2019.

Nga këta OE komisioni ka s'kualifikuar "D.B." me ofertën **299,000** lekë pa tvsh me argumentin se, është "oferta anomalisht të ulta", *pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët". (Diferenca midis ofertave është 500,000 – 299,000 = **201,000** lekë).*

Me USH nr. 40, dt. 16.04.2019 është likuiduar vlera prej 500,000 lekë për për operatorin E... sipas Faturës së thjeshtë tatimore nr. 16, dt. 26.03.2019 me vlerën 500,000 lekë pa tvsh dhe Fh. nr. 4, dt. 26.03.2019 . *Komisioni i vlerësimit të ofertave: N.N., E.D., S.L.*

6. Procedura "*Blerje dollapë për arshivën e protokollit*".

Me urdhrin nr.305/2 Prot, datë 07.05.2019, është miratuar fondi limit nga Titullari i A/K me vlerë 213,000 lekë pa tvsh, e shoqëruar me ftesën për ofertë me nr.305/3 Prot. datë 07.05.2019, procedurë e cila është anuluar me procesverbalin nr.305/4 Prot, datë 09.05.2019 për arsye të mos përcaktimit të saktë të specifikimeve teknike. Procedura është përsëritur në e shoqëruar me ftesën për ofertë me nr.305/5, datë 13.05.2019 dhe anuluar me procesverbalin nr.305/6 Prot, datë 15.05.2019 për mos vlerësim sipas udhëzimeve të APP nga ana e komisionit.

Procedura është ripërsëritur shoqëruar me ftesën nr. 305/7 Prot , datë 18.05.2019 ku morën pjesë 18 O/E. Komisioni i Vlerësimit për Procedurat e Prokurimeve me vlera të vogla, për O/E "X.S.", "N.H.", "D..." shpk, "E.S.", "O.D.", "R..." sha, vendosi refuzimin automatikisht të ofertave të paraqitura, për ofertë anomalisht të ulët. Për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik "*E.K.*" Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla mbështetur në kriteret e kualifikimit kërkuar sipas ftesës për ofertë vendosi ta konsiderojë ofertën e paraqitur nga ky OE si ofertë e vlefshme e cila është në përputhje me kriteret e kualifikimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në ftesën për ofertë, me vlerë të ofertës prej 180,000 lekë pa TVSH, i cili ka realizuar objektin e prokurimit të dokumentuar me procesverbalin nr.305/10 Prot, datë 22.05.2019.

Nga këta OE komisioni ka s'kualifikuar "X.S." me ofertën **90,000** lekë pa tvsh me argumentin se, është "oferta anomalisht të ulta", *pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët". (Diferenca midis ofertave është 180,000 – 90,000 = **90,000** lekë).*

Me USH nr. 68, dt. 03.06.2019 është likuiduar vlera prej 204,000 lekë për operatorin E.K. sipas Faturës së thjeshtë tatimore nr. 11, dt. 22.05.2019 me vlerën 204,000 lekë pa tvsh dhe Fh. nr. 7, dt. 22.05.2019. *me diferencë prej 24, 000 lekë nga fondi limit prej 180,000 lekë pa tvsh. Komisioni i vlerësimit të ofertave: N.N., E.D., G.X.*

7. Procedura me objekt "*Blerje shtypshkrime*".

Komisioni në përllogaritjen e fondit limit për blerje shtypshkrime është bazuar në ofertat e tre operatorëve ekonomike. Me shkresën nr.450/1 Prot, datë 02.10.2019, është miratuar fondi limit 50,000 leke pa tvsh nga titullari i AK, i shoqëruar me ftesën për ofertë nr.450/3 Prot, datë 02.10.2019. Në këtë procedurë të hapjes së ofertave me datën 07.10.2019, janë paraqitur me ofertat e tyre 11 O/E. Nga ofertat rezulton se O/E i radhitur i pari në klasifikimin elektronik "*S...*" me ofertën me të vlefshme në vlerën më të ulët 48,900 lekë pa tvsh, i cili ka realizuar objektin e prokurimit me AK të dokumentuar me procesverbalin nr.450/7 Prot, datë 10.10.2019.

8. Procedua me objekt "*Blerje shtypshkrime*".

Komisioni ka përllogaritur fondin limit duke u bazuar në çmimin më të ulët të tregut të jashtëm nga tre operatorë ekonomikë. Me shkresën nr.381/2, është miratuar fondi limit prej 400,000

lekë pa tvsh i shoqëruar dhe me ftesën për ofertë nr.381/3 Prot, datë 16.07.2019, ku në këtë procedurë u paraqitën 10 operatorë ekonomikë. Komisioni shpalli OE "E.K.", të renditur të parin por, nuk u paraqit dhe për mospjesëmarrjen e tij në procedurën e prokurimit është njoftuar OE "E..." i renditur i dyti të cilin, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël vendosi ta shpallë fitues me vlerë të ofertës prej 370,000 lekë pa TVSH, realizimin e të cilit e vërteton procesverbali nr.381/7 Prot, datë 27.07.2019.

9. Procedura "*Seminar mbi projektet e Këshillit Konsultativ*".

Komisioni ka përllogaritur fondin limit bazuar në VKM nr.285, datë 03.06.1999 "*Për dreka dhe darka zyrtare*" i ndryshuar për kostot maksimale për grupin e dytë është 3,500 lekë për person kur në takim marrin pjesë përfaqësues të huaj. Sipas kërkesës për pjesëmarrjen e 60 personave është përcaktuar fondi limit prej 210,000 leke pa tvsh. Fondi limit është miratuar me urdhër të AK me nr.321/2 Prot, datë 15.05.2019 i shoqëruar me ftesën për ofertë nr.321/3 Prot, datë 21.05.2019. O/E i radhitur i pari në klasifikimin elektronik "A..." është s'kualifikuar nga KPP-ja për ofertë anomalisht të ulët në vlerën 114,390 lekë pa tvsh. O/E "E.K.", i renditur i dyti në këtë klasifikim elektronik është s'kualifikuar për mospasje në ekstrakt objektin e prokurimit të dhënë nga AK. Komisioni shpalli O/E "E.R." të renditur të tretin si ofertë të vlefshme prej 190,000 lekë pa tvsh e dokumentuar me procesverbalin nr.321/4 Prot, datë 23.03.2019.

Nga këta OE komisioni ka s'kualifikuar "A..." me ofertën **114,390** lekë pa tvsh me argumentin se, oferta është "oferta anomalisht të ulta", *pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët"*. (*Diferenca midis ofertave është 190,000 – 114,390 = **75,610** lekë*).

Me USH nr. 58, dt. 24.05.2019 është likuiduar vlera prej 228,000 lekë pa për operatorin E... sipas Faturës së thjeshtë tatimore nr. 27, dt. 23.05.2019 me vlerën 228,000 lekë pa tvsh me diferencë prej **38,000** lekë nga fondi limit prej 190,000 lekë pa tvsh. *Komisioni i vlerësimit të ofertave: Nesti Ndoci, Enxhi Dosti, Greta Xhema.*

10. Procedura me objekt "*Shërbim automjeti Ford Fokus*".

Komisioni ka përllogaritur vlerën e fondit limit në bazë të çmimeve të tregut të marra nga tre operatore të ndryshëm. Me shkresën nr.441/2 Prot, datë 24.09.2019 është miratuar fondi limit 293,000 lekë pa tvsh i shoqëruar me ftesën për ofertë nr.441/3 Prot, datë 26.09.2019. Procedura është anuluar me procesverbalin nr.441/6 Prot, datë 30.09.2019, për shkak të përllogaritjes së gabuar të fondit limit. Me shkresën nr.441/7 Prot, datë 07.10.2019, është përllogaritur fondi limit bazuar në tre oferta të ndryshme nga operatorë në tregun e jashtëm e miratuar me vendim të titullarit të AK me nr.441/8 Prot, datë 07.10.2019, me fond limit 160,000 lekë pa tvsh, i shoqëruar me ftesën për ofertë me nr.441/3 Prot. datë 07.10.2019. Në këtë procedurë morën pjesë 5 operatorë ekonomik. Operatori ekonomik "B..." shpk, i radhitur i pari në klasifikim, vendosi të shpallë fitues këtë O/E me vlerë të ofertës prej 130,000 lekë pa TVSH, i cili e ka realizuar objektin e prokurimit, kjo e dokumentuar në procesverbalin nr.441/13 Prot , datë 16.10.2019.

11. Procedura "*Shërbim automjeti Santa Fe*".

Me shkresën nr.371/2 Prot, datë 05.07.2019 është miratuar fondi limit prej 160,000 lekë pa tvsh i shoqëruar me ftesën për ofertë nr.371/3, datë 05.27.2019. Operatori ekonomik "E.S." i radhitur i pari në klasifikim nuk u paraqit në ambientet e AMVV-së. Në këto kushte Komisioni për vlerësimin e ofertave vendosi të bëj thirrjen elektronike të operatorit ekonomik "B.Ç." shpk, i renditur i dyti ku ka vendosur ta konsiderojë ofertën e vlefshme e në përputhje me kriteret e kualifikimit të kërkuara nga AK në ftesën për ofertë, me vlerë prej 138,000 lekë pa TVSH, i cili e ka realizuar objektin e prokurimit e dokumentuar në procesverbalin nr.441/13 Prot, datë 16.10.2019.

12. Procedura me objekt "*Shërbim automjeti Toyota Prius*".

Me shkresën nr.293/1 Prot, datë 08.08.2019 është miratuar fondi limit prej 30,000 lekë pa tvsh, i shoqëruar me ftesën për ofertë nr.399/2 Prot,0 8.08.2019, në të cilën morën pjesë 9 operatorë ekonomik. Operatori ekonomik "K..." sha, i radhitur i pari në klasifikim KBV, vendosi ta

konsiderojë si, ofertë e vlefshme e cila është në përputhje me kriteret e kualifikimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në ftesën për ofertë, me vlerë prej 12,000 lekë pa TVSH, dokumentuar me procesverbalin nr.399/3 prot, datë 13.08.2019, i cili ka realizuar objektin e prokurimit "*shërbim automjeti*" e dokumentuar me procesverbalin e pritjes se mallit me nr.399/6 Prot, datë 15.08.2019.

Për procedurat e prokurimit për vitin 2019, Komisioni i prokurimit me vlera të vogla dhe titullari AK kanë s'kualifikuar ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedurë me argumentin se, "Ofertat janë anomalisht të ulëta" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët" dhe kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE me oferta ekonomike më të larta se ato të s'kualifikuara, veprime në mospërputhje me Nenin 40 pika 5 e VKM në të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlera të vogla të zhvilluar me mjete elektronike" i ndryshuar, ku ngarkon me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlera të vogla dhe Titullarin e AK, ***B.M., N.N.***, me detyrë jurist në cilësinë e kryetarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***E.D.***, me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***S.L.***, me detyrë jurist inspektor në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***G.X.*** me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla (larguar me Urdhrin nr.12, Prot. Datë 04.09.2019).

Titulli i Gjetjes:	*Komisioni i prokurimit me vlera të vogla dhe titullari AK kanë s'kualifikuar ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit me vlera të vogla me argumentin se, "Ofertat janë anomalisht të ulëta".*
Situata 1:	Në procedurën e prokurimit "*Blerje pajisje elektronike*" komisioni ka skualifikuar ofertën më të ulët me vlerën 299,000 lekë pa tvsh paraqitur nga "D.B.", të cilin komisioni i prokurimit e ka s'kualifikuar me argumentin se, "*Oferta është anomalish e ulët*" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE "E..." me ofertën 500,000 lekë pa tvsh (*Diferenca midis ofertave është 500,000 – 299,000 =* ***201,000*** *lekë*). *Komisioni i vlerësimit të ofertave: N.N., E.D., S.L.*
Situata 2:	Në procedurën e prokurimit "*Blerje dollapë për arshivën e protokollit*" komisioni ka s'kualifikuar OE "X.S." me ofertën 90,000 lekë pa tvsh me argumentin se, është "*oferta anomalisht të ulta*", pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "*çmimi më i ulët*". (Diferenca midis ofertave është 180,000 – 90,000 = **90,000** lekë). Me USH nr. 68, dt. 03.06.2019 është likuiduar vlera prej 204,000 lekë për operatorin Emanuela Kapxhiu sipas Faturës së thjeshtë tatimore nr. 11, dt. 22.05.2019 me vlerën 204,000 lekë pa tvsh dhe Fh. nr. 7, dt. 22.05.2019. me diferencë prej **24, 000** lekë nga fondi limit prej 180,000 lekë pa tvsh. Komisioni i vlerësimit të ofertave: N.N., E.D., G. X.
Situata 3:	Në procedurën e prokurimit "*Seminar mbi projektet e Këshillit Konsultativ*", komisioni ka s'kualifikuar "A..." me ofertën 114,390 lekë pa tvsh me argumentin se, oferta është "oferta *anomalisht të ulta*", *pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët"*. (*Diferenca midis ofertave është 190,000 – 114,390 =* ***75,610*** *lekë*).

	Me USH nr. 58, dt. 24.05.2019 është likuiduar vlera prej 228,000 lekë pa për operatorin "E..." sipas Faturës së thjeshtë tatimore nr. 27, dt. 23.05.2019 me vlerën 228,000 lekë pa tvsh me diferencë prej **38,000** lekë nga fondi limit prej 190,000 lekë pa tvsh. *Komisioni i vlerësimit të ofertave: N.N., E.D., G.X.*
Kriteri:	*Veprime të cilat janë në mospërputhje me piken 5 të Nenit 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", neni 40 si dhe me pikat 10, 14 dhe 17 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluar me mjete elektronike" i ndryshuar.*
Ndikimi/Efekti	Janë skualifikuar padrejtësisht operatorë me oferta më të ulta duke sjellë një efekt ekonomik më vlerën ***428,610*** *lekë pa tvsh.*
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, sektori i financës të merren masat të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **428,610** lekë nga anëtarët e Komisionit të Blerjeve në Vlera të Vogla për vitin 2019: - Për arkëtimin e vlerës prej **299,610** lekë nga K*omisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla* ***N.N.***, me detyrë jurist në cilësinë e kryetares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***E.D.***, me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***G.X.***, me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla dhe vlerës **67,000** lekë nga ***S.L.***, me detyrë jurist inspektor në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla <u>për skualifikimin e operatoreve ekonomikë me argumentin e paraqitjes së, "*Ofertave anomalisht të ulët*"</u> në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr.3, datë 08.01.2018 *"Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluar me mjete elektronike*" i ndryshuar, pikat 10, 14 dhe 17. - Për arkëtimin e vlerës prej **24,000** lekë nga operatori **E. K.** dhe vlerës prej **38,000** lekë nga operatori **E...** sa përfituar më tepër nga vlera e ofertës.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Menjëherë*

<u>Për sa më lart trajtuar në:</u>
Aktin e Konstatimit nr. 3, dt. 27.12.2019 "Auditimi i procedurës së prokurimeve për blerjet e vogla për vitin 2017".
Aktin e Konstatimit nr. 4, dt. 27.12.2019 "Auditimi i procedurës së prokurimeve për blerjet e vogla për vitin 2018-2019".

<u>Komente dhe shpjegime:</u>
Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:
Përsa i përket auditimeve të vitit 2019
- <u>Proçedura e prokurimit me objekt " Blerje kompjutera "</u>.
Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, përllogaritjen e fondit limit për blerjen e pajisjeve elektronike si dhe për specifikimet teknike është bazuar në faqen zyrtare të AKSHIT 561,314 lekë , ofertat e skualifikuara nga sistemi i app anomalisht të ulta , u moren parasysh nga komisioni për arsye se oferta e paraqitur nga OE të skualifikuar nuk mund të realizonin cilësinë e kërkuar në specifikimet teknike, ato ishin afërsisht sa gjysma e fondit limit, gjë e cila nuk do na siguronte cilësinë e kërkuar.

- Procedura e prokurimit seminar për projektet e Këshillit Konsultativ *Komisioni i prokurimime vlerë të vogël, OE Albturist Albania me ofertë ekonomike 114,000 lekë ku pjesmarrja në aktivitet është 60 persona nuk mund ta realizonte me ofertën ekonomike e afruar , në këtë aktivitet mernin pjesë zv/ministrat e ministrive , përfaqesues nga KE , të ambasadave zviceriane si dhe perfaqesues ndërkombëtarë të ftuar, të cilat na bënin të zhvillonim një aktivitet me cilësinë e duhur.Në asnjë rast komisioni i vlersimeve nuk ka pas për qëllim të anashkalojë OE apo të shpërdorojë fondet , në të gjitha rastet është munduar, të realizojë me cilësine e duhur sipas specifikimeve në ftesën për ofertë.*

- Procedura e prokurimit Blerje dollapë për arshivën dhe protokollin.

OE i skualifikuar X.S. me ofertë ekonomike 90,000 leke është skualifikuar nga sistemi si ofertë anomalisht e ulët. Komisioni i vlerësimeve duke patur rëndësinë e këtyre pajisjeve të cilat duhet të përdoren për arshivë dhe do mbanim dokumentacionin 5 vjeçar dollapët janë kërkuar prej druri të forta që të mbanin peshën e dokumentacionit dhe normalisht kishin kosto. Oferta nuk mund të plotësonte qëllimin e blerjes se pajisjeve, dhe e mori të mirëqenë skualifikimin nga sistemi..

I kërkojmë grupit të audituesve të KLSH të marrë parasysh moskualifikimin e anëtarëve të komisionit të blerjeve të vogla , të cilët janë për herë të parë anëtarë komisioni pa përvojë më parë pa kurse kualifikimi për procedurën e prokurimeve dhe nuk e kanë e kanë ditur ligjin që ofertat anomalisht të ulta nuk zbatohen për procedurën e blerjeve të vogla,. Më 27 prill të vitit 2018, për tenderimin e procedurës së prokurimit të kompjuterave anëtari i komisionit z. S.L. ka dhënë dorëheqjen nga njësia e prokurimeve pasi nuk ishte i kualifikuar dhe nuk mund të vazhdonte më pa kualifikim. Shprehemi më se të sinqertë që komisioni në asnjë mënyrë nuk ka pas për qëllim të anashkalojë OE apo të shpërdorojë fondet , në të gjitha rastet është munduar, të realizojë me cilësinë e duhur sipas specifikimeve në ftesën për ofertë., pasi fondet e investimeve për AMVV janë të limituara dhe për vitet në vazhdim nuk kemi më fonde investimesh.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:

KVO i ka s'kualifikuar OE me argumentin se, është "oferta anomalisht të ulta", pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët". Këto veprime janë në mospërputhje me piken 5 të Nenit 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", neni 40 si dhe me pikat 10, 14 dhe 17 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluar me mjete elektronike" i ndryshuar.

Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, sektori i financës të merren masat të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës së dëmit ekonomik të shkaktuar nga anëtarët e Komisionit të Blerjeve në Vlera të Vogla.

5- Në aspektin organizativ të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, auditimi do të përqendrohet kryesisht në drejtimet e mëposhtme:

-Mbi monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015-2020, si dhe planit të veprimit përkatës;

-Mbi Informimin në mënyrë periodike të institucioneve publike, grupet e interesit dhe qytetarët mbi çështjet që lidhen me qeverisjen vendore;

-Mbi mbështetjen e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;

-Mbi sigurimin e informacioneve lidhur me çështjet e vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike qendrore e vendore dhe harton raporte, analiza periodike mbi këto çështje;

-Mbi raportet periodike të dërguara pranë ministrit përgjegjës për çështjet vendore mbi veprimtarinë e saj dhe për realizimin e detyrave e të përgjegjësive të përcaktuara në këtë

vendim.

Në bazë të Vendimit nr.83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin e Agjencisë dhe funksionimin e Agjencisë për zbatimin e Reformës Territoriale*" pika 4, AZRT-ja, ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:

-Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore në koordinimin e punës për zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore;-Monitoron zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015-2020, si dhe planit të veprimit përkatës;-Informon periodikisht institucionet publike, grupet e interesit dhe qytetarët mbi çështjet që lidhen me qeverisjen vendore;-Bashkëpunon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015-2020;-Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;-Siguron informacione lidhur me çështjet e vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike.

Në bazë të Vendimit Nr.83, datë 28.01.2015, i ndryshuar me vendimin Nr.11, datë 12.01.2018 "*Për krijimin dhe funksionimin e AMVV"*, ka këto detyra dhe përgjegjësi: *-Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore në koordinimin e punës për zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore;-Monitoron zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020, si dhe planit të veprimit përkatës; -Informon periodikisht institucionet publike, grupet e interesit dhe qytetarët mbi çështjet që lidhen me qeverisjen vendore; -Bashkëpunon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020; -Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore; -Siguron informacione lidhur me çështjet e vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike qendrore e vendore dhe harton raporte, analiza periodike mbi këto çështje; -Ofron këshillim ligjor dhe teknik për njësitë e vetëqeverisjes vendore në procesin e ushtrimit të funksioneve të tyre; -Shërben si qendër e evidentimit dhe e promovimit të praktikave më të mira dhe/ose modeleve rekomanduese për çështjet e vetëqeverisjes vendore; -Bashkërendon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare; -Mbështet ministrinë përgjegjëse për çështjet vendore (në rolin e një sekretariati teknik) në koordinimin e punës me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë që mbështesin zhvillimin e njësive të vetëqeverisjes vendore; -Raporton periodikisht pranë ministrit përgjegjës për çështjet vendore mbi veprimtarinë e saj dhe për realizimin e detyrave e të përgjegjësive të përcaktuara në këtë vendim.".*

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMMV) funksionon bazuar në VKM Nr.11, datë 12.01.2018 "*Për disa ndryshime në Vendimin nr.83, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave,"Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale"*.

<u>Një ndër detyrat kryesore të menaxhimit është ngritja dhe vënia në funksion e sistemit kontrollit brendshëm.</u> Gjatë auditimit rezultoi se AMMV, me shkresën nr.585/3, datë 06.11.2018 ka përcjellë te nëpunësi Autorizues i MB, rregulloren e brendshme të institucionit. Për shkak të mangësive, projekt rregullorja është kthyer për t'u përmirësuar. Pas riparimeve me shkresën nr.157, datë 13.02.2019 është dërguar për miratim dhe është miratuar me Nr.2334/2 prot. datë 19.04.2019 me Urdhër nr.378, datë 19.04.2019. Hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme bën të mundur evidentimin e misionit dhe objektivave të Njësisë, përcaktimin e rregullave të sjelljes etike, të rregullave të menaxhimit burimeve njerëzore, të

aktiveve, dokumentacionit, përcaktimit të përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së menaxherëve etj.

AMVV ka si përgjegjësi kryesore koordinimin e punës për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore. Këtë e realizon duke monitoruar zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore. Për realizimin e kësaj, sektorët dhe mbi këtë bazë institucioni i AMVV ka hartuar "*Planin e veprimit për periudhën Mars-Dhjetor 2018*", si dhe "*Planin dhe objektivat e AMVV-së, për vitin 2018, aktivitet që do të organizohen në bashkëpunim me NJQV-të*". Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se Sektori i Analizës dhe Mbështetjes Institucionale e ka ndërtuar planin vjetor mbi bazën e prioriteteve, qëllimeve, produkteve, ndërkohë Sektori i Koordinimit me Qeverisjen Vendore e ka bazuar në drejtime.

Plani përmbledhës vjetor i institucionit i hartuar si plan veprimi dhe program pune përfshin si detyra më kryesore:

-Bashkëpunimin e AMVV me aktorët e tjerë për propozime dhe përmirësime të akteve ligjore e nënligjore në zbatim të SKNDQV.

-Krijimin dhe monitorimin e standardeve për shërbimet publike që ofrojnë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

-Rishikimi në strategjinë për decentralizim 2015-2019, për të analizuar objektivat, prioritetet, aktivitetet, arritjet dhe propozime për një shtyrje në një afat 2-3 vjeçar.

-Rritjen e performancës së administratës vendore, kjo nëpërmjet bashkëpunimit me ASPA, krijimit të një moduli trajnimi dhe vlerësimi.

-Ngritjen e strukturave të Integrimit Evropian në nivel vendor në 61 bashkitë të vendit.

-Krijimin e Komisionit të Sigurisë në nivel vendor.

-Ngritjen e Zyrave me një Ndalesë (One-Stop-Shop) në bashkitë e vendit, marrja e opinioneve për fillimin e zyrave.

-Organizimin e Konkursit për Praktikat më të Mira, në bashkëpunim me donatorët.

-Rritja e nivelit të monitorimit të standardit të shërbimeve që ofron pushteti qendror, për të sjellë shërbime më të shpejta dhe cilësore, zgjidhje të shqetësimeve, ankesave, konflikteve midis qytetarit dhe institucioneve, apo kërkesave nga qytetarët, kjo sa i takon institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

-Kryerjen e funksionit si sekretariat teknik për mirë funksionimin e Këshillit Konsultativ etj.

Për realizmin e këtyre detyrave AMVV, kishte planifikuar një sërë aktivitetesh për t'i kryer të decentralizuar funksione të tyre, takime informuese me NJQV me drejtuesit e komiteteve të rajoneve etj.

Nga shqyrtimi i planeve të punës rezultoi se, sektorët nuk përdorin një format unik për hartimin e detyrave vjetore. Institucioni planin vjetor nuk e ka të mbështetur në planet e sektorëve dhe e ka ndërtuar me dy formate si plan veprimi dhe si plan objektivash dhe aktivitetesh në bashkëpunim me NJQV. Formatet përveç ndryshimeve që kanë në formë dhe përmbajtje kanë edhe dublime detyrash. Konkretisht dublime të tilla në dy formatet e institucionit kishte për ngritjen e komisioneve të sigurisë pra në çdo NJQV, për ngritjen e rrjetit të 61 koordinatorëve vendore në zbatim të projektit "*Bashkitë për në Evropë*", ngritjen e zyrave me një ndalesë (One-Stop-Shop).

Vlen të theksohet se, në asnjërin format plani për vitin 2018, nuk rezultojnë të vendosura kryerja e detyrave apo përgjegjësive të tilla si:

-Vazhdimin e reformës administrative-territoriale me qëllim përfundimin dhe përcaktimin e kufijve administrativ dhe hartave përkatëse.

-Vazhdimin e reformës së decentralizimit për përfundimin e transferimit të pyjeve dhe kullotave.

-Konsolidimin e reformës në drejtim të decentralizimit për rrugët rurale, ujitjen e kullimin.

-Informimin periodik për institucionet publike apo grupet e interesit.

-Bashkëpunimin me Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave në MB për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të SKNDQV si dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në kuadër të integrimit në BE dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare.
-Përgatitjen e raporteve periodike për ministrin lidhur me çështje vendore.

Sa i takon zbatimit të programeve të punës rezulton se, AMVV detyrën e mbështetjes së ministrit për çështjet vendore në koordinimin e punës për zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore e ka realizuar nëpërmjet monitorimit të zbatimit Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, pjesëmarrjes në hartimin e propozimeve për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të SKNDV, mbështetjes së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e funksioneve të deleguara, në ndjekjen e përmbushjes detyrimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian duke evidentuar dhe promovuar praktikat me të mira si dhe duke kryer rolin e sekretariatit teknik për funksionimin e Këshillit Konsultativ.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit që pasqyron kryerjen e këtij aktiviteti rezulton se, AMVV deri në muajin dhjetor të vitit 2018 nuk kishte përgatitur raportet periodike për ministrin siç kërkohet në pikën "gj" të VKM Nr.11, datë 12.01.2018 "*Për disa ndryshime në Vendimin nr.83, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale"*. Këto raporte periodike ishin përgatitur për zv/Ministren, pa patur ndonjë shkresë për delegimin e kësaj kompetence nga ana e ministrit. Kabineti i Ministrit me shkresën nr.9993, datë 06.12.2018, ka kërkuar që raportimi periodik javor t'i drejtohet Ministrit të Brendshëm nëpërmjet kabinetit tij. Pas kësaj shkrese raportet periodike kanë filluar ti dërgohen ministrit.
Përsa i takon monitorimit të zbatimit Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore rezulton se, gjatë muajve prill-dhjetor 2018, është hartuar Raporti i Vlerësimit Afat mesëm të SNDQV 2015-2020. Raporti i Vlerësimit, në grupin e punës për hartimin e të cilit ishte edhe AMVV, hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të SNDQV 2015-2020. Ky raport mbulon progresin gjatë periudhës nga 2015 deri në fillim të 2018 duke venë në dukje arritjet e tre viteve të para të zbatimit të strategjisë në lidhje me nivelin e arritjes së objektivave të strategjisë.
Bazuar në raportin e shpërmendur MTR (Mid-Term Evaluation Report) pati synim të informoj autoritetet përgjegjëse në Shqipëri në lidhje me progresin e arritur në lidhje me zbatimin e strategjisë, identifikimin e pengesave dhe të nxjerrë mësimet përkatëse me qëllim ripërcaktimin dhe optimizimin e veprimeve dhe ndërhyrjeve për arritjen e objektivave dhe rezultateve të strategjisë.
Raporti kishte si objektiva:

Të vlerësojë efektivitetin e zbatimit të SKNDQV dhe Planin e saj të veprimit 2015-2017;
Të vlerësojë dobishmërinë e objektivave dhe aktiviteteve të reformës së decentralizimit;
Të vlerësojë performancën dhe eficencën e menaxhimit të funksioneve të reja.
Të vlerësojë eficencën e strukturave të menaxhimit për reformën e decentralizimit,
Të nxjerrë mësime dhe të japë rekomandime në rast se nevojitet një rishikim i strategjisë, ose të përgatisë terrenin për një strategji të re pas 2020-ës.

MTR shqyrton periudhën nga 2015 deri në fillim të 2018 dhe vë në dukje arritjet e tre viteve të para të zbatimit të strategjisë në lidhje me nivelin e arritjes së objektivave të strategjisë. Ai konsiderohet si një kontribut në procesin e përditësimit dhe/ose përshtatjes së strategjisë dhe/ose planit të veprimit për zbatimin e strategjisë për periudhën 2018-2020.
Pyetjet në këtë raport ndahen në dy grupe. Pyetjet që lidhen me eficencën dhe efikasitetin marrin në konsideratë nivelin e administratës publike dhe trajtojnë çështje të cilat janë kryesisht nën kontrollin e drejtpërdrejtë të autoriteteve zbatuese në nivelin qendror dhe lokal. Pyetjet në lidhje me dobishmërinë, ndikimin dhe qëndrueshmërinë marrin në konsideratë efektet që masat

e politikës do kenë në një mjedis më të gjerë. Këto të fundit janë më të vështira për t'u matur objektivisht dhe janë më pak nën kontrollin e grupeve operacionale të interesit.
Në terma të përfundimeve të këtij vlerësimi, Strategjia mbetet me interes dhe me vlerë për interesat e të gjithë aktorëve të përfshirë. Deri tani është arritur një progres i rëndësishëm, por ende është shpejt për të vlerësuar impaktin mbi qytetarët. Pas tre vjetësh periudhe zbatimi, mund të jetë nevoja për të rishikuar planin e veprimit për zbatimin e strategjisë, si dhe për të përmirësuar kuadrin e monitorimit.
Bazuar në rekomandimet e MTR, periudha e SNDQV, është konfirmuar të zgjatet deri në vitin 2022. Përsa më sipër, MB ka konfirmuar dhe filluar punën me përditësimin e Planit të Veprimit të SNDQV. Vendimi i mësipërm është dakordësuar me grupin donator të "STAR-2" dhe diskutuar në detaje me Delegacionin Evropian në Shqipëri.
Sa i takon krijimit dhe administrimit të një sistemi kombëtar unik për zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore rezulton se, me VKM Nr.691, datë 29.07.2015 është miratuar Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020. Për realizimin e kësaj në ketë VKM, pasqyrohen edhe treguesit e monitorimit dhe të vlerësimit si dhe planiveprimi sipas dy fazave. Viti 2018, si vit objekt auditimi përfshihet në fazën e dytë afat mesme 2017-2018. në ketë fazë përfshihen çështje të rëndësishme që lidhen me zbatimin e reformës së re territoriale-administrative dhe konsolidimin e njësive të reja vendore, si dhe konsolidimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore si:
-funksionalizmi i zyrave unike të shërbimit (One stop shop) në të gjitha njësitë administrative,
-programi për standardet minimale për shërbimet publike në nivel vendor.
-planet vendore për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.
-kalimi i kompetencave për shërbimet kundër zjarrit.
-konsolidimi i funksionimit për ujitjen dhe kullimin.
-konsolidimi i funksionit të mirëmbajtjes së rrugëve urbane dhe rurale.
-mbështetja për administratën tatimore në nivel vendor, për funksionimin e këshillave të bashkive, monitorimi i qeverisjes vendore mbi bazë të performancës për shërbimet publike programi i trajnimit për njësitë e qeverisjes vendore etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se, disa prej këtyre çështjeve nuk janë përfshirë në planin vjetor të AMVV. Të tilla janë mbështetja dhe monitorimi i:
-Vazhdimit të reformës administrative-territoriale me qëllim përfundimin dhe përcaktimin e kufijve administrativ dhe hartave përkatëse.
-Vazhdimit të reformës së decentralizimit për përfundimin e transferimit të pyjeve dhe kullotave.
- Konsolidimit të reformës në drejtim të decentralizmit për rrugët rurale, ujitjen e kullimin.
Sa i takon realizimit të detyrës lidhur me krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore rezultoi se, objektivi për funksionalizimin e zyrave unike të shërbimit (One stop shop) siç ishte parashikuar në të gjitha njësitë administrative nuk është realizuar në 49 bashki. Një pjesë e shërbimeve nuk realizohen edhe në bashkitë në të cilat ka filluar zbatimi i projektit. Në këtë kuadër AMVV nuk ka realizuar:
-Takimin me kryetarët e bashkive mbi problematikën e funksioneve të deleguara, standarteve kombëtare dhe legjislacionin për të krijuar kështu edhe një databazë të problematikave sipas njësive vendore.
-Takimet me ato ministri të cilat kanë kaluar apo decentralizuar funksione të tyre në bashki të cilat gjykojmë që shërbimet e tyre do ti kalojmë në zyrën "One stop shop", apo që nuk kanë përmbushur detyrimet për aktet në zbatim.
-Organizimin e një konference me të gjitha bashkitë për të ndarë dhe shkëmbyer eksperiencat e zyrave One Stop Shop, me ato bashki të cilat nuk i kanë ngritur ose janë në fazën e ngritjes, duke vlerësuar eksperiencat më të mira dhe duke i ndarë ato me të tjerat.
-Ndjekjen e hartimit të VKM me bashkë propozim me ministritë e linjës lidhur me funksionet e reja të cilat janë deleguar Vetëqeverisjes Vendore. (Ministria e Arsimit, Ministria e

Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë) etj).
AMVV, gjatë vitit 2018 ka bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore duke shërbyer edhe si koordinatore me institucionet publike qendrore si dhe duke i mbështetur ato me këshillime ligjore e teknike.
-Për zbatimin e funksioneve të deleguara si u trajtua më sipër.
-Aktivitete mbështetëse për integrimin, shërbimet me një ndalesë, praktikat më të mira.
-monitorime për veprimtari si plazhet, emergjencat dimërore etj.
-raporte e informacione të marra.
-dhënie asistence.
Për këtë, AMVV me urdhrin e brendshëm nr.227/1, datë 29.03.2018 drejtori ka ngarkuar secilin punonjës për bashkërendimin e punës dhe mbështetjen e Njësive Vetëqeverisjes Vendore (NIVV) për zbatimin e funksioneve të deleguara. Gjatë vitit agjencia ka realizuar një sërë aktivitetesh të tilla mbështetëse si ngritjen e rrjetit të koordinatorëve të BE në zbatim të projektit "*Bashkitë për në Evropë*", në disa raste ngritjen e zyrave me një ndalesë ("One stop shop"), organizimin e konkursit për "*Praktikat më të mira*", ngritjen e komisioneve të sigurisë etj. Nga ana tjetër Agjencia ka monitoruar zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr.315, datë 29.05.2018 "*Për monitorimin dhe kontrollin e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë në plazhe*", Urdhrit të Kryeministrit nr.124, datë 31.07.2018 "*Për ngritjen e grupit Ndër institucional të Punës për Verifikimin dhe Monitorimin e Procesit të Riorganizimit të Shoqërive të Ujësjellës-Kanalizimeve*", etj. Tërheqja e mendimeve ka ndikuar në angazhimin dhe interesimin e këtyre njësive për përmirësimet e akteve ligjore në drejtim të ushtrimit të përgjegjësive tyre. <u>Një formë tjetër e bashkëpunimit të Agjencisë me NIVV, ka qenë dhe ofrimi i ndihmës ligjore e teknike.</u>
<u>Kjo shprehet në</u>:
-Dhënien e asistencës direkte lidhur me problemet e ardhura nga funksionet e transferuara nga ministritë e linjave dhe orientimet mbi mbarëvajtjen e funksionimit të tyre.
-Ndihmë në kryerjen e analizave ekonomike lidhur me borxhet e trashëguara duke i evidentuar plotësisht ato.
-Ritrajnimin e specialistëve të IT-ve të 61 bashkive në kuadrin e dixhitalizimit të arkiv-protokollit të këtyre njësive.
-Njohjen herë pas here me aktet e reja ligjore e nënligjore apo me ndryshimet e bëra atyre duke u rekomanduar dhe marrjen e masave në zbatim si duhet bërë zbatimi i tyre. Të tilla janë:
-Njoftimi i dërguar bashkive për miratimin e Ligjit nr.48, datë 23.07.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Me këtë rast evidentohet fakti që Neni 15 dhe 17 i ligjit 48/2018 dhe Neni 28 i ligjit 69/2012 lidhen drejtpërdrejtë me fushën e përgjegjësisë, të drejtat, detyrat dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 23, pika 11 dhe pika 12. Mbi këtë bazë Agjencia ka rekomanduar që krahas njohjes së ligjit 48/2018 nga strukturat përkatëse në bashki, kërkohet bashkërendimi i punës me strukturat qendrore të arsimit, në nivel vendor (Drejtoritë Arsimore ose Zyrat Arsimore) për zbatimin e Nenit 15 dhe 17 të këtij ligji si dhe të udhëzimeve përkatëse të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve.
-Njoftimi për njohjen e dokumentit "Mbi Politikat e Sektorit të Pyjeve në Shqipëri", në vijim të të cilit sugjerohet që brenda muajit Dhjetor 2018 të bëhet analiza për gjendjen e administrimit të pyjeve në bashki dhe përcaktimi i masave dhe detyrave për përmirësimin e saj, duke siguruar mbështetje me të madhe buxhetore për vitin 2019, nga të ardhurat nga pyjet dhe nga të ardhurat e tjera vendore me qëllim mirë administrimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve e kullotave vendore.
-Dërgimi i udhërrëfyesit për hartimin e rregullores së organizmit dhe funksionimit të strukturës vendore të apelimit tatimor, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet të cilit është rekomanduar hartimi i rregullores, organizimi dhe funksionimi i strukturës vendore të apelimit

tatimor vendor si dhe informimi i taksa paguesve në nivel vendor se ankimimi ndaj Zyrës së Tatim Taksave e Tarifave bëhet pranë kësaj strukture vendore të apelimit tatimor.

Një ndër detyrat e AMVV për vitin 2018, ka qenë dhe promovimi i praktikave më të mira për çështjet e vetëqeverisjes vendore. Gjatë vitit 2018, Agjencia mori përsipër organizimin dhe realizimin e konkursit për praktikat e mira, me mbështetjen e DLDP-së. Pas ngritjes së grupit punës, ishte realizuar kalendari për hapat që do të ndiqte procesi, kriteret dhe formati i aplikimeve nga ana e bashkive. Për mbarëvajtjen e procesit ishin zhvilluar 4 takime informuese rajonale në Prefekturën e Qarkut: Fier, Elbasan, Lezhë dhe Durrës me pjesëmarrjen e specialistëve të angazhuar me ketë projekt duke u konsultuar me ta për formatin, kriteret pranuese dhe kriteret përjashtuese të konkursit. Në këtë konkurs aplikuan me projekte 39 bashki të vendit. Të gjitha aplikimet dhe prezantimet e projekteve u dorëzuan tek AMVV-ja, e cila siguroi transparencën e procesit. Në përfundim të konkurrimit juritë vlerësuan dhe shpallën praktikat fituese për të cilat pati edhe nga një çmim në vlerën 10 mije euro. Me çmime të para u vlerësuan bashkitë Has, Mirditë dhe Shkodër, ndërkohë me çmime të dyta bashkitë Përmet, Lezhë dhe Tiranë.

Në kuadër të procesit të integrimit në BE, aktiviteti kryesor i zhvilluar nga AMVV ka qenë ngritja e rrjetit të Koordinatorëve të BE-se në zbatim të Projektit të financuar nga BE-ja "*Bashkitë për në Evropë*", ngritja e platformës me 61 koordinatorët vendorë, mbledhja dhe analiza e të dhënave nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Bazuar në VKM Nr.450, datë 26.07.2018 "*Për koordinimin e procesit të integrimit evropian ndërmjet qeverisë qendrore dhe njësive të vetë-qeverisjes*", AMVV organizoi themelimin e Njësive të BE-së. Deri në fund të vitit 2018 nga 61 bashkitë, 20 prej tyre kishin konfirmuar themelimin e këtyre njësive, proces i cili përfundoi në fillim të vitit 2019. Me qëllim ndjekjen më nga afër të këtij procesi ndërmjet Agjencisë dhe projektit "*Bashkitë për në EU*", është nënshkruar dhe një "*Letër angazhimi*" për funksionimin dhe menaxhimin e platformës së internetit. Platforma përdoret kryesisht për të ndarë informacione mbi ngjarjet e organizuara nga njësitë e BE-së, prezantimet dhe informatat mbi programet e ndryshme të BE-së, ndarjen e praktikave më të mira etj. Ajo deri më tani ka rreth 130 abonentë kryesisht të stafit të bashkive (njësitë e BE-së). Në gjithë këtë aktivitet nuk rezulton të ketë gjurmë për ndonjë bashkërendim me strukturën përgjegjëse për çështjet vendore të MB (Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave).

Për sa i përket vitit 2019, AMVV, ka mbledhur informacion për ecurinë e miratimit të Buxheteve Vendore nga Këshillat Bashkiakë, ku rezulton se 59 bashki e kanë miratuar buxhetin për vitin 2019, ndër to dy bashki janë ende në proces, Bashkia Përrenjas dhe Bashkia Skrapar. Në mbështetje të Kodit Zgjedhor të RSH-së, Ligji "*Për Gjendjen Civile*", Ligji "*Për Sistemin e Adresave*", Ligji "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", Ligji "*Për Prefekti*n", VKM nr. 83, datë 28.01.2015 (i ndryshuar), si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Agjencia gjatë vitit 2019, ka ngritur Grupin e Punës mbi monitorimin dhe zbatimin e detyrave të njësive të vetëqeverisjes vendore për organizimin e zgjedhjeve vendore për vitin 2019. Mbledhja e informacioneve ditore në të gjitha Bashkitë e vendit, nëse kanë qenë përpara rasteve të problematikave klimaterike, si dhe mbi ngritjen e shtabeve të emergjencave. AMVV, me të gjithë stafin e saj është angazhuar për përgatitjen e planit të punës, planit të aktiviteteve të Agjencisë për vitin 2019, në koordinim dhe me projektet e huaja. Bazuar në Urdhrin nr. 680, datë 27.12.2018 të Ministrit të Brendshëm, për "*Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Projektligjit për Policinë Bashkiake"*, Agjencia ka marrë pjesë në takimet e organizuara nga Zv/ Ministrja e Brendshme për fillimin e punës mbi draftimin e ligjit për Policinë Bashkiake. Çështje kjo e cila është ndër detyrat më të rëndësishme të Agjencisë, për të cilën janë duke mbledhur informacion nga të gjitha bashkitë për: -Numrin e banorëve, -Sipërfaqen e çdo territori të bashkive, -Numrin e policëve bashkiak, -Funksionet e tyre.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.450 datë 26.07.2018, Agjencia ka përpiluar një draft-urdhër për t'i ardhur në ndihmë 61 bashkive të vendit, për ngritjen e Njësisë së Koordinimit të Integrimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj. AMVV, si pjesë e grupit të punës, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Drejtësisë e cila, ka nisur procesin e

rishikimit të Planit të Veprimit, 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

Nga sektorët dhe në shkallë institucioni nuk është krijuar një sistem unik i përshtatshëm për planifikimin vjetor të detyrave dhe objektivave përmes të cilit të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë. Kjo duket në përdorimin e formateve me të dhëna të ndryshme të përdorura nga sektorët dhe Agjencia, në mos koordinimin mes tyre si dhe duke mos përfshirë në planin vjetor disa detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme, në kundërshtim me pikën 8, 9 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. AMVV, nuk ka arritur të mbështesë sa duhet krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore, gjë e cila shprehet në mos përmbushjen e objektivit për funksionalizimin e zyrave unike të shërbimit (One stop shop), (nga 61 në 49 bashki) si dhe në mos realizimin e disa shërbimeve edhe në bashkitë në të cilat ka filluar zbatimi i projektit. Kjo pasi, AMVV edhe pse i kishte planifikuar, nuk ka:

-Ndjekur hartimin e VKM-ve me bashkë propozim me ministritë e linjës lidhur me funksionet e reja të cilat janë deleguar Vetëqeverisjes Vendore.

-Realizuar takime bashkëpunimi me ato ministri të cilat kanë kaluar apo decentralizuar funksione të tyre në bashki të cilat, shërbimet e tyre do kalohen në zyrën "One stop shop ", apo që nuk kanë përmbushur detyrimet për aktet në zbatim.

-Organizuar një takim me kryetarët e bashkive apo një konferencë me të gjitha bashkitë, gjë e cila do t'i jepte mundësinë e krijimit të një database për problematikat dhe përvojat sipas njësive vendore lidhur me funksionet e deleguara, krijimin e standardeve të tyre si një sistem unik kombëtar dhe të përmirësimeve të mëtejshme në legjislacionin përkatës.

AMMV gjatë realizmit të detyrës për propozimet lidhur me përmirësimet e akteve ligjore e nënligjore si dhe në përmbushjen e detyrave që rrjedhin në kuadër të procesit të integrimit në BE dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare rezulton të mos ketë, bashkëpunuar me strukturën përkatëse të Ministrisë së Brendshme për çështjet vendore (Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave), në kundërshtim me pika "c" dhe "f" të VKM Nr.11, datë 12.01.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.83, datë 28.01.2015, të KM, "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale, ku ngarkon me përgjegjësi: B.M., me detyrë Drejtori i Përgjithshëm i AMVV, S.P., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kordinimit me Vetëqeverisjen Vendore dhe G.S., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kordinimit me Vetëqeverisjen Vendore.

Titulli i Gjetjes:	*Nga AMVV, sektorët, nuk është krijuar një sistem unik i përshtatshëm për planifikimin vjetor të detyrave dhe objektivave përmes të cilit të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë.*
Situata 1:	- Nga sektorët, nuk është krijuar një sistem unik i përshtatshëm për planifikimin vjetor të detyrave dhe objektivave përmes të cilit të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë. Kjo konstatohet në përdorimin e formateve me të dhëna të ndryshme të përdorura nga sektorët dhe Agjencia, në mos koordinimin mes tyre si dhe duke mos përfshirë në planin vjetor disa detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme, në kundërshtim me pikën 8, 9 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
Situata 2:	Hartimi dhe miratimi i rregullores, në Prill 2019, ka bërë që për periudhën e auditimit, 2017, 2018, nuk është siguruar sa dhe si duhet ngritja e komponentëve të MFK, e cila do të rriste efektivitetin e punës për evidentimin e misionit dhe objektivave të njësisë, përcaktimit të përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së menaxhereve. Kjo ka ardhur si

	rezultat i mos përmbushjes së përgjegjshmërisë nga menaxhimi i lartë duke mos realizuar detyrimin e parashikuar në nenin 29 të ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*".
Kriteri:	*Pika 8, 9 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pika "c" dhe "f" të VKM Nr.11, datë 12.01.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.83, datë 28.01.2015, të KM, "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale".*
Ndikimi/Efekti	*AMVV, nuk ka arritur të mbështesë sa duhet krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore, duke mos realizuar disa shërbime edhe në bashkitë në të cilat ka filluar zbatimi i projektit.*
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	-Nga Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, sektorët, të krijohet një sistem unik i përshtatshëm për planifikimin vjetor të detyrave dhe objektivave përmes të cilit të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë, në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Në vijimësi*

Akti i Konstatimit nr. 5, dt. 27.12.2019 "Auditim mbi aspektet organizative të AMVV, monitorimet, informacionet dhe raportet periodike dërguar ministrit brendshëm për veprimtarinë e AMVV, etj".

6. Mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ, të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", bazuar në VKM nr. 910, datë 21.12.2016 "*Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjes Vendore*" në drejtimet e mëposhtme:

a- Organizimi i mbledhjeve të Këshillit Konsultativ dhe Funksionimi i Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve".*

- Zbatimi i procedurave të Konsultimit të akteve dhe mbledhjet e këshillit konsultativ, në lidhje me projektligjet, projektvendimet etj, që lidhen me fushën e funksioneve të vetëqeverisjes vendore sipas neneve 12,23,24,25,26,28,29,30,31,32,33,34-43 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*".

***Mbi monitorimin** dhe zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020, si dhe planit të veprimit përkatës;

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), funksionon bazuar në VKM nr. 11, datë 12.01.2018 "*Për disa ndryshime në vendimin nr. 83, datë 28.01.2015, të Këshillit Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale*".

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV), së bashku me planin e veprimit, është miratuar, me vendimin nr. 691, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020".*

Bazuar në vlerësimin e ndërmjetëm të arritjeve (VNA) të kësaj strategjie, ku janë konstatuar disa gjetje dhe paraqitur rekomandime, të diskutuara dhe dakordësuara edhe me grupet e

interesit në një sërë tryezash konsultimi, e për rrjedhojë është konsideruar i nevojshëm inicimi i procesit të rishikimit dhe përditësimit të planit të veprimit aktual.

Gjithashtu, përmbushja e disa prej objektivave dhe nën objektivave të planit të veprimit të miratuar me vendimin nr. 691, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, si dhe nevoja harmonizimit të këtij plani me ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", kanë diktuar nevojën e ndryshimit të këtij plani.

Projektvendimi "*Për miratimin e Planit të Veprimit 2019 – 2022, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015 – 2020*", ku si qëllim ka rishikimin e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, duke synuar ndryshimin e objektivave dhe nënobjektivave, bazuar në gjetjet dhe vlerësimin e arritjes së objektivave aktualë.

Gjithashtu, projektvendimi synon përditësimin e periudhës kohore të zbatimit të planit të veprimit aktual, deri në vitin 2022.

*__Bashkëlidhur,__ Plani i Veprimit ne Zbatim të Dokumentit Strategjik (2019-2020).

Vlen të cilësohet se në planin e veprimit apo planin e objektivave të AMVV, nuk janë parashikuar kryerja e detyrave apo **përgjegjësive të tilla**:

-Vazhdimin e reformës administrative–territoriale me qëllim përfundimin e kufijve administrative dhe hartave përkatëse.

-Vazhdimin e reformës së decentralizimit për përfundimin e transferimit të pyjeve dhe kullotave.

-Konsolodimin e reformës në drejtim të decentralizimit për rrugët rurale, ujitjen e kullimin.

-Informimin periodik për institucionet publike apo grupet e interesit.

- Bashkëpunimin me Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave në MB për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të SKNDQV si dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në kuadër të integrimit në BE dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Përgatitjen e raporteve periodike për ministrin lidhur me këto çështje.

Kjo Agjenci ka hartuar dhe miratuar rregulloren e Brendshme, sipas urdhrit nr. 378, prot datë 19.04.2019, miratuar nga ministri brendshëm, dërguar me shkresën e Ministrisë Brendshme me nr.378, prot datë 19.04.2019, bërë hyrje nga institucioni AMVV me nr. 17/2 prot datë 19.04.2019.

Hartimi dhe miratimi i rregullores, në Prill 2019, ka bërë që për periudhën e auditimit, 2017, 2018, nuk është siguruar sa dhe si duhet ngritja e komponentëve të MFK, e cila do të rriste efektivitetin e punës për evidentimin e misionit dhe objektivave të njësisë, përcaktimit të përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së menaxhereve. Kjo ka ardhur si rezultat i mos përmbushjes së përgjegjshmërisë nga menaxhimi i lartë duke mos realizuar detyrimin e parashikuar në nenin 29 të ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".*

Sa më sipër nga sektorët dhe institucioni nuk është krijuar një sistem unik i përshtatshëm, për planifikimin vjetore të detyrave dhe objektivave, ku të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë. Kjo në mos përmbushje të përgjegjshmërisë së menaxhimit siç parashikohet në pikën 8,9 të Ligjit nr. 10296, date 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar.

* **Mbi mbështetjen e ministrit** përgjegjës për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;

Sa i takon krijimit dhe administrimit të një sistemi kombëtar unik për zbatimin e funksioneve të deleguara, të vetëqeverisjes vendore, rezulton se në zbatim të VKM Nr. 691, datë 29.07.2015, është miratuar strategjia ndërsektoriale, për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020. Në VKM, janë parashikuar edhe treguesit e monitorimit dhe të vlerësimit, si dhe plan veprimi në dy faza. Viti 2018 si vit objekt auditimi përfshihet në fazën e dytë – afat

mesme 2017-2018, ku përfshihen, çështje të rëndësishme që lidhen me zbatimin e reformës territoriale- administrative dhe konsolidimin e njësive të reja. Funksionimi i zyrave unike të shërbimit (on-stop shop)në të gjitha njësitë administrative.
Objektivi për funksionimin e zyrave unike të shërbimit (on stop shop) nuk është realizuar në të gjitha njësitë administrative. Por edhe në Bashkitë për të cilën ka filluar zbatimi i projektit,
AMC nuk ka realizuar: Takimet me Kryetarë e Bashkive për problematikën e funksioneve të deleguara, standardeve kombëtare dhe legjislacionin për të krijuar një data besë të problemeve sipas njësive vendore.
Takime me ato ministri të cilat kanë deleguar apo kanë decentralizuar funksione të tyre në bashki etj.
Organizimin e një konference me të gjitha bashkitë, për të shkëmbyer eksperiencat e tyre, me ato bashki të cilat nuk i kanë ngritur apo janë fazën e ngritjes, duke vlerësuar eksperiencat ma të mira dhe duke i ndarë ato me të tjerët.
Ndjekjen e hartimit të VKM në bashkëpunim me ministritë e linjës lidhur me funksionet e reja të cilat janë deleguar Vetëqeverisjes vendore (Ministria Kulturës, Ministria e Arsimit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrin e Bujqësisë).
Gjatë vitit 2018 AMVV nuk ka arritur të ndihmojë sa duhet krijimin e një sistemi kombëtar unik me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore, gjë e cila shprehet në mos për mbushjen e objektivit për funksionalizimin e zyrave unike të shërbimit (on stop shop).
*Mbi raportet periodike** të dërguara pranë ministrit përgjegjës për çështjet vendore mbi veprimtarinë e saj dhe për realizimin e detyrave e të përgjegjësive të përcaktuara në këtë vendim.
Realizimin e programit të punës për mbështetjen e ministrit, në çështjet vendore, koordinimin e punës për zbatimin e politikës së përgjithshme, në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore e ka realizuar nëpërmjet monitorimit të zbatimit Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, mbështetjes së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e funksioneve të deleguara, në ndjekjen e përmbushjes detyrimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian duke evidentuar dhe promovuar praktikat ma të mira si dhe duke kryer edhe rolin e sekretarit teknik, për funksionimin e Këshillit Konsultativ.
* **Mbi sigurimin e informacioneve** lidhur me çështjet e vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike qendrore e vendore dhe harton raporte, analiza periodike mbi këto çështje;
Përsa i takon monitorimit të strategjisë Nërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore periudhë prill-dhjetor 2018 është hartuar Raporti i Vlerësimit Afatmesëm të SNKDQV. Në këtë grupe pune është përfshirë edhe AMVV, hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimeve të Strategjisë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015-2020. Raporti mbulon periudhën nga 2015 deri në fillim 2018, duke venë në dukje arritjet e tre viteve të zbatimit strategjisë.
Në raportin e shpërmendur, MTR (Mid-Term Evaluation Report), si synim kishte të informonte autoritet përgjegjëse në Shqipëri, në lidhje me progresin e arritur përsa i përket zbatimit të strategjisë, për identifikimin e pengesave, dhe të nxjerrë mësimet për ri përcaktimin dhe optimizmin e veprimeve dhe ndërhyrjes për arritjen e objektivave dhe rezultateve të strategjisë si:
Të vlerësojë efektivitetin e zbatimit të SNKDQV dhe planin e saj të veprimit 2015-2017.
Të vlerësojë dobishmërinë e objektivave dhe aktiviteteve të reformës së decentralizimit;
Të vlerësojë performancen dhe efiçencën e menaxhimit të funksioneve të reja;
Të vlerësojë efiçencën e strukturave të menaxhimit për reformën e decentralizimit;
Të nxjerrë mësime dhe të japë rekomandime në rast se nevojitet një rishikim i strategjisë, ose të përgatisë terrenin për një strategji të re pas 2020. MTR ka shqyrtuar periudhën 2015-2018, dhe venë në dukje arritjet e tre viteve të para të zbatimit të strategjisë. Strategjia mbetet me

interes të gjithë aktorëve të përfshirë, ku është parashikuar të zgjatet deri në vitin 2022. Pas tre vitesh mund të rishikohet mundësia e rishikimit të SNKDQV. Vendimi i mësipërm është dakordësuar me grupin donatorë të "STAR-2" dhe diskutuar në detaje me bashkimin Evropian në Shqipëri.

***Mbi Informimin në mënyrë** periodike të institucioneve publike, grupet e interesit dhe qytetarët mbi çështjet që lidhen me qeverisjen vendore;

Informimin AMVV e ka realizuar nëpërmjet faqeve Web. (*Platforma e AMVV, e Këshillit Konsultativ e praktikave të mira si dhe platforma bashkitë në Evropë*). Nëpërmjet disa menuve për këto platforma është dhënë informacioni i duhur për AMVV, në lidhje me aktivitet e kryera prej sajë, për tematikat e mbledhjeve të Këshillit Konsultativ, për praktikat më të kryera nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për veprimet e ndërmarra në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integrimit në BE etj. Për periudhën e auditimit, kjo Agjenci ka funksionuar duke dhënë mendime direkt si agjenci, ose në rolin e sekretarit teknik përmes Këshillit Konsultativ për projekt aktet ligjore, ku specifikojmë disa prej tyre si vijon:

Projektvendimin e KM "*Për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi*", dërguar Ministrisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Nr.89, datë 26.02.2018).

Projektvendimin e KM "*Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësore dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare*", dërguar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (Nr.171, datë 13.03.2018).

Projektvendimin e KM "*Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"*, dërguar Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit (Nr.133/1, datë 19.03.2018).

Projektvendimin e KM "*Për miratimin e Planit Kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit*", dërguar Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit (Nr.220/1, datë 13.04.2018).

Projektvendimin e KM "*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM, Nr. 452, datë 11.07.2012 "Për lanfillet e mbetjeve"* dërguar Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit (Nr.279/1, datë 25.03.2018).

Projektligjin "*Për përfundimin e proceseve tranzitore të pronësisë në RSH*", dërguar SP të Ministrisë Brendshme.

Projektvendimin e KM "*Për disa ndryshime në VKM, nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin Projektligjin "Për rininë*", dërguar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (Nr.513, datë 13.09.2018).

Projektligjin "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën*" i ndryshuar, dërguar Ministrisë Kulturës (Nr.607/1, datë 22.10.2018).

Projektligjin "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*, dërguar Ministrisë Shtetit për Diasporën (Nr.582, datë 25.10.2018).

Projektligjin "*Për buxhetin e vitit 2019*", dërguar Ministrisë Financave (Nr. 675, datë 06.11.2018).

Projektligjin "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën*", dërguar Ministrisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Nr.614/2, datë 10.12.2018).

Projektligjin "*Për ndryshimet klimatike*", dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Nr.614/3, datë 10.12.2018) etj.

Sa më sipër nga dokumentacioni paraqitur rezultoi se, AMVV gjatë realizimit të detyrës për propozimet lidhur me përmasimet e akteve ligjore e nënligjorë, rezulton se nuk është bashkëpunuar me strukturën përkatëse të Ministrisë Brendshme për çështjet vendore (Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave).

Kjo si përgjegjësi e menaxhimit siç parashikohet te pika ç e VKM nr. 11, date 12.01.2018: Për disa ndryshime në Vendimin nr. 83 datë 28.01.2015, të Këshillit Ministrave, "*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për zbatimin e Reformës Territoriale".*

b- Në zbatim të VKM Nr. 910, datë 21.12.2016 "*Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes*

qendrore, me qeverisjen vendore", AMVV në rolin e sekretariatit teknik në vazhdimësi ka organizuar mbledhjet e këshillit konsultativ duke dërguar për njohje dhe dhënie mendimesh për projekt akte të dërguara dhe të propozuara nga ministritë e linjës, mendime të cilat janë përmbledhur sipas raporteve përfundimtare dhe janë bërë pjesë diskutimi në mbledhjet e këshillit konsultativ.

Në mbledhjet e Këshillit Konsultativ nga viti 2017-2018-2019 janë paraqitur gjithsej 112 Projekt akte ndër të cilat specifikojmë dhe konkretisht:

Janë paraqitur 21 ligje nga të cilat 14 janë miratuar, ndërsa 2 janë pa miratuar.

- Ligji "*Për mbrojtën sociale në Republikën e Shqipërisë*".
- Projektligjin "*Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të klubeve sportive*".

Janë shqyrtuar 61 VKM, ndër to kemi 2 të tërhequra për shqyrtim si dhe 4 të pa prezantuara si më poshtë vijon:

Të tërhequra për shqyrtim:

- Projekt Vendim Shërbimet e decentralizuara arsimore dhe bashkëpunimi me MASR: Infrastruktura shkollore, financimi i arsimit parashkollor dhe transporti në zonat rurale.
- VKM "*Për kriteret për përcaktimin e Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për tu arsimuar në gjuhën e pakicës."*

Të pa prezantuara:

- Projektvendimi "*Për disa ndryshime në vendimin nr. 426, datë 09.07.1998 të Këshillit Ministrave 'Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptar, që vdesin brenda dhe jashtë shteti*", të ndryshuar.
- Projektvendimin "*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi*".
- Projektvendimin "*Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin*".
- Projektvendim "*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e varrezave të dëshmorëve të atdheut*".

Kemi të bëjmë me 17 prezantime në total, ku 13 prej tyre janë miratuar dhe kaluar në Këshill.

Të pa prezantuara;

- Projekt–Raport Auditimi, Përformance, Funksionimi i Bashkive në kuadër të Reformës Administrative Territoriale të vitit 2014.
- Prezantimin me temë: Parku Rekreativ, Mjedisi i munguar i qytetit tim.

Të pa kaluara;

- Praktika ma të mira - Çështjet Ligjore për gjobat administrative
- Praktika ma të mira - Këshilli i Sigurisë.

Në këshill janë paraqitur 11 akte të tjera ku të gjitha janë prezantuar dhe miratuar.

- Taksa e pronës.
- Buxheti Vendor 2018 dhe miratimi i tij nga këshillat e bashkive.
- Apelimi Tatimor në nivel vendor - Udhërrëfyes për Hartimin e Rregullores nga Njësitë e Vetëqeverisjes vendore.
- Matrica e kompetencave e Vetëqeverisjes Vendore – Raporti Përfundimtar.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 dhe Plan Veprimi.
- Udhëzim "*Për kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme*".
- Projekt udhëzimin "*Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret, për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit*."
- Udhëzimi "*Për ndërthurjen e programeve sociale të strehimit dhe shërbimeve sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor*."
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2019-2022.
- Programi Kombëtare për daljen nga Skema e Përfitimeve, nga Ndihma Ekonomike.

Tërhequr pa miratuar;
Projektvendimi "*Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit*", dërguar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
Projekt Vendim "*Për funksionet e deleguara dhe Përdorimin e Fondeve Publike"*, Ministria e Brendshme.
Sa më sipër, AMVV gjatë realizimit të detyrës për propozimet lidhur me përmirësimet ligjore dhe nënligjore, pa kaluar në Këshillin Konsultativ, për dhënien e ndihmës, në shkëmbim të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projekt ligjet, të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, parashikuar në kreu II –të Parimet e Procesit të Konsultimit germa a,b,c dhe ç të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr. 910 datë 21.12.2016.

*Zbatimi i procedurave të Konsultimit të akteve dhe mbledhjet e këshillit konsultativ, në lidhje me projektligjet, projektvendimet etj, që lidhen me fushën e funksioneve të vetëqeverisjes vendore sipas neneve 12,23,24,25,26,28,29,30,31,32,33,34-43 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*".
Këshilli Konsultativ është forumi kryesor konsultues midis qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore. Me qëllim institucionalizimin e procesit të konsultimit mes vetëqeverisjes vendore dhe qeverisjes qendrore.
Këshilli Konsultativ bazon veprimtarinë e saj në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 910, datë 21.12.2016, "*Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore*" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 751, datë 19.12.2018, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të ministrave, "*për çështjet, objekt konsultimi, dhe Strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të Funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore".*
Gjithashtu, aktiviteti i Këshillit Konsultativ është në zbatim të ligjit 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe të Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SKNDQV), për përmbushjen e detyrimeve ligjore për funksionet e deleguara sipas ligjit.
Këshilli Konsultativ që nga periudha e krijimit të tij ka zhvilluar 13 takime në total me frekuencë përgjithësisht mujore. Ku në total janë paraqitur 112 Projekt akte.
Aktet ligjore dhe nënligjore të shqyrtuara nga Këshilli Konsultativ janë të fushave të ndryshme si të ligjit për financat vendore, buxheti vendor, dhe miratimi i tije nga këshillat e bashkive, taksa e pronës, për menaxhimin e integruar të mbetjeve, për integrimin Evropian, për gjobat administratorëve, për Veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale që dyshohet apo ka kryer vepër penale", Mbi organizmin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit, Shërbimet e decentralizuara arsimore dhe infrastrukturë shkollore, financimi i arsimit parashkollor dhe transporti në zonat rurale, për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë dhe të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së shërbimit social shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore" etj.

Produkti i Arritur

Mbledhjet e Këshillit Konsultativ kanë:
Institucionalizuar procesin e konsultimit mes Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore duke informuar të gjithë palët për projektvendimet, projektligjet dhe projekt strategjitë që propozohen nga Qeverisja Qendrore.
Realizuar mbledhjen e vërejtjeve, mendimeve, komenteve dhe propozimeve të bashkive dhe ia kanë bashkëlidhur praktikës dokumentare që shoqëron procesin vijues të vendimmarrjes përkatëse në Këshillin e Ministrave ose në Kuvend.
Bllokuar vijimin e procedurës për miratimin e Projektvendimit "*Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit*" deri në rishikimin e plotë të projektvendimit.

Miratuar projektvendime që prekin funksionet dhe interesat e bashkive.
Njohur paraprakisht Njësitë e Qeverisjes Vendore me masat që duhet të ndërmerren në kuadër të zbatimit të Ligjeve dhe VKM-ve.
Rritur transparencën duke përfshirë shoqatat dhe bashkitë në procesin e formulimit të projekt – akteve ose projekt-ligjeve.
Informuar Bashkitë për Praktikat më të Mira të Këshillave të Sigurisë dhe Udhërrëfyeset e përgatitur nga Donatorët në fushën e Financave Vendore.
Sa më sipër përveç rezultateve të arritura dhe dhënien e ndihmesës për qeverisjen vendore dhe funksionimin e rolit koordinator ndërmjet qeverisjes qendrore me vetëqeverisjes vendore, Këshilli Konsultativ, nuk ka dalë me ndonjë vendim për krijimin me komisione këshillimi, si struktura ad-hoc për të mbuluar fusha dhe sektorë specifike, në zbatim të VKM nr. 910, datë 21.12.2016 Për çështjet Objekt Konsultimi dhe Strukturën , Procedurën, Formën, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore Kreu IV pika 23.
Megjithëse AMVV në zbatim (VKM nr. 764, dt.27.12.2018) ka parashikuar, listën e projekt akteve, që do të shqyrtohen në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Qeverisjen Vendore për vitin 2019, por të pa shqyrtuara në këshillin konsultativ.
Projekt aktet që mendohet të shqyrtohen si projektligje, projektvendime janë gjithsej 54, këto në zbatim të VKM, të propozuara nga Ministria e linjës (Ministri propozues ose bashkëveprues), afati kohor ndarë në tremujore, arsyet kryesore për propozimin e projekt aktit, Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projekt akti, lidhja me Planin Kombëtar dhe Integrimin Evropian**,** lidhja me Strategjitë Kombëtare dhe Sektoriale, mendimi i AMVV për shqyrtimin e projekt aktit në Këshillin Konsultativ, Shqyrtuar në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Qeverisjen Vendore ku veçojmë disa prej tyre dhe konkretisht:
Për procedurat, afatet dhe dokumentacioni për të përfituar strehim, sipas çdo programi, detyrim ligjor, i deleguar nga ligji nr. 22/2018 "*Strategjia Kombëtare për strehimin social 2016-2025*", (VKM Nr. 405, datë 1.6.2016), afati 4/mujori i pare, konsultuar në këshillin konsultativ me datë 31 janar 2019.
Për përcaktimin e rregullave për administrimin e kërkesave të NJQV për fonde nga buxheti i shtetit dhe bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për strehimin, detyrim ligjor, i deleguar nga ligji nr. 22/2018 "*Për strehimin social*", afati 4/mujori pare, konsultuar në këshillin konsultativ me datë 31 janar 2019.
Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të përfitimit të dhënies së grandeve konkurruese, detyrimi ligjore i deleguar nga ligji nr. 22/2018 "*Për strehimin Social*", afati 4/mujori i pare, dërguar për mendim bashkive, konsultuar në këshillin konsultativ me datë 31 janar 2019.
Projektvendim "*Për miratimin e kufijve territoriale e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e Këshillit të secilit prej tyre*", 4/mujori parë.
Kërkesë ligjore;
Rregullimi i territorit hidrografik me qëllim rritjen e eficences së menaxhimit të burimeve ujore.
Projektvendim "*Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Drin-Buna*", deleguar VKM nr.73, datë 07.02.2018 "*Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore*", 4/mujori dytë. Akti nënligjor parashikon që planet e menaxhimit të beseneve ujore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar, i deleguar VKM nr.73, datë 07.02.2018 "*Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore".*
Projektvendim "*Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Seman*" 4/mujori dytë, Akti nënligjor parashikon që planet e menaxhimit të baseneve ujore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar.

Projektvendim "*Për përcaktimin e zonave, distancave dhe gjerësive të brigjeve të burimeve ujore*" 4/mujori dytë, Akti nënligjor parashikon përcaktimin e zonave, distancave dhe gjerësive të brigjeve ujore.
Projektvendim "Për një ndryshim në VKM nr.662, dt.21.09.2016 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta*" 4/mujori pare. Ndryshimi i aktit nënligjor si pasojë e ndryshimeve institucionale në sektorin e ujit, Akti nënligjor parashikon ndryshimin e referencave të emërtimeve të reja të krijuara në sektorin e ujit.
Projektvendim "*Për disa ndryshime në VKM nr.408, date 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, 4/mujori tretë. Përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, nëpërmjet E-Leje Tipologjitë e ndërtimeve, vendimmarrja për të cilat janë kompetencë e KKT-së, Dispozitat për miratimin e Certifikatës së Përdorimit, Afatet procedurale.
Projektvendim "*Për miratimin e Planit Kombëtar të Integrimit Evropian 2019-2021*" MEPJ, 4/mujori parë, Zbatimi i MSA, Parashikimi i akteve ligjore e nënligjore për periudhën 2019-2021, në kuadrin e përafrimit me legjislacionin e BE.
Për miratimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen nga Prefekti i Qarkut, në rast mos përmbushje nga strukturat përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, të detyrimeve të përcaktuara në nenin 29, të ligjit nr.9270, dt.29.07.2004 "*Për sistemin e adresave*", të ndryshuar, 4/mujori pare.
Akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2006 "*Për sistemin e adresave*", të ndryshuar Miratimi i Rregullave dhe Procedurave që do të ndiqen nga Prefekti i Qarkut, në rast mos përmbushje nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të detyrimeve të përcaktuara në nenin 29 të ligjit 9270, datë 29.07.2004 "*Për sistemin e adresave*", të ndryshuar.
Për standardizimin dhe rregullat për vendosjen e emrave të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve në RSH, 4/mujori pare. Akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2006 "*Për sistemin e adresave*", të ndryshuar, miratimi i rregullave standarde për vendosjen e emrave të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve në RSH, në zbatim të ligjit nr.9270, dt. 29.07.2004 "*Për sistemin e adresave*", të ndryshuar.
Për miratimin e Rregullores së Shërbimit MZSH, 4/mujori pare, Akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri*" dhe miratimi i rregullave për disiplinën, etiken, marrëdhëniet e punës të parashikuara në ligj, Disiplina, etika, marrëdhëniet e punës dhe çështje të tjera, sipas autorizimit ligjor.
Projektligj "*Për buxhetin e vitit 2020*", 4/mujori tretë, detyrim i ligjit 9936, datë 20.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", Përcaktimi i të ardhurave dhe Shpenzimeve të buxhetit vendor dhe financimi reformës së decentralizimit.
Projektligji "*Për mbrojtjen sociale në RSH*" 4/mujori pare, Për qartësimin e kompetencave të funksioneve të deleguara dhe rolin e NJQV për shërbimet dhe mbrojtjen sociale", Qartësimi i kompetencave të këshillit të bashkisë dhe të administratorëve të NE dhe të shërbimeve sociale në bashki, Prezantuar në KK datë 7.12.2018, por pa u diskutuar mendimet e Bashkive dhe Shoqatave vendore.
Sa më sipër AMVV megjithëse ka programuar projekt aktet, në lidhje me projektligjet, projektvendimet me Ministrinë e Brendshme, Ministritë e Linjës, si koordinator ndërmjet Pushtetit Qendror dhe Pushtetit Vendorë nuk i ka shqyrtuar në Këshillin Konsultativ.

<u>Nga auditimi u konstatua si vijon:</u>

1. Problematikat, nga sektorët dhe institucioni nuk është krijuar një sistem unik i përshtatshëm, për planifikimin vjetore të detyrave dhe objektivave, ku të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë. Kjo në mos përmbushje të kërkesave, siç parashikohet në pikën 8,9 të Ligjit nr. 10296, date 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar.
2. Hartimi dhe miratimi i rregullores, në Prill 2019, ka bërë që për periudhën e auditimit, 2017, 2018, nuk është siguruar sa dhe si duhet ngritja e komponentëve të MFK, e cila do të rriste

efektivitetin e punës për evidentimin e misionit dhe objektivave të njësisë, përcaktimit të përngjashmërisë dhe përgjegjësisë së menaxhereve, kërkesa të nenit 29 të ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*".

3. AMVV, propozimet lidhur me përmirësimet e akteve ligjore e nënligjore, rezulton se nuk ka bashkëpunuar me strukturën përkatëse të Ministrisë Brendshme për çështjet vendore (Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave), kërkesa këto të parashikuara në pikë "ç" dhe "f" të VKM Nr. 11, datë 12.01.2018, "*Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 83, datë 28.01.2015 "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për zbatimin e Reformës Territoriale*".

4. Gjatë realizimit të detyrës AMVV për propozimet lidhur me përmirësimet ligjore dhe nënligjore, pa kaluar në Këshillin Konsultativ, për dhënien e ndihmës, në shkëmbim të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projekt ligjet, të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, parashikuar në kreu II –të Parimet e Procesit të Konsultimit germa a,b,c dhe ç të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr. 910 datë 21.12.2016.

5. Përveç rezultateve të arritura për dhënien e ndihmesës për qeverisjen vendore dhe funksionimin e rolit koordinator ndërmjet qeverisjes qendrore me vetëqeverisjes vendore, Këshilli Konsultativ, nuk ka dalë me ndonjë vendim për krijimin me komisione këshillimi, si struktura ad-hoc për të mbuluar fusha dhe sektorë specifike, në zbatim të VKM nr. 910, datë 21.12.2016 Për çështjet Objekt Konsultimi dhe Strukturën , Procedurën, Formën, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore Kreu IV pika 23.

Titulli i Gjetjes:	*Nga AMVV, sektorët, nuk është krijuar një sistem unik i përshtatshëm për planifikimin vjetor të detyrave dhe objektivave përmes të cilit të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë.*
Situata 1:	- Nuk ka arritur të mbështesë sa duhet krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore, gjë e cila shprehet në mos përmbushjen e objektivit për funksionalizimin e zyrave unike të shërbimit (*One stop shop*), (nga 61 në 49 bashki) si dhe në mos realizimin e disa shërbimeve edhe në bashkitë në të cilat ka filluar zbatimi i projektit.
Situata 2:	-Nuk ka ndjekur hartimin e VKM-ve me bashkë propozim me ministritë e linjës lidhur me funksionet e reja të cilat janë deleguar Vetëqeverisjes Vendore, nuk ka realizuar takime bashkëpunimi me ato ministri të cilat kanë kaluar apo decentralizuar funksione të tyre në bashki të cilat, shërbimet e tyre do kalohen në zyrën "*One stop shop* ", apo që nuk kanë përmbushur detyrimet për aktet në zbatim,
Situata 3:	-Nuk ka organizuar një takim me kryetarët e bashkive apo një konferencë me të gjitha bashkitë, gjë e cila do t'i jepte mundësinë e krijimit të një datëbas-i për problematikat dhe përvojat sipas njësive vendore lidhur me funksionet e deleguara, krijimin e standardeve të tyre si një sistem unik kombëtar dhe të përmirësimeve të mëtejshme në legjislacionin përkatës

Situata 4:	-Në planin e veprimit apo planin e objektivave të AMVV, në Zbatim të Dokumentit Strategjik (2019-2020) nuk janë parashikuar kryerja e detyrave apo përgjegjësive të tilla: *-Vazhdimin e reformës administrative–territoriale me qëllim përfundimin e kufijve administrative dhe hartave përkatëse.* *-Vazhdimin e reformës së decentralizimit për përfundimin e transferimit të pyjeve dhe kullotave.* *-Konsolidimin e reformës në drejtim të decentralizimit për rrugët rurale, ujitjen e kullimin.* *-Informimin periodik për institucionet publike apo grupet e interesit.* *- Bashkëpunimin me Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave në MB për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të SKNDQV si dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në kuadër të integrimit në BE dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare.* *-Përgatitjen e raporteve periodike për ministrin lidhur me këto çështje.*
Situata 5:	Gjithashtu rezulton se në disa raste propozimet lidhur me përmirësimet ligjore dhe nënligjore nuk janë kaluar në Këshillin Konsultativ, për dhënien e ndihmës, në shkëmbim të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projekt ligjet, të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, parashikuar në kreu II-të Parimet e Procesit të Konsultimit germa a,b,c dhe ç të VKM Nr. 910, datë 21.12.2016.
Situata 6:	-Përveç rezultateve të arritura për dhënien e ndihmesës për qeverisjen vendore dhe funksionimin e rolit koordinator ndërmjet qeverisjes qendrore me vetëqeverisjes vendore, Këshilli Konsultativ, nuk ka dalë me ndonjë vendim për krijimin me komisione këshillimi, si struktura ad-hoc për të mbuluar fusha dhe sektorë specifike, në zbatim të VKM nr. 910, datë 21.12.2016 "*Për çështjet Objekt Konsultimi dhe Strukturën, Procedurën, Formën, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore*" Kreu IV pika 23.
Situata 7:	-Nga auditimi konstatohet se AMVV, për propozimet lidhur me përmirësimet e akteve ligjore e nënligjore, nuk ka bashkëpunuar me strukturën përkatëse të Ministrisë Brendshme për çështjet vendore (Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave), kërkesa këto të parashikuara në shkronjat " ç" dhe "f" të VKM Nr. 11, datë 12.01.2018, "*Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 83, datë 28.01.2015* "*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për zbatimin e Reformës Territoriale*".
Kriteri:	*Pika 8, 9 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pika "c" dhe "f" të VKM Nr.11, datë 12.01.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.83, datë 28.01.2015, të KM, "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale". VKM nr. 910, datë 21.12.2016 "Për çështjet Objekt Konsultimi dhe Strukturën, Procedurën, Formën, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore" Kreu IV pika 23.*
Ndikimi/Efekti	*AMVV, nuk ka arritur të mbështesë sa duhet krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore, duke mos realizuar disa shërbime edhe në bashkitë në të cilat ka filluar zbatimi i projektit.*

	Nuk ka ndjekur hartimin e VKM-ve me bashkë propozim me ministritë e linjës lidhur me funksionet e reja të cilat janë deleguar Vetëqeverisjes Vendore.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Nga ana e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Titullarit të Institucionit të merren masa për të bashkëpunuar me strukturën përkatëse të Ministrisë Brendshme për propozimet lidhur me përmirësimet e akteve ligjore e nënligjore për çështjet vendore (*Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave*). AMVV propozimet lidhur me përmirësimet e akteve ligjore dhe nënligjore, duhet ti kalojë më parë në Këshillin Konsultativ. Këshilli Konsultativ, të marrë vendime përkatëse për krijimin e komisioneve të këshillimit, si struktura ad-hoc për të mbuluar fusha dhe sektorë specifike, në dhënien e ndihmesës për qeverisjen vendore. - Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore të verifikojë se cilat funksione dhe kompetenca nuk kanë kaluar ende në pushtetin vendor sipas Ligjit "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe mbi këtë bazë të programohet dhe të bëhet kalimi i tyre në NjQV. - AMVV gjatë hartimit të VKM-ve me bashkë propozim me ministritë e linjës, lidhur me funksionet e reja të cilat janë deleguar Vetëqeverisjes Vendore, duhet të realizojë takime bashkëpunimi me ato ministri të cilat kanë kaluar apo decentralizuar funksione të tyre në bashki të cilat, shërbimet e tyre do kalohen në zyrën "One stop shop" -AMVV të marrë masat për krijimin e një database për problematikat dhe përvojat sipas njësive vendore lidhur me funksionet e deleguara, krijimin e standardeve të tyre si një sistem unik kombëtar dhe përmirësimeve të mëtejshme në legjislacionin përkatës.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	*Në vijimësi*

Aktin e Konstatimit nr. 8, dt. 27.12.2019 "Auditim mbi funksionimin e Këshillit Konsultativ për vitet 2017, 2018 dhe 2019".

<u>Komente dhe shpjegime:</u>
Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:

Për piken 3, 4, 5 mbi konstatimet për funksionimin e Këshillit Konsultativ mes Qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjen vendore (VKM nr.910, dt.21.12.2016 "Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedure, formën, mënyrën e organizimit dhe te funksionimit te Këshillit Konsultativ te qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar:

a) Për çdo projektet qe është paraqitur nga Ministritë sektoriale, ne lidhje me reformën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore dhe qe kane ndikim ne ushtrimin e te drejtave dhe funksioneve te njësive te vetëqeverisjes vendore, <u>AMVV ka dhënë mendimet përkatëse Ministrive propozues,</u> duke vene ne dijeni Ministrinë e Brendshme dhe Shoqatat Vendore, mendime te cilat janë paraqitur krahas mendimeve te bashkive, për shqyrtimin e tyre ne Këshillin Konsultativ, duke zbatuar VKM nr. 910, dt.21.12.2016, ndryshuar me VKM nr.751, dt.19.12.2018 dhe VKM nr.11, dt.12.01.2018.

Kjo pasi edhe KM nuk ka pranuar nga Ministritë propozues dhe Ministria e Brendshme asnjë projektet pa mendimin e Këshillit Konsultativ te qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore.

b) *Për projektaktet e paraqitura nga Ministritë, qe nuk kane ndikim ne ushtrimin e te drejtave dhe funksioneve te njësive te vetëqeverisjes vendore, është zbatuar VKM nr. 910, dt. 21.12.2016, me ndryshimet, duke dhënë mendimet drejtpërdrejt propozuesve.*

Ne lidhje me konstatimin qe AMVV ka programuar projektaktet, qe ne zbatim te VKM përkatës do te shqyrtohen nga KM, por jo te gjithë projektaktet janë shqyrtuar dhe konsultuar ne Këshillin Konsultativ, sqarojmë se: Jo te gjithë projektaktet e parashikuara nga KM dhe ne tabelën përkatëse te AMVV duhet te paraqiten për shqyrtim dhe konsultim ne Këshillin Konsultativ.

Konsultimi për projektaktet e shqyrtuara eshte bere paraprakisht nga shoqatat vendore me ministritë sektoriale ne takime te organizuara ne nivel rajonal etj nga AMVV ne bashkëpunim te Ministritë dhe Shoqatat Vendore dhe Donatore qe zbatojnë projekte ne fushën e reformës se decentralizimit. Drejtuesit e Shoqatave Vendore kane dhënë mendimet e tyre për projektaktet ne çdo mbledhje te KK, ose janë shprehur dakort.

AMVV ka informuar periodikisht Ministrinë e Brendshme per zbatimin e reformes administrative-territoriale dhe te decentralizimit dhe ka marre pjese ne vlerësimin e ecurisë se procesit ne bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, duke paraqitur edhe shqetësimet e bashkive.

AMVV ka dhënë kontributin e saj për nxitjen dhe shpejtimin afateve te zbatimit te objektivave te reformës se decentralizimit dhe vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet bashkëpunimit për hartimin e projektvendimit "Për miratimin e Planit të Veprimit 2019 – 2022, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015 – 2020".

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar me shkresën nr. 147 datë 30.04.2020 grupi i auditimit i jep komentet dhe shpjegimet si më poshtë:

Nga auditimi është konstatuar se AMVV, nuk ka arritur të mbështesë sa duhet krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore, duke mos realizuar disa shërbime edhe në bashkitë në të cilat ka filluar zbatimi i projektit. Nuk ka ndjekur hartimin e VKM-ve me bashkë propozim me ministritë e linjës lidhur me funksionet e reja të cilat janë deleguar Vetëqeverisjes Vendore. Për sa më lart grupi i auditimit ka bërë rekomandimet përkatëse.

7. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.

Nga Titullari i njësisë publike si janë vendosur, përmbushur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*".

Sipas programit të auditimit të Ministrisë Brendshme nr. 965/2, datë 11.03.2019, "*Për auditimin e kombinuar (përputhshmërie dhe financiar) në Agjencinë Mbështetëse të Vetëqeverisjes Vendore*", është audituar për aktivitetin e vitit 2018 dhe përfundimet e auditimit janë pasqyruar në Raportin Final të Auditimit, dërguar kësaj Agjencie me shkresën e Ministrisë Brendshme nr.965/6, datë 13.05.2019, ku në përfundim të tij janë **rekomanduar 9 masa organizative**. Duke qenë se për aktivitetin e vitit 2019 afati i paraqitjes së deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm është deri më datën 28.02.2020, KLSH për efekt mbivendosje nuk e trajtoi këtë pikë, duke qenë dakord me gjetjet dhe rekomandimet e Njësisë Auditit të brendshëm trajtuar në faqe 7-13 të këtij Raporti.

Nga verifikimi i grupit të auditimit të KLSH, rezultoi se për zbatimin e 9 rekomandimeve të lëna nga drejtoria e Auditit të brendshëm publik të Ministrisë Brendshme nga ana e Agjencisë për mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore me shkresën nr. 137/5, datë 27.05.2019 është hartuar dhe dërguar Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve ku pjesa me e madhe e tyre janë zbatuar, ndërsa një pjesë janë në proces zbatimi.

Agjencia ë ishte krijuar dhe funksiononte pa u pajisur me rregullore të brendshme e cila pas auditimit dhe rekomandimet nga Ministria e Brendshme, me urdhrin e Ministrit Brendshëm nr. 378, datë 19.04.2019 ishte miratuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të administratës të Agjencisë Mbështetëse të Vetëqeverisjes Vendore, duke u zbatuar rekomandimi i lënë dhe konkretisht: Me qëllim përmbushjen e përgjegjshmërisë menaxhimi i

Agjencisë të hartojë dhe miratojë të titullari i Ministrisë Rregulloren e Brendshme të njësisë. Neni 29, i ligjit nr. 90/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"*.

Po kështu ishin në proces zbatimi apo ishin zbatuar edhe rekomandimet e mëposhtme:

1- Hartojë e miratojë procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
2 -Të ruajtjes dhe administrimit të aktiveve e dokumentacionit;
3-Listën e proceseve të punës dhe të aktiviteteve të kontrollit;
4-Procedurat e funksionimit të informimit dhe monitorimit të sistemit të MFK, si dhe Regjistrin e Riskut;

Sa sipër, mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 16-Vlerësimi i sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm, ku përcaktohet se:

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në ushtrim të kompetencave të tij, vlerëson funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm në organet subjekte të auditimit, duke dhënë, sipas rastit, opinionet dhe rekomandimet e duhura.

2. Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij, dhe pa cenuar të drejtën për të kryer vetë auditimet, Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të përdorë gjetjet e auditimeve të kryera nga organe të tjera audituese.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit i merr në konsideratë këto gjetje, vetëm në rast se standardet e përdorura për këto auditime janë në përputhje me standardet e veta dhe ato ndërkombëtare të auditimit.

Grupi i auditimit merr në konsideratë vetëm gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me menaxhimin financiar të trajtuar faqe 7-13 bashkëlidhur Raportit Final të Auditimit, përcjellë Agjencisë Mbështetëse e Vetëqeverisjes Vendore me shkresën e Ministrisë Brendshme nr. 965/2, datë 11.03.2019, "*Për auditimin e kombinuar (përputhshmërie dhe financiar*)" .

Aktin e Konstatimit nr. 1, dt. 26.12.2019 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

8. Mbi fondet e përfituara nga grantet apo projektet të financuara nga donatorë të ndryshëm.

Marrëveshja kuadër në lidhje me Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Ndihmën Humane dhe ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë Shqiptare, të nënshkruar më datën 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 9801 të datës 13 shtator 2007. Qëllimin e projektit, *është ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për qytetarët dhe zhvillimin lokal, përmirësimin e shërbimeve, forcimin e kapaciteteve, qëndrueshmëria e produkteve dhe kuadri ligjor*.

Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për zhvillim (SDC) dhe Bashkëpunimi i Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme e përfaqësuar nga "*Helvetas Swis Intercooperation*" si organizatë zbatuese. Qeveria e Republikës së Shqipërisë përfaqësohet nga Zyra e Zëvendës Kryeministrit.

Sipas marrëveshjes mbi programin për decentralizimin dhe zhvillimin lokal për fazën e tretë janar 2014 deri dhjetor 2017 neni 4 pika e dhe marrëveshjes mbi programin për decentralizimin dhe zhvillimin vendor për fazën e pestë janar 2018 deri 30 qershor 2019 neni 5 pika b janë vënë në dispozicion alokimet e nevojshme buxhetore për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar për projektin në një shumë maksimale prej CHF 777,966 (franga zvicerane).

Likuiduar TVSh në vlerën **58,609,454** lekë sipas Urdhër Shpenzimeve:

Urdhër shpenzimi		Faturat tatimore	Totali (Përfshirë TVSH)	TVSH
Nr.	Datë			
118	22.11.2016	Janar – Dhjetor 2014 Janar – Dhjetor 2015	54,431,949	9,064,509
139	22.12.2016	Janar – Dhjetor 2016	50,383,200	10,076,640
44	26.04.2019	Dhjetor 2016 – Mars 2017	60,043,542	10,000,000
62	29.05.2019	Mars – Gusht 2017	60,728,474	10,000,000
75	25.06.2019	Shtator – Dhjetor 2017	59,942,054	10,000,000
105	16.09.2019	Janar – dhjetor 2018	42,881,990	8,576,395

120	22.10.2019	Janar – Qershor 2019	4,459,550	891,910
	Totali		**332,870,759**	**58,609,454**

Dokumentet e paraqitura nga "*Helvetas Swis Intercooperation"* si organizatë zbatuese bashkëngjitur Urdhër Shpenzimeve janë:

1. Marrëveshja mbi programin për decentralizimin dhe zhvillimin lokal për fazën e tretë janar 2014 deri dhjetor 2017.
2. Programi për decentralizimin dhe zhvillimin lokal për fazën e tretë janar 2014 deri dhjetor 2017.
3. Marrëveshjes mbi programin për decentralizimin dhe zhvillimin vendor për fazën e pestë janar 2018 deri 30 qershor 2019.
4. Programi për decentralizimin dhe zhvillimin vendor për fazën e pestë janar 2018 deri 30 qershor 2019.
5. Faturat tatimore origjinale dhe përmbledhësja e tyre.
6. Raportet vjetore të projektit për decentralizimin dhe zhvillimin lokal;
7. Raportet vjetore të auditimit për decentralizimin dhe zhvillimin lokal.

Sa më lart në mbështetje të UMF nr. 6, dt. 30.01.2015 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"*, Neni 63 nga AMVV është likuiduar vlera e TVSH-së prej 58,609,454 lekë.

9. Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme:

Me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 146, date 28.09.2018, dërguar Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore me shkresën nr. 98/25 Prot. datë 07.10.2018, Departamenti i Auditimit të Performancës ka dërguar Raportin përfundimtar dhe bazuar në shkresën nr. 98/25, Prot. datë 07.10.2018, dërguar Agjencisë për Mbështetjen e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 3 rekomandime **për tu zbatuar deri në fund të 3-mujorit të parë të vitit 2019.**

Për këto rekomandime Ministria e Brendshme nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Dritan Palnikaj, me shkresën nr. 8297/2, datë 02.11.2018 dërguar Agjencisë për Mbështetjen e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, "*Për njohje dhe zbatim'', ku tekstualisht shkruhet: Bashkëlidhur ju përcjellim për njohje e zbatim, Raportin Përfundimtar të auditimit të Performancës me objekt "Funksionimi i bashkive në kuadër të reformës administrativo territoriale të grupit të auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës në KLSH. Në Raportin përfundimtar të auditimit të performancës, grupi auditues i KLSH ka dhënë disa rekomandime, duke vendosur afate për realizimin e tyre me qëllim përmirësimin e situatës dhe marrjen e masave konkrete në realizimin e objektivave kryesore të Reformës Administrative-Territoriale.*

Për sa më sipër kërkohet nga ana e Juaj, të merren masa për zbatimin brenda afateve të rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave, për hartimin e planit përkatës dhe përcjelljen pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga verifikimi rezulton se deri më datën 26.12.2019, Agjencia për Mbështetjen e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore nuk ka hartuar Plan-Veprimin dhe nuk i ka kthyer përgjigje KLSH-së, sipas shkresës dhe porosisë Ministrisë së Brendshme, dhe 3 rekomandimet e KLSH, deri më datën 26.12.2019, nuk janë zbatuar, prandaj ***rikërkojmë*** edhe njëherë zbatimin e tyre duke njoftuar Ministrinë e Brendshme dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit si më poshtë:

Rekomandimin nr. 2.

Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore të verifikojë se cilat funksione dhe kompetenca nuk kanë kaluar ende në pushtetin vendor sipas Ligjit "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" dhe mbi këtë bazë të programohet dhe të bëhet kalimi i tyre në NjQV.

Rekomandimi nr.

3.Ministria e Punëve të Brendshme t'i vendosë një afat kalendarik Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore që të raportojë të paktën 1 herë në vit mbi zbatimin e reformës administrative-territoriale dhe mbi problematikat që ndeshin bashkitë, raporte të cilat të paraqiten në Nënkomisionin për Çështjet Vendore në Kuvendin e Shqipërisë.

Rekomandimi nr. 4.

Ministria e Punëve të Brendshme t'i propozojë Këshillit të Ministrave ndryshimin e VKM-së nr. 910, datë 21.12.2016 mbi përbërjen e Këshillit Konsultativ, ku 2/3 e anëtarëve të jenë përfaqësues të pushtetit vendor (aktualisht zënë 1/2 e anëtarëve) dhe çdo vendim-marrje e Këshillit Konsultativ, në mbështetje ose jo të projektakteve të propozuara të qeverisjes qendrore, të merret me shumicë të votave (jo me konsensus).

Për mos raportimin në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, brenda **afatit prej 6** muaj nga data e njoftimit(dërgimit) të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mban përgjegjësi **z. B.M.**, drejtor i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, pasi përfundimet e auditimit i janë dërguar me shkresën e Kryetarit të KLSH shkresën nr. 98/25, Prot. datë 07.10.2018 dërguar Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Për këto rekomandime Ministria e Brendshme, me shkresën nr. 8297/2, datë 02.11.2018 nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Dritan Palnikaj i është dërguar Agjencisë për Mbështetjen e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, "*Për njohje dhe zbatim''.* Deri në datën 24.02.2019, nuk është raportuar në KLSH duke shkelur afatin për të cilën duhet të raportonte për realizimin e programit dhe rekomandimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.*

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Në përfundim të auditimin rezultuan gjetje me rekomandimet përkatëse si më poshtë vijon:

A. MASAT ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin, detajimin, rishpërndarjen dhe realizimin e fondeve buxhetore nëse është në përputhje me kriteret e paracaktuara, kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi rezultoi se:

- Gjatë viteve buxhetore kërkesat për rishpërndarje fondesh nga AMVV, jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, në përputhje me kriteret e paracaktuara në udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 me ndryshime;
- Janë kryer rishpërndarje fondesh gjatë vitit ushtrimor, transferimet e fondeve për investime (*fondet për investime shtuar në vitin 2016 në vlerën 78,454,150 lekë*), ku u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve. Kjo tregon gjithashtu, për një performancë jo të mirë të planifikimit të buxhetit, referuar kritereve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012.
-Nga auditimi rezulton se janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhat e fundit të vitit ushtrimor, gjë e cila shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të arkës, që është një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.
- Urdhër Shpenzimet (13) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2015 në vlerën totale 4,655,856 lekë.
- Urdhër Shpenzimet (10) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2016 në vlerën totale 77,786,967 lekë.
- Urdhër Shpenzimet (11) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2018 në vlerën totale 3,078,422 lekë.

- Urdhër Shpenzimet (16) me vlerat mbi materialitetin e përcaktuar të kontabilizuara në ditarin e bankës për muajt nëntor, dhjetor 2015 në vlerën totale 1,814,108 lekë.
(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1 (një) faqe 14 – 27 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të marrë masa planifikimin, detajimin, rishpërndarjen dhe realizimin e fondeve buxhetore duke i shoqëruar me analiza, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Komisionet e Inventarizimit të Aktiveve për vitet 2017 dhe 2018, gjatë procesit të inventarizimit nuk kanë përpiluar proces verbalet përkatëse të verifikimit fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë. Gjithashtu në komisionin e inventarizimit ka marrë pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin në kundërshtim me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* pika 82, 83. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 2 (një) faqe 49 – 51 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga Komisionet e Inventarizimit të Aktiveve të merren masat që gjatë procesit të inventarizimit të hartojnë proces verbalet përkatëse të verifikimit fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë.
- Gjithashtu Titullari i Agjencisë të merren masat që në komisionet e inventarizimit të mos marrin pjesë punonjësit që kanë në ngarkim/përdorim aktivin pas nuk duhet të ketë konflikt interesi, por ata duhet të jenë të pranishëm kur bëhet inventarizimi i aktiveve.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditmi: Nga auditimi u konstatua se në pasqyrat e performancës financiare për vitet 2017 dhe 2018 janë njohur gabimisht si të ardhura detyrimi i tatimit mbi të ardhurat personale në vlerën 1,064,246 lekë dhe detyrimi nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 3,908,619 lekë. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 2 (dy) faqe 54 – 55 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga ana AMVV, Sektori i Financës të merren masa për të sistemuar në pasqyrat financierë të vitit 2019 vlerën e paraqitur gabimisht si të ardhura në pasqyrën e performancës financiare, tatimin mbi të ardhurat personale në vlerën 1,064,246 lekë dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 3,908,619 lekë.

Me mbylljen e Bilancit 2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve operative, shërbime udhëtimi e dieta për vitin 2017 në vlerën 6,413,347 lekë, vitin 2018 në vlerën 6,391,290 lekë dhe vitin 2019 në vlerën 5,552,839 lekë rezultoi se urdhër shpenzimet janë shoqëruar me autorizimin me shkrim nga drejtori përgjithshëm por në disa raste rezulton se: nuk ishin të shoqëruara me programe pune, relacion apo raportime shoqëruar edhe me dokumentacionin e mbajtur në njësitë vendore sipas objektit të shërbimit, faturat e fjetjes në hotel nuk janë nënshkruar nga personi i cili ka qenë me shërbim dhe dërgimi i personave me shërbim është bërë pa patur parasysh fushën që mbulon, kërkesa sipas VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "*Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës se punës brenda vendit"*. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1 (një) faqe 36 – 37 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga ana AMVV, Sektori i Financës, të merren masat që urdhër shpenzimet për likuidimin e shërbimeve për udhëtim e dieta të shoqërohen me faturat tatimore të

nënshkruara nga nëpunësi udhëtues dhe një raport i hollësishëm për objektin dhe qëllimin e shërbimit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: AMVV për periudhën objekt auditimi, për transportin e punonjësve ka në funksion 3 automjete autovetura, por në strukturën e saj nuk ka drejtues mjeti (shofer) dhe automjetet drejtohen nga punonjësit e Agjencisë pa nënshkruar secili për sasinë e karburantit të harxhuar konkretisht:

-Mjeti tip Hyndai me targë AA401 MF më datën 27.12.2019, paraqet 167,540 km.
-Mjeti tip FORD, me targë AA694 AG më datën 27.12.2019 paraqet 150,182 km.
-Mjeti tip TOJOTA, me targë AA781 PM më datën 27.12.2019 paraqet 78,029 km.

Për këto 3 mjete janë harxhuar mesatarisht 611 litra në muaj në vlerën **3,079,742** lekë, por nuk mund të evidentohen harxhimet për secilin mjet, pasi janë përdorur nga punonjës të ndryshëm. Gjithashtu nga auditimi rezultoi se për vitet 2017-2018 Fletë Daljet e karburantit priteshin jo në fund të muajit dhe nuk bëhej rakordimi ndërmjet km të përshkruara, shënimit të matësit dhe sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina dhe harxhimin nga secili mjet.

Në disa raste Fletë daljet e magazinës karburantit, nuk nënshkruhen nga personi i cili ka tërhequr karburantin, por procedohet në bazë të një përmbledhëse, dhe në disa raste në fletë daljet e karburantit ishin nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Analizës dhe Mbështetjes Institucionale e cila kryen edhe funksionin e nëpunësit zbatues (Financës). Ndërkohë për administrimin e gomave nuk disponohen normativa të miratuara për kilometrat e përshkuara. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1 (një) faqe 37 – 40 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga AMVV, Sektori i Analizës dhe Mbështetjes Institucionale të merren masat që Fletë Daljet e harxhimit të karburantit të priten veçmas për secilin automjet në fund të çdo muaji duke u nënshkruhen nga personat udhëtues të cilët kanë përdorur kartën e tërheqjes së karburantit duke i bashkëlidhur kuponët e nxjerrë nga kasa fiskale.
- Për secilin mjet në fund të muajit të plotësohen fletët e udhëtimit të bëhet rakordimi me km e përshkruara, normativat e miratuara duke shënuar edhe numrin e matësit. Gjithashtu të merren masat për miratimin e normativave të harxhimit të gomave sipas Tipeve/Markave dhe km/përshkruara, etj.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i strukturës dhe organikës së AMVV–së e cila përcaktohet me Urdhër të Kryeministrit (përkatësisht nr. 68, datë 05.05.2015, "*Për miratimin e strukturës së Agjencisë së zbatimit të Reformës Territoriale*", ka qenë me 12 punonjës dhe nr. 82, datë 12.05.2016, janë shtuar edhe 2 punonjës,) nga muaji Maj 2016 e në vazhdim për vitet 217, 2018 dhe 2019, Struktura dhe organika e AMVV-së, aktualisht përbëhet mesatarisht në vit nga 14 punonjës dhe 3 punonjës me kontratë provizore të inkuadruar në 2 sektorë.

Nga verifikimi i listë pagesave më datën 31.12.2017 datën 31.12.2108 dhe datën 30.09.2019 rezulton se në total organika është zbatuar, por konstatohet se në Sektorin e Analizës & Mbështetjes Institucionale nga 4 punonjës të parashikuar, në fakt në total janë 4 punonjës, por në 1 rast nuk është ruajtur struktura e parashikuar në urdhrin e kryeministrit, pasi specialisti i Financës është zëvendësuar me një specialist tjetër jo të profilit Financë, në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 82, datë 12.05.2016. Mungesa e personelit të nevojshëm kontabël dhe të raportimit financiar ndikon në rritjen e riskut operacional. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 3 (tre) faqe 69 – 71 të Raportit të Auditimit).*

- Nga auditimi rezulton se më urdhër të drejtorit të përgjithshëm, z. B.M. janë emëruar në punë 5 punonjës (*pa përcaktuar asnjë kriter apo kërkesë, si konkurrim, shpallje të vendeve vakant etj*) dhe pa u marrë zyrtarisht (*me shkrim*) miratimin e Ministrit për Çështjet Vendore, duke përfituar pagën nga periudha e emërimit deri më datën 30.11.2019, në shumën prej 4,819,325 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar me VKM nr. 11, datë

12.01.2018, pika 8 ku përcaktohet se: *"Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Ata emërohen, lirohen ose shkarkohen nga drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore". (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 3 (tre) faqe 69 – 76 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të merren masa që Sektori i Analizës & Mbështetjes Institucionale, (ku bën pjesë edhe zyra e financës), të plotësohet me 1 (një) punonjës specialist finance, kjo brenda numrit total të punonjësve të miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 82, datë 12.05.2016 "*Për miratimin e strukturës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore".*
- Nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të merren masat që për 5 punonjësit në Sektorin e Koordinimit me Qeverisjen Vendore, të cilët nuk janë miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet vendore, të merret miratimi zyrtar (me shkrim) nga Ministri i Brendshëm, siç përcaktohet në VKM nr. 83, datë 28.01.2015 "*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore"* i ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.01.2018, pika 8, në të kundërtën të pezullohen pagesat deri në marrjen e miratimit.

Brenda datës 30.06.2020

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se te kolona Emërtesa sipas strukturës së miratuar vendosej vetëm shkurtimi i emrit Agjencisë (AMVV), dhe jo pozicionet zyrtare të secilit punonjës (*detyra funksionale*).

Nga përgjegjësit e sektorëve çdo muaj, hartohen Listë prezencat e paraqitjes në punë të punonjësve për secilën datë, të cilat nënshkruhen nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues, ndërkohë që listë pagesat nuk nënshkruhen edhe nga punonjësi i ngarkuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"* i ndryshuar, pika 69, "*Listë pagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij". (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 3 (tre) faqe 69 – 76 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga AMVV, Sektorët përkatës dhe punonjësi i ngarkuar me menaxhimin e burimeve njerëzore të marrin masat për respektimin e kritereve ligjore në hartimin e Listë prezencave të paraqitjes në punë të punonjësve, listë pagesave me emërtesat sipas strukturës së miratuar, dhe pozicionet zyrtare të çdo punonjësi.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nga specialisti i ngarkuar më personelin, janë hapur dosjet e personelit për 14 punonjësit, të cilat përgjithësisht përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm, por nuk janë të sistemuara si përcaktohet në kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes së personelit dhe Regjistrit Qendror të Personelit"* konkretisht:

1) Dosjet e personelit janë të pajisura me fletë inventarin për çdo dosje, por nuk janë të nënshkruar nga punonjës dhe specialist i ngarkuar me administrimin e dosjes së personelit, në të cilin duhet të jetë pasqyruar i gjithë dokumentacioni që ndodhet në dosje dhe shtesat apo ndryshimet përkatëse, si vendosja e shkresave për marrjen e masave disiplinore, kualifikimet etj.

2) Mungon fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit me mbi 21 kërkesat e tyre.

3) Mungon Certifikata e gjendjes familjare. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 3 (tre) faqe 69 – 76 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

- Nga specialisti i ngarkuar me personelin të merren masat për plotësimin e 14 dosjeve të punonjësve me inventarët përkatës të nënshkruar nga secili duke u plotësuar me 21 kërkesat dhe dokumentacionin e përcaktuar në VKM nr.117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes së personelit dhe Regjistrit Qendror të Personelit".*

Brenda datës 30.06.2020

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se AMVV, për propozimet lidhur me përmirësimet e akteve ligjore e nënligjore, nuk ka bashkëpunuar me strukturën përkatëse të Ministrisë Brendshme për çështjet vendore (Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave), kërkesa këto të parashikuara në shkronjat " ç" dhe "f" të VKM Nr. 11, datë 12.01.2018, "*Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 83, datë 28.01.2015 "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për zbatimin e Reformës Territoriale".*

- Në planin e veprimit apo planin e objektivave të AMVV, në Zbatim të Dokumentit Strategjik (2019-2020) nuk janë parashikuar kryerja e detyrave apo përgjegjësive të tilla:

-Vazhdimin e reformës administrative–territoriale me qëllim përfundimin e kufijve administrative dhe hartave përkatëse.

-Vazhdimin e reformës së decentralizimit për përfundimin e transferimit të pyjeve dhe kullotave.

-Konsolidimin e reformës në drejtim të decentralizimit për rrugët rurale, ujitjen e kullimin.

-Informimin periodik për institucionet publike apo grupet e interesit.

-Bashkëpunimin me Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave në MB për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të SKNDQV si dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në kuadër të integrimit në BE dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare.

-Përgatitjen e raporteve periodike për ministrin lidhur me këto çështje.

- Gjithashtu rezulton se në disa raste propozimet lidhur me përmirësimet ligjore dhe nënligjore nuk janë kaluar në Këshillin Konsultativ, për dhënien e ndihmës, në shkëmbim të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projekt ligjet, të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, parashikuar në kreu II-të Parimet e Procesit të Konsultimit germa a,b,c dhe ç të VKM Nr. 910, datë 21.12.2016.

- Këshilli Konsultativ, nuk ka krijuar komisione këshillimi, si struktura ad-hoc për të mbuluar fusha dhe sektorë specifike, në zbatim të VKM nr. 910, datë 21.12.2016 "*Për çështjet Objekt Konsultimi dhe Strukturën, Procedurën, Formën, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore*" Kreu IV pika 23[2]. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 6 (gjashtë) faqe 112 – 123 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga ana e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Titullarit të Institucionit të merren masa për të bashkëpunuar me strukturën përkatëse të Ministrisë Brendshme për propozimet lidhur me përmirësimet e akteve ligjore e nënligjore për çështjet vendore (*Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave*).
- AMVV propozimet lidhur me përmirësimet e akteve ligjore dhe nënligjore, duhet ti kalojë më parë në Këshillin Konsultativ.
- Këshilli Konsultativ, të marrë vendime përkatëse për krijimin e komisioneve të këshillimit, si struktura ad-hoc për të mbuluar fusha dhe sektorë specifike, në dhënien e ndihmesës për qeverisjen vendore.

[2] Mbështetur në **ISSAI 1610** "*Përdorimi i punës së Audituesve të Brendshëm".*

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: AMVV, sektorët, nuk kanë krijuar një sistem unik të përshtatshëm për planifikimin vjetor të detyrave dhe objektivave përmes të cilit të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë. Kjo konstatohet në përdorimin e formateve me të dhëna të ndryshme të përdorura nga sektorët dhe Agjencia, në mos koordinimin mes tyre si dhe duke mos përfshirë në planin vjetor disa detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme, në kundërshtim me pikën 8, 9 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

- Hartimi dhe miratimi i rregullores me vonesa, (Prill 2019), ka bërë që për periudhën e auditimit, 2017, 2018, nuk është siguruar sa dhe si duhet ngritja e komponentëve të MFK, e cila do të rriste efektivitetin e punës për evidentimin e misionit dhe objektivave të njësisë, përcaktimit të përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së menaxhereve. Kjo ka ardhur si rezultat i mos përmbushjes së përgjegjshmërisë nga menaxhimi i lartë duke mos realizuar detyrimin e parashikuar në nenin 29 të ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*". *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5 (pesë) faqe 104 – 112 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, sektorët, të krijohet një sistem unik i përshtatshëm për planifikimin vjetor të detyrave dhe objektivave përmes të cilit të përcaktoheshin prioritetet, qëllimet, aktivitetet dhe produktet e veprimtarisë, në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: AMVV, nuk ka arritur të mbështesë sa duhet krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore, gjë e cila shprehet në mos përmbushjen e objektivit për funksionalizimin e zyrave unike të shërbimit (One stop shop), (nga 61 në 49 bashki) si dhe në mos realizimin e disa shërbimeve edhe në bashkitë në të cilat ka filluar zbatimi i projektit.

- Nuk ka ndjekur hartimin e VKM-ve në bashkë propozim me ministritë e linjës lidhur me funksionet e reja të cilat u janë deleguar Vetëqeverisjes Vendore, nuk ka realizuar takime bashkëpunimi me ato ministri të cilat kanë decentralizuar funksione, kaluar e shërbime të tyre në bashki të cilat, do kalohen në zyrën "*One stop shop* ".
- Nuk janë organizuar takime me kryetarët e bashkive apo konferenca me bashkitë, gjë që ka sjellë mungesën e një database për problematikat dhe përvojat sipas njësive vendore lidhur me funksionet e deleguara, krijimin e standardeve të tyre si një sistem unik kombëtar dhe përmirësimeve të mëtejshme në legjislacionin përkatës. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 6 (gjashtë) faqe 112 – 123 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore të verifikojë se cilat funksione dhe kompetenca nuk kanë kaluar ende në pushtetin vendor sipas Ligjit "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" dhe mbi këtë bazë të programohet dhe të bëhet kalimi i tyre në NjQV.
- AMVV gjatë hartimit të VKM-ve me bashkë propozim me ministritë e linjës, lidhur me funksionet e reja të cilat janë deleguar Vetëqeverisjes Vendore, duhet të realizojë takime bashkëpunimi me ato ministri të cilat kanë kaluar apo decentralizuar funksione të tyre në bashki të cilat, shërbimet e tyre do kalohen në zyrën "*One stop shop*"
- AMVV të marrë masat për krijimin e një database për problematikat dhe përvojat sipas njësive vendore lidhur me funksionet e deleguara, krijimin e standardeve të tyre si një sistem unik kombëtar dhe përmirësimeve të mëtejshme në legjislacionin përkatës.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi:

a. Në procedurën e prokurimit "*Blerje pajisje Hardware, Software, instalim, mirëmbajtje, trajnim të përdoruesve për 1 vit*", me fond limit 150,300,000 lekë pa TVSH me procedurë prokurimi "*Tender i Hapur*" **sipas** procesverbalin nr.523 prot, datë 25.02.2016 të mbajtur KVO rezulton se kanë marrë pjesë në konkurrim 6 OE dhe janë skualifikuar:

1- "C...",
2- "I...",
3- "T.D.",
4- BOE "**B... & S...**" (*pasi OE B... konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit se është bashkuar duke krijuar BOE me operatorin S...*) me ofertë 149,595,125 lekë pa TVSH pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, KVO ka njoftuar OE në rrugë elektronike në SPE mbi skualifikimin e tyre për mos plotësim të specifikimeve teknike kërkuar në shtojcën 10 të DT.
5- "**I...**" me vlerë oferte 136,842,475 lekë pa TVSH, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, KVO ka njoftuar OE në rrugë elektronike në SPE mbi skualifikimin e tyre për mos plotësim të specifikimeve teknike kërkuar në shtojcën 10 të DT.

Për operatorin "**S...**" KVO nuk është shprehur.

b. Nga auditimi i ushtruar nga audituesit e KLSH për këtë procedure prokurimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe dosjen fizike, konstatohet se në faqen elektronike shfaqen në sistem 6 Operatorë Ekonomikë:

1. *"I..."*;
2. *"B...& S..."*;
3. *"I..."*;
4. *"T.D."*;
5. *"C..."*;
6. *"S..."*;

Nisur nga mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e kërkuar për tender, ky operator "**S...**" duhej të ishte skualifikuar si operator që garon me një ofertë dhe jo kur bashkohet me ofertën e operatorit B... (shqyrtuar më poshtë) si një bashkim i përkohshëm operatorësh ekonomikë, pasi bazuar në nenin 63, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", citohet "*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative*", pavarësisht faktit që në fund të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave si pjesëmarrës në BOE, KVO-ja ka vendosur skualifikimin e saj.

Në lidhje me Vendimin e KVO, BOE "B... & S..." dhe "I..." kanë bërë ankim pranë Autoritetit Kontraktor i cili nuk ka marrë parasysh ankesat e tyre e ndodhur në këto kushte ato i janë drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).

KPP me vendimin nr.298/2016 datë 05.05.2016 ka vendosur:

- të mos pranojë ankesën e OE "I..."
- <u>të pranojë ankesën e BOE "B... & S..."</u>
- <u>të anulojë vendimin e KVO mbi skualifikimin e BOE dhe të korrigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator ekonomik me vlerë ofertë 149,595,125 lekë pa TVSH.</u>

Operatori "**S...**" ka marrë pjesë në tender me dy oferta njëherë si operator i vetëm dhe njëherë si Bashkim operatorësh "**B... & S...**" <u>*si rezultat kualifikimi i BOE "B... & S..." nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është në kundërshtim*</u> me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", nenin 63, pika 3 "*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative*". *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 4 (katër) faqe 74 – 84 të Raportit të Auditimit).*

13. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla për "*Blerje kancelari*" me fondin limit 427,155 lekë pa TVSH, komisioni në ftesën për ofertë komisioni ka miratuar kritere kualifikimi për OE të cilat kanë të bëjnë me "*Paraqitjen nga OE i klasifikuar*

i pari, të mostrave të mallit të kërkuar nga AK të shoqëruar me certifikatën e cilësisë së produkteve". Kriteret e kërkuara në ftesën për ofertë "*Paraqitja nga OE i mostrave të mallit*" edhe pse nuk duhet të kërkohen në ketë procedurë sipas pikës 8 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 01.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës me vlere të vogël*" i ndryshuar, komisioni nuk ka dokumentuar në proces verbal paraqitjen nga OE i shpallur fitues të mostrave të mallit dhe njëkohësisht komisioni nuk ka kërkuar dhe administruar paraqitjen nga subjekti fitues të "*Vërtetimit nga OSHE për pagesën e detyrimeve*" si dhe "*Kontratave të ngjashme të realizuara me parë nga subjekti".*

- Në procedurën e prokurimit për blerje me vlera të vogla "*Mirëmbajtje ambientesh të jashtme*" me fondin limit 620,000 lekë pa TVSH, pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr.818/5, datë 24.12.2018, është paraqitur nga sektori shërbimeve kërkesa për anulim procedure me arsyen se, "*Koha e realizimit të shërbimit nuk është e mjaftueshme*". Me këtë kërkesë titullari AK ka miratuar formularin e njoftimit të anulimit të procedurës bazuar në kërkesën e sektorit të shërbimeve pa bërë argumentimin ligjor të anulimit të procedurës ndërkohë që po nga ky sektor është kërkuar dhe miratuar nga titullari AK, prokurimi i fondit për nevojën e kryerjes së këtij shërbimi.

- Komisioni i prokurimit me vlera të vogla dhe titullari AK, në 8 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla për vitet 2018 dhe 2019 kanë s'kualifikuar ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedurë me argumentin se, "*Ofertat janë anomalisht të ulëta*" në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr.3, datë 08.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla të zhvilluar me mjete elektronike* " i ndryshuar pika 10 duke sjellë një dëm ekonomik në vlerën 800,710 lekë.

- Në procedurën e prokurimit "*Rikonstruksion godine",* e llojit "*blerje me vlerë të vogël*", me fond limit 796,750 lekë pa TVSH realizuar në vitin 2015 konstatohet se, me VKM nr.276, datë 01.04.2015 "*Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes ….Agjencisë së Zbatimit të Reformës territoriale (AZRT)*" të ndryshuar AMVV-së i është dhënë në përdorim holl në katin e shtatë të ish shtëpisë së ushtarakëve.

Para fillimit të procedurës së prokurimit Ish titullari i AZRT z. A.S. për fillimin e punimeve të rikonstruksionit nuk ka marrë leje ndërtimi apo nuk ka depozituar deklaratë paraprake për kryerje punimesh në organin përkatës-bashki, në kundërshtim me nenin 39, pika 1, nenit 41, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*".

(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 4 (katër) faqe 87 – 104 të Raportit të Auditimit).

14. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e dokumentacionit të transferimit pa pagesë të aktiveve të AMVV-së pranë 61 Njësive Vendore të cilat janë pajisje kompjuterike rezulton se për 41 bashki, praktika për marrjen në dorëzim të mallit/paisjeve elektronike (*kompiutera, printera, switch, kabllo dhe UPS*) nuk kishte të bashkangjitur fletëhyrjen e bërë nga bashkitë pavarësisht se, marrja në dorëzim e tyre është konfirmuar në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Përdorimit nga Kryetari i Bashkisë si dhe konfirmimin për marrjen në dorëzim të mallit pa pagesë, kjo sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik*" Kap III, pika 56 ku citohet "*Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe Nëpunësi Autorizues*".

Procesi i transferimit të këtyre aktiveve është i shoqëruar me urdhrat e përbashkët ndërmjet Institucionit të AMVV-së dhe Kryetarëve të Bashkive, me kontratat e përdorimit si dhe janë dokumentuar me fletë daljet përkatëse për çdo njësi vendore dhe hyrjet përkatëse të firmosur nga të dy palët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të transferimit referuar një procedure (Bashkia Mat) u evidentua se kjo procedurë shoqërohet:

1. Me kontratën e përdorimit nr.721, datë 20.10.2016 të lidhur ndërmjet Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (AZRT) përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.S. dhe Bashkisë Mat përfaqësuar nga Kryetari z. N.R., në prani edhe të përfaqësuesit të kompanisë "B...", ku qëllimi i kontratës së lidhur ndërmjet palëve të sipër përmendura është dhënia në përdorim të Bashkisë Mat të pajisjeve kompjuterike me qëllim dixhitalizimin e arkivave të Bashkisë dhe Njësive Administrative në përbërje të saj, në kuadër të zbatimit të projektit "*Shqipëria Dixhitale*", financuar nga FZHR, më kohëzgjatje të kontratës 18 muaj nga dita e dorëzimit. Kontrata është e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm të AZRT z. A.S. dhe Kryetarit të Bashkisë Mat z. N.R.
2. Nëpërmjet Urdhrit të Përbashkët me nr. prot.692, datë 09.11.2018 të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe me nr.prot.2873 datë 12.11.2018 të Bashkisë Mat, në zbatim të kontratës nr.721 është vendosur për kalim kapitali pa pagesë të pajisjeve kompjuterike (përkatësisht 16 kompjutera Dell Optilex 3020 MT, 10 fotokopje Kyocera Fs-6525 MFP, 6 fotokopje Kyocera TASK alfa 2200, 16 pajisje UPS SPS PLI650I, 8 copë switch dhe 24 copë kabëll FTP CAT5).
3. Nga ana e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është bërë dalje me fletë daljen nr.159 datë 12.11.2018 me vlerën 3,030,720 lekë të firmosur nga personi përgjegjës për magazinën zj. O.R.
4. Nga ana e Bashkisë Mat është bërë hyrje me fletë hyrjen nr.42 datë 12.11.2018 të pajisjeve kompjuterike firmosur nga personi përgjegjës i magazinës për Bashkinë Mat.

Nga verifikimi në disa Bashki rezultoi se:

a. Bashkia Kurbin me Fletë hyrjen nr. 70, dt. 06.12.2018 ka bërë hyrje pajisjet elektronike sipas Fletë Daljes së AMVV nr. 187, dt. 6.12.2018. Gjithashtu rezultoi se materialet e mësipërme janë bërë hyrje nga Bashkinë Kurbin me FH nr. 89, dt. 31.12.2016 dhe nr. 90, dt. 31.12.2016 të cilat edhe janë kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2016. Por vlerat e tyre nuk përputhen me vlerat e FH nr. 70, dt. 06.12.2018.

b. Bashkia Skrapar me Fletë hyrjen nr. 42, dt. 12.11.2018 ka bërë hyrje pajisjet elektronike sipas Fletë Daljes së AMVV nr. 217, dt. 19.12.2018. Gjithashtu rezultoi se materialet e mësipërme janë bërë hyrje nga Bashkinë Kurbin me FH nr. 54, dt. 02.11.2016 dhe nr. 53, dt. 02.11.2016. Gjithashtu nga Bashkia Skrapar është mbajtur procesverbali i datës 19.12.2018 ku saktësohet se çmimet do të jenë sipas faturave të vitit 2018 pasi çmimet nuk përputhen. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 2 (dy) faqe 47 – 49 dhe pika 4 (katër) faqe 76 – 87 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

- Nga AMVV, Sektori i Financës të merren masat për plotësimin e procedurës së kalimit të pajisje kompjuterike me dokumentacionin përkatës te fletëhyrjeve nga njësitë vendore sipas fletë daljeve të AMVV. Me plotësimin e praktikave dokumentare në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik"* dokumentacioni i plotë konfirmuar kjo nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues i Njësisë ti vihet në dispozicion Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Brenda 30.06.2020

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Komisioni i prokurimit me vlera të vogla dhe titullari AK, kanë s'kualifikuar ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedurë për vitet 2018 dhe 2019 me

argumentin se, "*Ofertat janë anomalisht të ulëta*" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "*çmimi më i ulët*" dhe kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE me oferta ekonomike më të larta se ato të s'kualifikuara, për rrjedhoje midis ofertave të shpallura fituese dhe ofertave të s'kualifikuara rezulton një diference në total për shumën **800,710** lekë pa tvsh, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", Udhëzimin e APP nr.3, datë 08.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla të zhvilluar me mjete elektronike* " pika 10, i ndryshuar:

a. Për vitin 2018:

- Në procedurën e prokurimit "*Blerje pjesë këmbimi dhe shërbim automjetesh*" komisioni ka s`kualifikuar ofertën më të ulët me vlerën 228,000 lekë pa tvsh paraqitur nga OE "Kombinat Servis", me argumentin se, "*Oferta është anomalish e ulët*" dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE "B.M." me ofertën 258,900 lekë pa tvsh me të cilin është lidhur kontrata (*Diferenca midis ofertave është 258,900 – 228,000 =* ***30,900*** *lek*ë).

- Në procedurën e prokurimit "*Blerje goma për 2 automjete*" komisioni ka skualifikuar 3 OE (*A... me ofertë 69,200 lekë pa tvsh, "P..." me ofertë 128,000 lekë pa tvsh dhe B.A. me ofertë 138,000 lekë pa tvsh*) me argumentin se "*ofertat e tyre janë anomalisht të ulëta*", dhe ka klasifikuar 4 OE të mbetur nga të cilët ka vlerësuar e shpallur fitues OE "B.M." me vlerën 179,900 lekë pa tvsh, me të cilin është bërë edhe blerja dhe shërbimi i vendosjes së gomave në të 2 automjetet e institucionit (*Diferenca midis ofertave është 179,900 – 69,200 =* ***110,700*** *lekë*).

- Në procedurën e prokurimit "*Blerje shtypshkrime*", Komisioni me proces verbalin e vlerësimit të ofertave datë 16.10.2018, ka s'kualifikuar 2 oferta ekonomike ("*E.D." me ofertë 179,000 lekë pa tvsh i renditur i pari dhe ofertën e paraqitur nga OF "O..." me ofertë 194,100 lekë pa tvsh i radhitur i dyti*) me argumentin se, "*Oferta është anomalisht e ulët*". Nga OE të vlerësuar komisioni ka kualifikuar ofertën e OE "E.R." në shumën 380,000 lekë pa tvsh pas njoftimit dhe mos paraqitjes se dy OE të renditur në OE e kualifikuar në vend të parë dhe të dytë ("*F..." për 324,000 lekë dhe "Promoprint" për 377,000 lekë pa tvsh)*. (Diferenca midis ofertave është 380,000 – 179,000 = **201,000** lekë)..

- Në procedurën për "*Shërbim mirëmbajtje kondicionerësh*", komisioni ka përshkruar vetëm procedurën e ndjekur me dy OE nga të cilët ka kualifikuar e shpallur fitues OE "C...shpk" me ofertën 79,000 lekë pa tvsh. Gjithashtu komisioni nga 18 operatorë ekonomikë pjesëmarrës ka s'kualifikuar 2 OE "S..." me ofertën **49,500** lekë dhe "D.X." me ofertën 69,000 lekë me argumentin se, "*ofertat janë oferta anomalisht të ulta*". (*Diferenca midis ofertave është 79,000 – 49,500 =* ***29,500*** *lekë*). *Komisioni i vlerësimit të ofertave: S.P., E.D., S.P.*

b. Për vitin 2019:

- Në procedurën e prokurimit "*Blerje pajisje elektronike*" komisioni ka skualifikuar ofertën më të ulët me vlerën 299,000 lekë pa tvsh paraqitur nga "D.B.", të cilin komisioni i prokurimit e ka s'kualifikuar me argumentin se, "*Oferta është anomalish e ulët*" pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE "E.R." me ofertën 500,000 lekë pa tvsh (*Diferenca midis ofertave është 500,000 – 299,000 =* ***201,000*** *lekë*). *Komisioni i vlerësimit të ofertave: N.N., E.D., S.L.*

- Në procedurën e prokurimit "*Blerje dollapë për arshivën e protokollit*" komisioni ka s'kualifikuar OE "X.S." me ofertën 90,000 lekë pa tvsh me argumentin se, është "*oferta anomalisht të ulta*", pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "*çmimi më i ulët*". (*Diferenca midis ofertave është 180,000 – 90,000 =* ***90,000*** *lekë*).

Me USH nr. 68, dt. 03.06.2019 është likuiduar vlera prej 204,000 lekë për operatorin E.K. sipas Faturës së thjeshtë tatimore nr. 11, dt. 22.05.2019 me vlerën 204,000 lekë pa tvsh dhe Fh. nr. 7, dt. 22.05.2019. me diferencë prej **24, 000** lekë nga fondi limit prej 180,000 lekë pa tvsh. Komisioni i vlerësimit të ofertave: N.N., E.D., G.X.

- Në procedurën e prokurimit "*Seminar mbi projektet e Këshillit Konsultativ*", komisioni ka s'kualifikuar "A..." me ofertën 114,390 lekë pa tvsh me argumentin se, oferta është "oferta *anomalisht të ulta*", *pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vlerësim dhe njëkohësisht pa u mbështetur në kriteret e miratuara në ftesën për ofertë "çmimi më i ulët"*. (*Diferenca midis ofertave është 190,000 – 114,390 = **75,610** lekë*).

- Me USH nr. 58, dt. 24.05.2019 është likuiduar vlera prej 228,000 lekë pa për operatorin "E.R." sipas Faturës së thjeshtë tatimore nr. 27, dt. 23.05.2019 me vlerën 228,000 lekë pa tvsh me diferencë prej **38,000** lekë nga fondi limit prej 190,000 lekë pa tvsh. *Komisioni i vlerësimit të ofertave: N.N., E.D., G.X. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 4 (katër) faqe 92 – 104 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, sektori i financës të merren masat të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit:

- Për arkëtimin e vlerës prej **371,600** lekë nga anëtarët e Komisionit të Blerjeve në Vlera të Vogla për vitin 2018; ***S.P.***, me detyrë juriste në cilësinë e kryetares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***E.D.***, me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, ***S.P.***, me detyrë jurist inspektor në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla për skualifikim të ofertave me argumentin "*Oferta anomalisht e ulët*" në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe Udhëzimin e APP nr.3, datë 08.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlera të vogla të zhvilluar me mjete elektronike*".
- Për arkëtimin e vlerës prej **299,610** lekë nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla për vitin 2019, **N.N.**, me detyrë jurist në cilësinë e kryetares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, **E.D.**, me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, **G.X.**, me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla dhe vlerës dhe **67,000** lekë nga **S.L.**, me detyrë jurist inspektor në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla për skualifikimin e operatoreve ekonomikë me argumentin e paraqitjes së, "*Ofertave anomalisht të ulët*" në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe Udhëzimin e APP nr.3, datë 08.01.2018 "*Për përdorimin e procedurës se prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluar me mjete elektronike*" i ndryshuar, pikat 10, 14 dhe 17.
- Për arkëtimin e vlerës prej **24,000** lekë nga operatori **E.K.** dhe vlerës prej **38,000** lekë nga operatori **E.R.** sa përfituar më tepër nga vlera e ofertës.

  Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, të analizojë shkeljet e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlerë të vogël, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjësi dhe të marrë masë për eliminimin e mangësive në të ardhmen.

Menjëherë

C. SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUNDËRSHTIM ME KËRKESAT LIGJORE TË PROKURIMIT DHE EFEKTE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E FONDEVE ME EFEKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET (3E).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve nëpërmjet Bankës (Urdhër shpenzimeve) u konstatua se:

a. Në 5 raste për periudhën e vitit 2017 *pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik*, janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje*" në vlerën **2,282,570** lekë, ku në urdhrin janë

përcaktuar vetëm numri i personelit të AMVV *pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë*, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja"* të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.06.1999. Vlera e mësipërme do të konsiderohet përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në.

b. Në 4 raste për periudhën e vitit 2018 *pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik*, janë kryer shpenzime për Seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "*Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje*" në vlerën **1,055,500** lekë, ku në urdhrin janë përcaktuar vetëm numri i personelit të AMVV *pa u përcaktuar dhe miratuar lista emërore e personelit që ka marrë pjesë*, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja"* të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.06.1999. Vlera e mësipërme do të konsiderohet përdorim i fondeve pa efektivitet për AMVV-në.

Rekomandojmë:

- Titullari i Autoritetit Kontraktor, të analizojë dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e shkeljeve të cilësuara më lart, me pasojë efekte financiare negative, në buxhetin e AMVV-në, i cili në rastin konkret rezulton në vlerën **3,338,070** lekë.

Menjëherë

"*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi*"

GRUPI I AUDITIMIT
B.Z.,
N.N.,
M.H.,
A.H.,
D.K.,
D.Z.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT